



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare” (KESH SHA)

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

**Korporata Elektroenergjitike Shqiptare
(KESH) SHA**

“Auditim i Përputhshmërisë”

Shkurt 2024

PËRMBAJTJA:

Nr.	Përmbajtja	FAQE
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1.	Përshkrim i shkurtër i objektit të auditimit.....	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	5
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit.....	7
II	HYRJA	10
1	Objekti i auditimit..... i	10
2	Qëllimi i auditimit.....	10
3	Identifikimi i çështjes.....	10
4	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	11
5	Përgjegjësitë e audituesve.....	11
6	Kriteret e vlerësimit.....	11
7	Standardet e auditimit..... e	11
8	Metoda e auditimit.....	12
9	Dokumentimi i auditimit..... i	13
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.	14-117
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.	14-14
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.	14-14
2.1	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së.	14-15
2.2	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të shoqërisë.	16-29
2.3	Mbi zbatimin e Strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi	30-34
2.4	Auditimi me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlerë të vogla (Shpenzimet administrative për automjetet udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj.).	35-44
2.5	Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave	45-85
2.6	Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale.	86-87
2.7	Mbi zbatimin e rregullave dhe procedurave të shitblerjes të energjisë elektrike.	88-99
2.8	Auditimi i organizimit dhe mbajtja e evidencës kontabël, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e pasqyrave financiare nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi i miratimi i tij në institucionet eprorë. analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit. Inventarizimi fizik i pasurisë, zbatimi i afateve, cilësia e inventarizimeve, si dhe mbyllja e sistemimi i rezultateve në pasqyrat financiare vjetore.	100-111
2.9	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.	112-112
2.10	Trajtim ankese	113-116
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET.....	117-138
V.	ANEKSE.....	139-169

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Raporti i Auditimit.

Në mënyrë të përmbledhur është konstatuar si më poshtë:

1. Dëm ekonomik në shumën **21,980,573 lekë**, si më poshtë:

- Sipas kontratës “Punime për mbrojtjen e shpatullës së djathtë mes veprës së marrjes dhe kreshtës së digës në HEC Koman, platforma mbrojtëse nuk është realizuar sipas specifikimeve të kërkuara dhe nga dokumentacioni i paraqitur nuk mund të vlerësohet vlera e detajeve të pa realizuara, e kështu vlera e saj prej 20,000,000 lekë pa TVSH konsiderohet dëm ekonomik.

- Sipas procedurës “Mbrojtja e kullave të ekuilibrit nga çarja e shkëmbinjve mbi to dhe sistemimi i rrëshqitjes së koluvioneve mbi rrugën e digës HEC Koman”, pajisjet janë përlogaritur me TVSH, duke krijuar një gabim në llogaritje me vlerë 1,071,302 lekë.

- Në tre kontrata janë konstatuar mangësi në lidhje me raportimin e punimeve, shoqëruar me dëm ekonomik me vlerë 909,271 lekë.

2. Shpenzime pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, me vlerë **609,795,428 lekë**, si më poshtë:

- KESH SHA ka shkëmbyer energji elektrike me Kompaninë “N” SHPK, sipas marrëveshjes së nënshkruar me nr. 2350/1 ptot., datë 04.05.2021. Deri me datë 31.12.2022, gjendja e shkëmbimit të energjisë elektrike paraqitet në dhënie sasia 149442 MWh, ndërsa në marrje sasia 132002 MWh, me një diferencë në shumën 17440 MWh. Për vitin 2022, nga Shoqëria “N”, është marrë sasia 2546 MWh, nga e cila sasia 2398 MWh është marrë me datë 01.04.2022. Brenda kësaj dite, sasia më e madhe e energjisë në shumën 2278 MWh, është marrë në periudhë jo piku, ku çmimi i energjisë në bursë është shumë i ulët.

Bazuar në të dhënat në dispozicion, KESH SHA për vitin 2022, ka blerë energji elektrike në sasinë 1,460,437 MWh, me çmim mesatar nga 209.6 Euro/MWh deri në 482.2 Euro/MWh. Diferenca në sasinë 17440 MWh, duhet të merrej gjatë kësaj periudhe ku çmimi në bursë rezulton i lartë. Referuar bursës HUPX për vitin 2022, për të njëjtin profil, çmimi mesatar i tregtimit të energjisë elektrike ishte 271.6 Euro/MWh.

Referuar çmimit mesatar të blerjes së energjisë elektrike dhe çmimit të bursës për vitin 2022 (për profile të ngjashme), si pasojë e mos marrjes së energjisë elektrike të rezervuar pranë Kompanisë “N” SHPK për këtë vit, KESH SHA rezulton me humbje me vlerë **2,774,536 Euro** $[(271.6 \text{ MWh} - 115.2 \text{ MWh}) \times 17740 \text{ MWh}]$, vlerë e cila konsiderohet efekt financiar.

- Gjatë auditimit të pagesave të kryera me bankë, për periudhën objekt kontrolli të auditimit, KESH ka bërë pagesa për shërbime riparimi të automjeteve të shoqërisë ndaj Operatorit Ekonomik, “A” sh.p.k. Në procesin e dokumentimit të shpenzimeve për riparime automjesh u konstatuan parregullsi që kanë lidhje me dokumentet justifikues të marrjes në dorëzim si proces verbalët e firmosura nga komisioni, certifikatat për origjinalitetin dhe cilësinë e pjesëve që ishin ndërruar si dhe proces verbalët për hyrjet në magazinën rekupero të pjesëve të vjetra të ndërruara.

Në kreun V, Të tjera, të udhëzimit, pika 122, në Gjurmët Standarde të Auditit, germa c, Gjurma për marrjen në dorëzim të aktiveve, përcakton se titullari i shoqërisë urdhëron ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të aktiveve, i cili kryen verifikimin fizik të sasisë, çmimit, si dhe verifikon përputhshmërinë me specifikimet e dakordësuara më parë.

Deri më datë 31.12.2022, shoqëria “A” sh.p.k., i ka faturuar KESH sh.a., vlerën 156,544,680 lekë për riparime dhe shërbime të automjeteve. **Vlera 156,544,680 lekë** përbën shpenzime pa ekonomikitet për KESH sh.a.

- Nga auditimi i dokumentacionit të listë pagesave për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022 rezultoi se dieta për trajtim ushqimor është paguar në masën 500 lekë vakt/ditë pune, ndërkohë që duhet të paguhej 300 lekë/ditë. Nga llogaritja e listëpagesave të periudhës 01.01.2021 - 31.12.2022 rezulton se ky përfitim është në masën 170,018,888 lekë, nga 102,011,333 lekë që duhej të ishte pra është paguar më tepër shuma prej **68,007,555 lekë e cila konsiderohet shpenzim pa efektivitet** për buxhetin e shoqërisë.

- Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të KESH SHA nr. 6 prot, datë 26.02.2021 “Për dhënien e shpërblimit për disa punonjës të KESH SHA, pas periudhës të gatishmërisë dhjetor 2020 – shkurt 2021”, është miratuar dhënia e shpërblimit në masën 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për disa punonjës të KESH SHA. Duke qenë se shoqëria nuk ka një analizë të realizimit të objektivave, vlera **3,300,000 lekë**, e akorduar për këtë shpërblim, konsiderohet **shpenzim pa efektivitet** për buxhetin e shoqërisë.

-Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të KESH SHA nr. 6295 prot, datë 29.12.2021 “Për dhënien e një shpërblimi të veçantë mbi pagë në fund të vitit për punonjësit e KESH SHA”, janë dhënë shpërblime me vlerën 61,402 mijë lekë.

Duke qenë se shoqëria nuk ka një analizë të realizimit të objektivave, vlera **61,402,000 lekë** konsiderohet **shpenzim pa efektivitet** për buxhetin e shoqërisë.

-Me vendimin nr. 13, datë 01.07.2021, të Këshillit Mbikëqyrës, është vendosur për miratimin e krijimit të fondit të pensionit profesional për punonjësit e KESH sh.a.

Për vitin 2021 janë transferuar 5,780,802 lekë dhe për vitin 2022 janë transferuar 15,378,310 lekë për këtë fond.

Aprovimi i këtij fondi që është një formë shpërblimi për punonjësit rezulton në kundërshtim me Ligjin nr.10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6.

Vlera 5,780,802 lekë për periudhën 2021 dhe **vlera 15,378,310 lekë** përbëjnë shpenzime pa efektivitet.

- Nga auditimi konstatohet se lidhur me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 81 çështje gjyqësore në apel, nga ku janë humbur 3 çështje gjyqësore në Gjykatat e Shkallës të Lartë dhe në Gjykatat e Apelit, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën 2,375,484 lekë si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore. Për periudhën objekt auditimi, janë në proces gjykimi 7 çështje gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, në vlerën 1,810,437 lekë si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore. Në total, vlera **4,185,921 lekë**, **shpenzim pa efektivitet** për buxhetin e shoqërisë.

- Sipas kontratës “Ndërrhyrje për mirëmbajtjen e sistemeve të CO₂ në HEC Fierzë dhe HEC Koman”, është përdorur fondi rezervë, ndërkohë që kemi të bëjmë me kontratë me çelësa në dorë. Vlera e fondit rezervë në shumën **2,750,000 lekë** konsiderohet si shpenzim pa efektivitet, pasi procesi i komandimit mund të realizohej edhe me 4 panele siç ishte parashikuar. Nuk ka një analizë sipas të cilës të identifikohet nevoja e shpenzimit për vendosjen e paneleve, apo trajnimi i punonjësve që angazhohen në procesin e komandimit në raste të rënies së zjarrit.

- Për përlllogaritjen e fondit limit sipas kontratës “Rinovim i sistemit të mbrojtjes për dy agregatë me vendosje konfigurim të releve të reja që zëvendësojnë ato ekzistuese REG, RET në HEC Fierzë”, është aplikuar studimi i tregut duke i'u dërguar kërkesë për ofertë 3 OE që operojnë në këtë fushë. Fondi limit është përcaktuar me vlerën më të ulët të ofruar në shumën

75,000,000 lekë. Në ofertat e paraqitura nga studimi i tregut, konstatohet se OE kanë paraqitur vlerë shumë të lartë për zërin “Trajnim i plotë 3 ditor për konfigurimin e releve të reja, back-up e fileve dhe testet, sipas specifikimeve”, konkretisht 8,200,000 lekë, 7,840,000 lekë dhe 7,840,000 lekë. Nga ana e komisionit nuk është marrë në konsideratë kontrata e ngjashme e realizuar në vitin 2020 “Rinovim i sistemit të mbrojtjes për dy agregate me vendosje/konfigurim të releve të reja që zëvendësojnë ato ekzistueset REG/RET, në Vaun e Dejës”.

Duke marrë në konsideratë vlerën e ofertës së paraqitur në shumën 73,500,000 lekë, diferenca me **vlerë 1,120,000 lekë**, konsiderohet pa ekonomicitet për buxhetin e shoqërisë.

2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

Nga auditimi janë konstatuar mangësi të cilat, në mënyrë të përmbledhur paraqiten si më poshtë:

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me Raportin Përf. të auditimit.	Rëndësia	Rekomandimi
1	KESH SHA ka shkëbyer energji elektrike me Kompaninë “N” SHPK, sipas marrëveshjes së nënshkruar me nr. 2350/1 ptot., datë 04.05.2021. Deri me datë 31.12.2022, gjendja e shkëmbimit të energjisë elektrike paraqitet në dhënie sasia 149442 MWh, ndërsa në marrje sasia 132002 MWh, me një diferencë në shumën 17440 MWh. Për vitin 2022, nga Shoqëria “N”, është marrë sasia 2546 MWh, nga e cila sasia 2398 MWh është marrë me datë 01.04.2022. Brenda kësaj dite, sasia më e madhe e energjisë në shumën 2278 MWh, është marrë në periudhë jo piku, ku çmimi i energjisë në bursë është shumë i ulët. Bazuar në të dhënat në dispozicion, KESH SHA për vitin 2022, ka blerë energji elektrike në sasinë 1,460,437 MWh, me çmim mesatar nga 209.6 Euro/MWh deri në 482.2 Euro/MWh. Diferenca në sasinë 17440 MWh, duhet të merrej gjatë kësaj periudhe ku çmimi në bursë rezulton i lartë. Referuar bursës HUPX për vitin 2022, për të njëjtin profil, çmimi mesatar i tregtimit të energjisë elektrike ishte 271.6 Euro/MWh. Referuar çmimit mesatar të blerjes së energjisë elektrike dhe çmimit të bursës për vitin 2022 (për profile të ngjashme), si pasojë e mos marrjes së energjisë elektrike të rezervuar pranë Kompanisë “N” SHPK për këtë vit, KESH SHA rezulton me humbje me vlerë 2,774,536 Euro $[(271.6 MWh - 115.2 MWh) \times 17740 MWh]$, vlerë e cila konsiderohet efekt negativ financiar. Nga ana e KESH SHA duhet të merreshin masa për tërheqjen e energjisë elektrike në periudhën kur çmimi në bursa është i lartë, për të shmangur shpenzimet e larta për blerje të saj.	Pika 7	E lartë	KESH SHA, për kontrata shkëmbi të energjisë elektrike në të ardhmen, të marrë masa për përcaktimin e detajuar të shkëmbimit, duke vendosur marrjen dhe dhënien në profile të njëjta dhe në fasha orare të njëjta. Për të mbrojtur interesat e ndërsjella, në këto kontrata duhet përcaktuar edhe referenca e çmimit në bursa, në mënyrë që ndikimi i luhatjes së çmimit mos të ketë ndikim negativ, referuar periudhave në të cilat realizohet shkëmbimi.
2	Gjatë auditimit të pagesave të kryera me bankë, për periudhën objekt kontrolli të auditimit, KESH ka bërë pagesa për shërbime riparimi të automjeteve të shoqërisë ndaj Operatorit Ekonomik, “A” sh.p.k. Në procesin e dokumentimit të shpenzimeve për riparime automjeteve u konstatuan parregullsi. Në procedurat e pagesave mungonin dokumentet justifikues të marrjes në dorëzim si proces verbalet e firmosura nga komisioni, certifikatat për origjinalitetin dhe cilësinë e pjesëve që ishin ndërruar si dhe proces verbalet për hyrjet në magazinën rekupero të pjesëve të vjetra të ndërruara.	Pika 4	E lartë	Administratori i shoqërisë KESH sh.a., nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të zbatimit të kontratave për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike, në vlerën 156,544,680 lekë,

	Nga auditimi i situacioneve të paraqitura për pagesat e riparimeve u konstatua se riparimet në pjesët e zëvendësuara që kalojnë vlerën e 10,000 lek, dhe me jetëgjatësi më të madhe se një vit, janë klasifikuar si shpenzime të periudhës dhe jo si aktive afatgjata, në kundërshtim me pikën 29 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik" nuk janë trajtuar sipas udhëzimit sa më sipër. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.			e cila përbën shpenzim pa efektivitet. Administratori i shoqërisë të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësi administrative, si për hartimin e procedurave dhe kontroleve që verifikojnë shpenzimet e kryera për automjete.
3	Nga auditimi i dokumentacionit të listë pagesave për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022 rezultoi se; me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. Nr. 68, datë 7.02.2018 "Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore", pika 2, germa a), kjo dietë është caktuar deri në masën 300 lekë në vakt/ditë pune. Nga ana e Administratorit të Shoqërisë, Drejtorisë Juridike, Drejtorisë së Burimeve njerëzore nuk janë marrë masat për reflektimin e ndryshimeve ligjore për caktimin e dietës ushqimorë në përputhje me legjislacionin e sipërpërmendur, dhe paga në natyrë (dieta) për trajtim ushqimor është paguar në masën 500 lekë vakt/ditë pune. Ky fenomen është konstatuar edhe nga auditimet e mëparshme të KLSH për të cilin janë dhënë rekomandimet përkatëse të cilat përsëri konstatohet se nuk janë bërë reflektimet e duhura për përditësimin e legjislacionit dhe ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive. Nga llogaritja e listëpagesave të periudhës 01.01.2021 - 31.12.2022 rezulton se ky përfitim është në masën 170,018,888 lekë, nga 102,011,333 lekë që duhej të ishte pra është paguar më tepër shuma prej 68,007,555 lekë e cila konsiderohet shpenzim pa efektivitet për buxhetin e shoqërisë. Sa më sipër bie në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. Nr. 68, datë 7.2.2018 "Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore", pika 2, germa a).	Pika 3	E lartë	Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të marrin masat e duhura, për azhurnimin e legjislacionit, dhe të ndiqen procedurat administrative për personat përgjegjës, bazuar në Kodin e Punës dhe Rregulloren e brendshme të Shoqërisë. Administratori i Shoqërisë, Departamenti Ligjor të marrin masat e duhura dhe të kryejnë ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive, duke nxjerrë aktet përkatës për mos vazhdimin e dietës ushqimore më tepër nga përcaktimet ligjore.
4.	Me vendimin nr. 13, datë 01.07.2021, të Këshillit Mbikëqyrës, është vendosur për miratimin e krijimit të fondit të pensionit profesional për punonjësit e KESH sh.a. Për vitin 2021 janë transferuar 5,780,802 lekë dhe për vitin 2022 janë transferuar 15,378,310 lekë për këtë fond. Aprovimi i këtij fondi që është një formë shpërblimi për punonjësit rezulton në kundërshtim me Ligjin nr.10405, datë 24.03.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", neni 6. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr.10405, datë 24.03.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", neni 6 "Kompetencat e organeve kolegjiale", pika 1/a. Vlera 5,780,802 lekë për periudhën 2021 dhe vlera 15,378,310 lekë përbëjnë shpenzim pa efektivitet për shoqërinë.	Pika 3	E mesme	Organet drejtuese të KESH sh.a. të analizojnë vlerën 21,159,112 lekë, e cila përbën shpenzim pa efektivitet dhe në të ardhmen nga shoqëria të akordohet dhënia e shpërblimeve me miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës.
5	Nga auditimi konstatohet se lidhur me proceset gjyqësorë në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 81 çështje gjyqësorë në apel, nga ku janë humbur 3 çështje gjyqësorë në Gjykatat e Shkallës të Lartë	Pika 3	E lartë	Nga Administratori, Departamenti Juridik dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore të shoqërisë të merren masa për ndjekjen

	dhe në Gjykatat e Apelit, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën 2,375,484 lekë si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbartimore. Për periudhën objekt auditimi, janë në proces gjykimi 7 çështje gjyqësorë në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, në vlerën 1,810,437 lekë si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbartimore. Në total, vlera 4,185,921 lekë , konsiderohet shpenzim pa ekonomikitet për buxhetin e shoqërisë.			me përgjegjësi të procedurave të shkëputjes të marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.
	Në kontratën “Punime për mbrojtjen e shpatullës së djathtë mes veprës së marrjes dhe kreshtës së digës në HEC Koman” të lidhur midis Autoritetit Kontraktor KESH dhe Operatorit Ekonomik “S” sh.p.kme Nr.4100/8Prot. datë 17.03.2021 në projekt-preventiv është parashikuar një platformë e cila do të bëjë të mundur pritjen e materialeve duke shmangur mbushjen e basenit gjatë kryerjes së punimeve të kësaj kontrate dhe në të ardhmen. Nga verifikimi në terren, nga vëzhgimi me sy të lirë konstatohet se në një pjesë të saj kjo platformë nuk është e mbuluar me binarët e drutit. Gjithashtu platforma nuk është e ankoruar në afërsi të skarpatit për të kryer funksionin e saj pas përfundimit të projektit. Nisur nga fakti që platforma nuk është realizuar sipas specifikimeve të kërkuara dhe nga dokumentacioni i paraqitur nuk mund të vlerësohet vlera e detajeve të pa realizuara, e kështu vlera e saj prej 20,000,000 lekë pa TVSH konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe të shoqërisë deri në këtë fazë të auditimit.	Pika 5	E Lartë	KESH në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marri masa, për plotësimin e platformës pluskuese me pjesët përbërëse sipas projektit, konkretisht binarët e drutit. Në rast se plotësimi i saj nuk realizohet vlera prej 20,000,000 lekë pa TVSH të konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe të arkëtohet, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, nga OE “S” sh.p.k sipas kontratës së lidhur me Nr.4100/8Prot. datë 17.03.2021për realizimin e punimeve civile.
	Fondi limit sipas procedurës “Mbrojtja e kullave të ekuilibrit nga çarja e shkëmbinjve mbi to dhe sistemimi i rrëshqitjes së koluvioneve mbi rrugën e digës HEC Koman”, është përllogaritur me vlerë 369,639,401 lekë. Për përllogaritjen e fondit limit, janë aplikuar ku ka qenë e mundur çmimet e manualeve, për zëra të tjerë është aplikuar studimi i tregut. Nga verifikimi çmimit të ofertës së paraqitur nga BOE “S & S” SHPK, rezulton se pajisjet me vlerë 5,356,510 lekë, megjithëse zë i ndarë, janë përfshirë në përllogaritjen e vlerës së kontratës me TVSH. Vlera e kontratës me TVSH është përcaktuar në shumën 395,748,714 lekë, ndërkohë që duhet të llogaritej me vlerë 394,677,412 lekë. Vlera e TVSH e përcaktuar më tepër është me vlerë 1,071,302 lekë. Preventivi i përfshirë në tender është përcaktuar me këtë strukturë, e cila është ndjekur nga ana e ofertuesve. Bazuar në Situacionin Përfundimtar të Punimeve, vlera e TVSH likuiduar kontraktorit është 65,958,119 lekë, ndërkohë që duhet të ishte 64,886,817 Lekë. Vlera 1,071,302 lekë (65,958,119 lekë - 64,886,817 lekë), konsiderohet si shpenzim i pa justifikuar, për të cilin kërkohen rregullimet përkatëse, para pagesë së garancisë së objektit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika A “Shpenzimet për materialet”.	Pika 5	E lartë	KESH SHA të marrë masa për rillogaritjen e vlerës së TVSH dhe zbritjen e vlerës 1,071,302 lekë , për kontratën “Mbrojtja e kullave të ekuilibrit nga çarja e shkëmbinjve mbi to dhe sistemimi i rrëshqitjes së koluvioneve mbi rrugën e digës HEC Koman”, përllogaritur më tepër, si pasojë e mos klasifikimit të pajisjeve pa TVSH.

3. Konkluzioni i përegjithshëm dhe opinionin i auditimit.

Nga auditimi i kryer pranë KESH SHA, për periudhën 01.01.2021 deri datë 31.12.2022, lidhur me përputhshmërinë, rezultuan mangësi kryesisht me shkëmbimin e energjisë elektrike, pagesa për shërbimin e riparimit të automjeteve, pagesa për kuotë ushqimore dhe shpërblime, largime nga puna pa shkaqe të përligjura etj., me efekt negativ financiar me vlerë 609,795,428 lekë. U konstatuan mangësi në realizimin e procedurave të prokurimit kryesisht kriteret e veçanta të dokumenteve të tenderit, si dhe në drejtim të zbatimit të kontratave të punimeve civile dhe mallra me vlerë të dëmit ekonomik 21,980,573 lekë.

A. OPINIONI I AUDITIMIT.

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Korporata Elektroenergjitike Shqiptare KESH sh.a për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2022, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti të ligjeve, vendimeve rregullave dhe rregulloreve, udhëzimeve politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, nëpërmjet: a) auditimit të sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret; b) auditimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik; c) auditimit të integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar, d) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t'u bërë publike.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e subjektit KESH sh.a janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionin të kualifikuar”, e shprehur kjo në bazën për opinion.

Baza për opinionin e kualifikuar:

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI 100; ISSAI 400-499; ISSAI 4000-4899). Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e këtij opinionin. Nga evidencat e marra për veprimtarinë e KESH sh.a rezultuan:

- Mangësi në procedurat e shkëmbimit të energjisë elektrike shoqëruar me efekt negativ financiar me vlerë 2.774.536Euro.
- Mangësi në lidhje me procesin e realizimit të shërbimit të automjeteve shpenzime pa ekonomikitet me vlerë 156,544,680 lekë.
- Mangësi në pagesa për trajtim ushqimor shoqëruar me shpenzime pa efektivitet me vlerë 68,007,555 lekë.
- Mangësi në zërin shpërblime shoqëruar me shpenzime pa efektivitet me vlerë 64,702,000 lekë.
- Mangësi në lidhje me krijimin e fondit për pension profesional, me efekt negativ financiar me vlerë 21,159,112 lekë.
- Proceste gjyqësore të humbura për largime nga puna pa shkaqe të përligjura shpenzime pa efektivitet me vlerë 4,185,921 lekë.

- Mangësi në përlllogaritjen e fondit limit në procedurat e prokurimit shoqëruar me shpenzime pa ekonomikitet me vlerë 3,870,00 lekë si dhe mangësi në zbatimin e kontratave shoqëruar me dëm ekonomik me vlerë 21,980,573 lekë.
- Mangësi në mbajtjen e evidencës kontabël dhe auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë, si dhe mangësi në administrimin e aseteve.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të KESH SHA:

Strukturat drejtuese të KESH sh.a, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Gjithashtu, është përgjegjësi e drejtuesve të njësisë publike të përgjigjen dhe të jenë transparente për veprimtarinë e tyre, si edhe të sigurojnë se i administrojnë këto fonde në pajtim me kriteret ligjore e rregullatore. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara ligjore, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të programit të auditimit nr. 407/1, datë 05.06.2023 “Mbi auditimin e përputhshmërisë në KESH SHA” (me ndryshime), miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 06.06.2023 deri në 17.11.2023 ushtroi auditim “Mbi përputhshmërisë”, në subjektin “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare” (KESH SHA), për periudhën nga 01.01.2021 – 31.12.2022, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A. T (përgjegjës grupi),
2. B. Sh, anëtar,
3. S. H, anëtar,
4. I. B, anëtar
5. A. R, anëtar,
6. J. M, anëtar.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi veprimtarinë e “Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare” SHA (këtu e në vazhdim KESH SHA), duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore, në procedurat e shitblerjes të energjisë elektrike, veprimet më bankë, emërimet dhe funksionin e strukturave drejtuese vendimet e mara dhe zbatimi i tyre, dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale, procedurat e prokurimeve publike dhe zbatimi i kontratave.

Auditimi u krye me zgjedhje për periudhën 01.01.2021, deri 31.12.2022, bazuar të dhënave të marra në subjekt, botimet në mediat e shkruara, ndjeshmërinë publike dhe të grupeve të interesit, riskun, u identifikuan fushat e auditimit.

1. Objekti i auditimit: Raport mbi auditimin e “Përputhshmërisë” në Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2022.

2. Qëllimi i auditimit: Ky auditim ka për qëllim kryerjen e auditimit të përputhshmërisë (pajtuueshmërisë) me qëllim vlerësimin e përgjithshëm të përputhshmërisë së aktivitetet të parashikuara në programin e auditimit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Çështjet e trajtuara në këtë raport, lidhen me zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore, në procedurat e shitblerjes të energjisë elektrike, emërimet dhe funksionin e strukturave drejtuese vendimet e mara dhe zbatimi i tyre, dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale, procedurat e prokurimeve publike dhe zbatimi i kontratave, realizimi i shpenzimeve, organizimi dhe mbajtja e evidencës kontabile etj.

Auditimi duke qenë pjesë jetike e një sistemi rregullator, ka për qëllim të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndosh financiar si edhe shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

Auditimi ka për objektiv dhënien e një vlerësimi profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord. Nëse shpenzimet kanë qenë në përputhje me ligjin, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik.

3. Identifikimi i çështjes: “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH)” SHA është një shoqëri me kapital 100% shtetëror, e cila vepron në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, që ka për mision të prodhojë energjinë e së nesërme, të sigurtë, me inteligjencë dhe me ndikime minimale në mjedis nëpërmjet rritjes së kompetencës së punonjësve dhe besimit të tyre për të qenë pjesë e shoqërisë, orientimit drejt komercializimit të shoqërisë, shërbimit me përkushtim ndaj shfrytëzimit racional dhe mirëmbajtjen efektive të Aseteve prodhuese. Gjithashtu Shoqëria KESH SHA synon të ruajë dhe konsolidojë pozitën në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike në Shqipëri duke u përshtatur me ndryshimet në mjedisin e biznesit, teknologjinë, mundësive për financim dhe ruajtjen e mjedisit. Synimi i përgjithshëm i KESH përqendrohet në rritjen e performancës, zhvillimin e kapaciteteve dhe krijimin e kulturës së përmirësimit të vazhdueshëm.

Aktivitetet e vlerësuara nga ana e grupit të auditimit, janë realizuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit nr. 407/1, datë 05.06.2023 “Mbi auditimin e Përputhshmërisë” (me ndryshime) në KESH SHA për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Drejtimi i KESH SHA është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara.

Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

5. Përgjegjësia e Audituesve: Audituesit e KLSH janë përgjegjëspërdhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj; shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e opinionit, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

6. Kriteret e vlerësimit: Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë e dytësor, në dispozita të tjera si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit:

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, (me ndryshime); Ligji 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; Vendimin e KM nr. 244, datë 30.3.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik”; Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, (me ndryshime); Ligji nr. 25/2018 datë 10.5.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, (me ndryshime); Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, (me ndryshime); Ligji nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, (me ndryshime); Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, (me ndryshime); Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për Sponsorizime”, (me ndryshime); Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (me ndryshime); Ligji nr. 9154, datë 26.11.2003 “Për arkivat”; Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar; Ligji nr. 9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, (me ndryshime); Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për

menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, (me ndryshime); Ligji nr. 8510, datë 15.7.1999 *“Për përgjegjësinë jashtë kontraktore të organeve të administratës shtetërore”* (me ndryshime); Ligji nr. 44/2015 datë 30.4.2015 *“Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”*; Ligji nr. 107/2014 *“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”* (me ndryshime); VKM nr. 338, datë 19.3.2008 *“Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”* (me ndryshime); VKM nr. 914 datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, ndryshuar me VKM nr. 285, datë 19.05.2021; VKM nr. 870, datë 14.12.2011 *“Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”*; VKM nr. 997, datë 10.12.2010 *“Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”*, (me ndryshime); VKM nr. 642, datë 11.10.2005 *“Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”*, (me ndryshime); Udhëzimi i MZHETS nr. 394, datë 21.8.2014 *“Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”*; Udhëzimi i Ministrisë së Ekonomisë nr. 318, datë 8.4.2009 *“Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”*; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, (me ndryshime); Akti i themelimit; Statuti dhe rregullorja e brendshme e shoqërisë; etj.*

7.Standardet e Auditimit:

Auditimi bazohet në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, Manualin e Auditimit Përputhshmërisë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 66, datë 23.6.2020, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.6.2020, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

- ISSAI 100 *(Parimet themelore të auditimit të sektorit publik)* që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 400 *(Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë)* që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 *“Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”*;
- INTOSAI GOV 9100 *“Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”*; INTOSAI GOV 9110 *“Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”*.

8.Metodat e auditimit:

Për arritjen e objektivave, metoda e auditimit u bazua tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në kryerjen e auditimit janë përdorur metoda e bazuar në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, metoda e bazuar në procedurat bazë dhe në procedurat analitike. Pas testimit të kryer, për të kuptuar sesi funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm dhe pas marrjes së informacionit në mënyre të përgjithshme, në ushtrimin e auditimit për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar u bënë teste lidhur me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm morëm dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ja nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve.

Po kështu nga ana jonë u përshkrua legjislacioni autorizues, rregullat e vendosura sipas legjislacionit autorizues, caktimi i përgjegjësisë dhe autoritetit, etj.

9.Dokumentimi i rezultateve të auditimit: Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit Përputhshmërisë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 66, datë 23.6.2020, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.6.2020, si edhe në Standardet

Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Teknikat e kontrollit të përdorura gjatë auditimit janë; *kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi.*

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, rezultateve të akt konstatimeve dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

“Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH)” SHA është një shoqëri me kapital 100% shtetëror, e cila vepron në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, që ka për mision të prodhojë energjinë e së nesërme, të sigurtë, me inteligjencë dhe me ndikime minimale në mjedis nëpërmjet rritjes së kompetencës së punonjësve dhe besimit të tyre për të qenë pjesë e shoqërisë, orientimit drejt komercializimit të shoqërisë, shërbimit me përkushtim ndaj shfrytëzimit racional dhe mirëmbajtjen efektive të Aseteve prodhuese. Gjithashtu shoqëria KESH sh.a synon të ruajë dhe konsolidojë pozitën në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike në Shqipëri duke u përshtatur me ndryshimet në mjedisin e biznesit, teknologjinë, mundësive për financim dhe ruajtjen e mjedisit. Synimi i përgjithshëm i KESH përqendrohet në rritjen e performancës, zhvillimin e kapaciteteve dhe krijimin e kulturës së përmirësimit të vazhdueshëm.

2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

Në mënyrë të detajuar, gjatë këtij auditimi rezulton si më poshtë:

III.2.1. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së.

Nga auditimi u konstatua se:

- 1. Titulli i gjetjes:** KESH sha nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm nga KLSH.
- Situata:** Administratori i KESH sha nuk ka dërguar informacion (Planin e Masave) mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së, brenda afatit 20 ditor.
- Në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, nga KESH sha nuk është raportuar me shkrim për zbatimin e rekomandimeve të lëna, brenda 6 muajve nga dërgimi i shkresës së KLSH-së.
- KESH sha nuk i ka trajtuar me korrektësi rekomandimet e lëna nga auditimi i KLSH dhe në lidhje me to ka zbatuar si më poshtë vijon:
- Janë rekomanduar 20 masa organizative, nga të cilat nuk janë zbatuar 9 masa, janë në proces realizimi 3 masa dhe 8 masa janë zbatuar.
 - Janë rekomanduar 9 masa për shpërblim dëmi, në vlerën 63,223,634 lekë, nga të cilat 8 masa janë në proces zbatimi dhe 1 masa nuk është zbatuar.
 - Janë rekomanduar 14 masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, nga të cilat janë në proces realizimi 10 masa, 2 masa janë zbatuar dhe 2 masa nuk janë zbatuar.
 - Janë rekomanduar 4 masa të ardhura të munguara, 4 masa janë në proces realizimi.
- Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:*
- KESH sha nuk i ka trajtuar me korrektësi rekomandimet e lëna nga auditimi i KLSH.
- Kriteri:** Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe

funksionimin e KLSH”, neni 15 germa “j”, neni 30, pika 2, ku përcaktohet se:

- *Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rastit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës;*

- *Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.*

Ndikim/Efekti: Në arritjen e objektivave dhe politikave të KESH sha.

Shkaku KESH sha nuk kanë vlerësuar zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi.

Rëndësia: I Lartë.

1.1.Rekomandimi: KESH sha, të marri masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara.

Në mënyrë të detajuar, zbatimi i rekomandimeve paraqitet në aneksin nr. 3.

II.2.2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të shoqërisë.

Nga auditimi konstatohet që:

- 1. Titulli i gjetjes:** Procesi i hartimit të programit ekonomik financiar jo në përputhje me VKM-të përkatëse.
- Situata:** Nga auditimi konstatohet se Urdhri i administratorit për iniciimin e procesit të parashikimit dhe përlogaritjeve të shpenzimeve, të ardhurave e investimeve. u është drejtuar departamenteve pa cilësuar personat përgjegjës për kryerjen e detyrave .
-Komunikimi ndërmjet punonjësve që kanë dërguar informacionin në Divizionin e Programimit dhe Menaxhimit Strategjik, është mbajtur në formë elektronike, dhe jo në formë shkresore.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se kërkesat nga drejtoritë përkatëse *nuk argumentonin me raportime, shpjegime, arsyet dhe llogaritje të kontrollueshme shpenzimet e kërkuara, si dhe duke mos plotësuar elementët e dokumentit financiar dhe të tjera elementë që i japin dokumentit vlerën administrative.*
Rritjet e elementëve të kostos nuk janë justifikuar me relacionet përkatëse, ku të sqaroheshin arsyet, rritja e numrit, e strukturës etj.
Ky veprim është në kundërshtim me pikën 26 e nenit 4, neni 16 dhe neni 23 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe Udhëzimi i MZHETS nr. 15, datë 2.5.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”.
- Kriteri:** Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26.e, neni 16 dhe 23, si dhe Udhëzimi i MZHETS nr. 15, datë 2.5.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”.
- Ndikimi:** Programi ekonomik është i rëndësishëm për pasqyrimin e performancës ekonomike të shoqërisë si dhe për situatën e investimeve të realizuara.
- Shkaku** Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
- Rëndësia:** E lartë.
- 1.1.Rekomandimi:** Administratori i shoqërisë të marrë masa që procesi i hartimit të programit ekonomik financiar, të të ardhurave dhe shpenzimeve të pritshme, të kryhen bazuar në metodat ekonomike, në relacione të detajuara me qëllim realizimin e objektivave të shoqërisë
- 2. Titulli i gjetjes:** Mos realizimi i investimeve të parashikuara.
- Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se për vitin 2021, se lidhur me realizimin për vitin 2021, rezulton me **84%** realizim lidhur me planifikimin përfundimtar (dhe **69,5%** me planifikimin fillestar). Konkretisht paraqiten dy rishikime buxheti, ku totali i investimeve në rishikimin e parë rritet me 829,491 mijë lekë (shkon në 7,191,757 mijë lekë), e shprehur në përqindje rezulton me një rritje prej 13%. Sa i takon rishikimit të dytë rezulton me ulje në vlerën prej 1,932,218 mijë lekë (shkon në 5,259,539 mijë lekë),e shprehur në përqindje ulja rezulton në 26.9% krahasuar kjo me rishikimin e parë

dhe me vlerë 1,102,727 mijë lekë, ose me një ulje prej 17% krahasuar me planifikimin fillestar të buxhetit të investimeve.

Nga vlera gjithsej e *parashikuar*, lidhur me investimet prej **6,362,266 mijë lekë**, nga e cila: vlera prej 1,974,155 mijë lekë me fonde të huaja dhe vlera prej 4,049,700 mijë lekë me fondet e shoqërisë. Janë *realizuar* nga parashikimi vlera **4,388,111 mijë lekë** investime, nga të cilat: vlera 1,072,425 mijë lekë nga kostot e huaja dhe vlera 3,346,916 mijë lekë nga fondet e veta dhe kosto lokale.

Për vitin 2022: Nga grupi i auditimit konstatohet se lidhur me realizimin për vitin 2022, rezulton me **60%** realizim.

Konkretisht: është rishikuar parashikimi fillestar i buxhetit, me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 5, datë 26.07.2022 “Për miratimin e të investimeve të KESH SHA për vitin 2022”, ku ndryshimet kryesore konsistojnë në rialokimin e programimit të investimeve për vitin 2022, nga 5,134,096 lekë, në 5,107,995 lekë, pra me zbritje prej 1%, e cila paraqitet si më poshtë:

1. Totali i investimeve për KESH Gjenerimin nga 1,950,019 lekë në 1,460,619 lekë, pra me një zbritje prej 25%, e cila konsiston në:

- ulja e investimeve në HEC Fierzë nga 818,879 mijë lekë në 531,979 mijë lekë, pra -35%;

- ulja e investimeve në HEC Koman nga 575,000 mijë lekë në 504,000 mijë lekë, pra -12%;

- ulja e investimeve në HEC Vau i Dejës nga 556,140 mijë lekë në 424,640 mijë lekë, pra – 24%.

2. Totali i investimeve në KESH Qendër, përfshirë këtu dhe TEC Vlora nga 1,945,000 mijë lekë në 2,408,300 mijë lekë, pra me një rritje prej 24%.

Nga vlera gjithsej e *parashikuar* prej **5,134,096 mijë lekë**, nga të cilat: vlera prej 1,032,564 mijë lekë me fonde të huaja dhe vlera prej 4,101,532 mijë lekë me fondet e shoqërisë. Janë *realizuar* nga parashikimi vlera **2,752,643 mijë lekë** investime, nga të cilat: vlera 426,562 mijë lekë nga kostot e huaja dhe vlera 2,326,080 mijë lekë nga fondet e veta dhe kosto lokale.

Mos realizimi i investimeve të planifikuara ka ndikuar në mosrealizimin e objektivave kryesorë të shoqërisë për periudhat audituese dhe rezultatin financiar duke mos realizuar të ardhurat e planifikuara.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015, neni 5 “Menaxhimi financiar dhe kontrolli”.

Ndikimi/Efekti: Mos kryerja e investimeve të parashikuara sjell rritje të riskut për realizimin e objektivave kryesorë të shoqërisë për periudhat e ardhshme.

Shkaku Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

Rëndësia: E lartë.

2.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa që në të ardhmen, të analizojë shkaqet dhe arsyet e mos realizimit të investimeve të planifikuara për lidhur me investimet. Drejtimi i shoqërisë të marrë masa që në të ardhmen, procesi i investimeve të shikohet me përparësi si një premisë kryesore për realizimin e objektivave kryesorë të shoqërisë për periudhat e ardhshme.

Për sa më sipër mban përgjegjësi Nëpunësi Autorizues, Administratori z. E V dhe Nëpunësi Zbatues, Drejtori i DEK znj. F K.

Viti 2021

Me shkresën nr. 2646 Prot., datë 02.09.2020, administratori i KESH SH.A, ka iniciuar procedurën e marrjes së informacionit të nevojshëm për hartimin e Programit të zhvillimit ekonomik financiar për vitin 2021 dhe të Planit të Veprimeve për vitet 2021 – 2025. Shkresa i drejtohet Divizionit të Gjenerimit, duke kërkuar sasinë e energjisë që planifikohet për tu prodhuar nga Heci i Kaskadës, parashikimi i planit të investimeve si dhe paraqitje e detajuar për projektet që janë pjesë e planit, parashikimi i detajuar i zërave përkatëse të shpenzimeve, Departamentit të tregtimit të Energjisë duke kërkuar sasinë e energjisë që planifikohet për tu tregtuar e shkëmbyer, Departamentit Ekonomik për parashikimin e zërave përkatës të të ardhurave dhe shpenzimeve operative dhe financiare për njësinë Qendër Kesh, skedulimin e pagesave dhe arkëtimeve, Departamentit të Burimeve Njerëzore lidhur me shpenzimet për personelin, Departamentit të Shërbimeve për investimet në Qendër Kesh, PMU-PRSD, PIU të TEC Vlorë, dhe strukturës së TEC-it për parashikimet e planit të investimeve dhe shpenzimeve operative e financiare.

-Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 22, datë 17.12.2020 “Për miratimin e programit Ekonomik – Financiar të KESH SHA për vitin 2021 dhe parashikimi për 2020 - 2025”.

-Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 17, datë 01.07.2021 “Për miratimin e disa ndryshimeve në programin Ekonomik – Financiar të KESH SHA për vitin 2021”, ku ndryshimet kryesore konsistojnë në:

1. Totali i prodhimit NETO në KESH nga 3,977,367 mijë lekë në 5,322,813 mijë lekë, pra me rritje prej 33,83%,
2. Të ardhurat gjithsej nga 8,070,330 mijë lekë në 18,653,666 mijë lekë, pra me rritje prej 131,14%,
3. Shitje për klientët tarifore të OSHEE nga 5,925,000 mijë lekë në 8,120,772 mijë lekë, pra me rritje prej 37,06%,
4. Shitjet e energjisë për humbjet e transmetimit nga 0 lekë në 635,564 mijë lekë, pra me rritje prej 100%,
5. Shitje energjie elektrike në treg dhe optimizim energjie nga 1,189,489 mijë lekë në 6,817,226 lekë, pra me rritje prej 473,96%,
6. Të ardhura nga shërbimet ndihmëse për OST dhe KOSTT nga 820,741 mijë lekë në 2,801,025 mijë lekë, pra me rritje prej 241,28%,
7. Të ardhura financiare të tjera nga 135,099 mijë lekë në 269,080 mijë lekë, pra me rritje prej 99,17%,
8. Fitimi/(Humbja) Neto nga 102,345 mijë lekë në 5,733,571 mijë lekë, pra me rritje fitimi prej 5502,20%,
9. Investime nga 6,362,266 mijë lekë në 7,191,757 mijë lekë, pra me një rritje prej 13,04%.

-Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 20, datë 21.10.2021 “Për miratimin e disa ndryshimeve në programin Ekonomik – Financiar të KESH SHA për vitin 2021”, ku ndryshimet kryesore konsistojnë në:

1. Të ardhurat gjithsej nga 18,653,666 mijë lekë në 18,267,317 mijë lekë, pra me zbritje prej 2,07%,
2. Shitje energjie elektrike në treg dhe optimizim energjie nga 6,817,226 mijë lekë në 6,538,161 mijë lekë, pra me zbritje prej 4,23%,
3. Të ardhura nga shërbimet ndihmëse për OST dhe KOSTT nga 2,801,025 mijë lekë në 6,607,549 mijë lekë, pra me zbritje prej 6,84%,
4. Të ardhura financiare të tjera nga 269,080 mijë lekë në 162,028 mijë lekë, pra me zbritje prej 39,78%,

5. Fitimi/(Humbja) Neto nga 5,733,571 mijë lekë në 6,740,471 mijë lekë, pra me rritje fitimi prej 17,56%,
6. Investime nga 7,191,757 mijë lekë në 5,259,539 mijë lekë, pra me një zbritje prej 26,87%.

Tabela nr. 1: Përmbledhëse e treguesve kryesorë ekonomik – financiar të KESH SHA, për vitin 2021

Nr.	Emërtimi	Njësia	Viti 2021			
			Viti 2021 i Miratuar	Viti 2021 i rishikuari - i-re	Viti 2021 i rishikuari - ii-te	Realizimi operacional 2021
I.	Të Ardhura gjithsej	(000/lekë)	8,070,330	18,653,666	18,267,313	18,904,679
I.I	Të Ardhura operative	"	7,935,230	18,384,587	18,105,285	18,377,842
I.II.	Të Ardhura Financiare	"	135,099	269,080	162,028	526,837
II.	Shpenzime gjithsej	(000/lekë)	7,949,924	11,908,289	0,337,347	10,418,753
II.I.	Shpenzime Blerje Energjie	"	947,726	2,698,171	2,062,737	2,142,793
II.II.	Shpenzime Personeli	"	1,530,828	1,530,828	1,309,716	1,257,930
II.III.	Blerje lëndë djegëse	"	-	-	-	-
II.IV.	Blerje Materialesh dhe Produktesh(I+II)	"	208,495	208,495	154,894	96,639
II.V.	Shpenzime amortizimi e zhvlerësimi, humbje nga zhvlerësimi	"	2,967,120	3,618,459	3,618,459	3,561,102
II.VI.	Furnitorë dhe Shërbime (Të tjerë)	"	1,346,400	1,468,313	1,095,337	863,067
II.VII.	Shpenzime të tjera Operative	"	104,971	1,514,561	1,507,343	1,549,974
II.VIII	Shpenzime Financiare	"	844,383	869,462	588,861	947,248
III.	Fitimi para taksave dhe të jashtëzakonshme	(000/lekë)	120,406	6,745,378	7,929,966	8,485,926
III.I.	Shpenzime / (Të ardhura të jashtëzakonshme)	"	-	-	-	-
IV.	Fitimi para taksave	"	120,406	6,745,378	7,929,966	8,485,926
V.	Tatim Fitimi	"	18,061	1,011,807	1,189,495	1,272,889
VI.	Fitimi i Vitit	"	102,345	5,733,571	6,740,471	7,213,037
VII.	Treguesit e punës					
	Numri mesatar i punonjësve	Nr.	765	765	765	741
	Paga mesatare mujore	lekë/muaj	87,507	87,507	87,507	85,047
VIII.	Investimet	(000/lekë)	6,362,266	7,191,757	5,259,539	4,419,341
	Projekti i Sigurisë së Digave (Kosto e huaj)	"	1,974,155	1,975,555	1,602,596	1,072,425
	Projekti i Sigurisë së Digave (Kosto lokale)	"	338,411	343,170	268,579	214,485
	Investime me fondet e veta	"	4,049,700	4,873,032	3,388,364	3,132,431

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Zhvillimit Strategjik, përpunoi grupi i auditimit.

Viti 2022

Realizimi i aktivitetit operacional të Korporatës lidhur me të dhënat kryesore të Aktivitetit tregtar ekonomik konsiston në:

- Sigurimin e volumeve të energjisë energji elektrike për detyrimin për shërbimin publik;
- Ofrimin në kohë dhe me cilësinë e duhur të shërbimeve të balancimit dhe atyre ndihmëse;
- Aktivitet tregtar sa më dinamik, për të siguruar të ardhura nga aktiviteti në tregun e lirë, të cilat në kushtet e emergjencës dhe të një viti jo të mirë hidrik, të amortizojë sa më shumë efektin negative të ekspozimit ndaj tregjeve;

Tabela e mëposhtme, paraqet volumet kryesore të aktivitetit të shitjes së energjisë dhe shkëmbimit, krahasuar me PEF të miratuar për 2022:

Tabela nr. 2: Shitje + Dhënie Energjie (MWh)

KESH SHA	PEF i miratuar	Realizimi
Shitje OSHEE Klientë tariforë	5,702,743	5,690,689
Shitje me çmime tregu + optimizimi	24,000	202,016
Shitje OST + KOSTT Humbje transmetimi	0	90,888
Shkëmbim energjie Dhënie + FTL	0	251,001
Shërbime ndihmëse/ balancimi Totale	126,000	118,069

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Zhvillimit Strategjik, përpunoi grupi i auditimit

Si reflektim i situatës së emergjencës, **aktiviteti operacional gjatë vitit 2022**, i shprehur me shifra agregate, kishte si objektiv kryesor reagimin adekuat me qëllim plotësimin e DSHP-së, dhe minimizimin sa më shumë të jetë e mundur të ekspozimit ndaj tregjeve, për të ulur kostot e larta të importit.

Zërat kryesorë përgjithshme agregate dhe i krahasuar me PEF të miratuar fillestar 2021, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 3: Realizimi i të ardhura/shpenzimeve (në miliardë Lekë)

KESH SHA	PEF i miratuar	Realizimi
Të ardhurat nga aktiviteti energjetik	28.7	36.6
Shpenzimet nga aktiviteti energjetik	21.4	57.8
Shpenzime të përgjithshme aktiviteti	6.4	6.2

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Zhvillimit Strategjik, përpunoi grupi i auditimit

Sa më sipër, konstatohet se:

- Të ardhurat nga aktiviteti energjetik janë rritur me 28% krahasuar me planin, ku 21.34 miliardë lekë ose 58% e totalit e përbejnë të ardhurat nga DSHP-ja;
- Shpenzimet nga aktiviteti energjetik janë rritur me 170% krahasuar me planin, ku 52.5 miliardë lekë ose 91% e totalit e përbëjnë shpenzimet e importit të energjisë elektrike, në një treg me çmime shumë të larta;
- Shpenzimet e Përgjithshme të Aktivitetit (Administrative + Amortizimi) janë ulur me 0.2 miliardë lekë ose -3% krahasuar me planin, duke rritur eficiencën dhe optimizimin e e kostove fikse të aktivitetit;
- Rezultati neto i operacioneve të vijueshëm të aktivitetit për 2022, është me humbje prej -25.8 miliardë lekë, imponuar plotësisht nga importi shumë i shtrenjtë si pasojë e krizës globale të energjisë.

Prodhi i Energjisë Elektrike – Operimi

Në lidhje me situatën hidrike, 8 mujori e parë viti 2022 u karakterizua nga një situatë jo e favorshme hidrike dhe njëkohësisht mjaft sfiduese për shkak të situatës së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, shkaktuar nga kriza globale e çmimeve të energjisë. Në tërësi treguesit hidrikë janë më të ulët jo vetëm me vitet e lagësht 2018 dhe 2021, por edhe treguesit mesatar shumëvjeçar 1993-2021.

Sipas treguesve hidrik viti 2022, rezultoi lehtësisht më pozitiv, krahasuar me vitet e thata 2019 dhe 2020.

Thatësira e zgjatur dhe mungesa e reshjeve në 8 mujorin e parë rezultuan në prurje mesatare në liqenin e Fierzës prej rreth 141 m³/s, përkatësisht 51% më pak se në 8 mujorin e parë të vitit 2021 me prurje prej 287 m³/s dhe 28% më pak se mesatarja shumëvjeçare 1993-2021 prej 195 m³/s.

Në ndryshim nga 8 mujori i parë, 4 mujori i fundit u karakterizua nga mot i lagësht me reshje dhe prurje të konsiderueshme në 3 liqenet e kaskadës. Gjatë këtij 4 mujori, prurjet në liqenin e Fierzës ishin rreth 237 m³/s në krahasim me prurjet mesatare prej 125 m³/s gjatë së njëjtës periudhë në 2021.

Në tërësi, prurjet mesatare të vitit 2022 ishin rreth 172 m³/s ose 26% më pak se në vitin 2021 me rreth 233 m³/s dhe 5% më pak se mesatarja shumëvjeçare prej 181 m³/s.

Tabela 4: Prurjet dhe prodhimi 2022 vs Mesatarja Shumëvjeçare

Prurjet dhe prodhimi	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018	Viti 2017	Mesatarja 15 vjeçare
Prurjet në Fierzë (m ³ /sek)	172	233	119	121	235	181	
Krahasuar me mesataren shumëvjeçare (%)	95.4%	129%	65.9%	67%	130.1%	72.6%	
Prodhimi Bruto i Kaskadës (GWh)	3,892	5,539	3,121.2	3,010	5,902	2,945	4,306
Krahasuar me mesataren shumëvjeçare	90.4%	125.2%	72.5%	69.9%	137%	68.4%	

Shënim: mesatarja 15 vjeçare i referohet viteve 2007 – 2021

Rrjedhimisht, situata hidrike u reflektua në prodhimin bruto total prej rreth 3,892 GWh, 28% më pak se në vitin 2021 prej rreth 5,393 GWh dhe 9.6% më pak se mesatarja shumëvjeçare prej 4,306 GWh.

Analiza e Bilancit Energjetik

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet bilanci energjetik i volumeve të energjisë për vitin 2022:

Tabela 5: Bilanci Energjetik për vitin 2022 (MWh)

	Viti 2022		Viti 2022	
Treguesit	Plan	Fakt	Plan (sasi)	Fakt (sasi)
Sasia kontraktuale sipas shifrës të vendosur nga MIE me Vendim nr. 1349/1 prot, datë 16.02.2022	5,702,743	5,690,689	-12,054	-0.21%
PEF KESH SHA 2022 - 2026				
Prodhimi neto KESH	3,950,000	3,859,730	-90,270	-2.29%
Shkëmbimi KESH/marrje	0	228,876	228,876	100%
Kontratë Depozitim - Shkëmbim VKM 620 - 2021/marrje	1,752,743	1,460,962	-291,781	-16.65%
Blerje energjie me çmime tregu (import + tregtarë vendas, VKM 757/21)	60,000	6,772	-53,228	-88.71%
Marrje depozitim nga FTL	0	652,472	652,472	100%
OST shërbime ndihmëse (Energji balancuese)	84,000	127,812	43,812	52.16%
KOSTT shërbime ndihmëse (Energji balancuese)	0	0	0	0%
Disbalanca negative KESH	6,000	11,404	5,404	90.06%
ASHTA Devijim Pozitiv	0	4,635	4,635	100%
Totali energji për tregtim nga KESH + shkëmbim	5,852,743	6,352,663	499,920	8.54%
Shitje FSHU/OSHEE - klientë tariforë	4,630,829	4,624,275	-6,553	-0.14%
Shitje FMF - klientë tariforë	1,071,914	1,066,414	-5,500	-0.51%
Shitje OSHEE humbje	0	0	0	0%
Shitje OST humbje	0	90,888	90,888	100%
Shitje KOSTT humbje	0	0	0	0%
Kthim borxhi shoqërisë FTL, në zbatim të VKM 456/2022	0	113,116	113,116	100%
Shkëmbim KESH/dhënie	0	135,965	135,965	100%

Kontratë Depozitim - Shkëmbim VKM 620 - 2021/dhënie	0	1,920	1,920	100%
Shitje me çmime Tregu (eksport + tregtarë vendas)	0	194,536	194,536	100%
Shitje energjie për optimizimin (eksport + tregtarë vendas)	24,000	7,480	-16,520	-68.83%
OST shërbime ndihmëse (Energji balancuese)	60,000	66,011	6,011	10.02%
KOSTT shërbime ndihmëse (Energji balancuese)	36,000	15,987	-20,013	-55.59%
Disbalanca pozitive KESH	24,000	31,484	7,484	31.18%
ASHTA Devijim Pozitiv	6,000	4,587	-1,413	-23.55%
Totali energji për tregtim nga KESH + shkëmbim	5,852,743	6,352,663	499,920	8.54%
Disbalancë energjie për t'u verifikuar nga OST	0	0	0	0%

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Zhvillimit Strategjik, përpunoi grupi i auditimit

Energji e Prodhuar + Blerje (Disponibël për Tregtim):

- Referuar tabelës së treguesve në volume të bilancit energjetik për 2022, rezultojnë që prodhimi neto ka qenë në sasinë rreth 3,86 TWh dhe vetëm -2.3% nga parashikimi. Konsiderohet një rezultat shumë i mirë krahasuar me parashikimin dhe vitin relativisht të thatë.
 - Energji e blerë në treg të lirë/import 1.46 TWh, ose rreth -17% nga plani, duke arritur sadopak uljen e ekspozimit ndaj importit me çmime të larta.
 - Marrje depozitim nga FTL për mbullim humbje në shpërndarje prej 652.47 GWh, referuar VKM nr. 456; dt. 29.06.2022.
 - Blerje energjie për optimizim portofoli ku përfshihen edhe blerja e shërbimeve ndihmëse, disbalancat negative (OST/KOSTT) dhe devijimet(+) përlllogariten në 150.6 GWh.
 - Shkëmbimi në marrje i energjisë ka pasur volum prej 228.9 GWh.
- Në total, volumi i energjisë elektrike për tregtim nga KESH sh.a. ka rezultuar në sasinë mbi 6.35 TWh ose rreth +0.5 TWh (+8.5%) më shumë se programimi në PEF.

Energji e Shitur (Tregtuar):

- Energjia e shitur për klientët e FSHU dhe FMF rezultojnë në sasinë mbi 5.69 TWh ≈ 5.7 TWh. Pra objektivi kryesor për sigurimin e energjisë për DSHP në kushtet e emergjencës është arritur.
- Energjia elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit ka qenë në sasinë prej 90.8 GWh.
- Energjia elektrike e shitur në tregun e lirë (në kushtet e prurjeve) rezultojnë në sasinë prej gati 195 GWh.
- Kthim Borxhi FTL për mbullim humbje në shpërndarje prej mbi 113 GWh, referuar VKM nr. 456; dt. 29.06.2022.
- Energji e shitur për optimizim portofoli ku përfshihen edhe shitja e shërbimeve ndihmëse, disbalancat pozitive (OST/KOSTT) dhe devijimet (-) përlllogariten në rreth 126 GWh ose -16% më pak se programimi i planifikuar prej 150 GWh.
- Shkëmbimi në dhënie i energjisë ka pasur volum prej gati 138 GWh. Si rezultat balanca neto e shkëmbimit është në rreth 91 GWh (pozicion marrje), dhe gati e gjithë sasia është ndaj KEK (88.7 GWh), sasi kjo që do i kthehet shoqërisë KEK gjatë periudhës së tepërcave të energjisë elektrike.

Realizimi i Investimeve për vitin 2022

Sa i takon vitit 2022, investimet janë përqendruar në investime rinovuese kapitale të nevojshme për aktivitetin e operim/shfrytëzimit dhe në infrastrukturën kritike të teknologjisë dhe informacionit.

Në total realizimi i investimeve gjatë 2022 ka kapur vlerën e mbi 2.752 Mld. Lekë ,krahasuar me Planin Ekonomik prej gati 5.108 Mld. Lek, **pra investimet janë realizuar në masën 54%.**

Politika investuese e Korporatës është fokusuar në sigurinë dhe efikasitetin e veprave hidrike, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të investimeve pasi asetet gjeneruese aktuale, për vetë madhësinë dhe problematikat e amortizimit të tyre në vite, kanë nevojë për investime mirëmbajtëse/rinovuese dhe modernizuese periodike.

Referuar tabelës së mëposhtme, si pasojë e situatës së emergjencës në sektorin elektro energjetik dhe vitit të pafavorshëm hidrik, në vitin 2022 vërehet një ulje e realizimit të investimeve prej -38%, krahasuar me realizimin në 2021.

Tabela nr. 6: Realizimi i Investimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2021 – 31.12.2022 (në miliardë lekë)

Vlera e investimeve të realizuara	Viti 2021	Viti 2022
Investimet e vetë financuara	3,347	2,325
Investimet me financim të huaj	1,072	427
Totali	4,419	2,752
Investime Njësia Fierzë	785	149
Investime Njësia Koman	990	288
Investime Njësia Vau i Dejës	828	531
Investime në Aparatin Qendror	1,816	1,791

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Zhvillimit Strategjik, përpunoi grupi i auditimit.

Shpërndarja e Investimeve të realizuara për 2022, sipas njësive/qendrave të kostos, ndahet në masën përkatësisht në HEC Fierzë 149 Mln.Lek (5% e totalit); HEC Koman 288 Mln. Lek (11% e totalit); HEC Vau i Dejës 531 Mln. Lek ose 19% dhe KESH Qendër + TEC Vlora 1,791 Mln. Lek (65% e totalit).

Konstatohet se volumi më i madh i fondit të investimeve është alokuar për rritjen/garantimin e sigurisë së veprave, gjatë 2022 realizimi më i madh ka kaluar tek rritja e efikasitetit të prodhimit/kapacitetit të reja me 76.4% kundrejt 23.5% për rritjen/garantimin e sigurisë së veprave. Kjo për 2 arsye kryesore:

-duke qenë se garantimi i sigurisë së veprave është i lidhur më së shumti me Projektin e Sigurisë së Veprave Hidrike, i cili është drejt finalizimit, prandaj edhe për vitin 2022 kjo kategori investimesh ka pasur një peshë më të vogël;

-objektivi i Rritjes së Efikasitetit/kapacitetit të reja ka zënë peshë më të madhe gjatë 2022, pasi pjesa më e madhe e investimeve janë të tipit investues-rinovues, investime në fushën e teknologjisë dhe informacionit dhe me rritjen e kapaciteteve të reja, veçanërisht lidhur me gjeneruesit termik lundrues dhe Fazën e I të projektit të HEC Skavica.

Investimet e financuara nga partnerët ndërkombëtarë

Investimet në Sigurinë e Digave financohet paralelisht nga disa institucione ndërkombëtare financiare si Banka Botërore (WB), Sekretariati Shtetëror i Bashkëpunimit Financiar Zviceran (SECO), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) dhe Banka Gjermane për Zhvillim (KfW). Investimet paraqiten si më poshtë:

1.Banka Botërore (EB) – SDR 21.7 Milion

Rehabilitimi i Portave të Shkarkimit të HEC-eve Fierzë dhe Koman: Rehabilitimi i portave të mirëmbajtjes dhe shkarkimit në HEC Koman dhe Fierze përfundoi me sukses duke realizuar objektivin 100% në muajin Nëntor 2021.

Disbursimet e pagesave janë realizuar sipas procedurave të Bankës Botërore deri në muajin Prill 2022.

2.SECO – CHF 6.4 Milion

Projekti i Sigurisë së Digave në Kaskadat e lumenjve Drin, i cili është nënshkruar më 24 Maj 2011, projekti fillestar ka përfunduar investimet në:

-Furnizimin dhe Instalimin i Sistemeve të Monitorimit Gjeologjik dhe Sizmik të Digave të Kaskadave Drin.

-Furnizimin dhe Instalimin i Sistemeve të Monitorimit Gjeodezik të Digave të Kaskadave Mat dhe Drin.

-Mbrotjtja nga Rreziku i rënies së shkëmbinjve në HEC Fierzë.

Marrëveshja e Projektit pas amendimeve të kryera është e vlefshme deri në fund të vitit 2022. Aktualisht SECO asiston Departamentin e Sigurisë së Digave me ekspertizë në argumentimin e të dhënave monitoruese të digave në kaskadën e Drinit.

3.BERZH (EBRD) – EUR 12.7 Milion

-Rehabilitimi i portave të shkarkimit të HEC Koman

Marrëveshja e Financimit me BERZH në shumën e EUR 12.7 milion është bërë efektive më 15 Nëntor 2013. Kjo marrëveshje financoi rehabilitimin e Digës së Komanit dhe përfundoi në Korrik 2016. Financimi prej EUR 6.128 milion i kursyer nga kjo marrëveshje u transferua si bashkëfinancim me Bankën Botërore për rehabilitimin e portave të shkarkimit të HEC Koman dhe Fierzë. Ky transferim është ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligj të posaçëm. Afati i fundit të disbursimeve për këtë marrëveshje ishte deri në 31 Dhjetor 2021. Kontrata ka përfunduar dhe është disbursuar shuma e financimit në masën 100%.

4.KfW – EUR 20 Milion

-Rehabilitimi i Portave të Shkarkimit të HEC Vau i Dejës: Konsulent i zbatimit të projektit është Fichtner GmbH Gjermani i cili po asiston në kontraktimin për rehabilitimin e portave të shkarkimit të HEC Vau i Dejës dhe mbikëqyrjen e zbatimit të projektit. Kontrata është në proces deri në fund të vitit 2023. Gjatë 2022, investimet janë përqendruar më së shumti në rehabilitimin e portave të mirëmbajtjes dhe shkarkimit në HEC Vau i Dejës. Punimet sipas marrëveshjes, pritet të përfundojnë në muajin Tetor 2023. Gjatë vitit 2022 kanë përfunduar portat e mirëmbajtjes dhe shkarkimit në digën e Zadejës dhe puna vazhdon rehabilitimi i portave të digës së Qyrsaqit.

-Implementimi i Qendrës së Kontroll-Monitorimit të Kaskadës së lumit Drin.

Konsulenti i zbatimit të këtij aktiviteti është duke realizuar procedurat kontraktuale dhe nuk paraqet asnjë problematikë. Kontrata është duke u zbatuar sipas parashikimeve kontraktuale. Kontraktori i zbatimit të projektit është duke zbatuar kontratën pa problematika dhe pritshmëria e realizimit të tij parashikohet deri në fund të 2023.

4.1.KfW – EUR 40 Milion Kredi + EUR 2 Milion Grant

-Projekti për rehabilitimin Elektro-Mekanik të HEC Fierzë

Në bazë të ligjit Nr. 69/2021 datë 20.5.2021, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar për projektin “Rehabilitimi i HEC Fierzë”.

Marrëveshja e huasë në shumën 40 Mln. EUR ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Koorporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) (agjencia e zbatimit të projektit) dhe KfW Frankfurt am Main për rehabilitimin Elektro – Mekanik të HEC Fierzë, i ratifikuar me ligjin nr 44/2022, datë 28.04.2022 , i cili ka hyrë në fuqi më datë 28.05.2022 dhe është bërë efektiv në datë 23.08.2022.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje është siguruar një kredi e butë nga Banka Gjermane e Zhvillimit KfW e cila do të shkojë për rehabilitimin e plotë elektro – mekanik të HEC Fierzës. Përveç kredisë nga Banka Gjermane e Zhvillimit KfW, nëpërmjet programit EBIF u akordua edhe një grant prej 8.35 Mln. EUR nga BE për këtë projekt.

Marrëveshja e Grantit shoqërues ndërmjet Republikës së Shqipërisë, KfW Frankfurt am Main dhe KESH SHA për shumën 2 Mln. EUR, për masat shoqëruese rehabilitimin e hidrocentralit të Fierzës.

Në Total projekti kap vlerën e financimit *50.35 Mln. EUR = 40 Mln. EUR Kredi + 10.35 Mln. EUR Grant.*

Kontrata me konsulentin e zbatimit është realizuar dhe projekti është në fazën e hartimit të specifikimeve teknike dhe dosjes së tenderit për punimet rehabilituese. Pritshmëria për fillimin e punimeve rehabilituese është në muajin Tetor 2023.

Investimet me Fondet e Veta (KESH SHA)

-Si pasojë e gjendjes së emergjencës në sektorin e energjisë, viti 2022 pati kufizim në realizimin e investimeve. Gjatë vitit 2022, ndër investimet më kryesore të Korporatës në funksion të sigurisë së veprave hidroteknike të përfunduara ose në proces përmendim në vijim:

- Mbrojtja e shpatit të djathtë të digës HEC Koman;
- Sistemimi dhe asfaltimi i rrugës lidhëse të galerisë së kuotës 178 mmnd në Fierzë;
- Rehabilitimi i tuneleve dhe galerive ndihmëse të digës Koman;
- Mbrojtja e kullave të ekuilibrit nga çarja e shkëmbinjve mbi to dhe sistemimi i rrëshqitjes së koluvioneve mbi rrugën e digës HEC Koman;
- Rikonstrukcioni i sallës së makinerive, sallës së turbinave dhe galerive në godinën e centralit të HEC-it (Koman);
- Mbilartësimi, ndërtim/instalim i pritave malore tek përrenjtë e Salcës dhe Bugjonit (në proces);

Investimet të cilat nuk mundën të implementohen gjatë vitit 2022, janë planifikuar të fillojnë implementimin gjatë vitit 2023. Kjo është e parashikuar në Programin Ekonomik të vitit 2023.

1. Me fondet e vetë Korporatës janë kryer ose janë në vazhdimësi investime të profilit elektro-mekanike të karakterit riparues/rinovues si:

- Projekti “Rehabilitimi me Rinovim Teknologjik të Kushinetave Mbështetëse të 5 agregateve të HEC Vau Dejës”. Me rehabilitimin e AG.1 dhe AG.3 gjatë vitit 2022, kjo kontratë ka përfunduar me sukses për të vazhduar me periudhën garancisë.
- “Rehabilitimi elektro-mekanik i vinçit 2 x 10 ton në bjefin e poshtëm në HEC Fierzë”;
- “Rinovimi i sistemit të mbrojtjeve për 2 Agregate me vendosje/konfigurim të releve të reja që zëvendësojnë ato ekzistuese REG, RET në HEC Fierzë”;
- Projekti “Ndërrhyrje për Mirëmbajtjen e Sistemeve të CO2 në HEC Fierzë dhe HEC Koman”.

Investimet të cilat nuk mundën të implementohen gjatë vitit 2022, janë planifikuar të fillojnë implementimin gjatë vitit 2023. Kjo është e parashikuar në Programin Ekonomik të vitit 2023.

-Në fushën e Automatizimit, Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, për shkak të situatës kibernetike në rajon janë ndërmarrë një sërë masash të kombinuara edhe me investime për të akomoduar këto çështje në kuadër të rritjes së përshtatshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Masat organizative përmbliken në:

- Masat e menaxhimit të sigurisë së informacionit;
- Masat e menaxhimit të rrezikut;
- Masat e politikave të sigurisë;
- Masat sigurisë organizative;
- Masat e kërkesave të sigurisë për palët e treta;
- Masat e menaxhimit të aseteve;
- Masat e sigurisë së burimeve njerëzore dhe aksesit të personave;
- Masat ndaj ngjarjeve të sigurisë dhe menaxhimit të incidenteve të sigurisë kibernetike;
- Masat e menaxhimit të vazhdimësisë së punës (Business Continuity Management);
- Masat e kontrollit dhe auditit.

Masat administrative/organizative janë shoqëruar me masat teknike si më poshtë:

- Masat e sigurisë fizike;
- Masat e mbrojtjes së integritetit të rrjeteve të komunikimit;
- Masat e menaxhimit për autorizimin e aksesit;
- Masat e veprimtarisë së administratorëve dhe të përdoruesve;
- Masat e mjeteve të gjurmimit dhe vlerësimit të ngjarjeve të sigurisë kibernetike;
- Masat e sigurisë së aplikacioneve;
- Masat e sigurisë së pajisjeve kriptografike;

-Masat e sigurisë së sistemeve industriale.

Investime kryesore në fushën e automatizimit, teknologjisë së informacionit dhe komunikimit mund të përmendim:

-Monitorimi gjeodezik i Digave të kaskades së lumit Drin dhe masiveve të paqëndrueshëm gjeodezik pranë tyre;

-Upgrade i versionit të softëare të sistemit SCALA 250, sistemit operativ dhe hardware për DCS SCADA në HEC Koman;

-Sistemi i sigurisë kibernetike Faza 2;

-Vazhdimi i implementimit të sistemit ERP të Menaxhimit (moduli i menaxhimit të kontratave);

-Program për menaxhimin e projekteve të shit-blerjes së energjisë;

-Sistemi i parashikimit satelitor të METEO Faza 2;

-Studimi i menaxhimit të emergjencave dhe kontrollit të sigurisë së digave Faza 1;

-Sistemi i monitorimit të infrastrukturës IT dhe menaxhimi i shërbimeve të helpdesk;

-Sistemi i DMS dhe arkivës teknike;

-Blerje Licenca dhe Softëare për sistemet informatike;

-Konsulencë për implementimin e standardit ISO 27001 në sistemet TIK të KESH SHA.

Objektivat për vitin 2023 është përafrimi i standardeve dhe certifikimi drejt ISO 27001 duke ndihmuar DATIK dhe KESH të ketë procedura, rregullore të qarta dhe funksionale për të siguruar të gjithë aktivitetin teknologjik, duke evidentuar çdo rrezikshmëri kibernetike si faktor kyç për infrastrukturën kritike, si dhe ngritja e qendrës së monitorimit dhe kontrollit të HEC-eve.

Ecuria e Projekteve BRE dhe Përgjegjshmëria Social – Mjedisore

Një objektiv strategjik dhe konstant i Korporatës është rritja e kapaciteteve të reja gjeneruese, nëpërmjet burimeve të diversifikuara. Kjo strategji e ndjekur nga Korporata është në linjë me politikat kombëtare të vendosura nga Qeveria Shqiptare, dhe bazuar në dokumentin “Zhvillimi i Strategjik i Sektorit Energjetik”, përgatitur nga CMA dhe Growth Lab të Universitetit të Harvardit. Ky dokument përfaqëson një udhërrëfyes, i cili shpalos rrugët konkrete për një zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë dhe të integruar të Sektorit Elektroenergjetik Shqiptar, ku KESH SHA, si një aktor qendror i sektorit ka rol kryesor.

-Impianti fotovoltai 5.14 MWh në digën e Qyrasqit të HEC Vau i Dejës:

Fillimi i aktivitet gjenerues i impiantit PV me fuqi të instaluar prej 5.143 MW, i instaluar në digën e Qyrasqit – HEC Vau i Dejës, si i pari burim i diversifikuar që i shtohet portofolit gjenerues të shoqërisë. Ndërtimi i impiantit fotovoltai është financuar me fondet e Koorporatës.. Impianti filloi zyrtarisht prodhimin më 12 Maj 2022. Gjatë vitit 2022 ky impiant ka prodhuar 4,203 MWh energji elektrike.

-Projekti për ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës:

Në vitin 2020 filloi Faza I e projektit të HEC Skavicës, e cila përfshin kryesisht të gjithë punën përgatitore për sa i përket të gjitha studimeve që do të bëhen, duke nisur nga studimi mjedisor, gjeologjik, teknik dhe social. Kjo fazë ka hyrë në fuqi në datë 24.08.2021. Aktualisht pas disa diskutimeve, priten të paraqiten variantet përfundimtare të studimeve të realizuara të cilat do të kalojnë procesin e vlerësimit nga strukturat e KESH SHA dhe më pas është parashikuar opoenca në bashkëpunim me stafin e pedagogëve të UPT.

Sipas parashikimit aktual, pritet që deri në Qershor 2023 të përfundojnë aktivitetet kryesore të Fazës I dhe më pas të fillojnë përgatitjet për Fazën II të kontratës.

-Projekti për ndërtimin e impiantit fotovoltai lundruar 12.9 MWp në liqenin e Vaut të Dejës:

Zhvillimi i këtij projekti po realizohet në bashkëpunim me BERZH, që ka shprehur gatishmërinë për financimin e këtij projekti nëpërmjet një kredie tregtare. Gjatë këtij viti u nënshkrua marrëveshja e kredisë ndërmjet KESH SHA dhe BERZH, dhe ka përfunduar procesi i përzgjedhjes së supervisorit. Aktualisht ka përfunduar procesi i tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorit dhe është në fazën e vlerësimit të aplikimeve. Po kështu projekti

ka fituar mbështetjen financiare në formën e grantit në kuadër të programit financues të ËBIF – EIP.

-Projekti për ndërtimin e impiantit fotovoltai 8.25 MWp në digën e Zadejës të HEC Vau i Dejës:

Ky projekt ka marrë miratimin paraprak në MIE. Aktualisht janë duke u përgatitur termat e referencës për përzgjedhjen e kontraktorit, i cili do të realizojë studimet e nevojshme për fazën e miratimit për ndërtim dhe më pas ndërtimin e impiantit.

-Projekti për impiantin fotovoltai 50 MWp në zonën Belsh:

Ky është një projekt në shkallë të gjerë dhe me impakt që synon diversifikimin e prodhimit të energjisë elektrike. Aktualisht projekti është në fazë fillestare ku ka përfunduar procesi i parafizibilitetit. Për zhvillimin e këtij projekti ka shfaqur interes për ta financuar BERZH, nëpërmjet një kredie me terma preferencialë, si dhe nëpërmjet një granti për asistencë teknike për realizimin e studimeve dhe projektit teknik. Gjithashtu projekti ka kërkuar mbështetje në programin e ËBIF për një grant për investimin.

-Situata e TEC Vlorë:

Gjatë vitit 2020 shoqëria TEC Vlora SHA, ka kryer aktivitetin e saj në lidhje me konservimin e asetit gjenerues i cili nuk është në gjendje pune për shkak të problematikave të shfaqura që nga viti 2012.

Gjatë vitit 2021, MIE ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me Korporatën Ndërkombëtare Amerikane Excelerate (Exxon Mobile), e cila ka marrë përsipër vlerësimin tekniko – ekonomik për rivënien në punë të TPP Vlora. KESH SHA dhe MIE janë në pritje të konkluzioneve të studimit për rivënien në punë të këtij impianti, duke konsideruar edhe alternativën furnizimin me lëndë djegëse të impiantit të llojit Gaz apo Lëng.

-Përgjegjshmëria Social-Mjedisore

Në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm dhe si prodhues i energjisë elektrike 100% në formën hidro (nëpërmjet HEC), një rëndësi të veçantë për Korporatën në vitin 2022 ka patur organizimi i aktiviteteve studimore (kryesisht në HEC Vau Dejës) sipas programit të edukimit dhe informimit me brezin e ri. Qëllimi këtyre aktiviteteve me shkolla të ndryshme në Tiranë ka qenë informimi në lidhje me prodhimin e energjisë së rinovueshme, mbrojtjen e mjedisit, shfrytëzimin racional të qëndrueshëm të burimeve ekzistuese si dhe synimet për të nxitur përdorimin e burimeve të reja të rinovueshme të energjisë. Veçanërisht në situatën e emergjencës gjatë vitit 2022, u zhvillua fushata sensibilizuese për kursimin e energjisë elektrike nga popullata, e cila pati efekte pozitive. Gjithashtu, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare të profilizuara në zhvillimin e qëndrueshëm harmonik si anëtar i IHA (International Hydropower Association), janë realizuar disa programe trajnimi për stafin e KESH në kuadër të “Capacity Building” gjatë vitit 2022. IHA ka luajtur një rol udhëheqës në zhvillimin e Standardit dhe Mjeteve të Qëndrueshmërisë së Hidroenergjisë. Standardi përdoret për certifikimin e performancës së qëndrueshmërisë së projekteve hidroenergjetike në mbarë botën. Gjatë vitit 2022 KESH SHA me asistencën e IHA ka nisur procesin për standardizimin Skavicës që në fillimet e tij si Aset i Qëndrueshëm i Hidroenergjisë.

Me shkresën nr. 4501 Prot., datë 10.09.2021, administratori i KESH SH.A, ka iniciuar procedurën e marrjes së informacionit të nevojshëm për hartimin e Programit të zhvillimit ekonomik financiar për vitin 2022 dhe të Planit të veprimeve për vitet 2022 – 2026. Shkresa i drejtohet Divizionit të Gjenerimit, duke kërkuar sasinë e energjisë që planifikohet për tu prodhuar nga Heci i Kaskadës, parashikimi i planit të investimeve si dhe paraqitje e detajuar për projektet që janë pjesë e planit, parashikimi i detajuar i zërave përkatëse të shpenzimeve, Departamentit të tregtimit të Energjisë duke kërkuar sasinë e energjisë që planifikohet për tu tregtuar e shkëmbyer, Departamentit Ekonomik për parashikimin e zërave përkatës të të ardhurave dhe shpenzimeve operative dhe financiare për njësinë Qendër Kesh, skedulimin e pagesave dhe arkëtimeve, Departamentit të Burimeve Njerëzore lidhur me shpenzimet për personelin, Departamentit të Shërbimeve për investimet në Qendër Kesh, PMU-PRSD, PIU të

TEC Vlorë, dhe strukturës së TEC-it për parashikimet e planit të investimeve dhe shpenzimeve operative e financiare.

-Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 1, datë 19.01.2022 “Për miratimin e programit Ekonomiko – Financiar të KESH SHA për vitin 2022 dhe parashikimi për 2023 - 2026”.

-Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 5, datë 26.07.2022 “Për miratimin e të investimeve të KESH SHA për vitin 2022”, ku ndryshimet kryesore konsistojnë në rialokimin e programimit të investimeve për vitin 2022, nga 5,134,096 lekë, në 5,107,995 lekë, pra me zbritje prej 1%, e cila paraqitet si më poshtë:

1. Totali i investimeve për KESH Gjenerimin nga 1,950,019 lekë në 1,460,619 lekë, pra me një zbritje prej 25%, e cila koniston në:

- ulja e investimeve në HEC Fierzë nga 818,879 mijë lekë në 531,979 mijë lekë, pra -35%.

- ulja e investimeve në HEC Koman nga 575,000 mijë lekë në 504,000 mijë lekë, pra -12%,

- ulja e investimeve në HEC Vau i Dejës nga 556,140 mijë lekë në 424,640 mijë lekë, pra – 24%.

2. Totali i investimeve në KESH Qendër, përfshirë këtu dhe TEC Vlora nga 1,945,000 mijë lekë në 2,408,300 mijë lekë, pra me një rritje prej 24%.

Tabela nr. 7: Përmbledhëse e treguesve kryesorë ekonomik – financiar të KESH SHA, për vitin 2022

Nr.	Emërtimi	Njësia	Plani Vjetor i Miratuar 2022	Realizimi operacional 2022
I.	Të Ardhura gjithsej	(000/lekë)	28,814,300	39,206,609
I.I	Të Ardhura operative	"	28,679,292	35,205,751
I.II.	Të Ardhura Financiare	(000/lekë)	135,008	4,000,858
II.	Shpenzime gjithsej	(000/lekë)	28,457,814	65,024,709
II.I.	Shpenzime Blerje Energjie	"	21,433,117	57,779,945
II.II.	Shpenzime Personeli	"	1,382,201	1,241,443
II.III.	Blerje lëndë djegëse	"	-	-
II.IV.	Blerje Materiale dhe Produktesh(I+II)	"	201,522	102,214
II.V.	Shpenzime amortizimi e zhvlerësimi, humbje nga zhvlerësimi	"	3,610,810	3,841,114
II.VI.	Furnitorë dhe Shërbime (Të tjerë)	"	1,133,988	918,551
II.VII.	Shpenzime të tjera Operative	"	18,126	58,505
II.VIII.	Shpenzime Financiare	(000/lekë)	678,048	1,082,937
III.	Fitimi para taksave dhe të jashtëzakonshme	(000/lekë)	356,486	(25,818,100)
III.I.	Shpenzime / (Të ardhura të jashtëzakonshme)	"	-	-
IV.	Fitimi para taksave	"	356,486	(25,818,100)
V.	Tatim Fitimi	"	53,473	-
VI.	Fitimi i Vitit	"	303,013	(25,818,100)
VII.	TREGUESIT E PUNËS			
	Numri mesatar i punonjësve	Nr.	765	736
	Paga mesatare mujore	lekë/muaj	87,505	85,883
VIII.	INVESTIMET	(000/lekë)	5,134,096	2,752,643
	Projekti i Sigurisë së Digave (Kosto e huaj)	"	1,032,564	426,562
	Projekti i Sigurisë së Digave (Kosto lokale)	"	206,513	85,312
	Investime me fondet e veta	"	3,895,019	2,240,768

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Zhvillimit Strategjik, përpunoi grupi i auditimit.

Referuar dokumentacionit të administruar, treguesit kryesorë vlerësohen shkurtimisht si më poshtë:

1.Të ardhurat prej aktivitetit kryesor 36.6 Mld. Lekë konsistojnë në: rreth 30 Mld. Lekë nga shitja e energjisë në tregun e rregulluar për përmbushjen e DSHP, tregun e parregulluar, optimizim, shitje humbje transmetimi dhe disbalanca. Shërbimet ndihmëse energjetike janë 5.26 Mld. Lekë, dhe “Të ardhurat të tjera” ku përfshihen të ardhura ekstra bazuar në kontrata

mbi energjinë elektrike (si kamatëvonesa, penalitete etj.) kryesisht ndaj OSHEE dhe OST në vlerën prej 1.4 Mld. Lekë;

2.Rezultati neto për periudhën është në vlerën rreth -25.82 Mld. Lekë, ndikuar nga shpenzimet e importit të energjisë të cilat arritën në 52.52 Mld. Lekë, duke dhënë impaktin negativ në rezultatin ekonomik tëperiudhës;

3.Indikatori “Shpenzimet Operative Fikse/GWh të prodhuar” është në vlerën 595 mijë lekë/GWh të prodhuar, duke ulur këtë tregues me vite të ngjashme prodhimi si 2020, 2019 dhe 2017, duke treguar rritje të efijencës operationale të Korporatës;

4.Si tregues i vlerësimit të likuiditetit, vërehet se “Llogaritë e Arkëtueshme” në fund të 2022 janë rritur me rreth 9.5 Mld. Lekë (+15%), krahasuar me 2021, duke ndikuar negativisht në likuiditetin e Korporatës dhe cenuar ndjeshëm zhvillimin ekonomik – financiar,

5.Si tregues i vlerësimit të aftësisë paguese (solvency), vërehet se “Llogaritë e Pagueshme” në fund të 2021 janë rritur me 14.6 mld. Lekë (ose +136%), krahasuar me 2021. Rritja e këtij zëri, tregon uljen e aftësisë paguese si pasojë e efektit të lidhjes që krijohet ndërmjet “Llogarive të Arkëtueshme” dhe “Llogarive të Pagueshme”, aktorët e tjerë të sektorit nuk paguajnë ose paguajnë pjesërisht detyrimet ndaj KESH, duke mbajtur të larta “Llogaritë e Arkëtueshme” dhe kushtëzuar flukset hyrëse të likuiditetit aq të nevojshëm për soliditetin ekonomik-financiar.

6.Të ardhurat totale janë rritur me 27.6% krahasuar me PEF. Kjo rritje përbëhet nga të ardhurat nga aktiviteti korrent i shitjes së energjisë me 22.76 % dhe "Të ardhura të tjera operationale" që janë kryesisht nga penalitete për vonesa në pagesën e faturave nga OST & FSHU me 4.84%.

7.Shpenzimet totale të periudhës rezultojnë 63.94 Mld. Lekë me një rritje prej 36.16 Mld. Lekë ose +130%, krahasuar me PEF. I gjithë efekti i rritjes së shpenzimeve vjen nga “Blerja e Energjisë në tregun e Parregulluar/Importi”, për të përballuar furnizimin për DSHP. Ky zë shpenzimi, i cili përbën 90% të gjithë totalit të shpenzimeve, u rrit ndjeshëm me +32.37 Mld. Lekë ose +161%, krahasuar me parashikimin, pasi Korporata u ekspozua ndjeshëm nga kushtet jo të favorshme hidro-meteorologjike, të cilat kufizuan prodhimin e brendshëm duke e detyruar të blejë sasi energjie të konsiderueshme.

8.Veçojmë faktin që shpenzimet tjera operationale si “Shpenzime Personeli” (-10%), “Materiale të Para dhe të Konsumueshme” (-49.3%) apo “Shpenzime të tjera Operationale” (-15%), janë më të ulta se PEF, duke treguar një qasje mjaft efijente në menaxhimin e kostove fikse operative-administrative.

9.Aktiviteti operacional financiar rezultoi pozitiv me një rritje neto prej +2 Mld. Lekë ose +3.7 herë më të larta se parashikimi, kryesisht nga "te ardhura nga interesat" dhe "fitim nga kursi i kembimit".

10.Si pasojë e rritjes së ndjeshme të shpenzimeve operative me +130.2%, krahasuar me rritjen e të ardhurave operative me vetëm +27.6%, aktiviteti ekonomik - operacional për vitin 2022 rezultoi me -25.82 Mld. Lekë humbje neto nga operationet e vijueshëm (rezultati përfundimtar duhet çertifikuar).

II.2.3. Mbi zbatimin e Strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Nga auditimi konstatohet që:

2. Titulli i gjetjes:	Mos respektimi i procedurave të rekrutimit të punonjësve dhe të dhënies të masave disiplinore.
Situata:	Nga auditimi konstatohet se referuar dokumentacionit të administruar, për periudhën objekt auditimi konstatohet se: -Është miratuar me nr. 892 prot, datë 17.02.2022 Manuali “Për funksionimin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore”. -Rregullorja e përgjithshme nuk është azhurnuar me ndryshimet në strukturë dhe si e tillë përshkrimi i vendeve të punës dhe detyrat e secilit pozicion aktual nuk ka përputhshmëri me këtë strukturë. -Nuk është bërë për asnjë rast shpallja e vendeve vakante dhe as intervistimi apo testimi i kandidatëve. -Për mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve për punë, nga Burimet Njerëzore, pranë KESH SHA nuk ka asnjë informacion apo gjurmë si janë kryer këto procedura. Po ashtu procedura e ndjekur gjatë kësaj përzgjedhje nuk është e qartë dhe transparente, sepse nuk ka të dokumentuar asnjë nga hapat që duhet të ndiqen për rekrutimin e punonjësve të rinj. -Nga auditimi konstatohet se gjatë periudhës objekt auditimi në total janë dhënë 110 masa disiplinore, në KESH SHA, mëposhtme nga këto 96 “Vërejtje”, 13 masa “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, 1 masë “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna dhe kalim në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët” dhe 0 masa “Pushim nga puna”.
Kriteri:	Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se nuk ka procedura transparente, dhe nuk ka komision apelimi. Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015.
Ndikimi/Efekti:	Mos zbatimi i procedurave të rekrutimit të marrëdhënieve të punës sipas ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015 sjell parregullsi dhe mangësi në punësimin e punonjësve për shoqërinë KESH SHA.
Shkaku	Mos zbatimi i ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë” dhe mangësitë në zbatimin e procedurave rekrutimit të punonjësve të rinj të shoqërisë KESH SHA.
Rëndësia:	E lartë.
2.1.Rekomandimi:	Nga Administratori dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore , të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të rekrutimit të punonjësve të rinj, dhe hartimi dhe miratimi i rregullores së brendshme të shoqërisë KESH SHA.
2.2.Rekomandimi:	Nga Administratori dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore , të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi dhe transparencë të procedurave të dhënies të masave disiplinore, si dhe ngritjen e komisionit të apelit lidhur me masat disiplinore në shoqërinë KESH SHA.

3. Titulli i gjetjes:	Mos miratimi dhe mos përcaktimi i kriterëve për klasifikimin e pagave.
Situata:	Nga auditimi konstatohet se, niveli i pagave është përcaktuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 09, datë 17.10.2019 për “Miratimin e dokumentacionit të unifikuar të klasifikimit dhe trajtimit të punonjësve të KESH SHA”. Niveli i shkallëve në këtë vendim është bërë në 6 grupe nga 1 më i ulëti te 4 më i larti, por në këtë klasifikim nuk janë përcaktuar kriteret që i diferencojnë qartë këto shkallë. Nga auditimi konstatohet se për të njëjtin pozicion pune, në disa raste punonjësit trajtohen me paga të ndryshme. <i>Sa më sipërnuk ka kriteret të përcaktuara qartë dhe praktika e krijuar ka qenë klasifikimi nga 1 , si shkalla me e ulët në 6, si shkalla më e lartë, duke ju lenë në dorë drejtuesve në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore (duke ruajtur fondin e pagave), sipas aftësive dhe përgjegjësisë, detyrave dhe shkallës së vështirësisë në kryerjen e tyre, si dhe volumit të punës që punonjësit kanë.</i>
Kriteri:	Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1, shkronja (a).
Ndikimi/Efekti:	Mos përcaktimi i kriterëve lidhur me klasifikimin e nivelit të pagave, sjell paqartësi në dhënien e tyre.
Shkaku	Mos përcaktimi i kriterëve lidhur me klasifikimin e nivelit të pagave.
Rëndësia:	E lartë.
3.1.Rekomandimi:	Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të marrë masat e duhura, lidhur me miratimin e pagave dhe përcaktimin e kriterëve për klasifikimin e tyre sipas secilit nivel.
4. Titulli i gjetjes:	Paga në natyrë më tepër nga kuota e miratuar.
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit të listë pagesave për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022 rezultoi se; me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. Nr. 68, datë 7.02.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetorë”, pika 2, germa a), kjo dietë është caktuar deri në masën 300 lekë në vakt/ditë pune. Nga ana e Administratorit të Shoqërisë, Drejtorisë Juridike, Drejtorisë së Burimeve njerëzore nuk janë marrë masat për reflektimin e ndryshimeve ligjorë për caktimin e dietës ushqimorë në përputhje me legjislacionin e sipërpërmendur, dhe paga në natyrë (dieta) për trajtim ushqimor është paguar në masën 500 lekë vakt/ditë pune. Ky fenomen është konstatuar edhe nga auditimet e mëparshme të KLSH për të cilin janë dhënë rekomandimet përkatëse të cilat përsëri konstatohet se nuk janë bërë reflektimet e duhura për përditësimin e legjislacionit dhe ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive. Nga llogaritja e listëpagesave të periudhës 01.01.2021 - 31.12.2022 rezulton se ky përfitim është në masën 170,018,888 lekë, nga 102,011,333 lekë që duhej të ishte pra është paguar më tepër shuma prej 68,007,555 lekëshpenzime pa ekonomikitet për buxhetin e shoqërisë.
Kriteri:	Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. Nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, pika 2, germa a).
Ndikimi/Efekti:	Efekt financiar negativ në shumën prej 68,007,555 lekë lekë.

Shkaku	Mos azhurnimi i ndryshimeve ligjore dhe ndryshimi i kontratës kolektive të shoqërisë në përputhje me këto ndryshime.
Rëndësia:	E lartë.
4.1.Rekomandimi:	Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të marrë masat e duhura, për mos azhurnimin e legjislacionit, dhe të ndiqen procedurat administrative për personat përgjegjës, bazuar në Kodin e Punës dhe Rregulloren e brendshme të Shoqërisë. Administratori i Shoqërisë, Departamenti Ligjor të marrë masat e duhura dhe të kryejë ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive, duke nxjerrë aktet përkatës për mos vazhdimin e dietës ushqimore më tepër nga përcaktimet ligjore.
5. Titulli i gjetjes:	Proceset gjyqësore për ndërprerjen e paligjshme të marrëdhënieve të punës.
Situata:	Nga auditimi konstatohet se lidhur me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 81 çështje gjyqësore në apel, nga ku janë humbur 3 çështje gjyqësore në Gjykatat e Shkallës të Lartë dhe në Gjykatat e Apelit, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën 2,375,484 lekë si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore. Për periudhën objekt auditimi, janë në proces gjykimi 7 çështje gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, në vlerën 1,810,437 lekë si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore. Në total, vlera 4,185,921 lekë, shpenzime pa ekonomikitet për buxhetin e shoqërisë.
Kriteri:	Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015.
Ndikimi/Efekti:	Efekt financiar negativ në shumën prej 4,185,921 lekë .
Shkaku	Mos zbatimi i ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, dhe mangësitë në zbatimin e procedurave të largimit nga puna të punonjësve, të shoqërisë KESH SHA.
Rëndësia:	E lartë.
5.1.Rekomandimi:	Nga Administratori, Departamenti Juridik dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore të shoqërisë të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të shkëputjes të marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.
6. Titulli i gjetjes:	Dhënia e shpërblimeve në situatën e rezultatit financiar negativ të shoqërisë.
Situata:	Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të KESH SHA nr. 6 prot, datë 26.02.2021 “Për dhënien e shpërblimit për disa punonjës të KESH SHA, pas periudhës të gatishmërisë dhjetor 2020 – shkurt 2021”, është miratuar dhënia e shpërblimit në masën 50,000 (pesëdhjetë mijë) Lekë, për disa punonjës të KESH SHA, në strukturat, si më poshtë: - punonjës të Departamentit të Gjenerimit, - punonjës të Drejtorisë së Operacioneve Tregtare. Duke qenë se shoqëria nuk ka një analizë të realizimit të objektivave, vlera 3,300,000 lekë , e akorduar për këtë shpërblim, konsiderohet shpenzim pa efektivitet për buxhetin e shoqërisë.

-Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të KESH SHA nr. 6295 prot, datë 29.12.2021 “Për dhënien e një shpërblimi të veçantë mbi pagë në fund të vitit për punonjësit e KESH SHA”, janë dhënë shpërblime me vlerën 61,402 mijë lekë.

Duke qenë se shoqëria nuk ka një analizë të realizimit të objektivave, vlera **61,402,000 lekë** konsiderohet **shpenzim pa efektivitet** për buxhetin e shoqërisë.

Kriteri: Neni 32 i Kontratës Kolektive ku përcaktohet: *“Për një kategori të caktuar punonjësish, Administratori mund të japë shpërblime shtesë (deri në dy paga mujore në vit) në përputhje me realizimin e objektivave të ngarkuara”.*

Ndikimi/Efekti: Shpenzim pa efektivitet në shumën prej **64,702,000 lekë**.

Shkaku Mos zbatimi i përcaktimeve të kontratës kolektive të shoqërisë lidhur me dhënien e shpërblimeve për punonjësit.

Rëndësia: E lartë.

6.1.Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të analizojnë situatën dhe të marrin masa lidhur me dhënien e shpërblimeve konform rezultateve financiare të shoqërisë.

7. Titulli i gjetjes: Mos rinovimi i Kontratës Kolektive.

Situata: Marrëdhëniet e punës janë të rregulluara me kontratën kolektive nr. 2399 prot., datë 23.05.2019 midis KESH SHA të përfaqësuar nga Administratori B. B dhe Federatës Sindikale të Punonjësve të Industrisë të Shqipërisë (FSPISH) të përfaqësuar nga T. K, për një periudhë tre vjeçare.

Sa më sipër rezulton se kontrata kolektive nuk është rinovuar.

Kriteri: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, neni 176, pika 1.

Ndikimi/Efekti: Mosrealizim i qëllimit të kontratës kolektive.

Shkaku Mos rinovimi i kontratës kolektive.

Rëndësia: E lartë.

7.1.Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë të marrë masa lidhur me rinovimin e kontratës kolektive me Federatën Sindikale të Punonjësve të Industrisë të Shqipërisë (FSPISH).

Për sa më sipër mban përgjegjësi Nëpunësi Zbatues, Drejtori i DEK znj. F.K dhe Drejtori i Burimeve Njerëzore znj. J. B.

Për sa më sipër është hartuar Projekt Raporti , me nr. 407/11 prot, datë 13.12.2023 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse nr. 2205/80, datë 15.01.2024, administruar në KLSH me nr. 407/12, datë 17.01.2024, znj. J. B ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Pretendimet e subjektit të audituar:

1. “...theksojmë se ekzistenca e kontratës kolektive të punës nuk është përmbushje e ndonjë detyrimi ligjor, por shprehje përfundimtare e vullnetit të lirë të palëve të cilat hyjnë në këtë marrëdhënie ...”

2. “...masat disiplinore në KESH SHA jepen sipas parashikimeve të Kontratës Kolektive dhe parashikimeve të Kontratës Individuale të Punës...”

3. “...dhënia e shpërblimit për disa punonjës në KESH SHA, është në përputhje me përcaktimet e Kontratës Kolektive dhe si e tillë, është një detyrim kontraktor...”

4. “...shpërblimi i veçantë mbi pagë, konsiston në një të drejtë të fituar nga punonjësit e KESH SHA, përmes Kontratës Kolektive...”

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH^{-së}:

1. Lidhur me observacionin tuaj, ju nuk paraqesni fakte të reja lidhur me mos rinivimin e kontratës kolektive. Përrjedhojë, observaonijuaajnukmerretnëkonsideratë.
2. Lidhur me observacionin tuaj, ju nuk paraqesni fakte të reja lidhur me mos procedurat e rekrutimit. Përrjedhojë, observaonijuaajnukmerretnëkonsideratë.
3. Lidhur me observacionin tuaj, ju bini në kundërshtim me argumentin tuaj duke qenë se Kontrata Kolektive nuk është rinovuar dhe si e tillë nuk mund të merret në konsideratë.
4. Lidhur me observacionin tuaj, ju bini në kundërshtim me argumentin tuaj duke qenë se Kontrata Kolektive nuk është rinovuar dhe si e tillë nuk mund të merret në konsideratë.

III.2.4. Auditimi me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlerë të vogla (Shpenzimet administrative për automjetet udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizimet, etj.) e sistemimi i rezultateve në pasqyrat financiare vjetore.

Në zbatim të pikës 4 së Programit të Auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentacioni i pagesave të bankës
- Dokumentacioni i arkëtimeve, pagesave të arkës.
- Dokumentacioni hyrjeve dhe daljeve të magazinës.
- Dokumentacioni i mbajtur mbi marrjen në dorëzim të furnizimeve.
- Dokumentacioni i mbajtur për blerjet me vlera të vogla

Nga auditimi konstatua se:

Me urdhrin nr. 220 prot., datë 11.01.2021, administratori i KESH sha ka autorizuar Z.A. G të veprojë në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor për procedurat për prokurim me vlerë të vogël. Me urdhrin nr. 220/1 Prot., datë 12.01.2021, Titullari i autoritetit kontraktor, ka ngritur komisionin e blerjeve me vlera të vogla i përbërë nga A. N kryetar, F. D anëtar dhe A. Hanëtar. Me urdhrin nr. 220/2 prot., datë 04.05.2021, është anuluar urdhri i mësipërm dhe është krijuar komisioni me J. K kryetar, dhe A. N anëtar dhe F. D anëtar. Me urdhrin nr. 27 Prot., datë 05.01.2021, administratori i KESH sha, ka ngritur komisionin për prokurimin me vlerë të vogël i përbërë nga E. D kryetar, A. N anëtar dhe A. H anëtar. Me urdhrin nr. 26 Prot., datë 05.01.2022, administratori i KESH sha ka autorizuar A. G të veprojë në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor për procedurat për prokurim me vlerë të vogël. Me urdhrin nr. 27 Prot., datë 05.01.2022, titullari i autoritetit kontraktor, ka ngritur komisionin e blerjeve me vlera të vogla i përbërë nga E. D kryetar, A. N anëtar dhe A. H anëtar.

1. Titulli i gjetjes: Lidhja e kontratave me operatorë të shërbimit të telefonisë celulare pa kryerjen e procedurave të prokurimit.

Situata: Më datë 27.05.2019, administratori i KESH sha, i përfaqësuar nga A. G ka lidhur kontratën me “V” sha, me nr. 1985/4 Prot., për një periudhë 2 vjeçare, duke marrë përsipër pagesën minimalisht të vlerës 256,200 lekë, ku përfshihen 74 numra me shërbim të telefonisë dhe internet dhe 50 numra për shërbimin e GPS. Me datë 20.06.2019, administratori i shoqërisë z. B. B, ka nxjerrë urdhrin nr. 52, “Për pajisjen me numër telefoni celular të punonjësve të strukturave të KESH dhe pagesën e faturave tatimore të operatorit të telefonisë së kontraktuar”. Në listën e aprovuar përveç drejtuesve ka shefa sektori si dhe specialistë, që nuk justifikojnë mbulimin e shpenzimeve nga shoqëria.

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2 dhe neni 4.

VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publik”, i ndryshuar.

Lidhja e kontratës së shërbimit është kryer pa zhvilluar procedura prokurimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Ndikim/Efekti: Mos kryerja e procedurave të prokurimit zvogëlon ekonomikitetin e menaxhimit të fondeve të shoqërisë.

Shkaku Jo vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore.

Rëndësia: E lartë.

1.1.Rekomandimi: AK duhet të tregojë kujdesin e duhur për realizimin dhe menaxhimin

e procedurave të prokurimit si dhe të marrë masa për trajnimin e punonjësve që kryejnë procedurat e prokurimit, duke ndikuar në rritjen e kapaciteteve të brendshme për menaxhimin e fondeve publike me efikasitet dhe ekonomikitet.

Për sa më sipër mban përgjegjësi ish administratori B. B.

- 2. Titulli i gjetjes:** Forma shpërblimi në kundërshtim me kuadrin ligjor.
- Situata:** Me vendimin nr. 13, datë 01.07.2021, të Këshillit Mbikëqyrës, është vendosur për miratimin e krijimit të fondit të pensionit profesional për punonjësit e KESH sh.a.
Për vitin 2021 janë transferuar 5,780,802 lekë dhe për vitin 2022 janë transferuar 15,378,310 lekë për këtë fond.
Aprovimi i këtij fondi që është një formë shpërblimi për punonjësit rezulton në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6.
- Kriteri:** Ligji nr.10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6 “Kompetencat e organeve kolegjiale”, pika 1/a.
- Ndikim/Efekti:** Vlera **5,780,802 lekë** për periudhën 2021 dhe vlera **15,378,310 lekë** përbëjnë efekt ekonomik negativ për shoqërinë.
- Shkaku** Jo vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore
- Rëndësia:** E lartë.
- 2.1.Rekomandimi:** Organet drejtuese të KESH sh.a. të analizojnë vlerën 21,159,112 lekë, e cila përbën efekt financiar negativ dhe në të ardhmen nga shoqëria të akordohet dhënia e shpërblimeve me miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës znj. E. M,z. Gj. S, z. L. P, znj. A. G, z. E. L dhe z. Th. Xh.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë Nr. 2205/85 Prot., datë 15.01.2024, “Observacione për Akt-Konstatimin nr. 6” nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Për sa ngarkoni me përgjegjësi Këshillin Mbikëqyrës të shoqërisë KESH sh.a., lidhur me miratimin e fondit profesional për punonjësit e KESH sh.a. sqarojmë si vijon:

Fondi i pensionit profesional për punonjësit e shoqërisë KESH sh.a., është miratuar nga ky Këshill në bazë të kompetencave që i jep ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe statuti i shoqërisë, mbështetur në përcaktime të ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, e cila nuk referohet në përmbajtjen e akt konstatimit duke ju referuar:

Neni 4. Përkufizime.Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: a) “Asete” janë letra me vlerë, para dhe pasuri të tjera, të cilat janë në pronësi të anëtarit të fondit të pensionit, të shoqërisë administruese apo të depozitarit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji. c) “Administrator” është personi fizik me përgjegjësi drejtuese dhe administruese në shoqëri, i cili është drejtori ekzekutiv ose punon nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të drejtorit ekzekutiv. g) “Fond pensioni vullnetar”, në vijim “fond pensioni”, është një grup asetesh në pronësi të anëtarëve të fondit të pensionit. gj) “Fond pensioni profesional” është fondi i pensionit, për të cilin punëdhënësi ka kontraktuar me shoqërinë administruese, për t’u ofruar punonjësve të vet një plan pensioni profesional.l) “Kuotë pensioni” është pjesa përpjesëtimore e pronësisë në grupin e asetëve të fondit të pensionit. Të gjitha kuotat përfaqësojnë fraksione të barabarta

pronësie të aseteve të fondit të pensionit dhe vlera totale e të gjitha kuotave të fondit të pensionit, gjithmonë, është e barabartë me vlerën totale neto të aseteve të këtij fondi pensioni. ll) “Kthim nga investimi” është rezultati, që merret nga investimi i aseteve dhe fitimi i kapitalit. p) “Përfitime” janë pagesat në para, në formë pensioni, të shumave, që gjenden në llogarinë e anëtarit të fondit të pensionit. q) “Punëdhënës” janë tregtari, personat juridikë, përfshirë institucionet shtetërore, institucionet e financuara nga Buxheti i Shtetit dhe institucionet e pavarura. r) “Plan pensioni” është kontrata ndërmjet individit dhe shoqërisë administruese, për ofrimin e përfitimeve për pension. Shërbimet e fondit të pensionit, të krijuar nga shoqëria administruese, i ofrohen individit, i cili, me pëlqimin e vet, bëhet anëtar i fondit të pensionit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Kuptohet qartësisht se nuk kemi të bëjmë me një fond shpërblimi i cili është trajtuar si i tillë në akt konstatimin e audituesve të KLSH, por me një fond të pensionit profesional, trajtimi fiskal i të cilit është i ndryshëm nga trajtimi fiskal i shpërblimit.

Referencë e mëtejshme e ligjit nr. 1019, datë 10.12.2009. neni 88, “Lehtësitë tatimore të kontributeve të anëtarëve të fondit të pensionit.

Neni 88, Lehtësitë tatimore të kontributeve të anëtarëve të fondit të pensionit 1. Kontributi i bërë nga çdo anëtar i një fondi pensioni zbritet nga të ardhurat personale të tij, për efekt tatimi. 2. Kthimi i investimit, përfshirë fitimet nga kapitali prej investimeve të kryera me asetet e fondit të pensionit nuk i nënshtrohen tatimit, as për vetë fondin e pensionit dhe as për shoqërinë administruese. 3. Kontributet e bëra nga punëdhënësi dhe çdo kontribues tjetër, në emër dhe për llogari të anëtarit të një fondi pensioni, për efekte fiskale, nuk vlerësohen si të ardhura personale të anëtarit. 4. Kufiri maksimal për lehtësitë tatimore për kontributet vjetore, përveç rastit të parashikuar në pikën 5 të këtij neni, të bëra sipas përcaktimit të pikave 1 e 3 të këtij neni, është vlera më e vogël, që del nga krahasimi i shumës 200 000 lekë dhe 15 për qind të të ardhurave vjetore bruto të anëtarit. 5. Në rast se anëtari është mbi 50 vjeç, kufiri maksimal për lehtësitë tatimore për kontributet vjetore, të përcaktuara në pikat 1 e 3 të këtij neni, është vlera më e vogël, që del nga krahasimi i shumës 250 000 lekë dhe 25 për qind të të ardhurave vjetore bruto të anëtarit. 6. Blerja e kuotave të një fondi pensioni është shërbim financiar dhe, si rrjedhojë, është e përjashtuar nga TVSH-ja. 7. Shërbimet e ofruara nga depozitari për shoqërinë administruese dhe anëtarët vlerësohen si shërbim financiar dhe, si rrjedhojë, janë të përjashtuara nga TVSH-ja. 8. Tatimi, që shoqëron tërheqjen e parakohshme, është sa norma e zbatueshme në çastin e tërheqjes. 8217 Neni 89 Trajtimi fiskal i kontributeve të bëra nga punëdhënësi Kontributet e bëra nga punëdhënësi në interes të punëmarrësve të tij në një plan pensioni profesional vlerësohen shpenzim operativ, deri në shumën vjetore për çdo punëmarrës, të barabartë me 250 000 lekë dhe kjo shumë vlerësohet shpenzim i zbritshëm, për qëllime të tatimit mbi fitimin të punëdhënësit.

Për sa më sipër kemi referuar, fondi i pensionit profesional ka një përcaktim të qartë ligjor pikërisht ligjin nr. 10 197, datë 10.12.2019, dhe jo sikundër është trajtuar nga ana juaj me përcaktimin ligjor të ligjit 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë që ligji të cilit i referoheni ju është për fonde të pensionit vullnetar dhe jo për pagesa të detyrueshme për efekt të kontributeve shoqërore.

Shoqëria KESH sh.a., ka detyrime që të kryejë pagesat për sigurime shoqërore në bazë të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993, Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Neni 2, Sigurimi shoqëror i detyrueshëm është jofitimprurës, që mbron me të ardhura: a) Personat e punësuar në lidhje me:- pleqërinë, Neni 14. Shpërndarja e kontributeve, 1. Kontributet e paguara nga personat e punësuar shpërndahen në tri degë, që

administrojnë fondet e sigurimeve shoqërore: c) dega e sigurimit të pensioneve, 21.6 për qind të shumës së listë pagesave. *Pensione*, Neni 30 (shtuar shkronja b/1, me ligjin nr. 8889, datë 25.04.2002; shfuqizuar shkronja b, me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014; shtuar shkronja ç/1, me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014) Në degën e sigurimit të pensioneve paguhet: a) pension pleqërie; Në Nenin 5/2, Fondet profesionale dhe fondet e pensionit vullnetar (shtuar neni me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014) citohet se: *Krijimi, veprimtaria dhe mbikëqyrja e fondeve profesionale dhe fondeve të pensionit vullnetar bëhen sipas ligjit të veçantë.*” Ju pretendoni se jeni mbështetur në ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, por fondet e pensionit që trajton ky ligj janë vullnetare dhe jo të detyrueshme. Për sa përcaktohet më sipër në nenin 4. 1) “*Kuotë pensioni*” është pjesa përpjesëtimore e pronësisë në grupin e asetëve të fondit të pensionit. Të gjitha kuotat përfaqësojnë fraksione të barabarta pronësie të asetëve të fondit të pensionit dhe vlera totale e të gjitha kuotave të fondit të pensionit, gjithmonë, është e barabartë me vlerën totale neto të asetëve të këtij fondi pensioni. 2) “*Kthim nga investimi*” është rezultati, që merret nga investimi i asetëve dhe fitimi i kapitalit.p) “**Përfitime**” janë pagesat në para, në formë pensioni, të shumave, që gjenden në llogarinë e anëtarit të fondit të pensionit.”, kemi një shpërblim me pagesa në para në formë pensioni. Pagesat sa më sipër janë shpenzime operative jo të detyruara nga kuadër ligjor por janë në baza vullnetare për përfitime të mëvonshme. Observacioni nuk merret në konsideratë.

- 3. Titulli i gjetjes:** Mungesa e një sistemi monitorimi të pagesave të kryera me bankë.
- Situata:** Nga verifikimi i pagesave të furnitorëve u konstatua se nga Departamenti Ekonomik dhe i Financës nuk është ngritur një sistem i monitorimit të afateve të skadencave të detyrimeve të pagueshme, për të garantuar pagesën e të gjithë kreditorëve në kohë si dhe për të dokumentuar që pagesat kryhen sipas skadencave kronologjike.
- Kriteri:** Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12 dhe 16.2.ku përcaktohet se: “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues 2. Nëpunësi zbatues i njësisë publike është përgjegjës dhe i raporton nëpunësit autorizues të njësisë publike për garantimin e cilësisë së: gj) garantimin që të gjithë kreditorët të paguhet në kohë dhe në rastet kur kreditorët nuk janë paguar apo në rast ankesash për mospagesë nga kreditorët, nëpunësi zbatues duhet t’ia shpjegojë rrethanat nëpunësit autorizues.” dhe nenit 16, pika 2, detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit ku citohet: 2. *Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.* 3. *Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.*
- Ndikim/Efekti:** Mos monitorimi në kohë i detyrimeve të pagueshme rrit riskun për krijimin e penaliteteve ndaj shoqërisë.
- Shkaku** Jo vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore.
- Rëndësia:** E lartë.
- 3.1.Rekomandimi:** Nga administratori i shoqërisë të merren masa për hartimin e një sistemi të monitorimit të afateve të skadencave të detyrimeve të

pagueshme, për të garantuar pagesën e të gjithë kreditorëve në kohë. Ky sistem do të shërbej për uljen e riskut të shoqërisë për krijimin e penaliteteve për mos pagesa në afat.

Për sa më sipër mban përgjegjësi Nëpunësi Zbatues, Drejtori i DEK znj. F. K.

- 4. Titulli i gjetjes:** Mungesa e sistemeve të kontrollit në dokumentimin e shpenzimeve të karburantit.
- Situata:** Në procesin e dokumentimit të shpenzimeve për karburant, u konstatua mungesa e ngritjes së sistemeve të kontrollit, ndarjes së përgjegjësive si dhe verifikimeve. Shpërndarja e sasive të karburantit kryhej me karta elektronike dhe sasitë e përshkuara verifikoheshin me sistemin GPS nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, por grupit të auditimit nuk iu vunë në dispozicion rregullore, urdhra të titullarëve, etj., në lidhje me organizimin e logjistikës së menaxhimit të mjeteve të shoqërisë, shpërndarjes së karburantit si dhe sistemeve të kontrolleve dhe verifikimeve përkatëse.
- Kriteri:** Udhëzimit nr.30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 35 dhe 45.
- Ndikim/Efekti:** Mungesa e sistemeve të kontrollit rrit riskun e zvogëlimin të aktiveve të shoqërisë.
- Shkaku** Jo vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore.
- Rëndësia:** E mesme.
- 4.1.Rekomandimi:** Administratori i shoqërisë dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për hartimin e rregullores së procedurave të menaxhimit të shpenzimeve për karburant, ngritjen e sistemeve të kontrollit, verifikimeve përkatëse dhe urdhrat e delegimit të përgjegjësive menaxheriale.

Për sa më sipër mban përgjegjësi Nëpunësit Autorizues z. E. V dhe Nëpunësi Zbatues, Drejtori i DEK znj. F. K.

- 5. Titulli i gjetjes:** Copëzimi i fondeve për blerje.
- Situata:** Në lidhje me procedurat e prokurimit me vlerë të vogël në periudhën 2022, u konstatua se për shërbimin e internetit është bërë copëzimi i fondit të kontraktuar. Më datë 27.05.2022 është hapur procedura për Fibër Optike, HEC Vau i Dejës-Rragam, me vlerë 400,000 lekë pa tvsh dhe me datë 27.05.2022, procedurën për “Shërbimi i lidhjes backup Data” të Kesh sh.a. me OST sha. me vlerë 700,000 lekë pa tvsh. Në të dyja procedurat e mësipërme megjithëse titujt janë të ndryshëm në thelb kërkesa është e njëjtë, pra ofrimi i fijeve optike të pandërprera me të njëjtat specifikime teknike për lidhjen e serverëve.
- Kriteri:** Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, pika 5.
- Ndikim/Efekti:** Ndarja e fondit limit dhe përdorimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, ul ekonomikitetin, efektivitetin dhe eficiencën e menaxhimit të fondeve të shoqërisë.
- Shkaku** Mos vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore.
- Rëndësia:** E mesme.
- 5.1.Rekomandimi:** AK duhet të marrë masa për trajnimin e punonjësve që kryejnë procedurat e prokurimit, duke ndikuar në rritjen e kapaciteteve të brendshme. Komisioni i blerjeve me vlera të vogla në zhvillimin e procedurave duhet të vlerësojë pjesën thelbësore të shërbimit të kërkuar, për menaxhimin e fondeve publike me efikasitet dhe

ekonomicitet.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të blerjeve me vlera të vogla, E. D, A. N, dhe A. H.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2205/85/8 Prot, datë 16.11.2023, “Komente mbi gjetjet e evindentuara në Akt-Konstatimin nr. 6” nga z. A. N ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me pretendimet për copëzimin e fondit limit, në nuk qëndrojnë pasi është kryer vetëm procedura për shërbimin e internetit me “V” sh.a., me vlerë 390.000 lekë pa tvsh.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, observacioni merret pjesërisht në konsideratë.

6. Titulli i gjetjes: Parregullsi në pagesat me bankë.

Situata: Gjatë auditimit të pagesave të kryera me bankë u konstatua se KESH sh.a., më datë 12.11.2018, ka lidhur marrëveshjen kuadër me shoqërinë A. sh.p.k., me objekt “Riparimin e automjeteve të KESH sh.a. për një periudhë 3 vjeçare me vlerë 161,138,520 lekë me Tvsh. Pas përfundimit të periudhës 3 vjeçare KESH sh.a., e rinovuar kontratën për pjesën e mbetur të vlerës së fondit limit. Në procesin e dokumentimit të shpenzimeve për riparime automjeteve u konstatuan parregullsi. Nga nëpunësi zbatues nuk janë zbatuar veprimet që duhet të kryejnë strukturat e nëpunësit zbatues. Në procedurat e pagesave mungonin dokumentet justifikues të marrjes në dorëzim si proces verbalet e firmosura nga komisioni, certifikatat për origjinalitetin dhe cilësinë e pjesëve që ishin ndërruar si dhe proces verbalet për hyrjet në magazinën rekupero të pjesëve të vjetra të ndërruara. Në kontratën e lidhur mes palëve, pika 6.2 është përcaktuar se pas përfundimit të punës, kontraktuesi njofton AK se automjeti është riparuar dhe ky njoftim shoqërohet me faturën tatimore të shërbimit, situacionin përkatës të riparimit dhe shërbimit të kryer të firmosur nga përfaqësuesit e dy palëve, akt verifikimin e kryerjes së riparimit dhe të shërbimit nënshkruar nga përfaqësuesi i KESH sh.a., drejtuesi i automjetit përkatës dhe përfaqësuesi i “A” sh.p.k., dhe certifikatën e garancisë së riparimit dhe shërbimit të kryer. Nga auditimi i situacioneve të paraqitura për pagesat e riparimeve u konstatuan se riparimet si dhe pjesët e zëvendësuara që kalojnë vlerën e 10,000 lek, si dhe me jetëgjatësi më të madhe se një vit, duke u klasifikuar si aktive afatgjata dhe jo si shpenzime të periudhës, sipas pikës 29 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” nuk janë trajtuar sipas udhëzimit sa më sipër. Në marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara titullari i AK miraton urdhrin për ngritjen e një komisioni për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale. Në kontratën mes

palëve është rënë dakord vetëm për një përfaqësues të KESH sh.a. për të nënshkruar aktin e verifikimit të kryerjes së riparimit dhe shërbimit. Në lidhje me verifikimin e sasisë, cilësisë, llojin, plotësinë e tyre dhe te dokumentacionit shoqërues u konstatua se vetëm në disa raste pjesët e ndërruara janë kthyer dhe bërë hyrje në magazinën e materialeve të nxjerra jashtë përdorimit. Në DST e procedurës është përcaktuar se *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit / prodhuesve apo distributorit të autorizuar si dhe skemat origjinale të montimit për pjesët e këmbimit që do të montohen gjatë riparimit për mallrat e paraqitura ne Tabelën teknike bashkëlidhur DT, pjesët që i përkasin të dhënave teknike për këto artikuj duhet të jene të përkthyer ne gjuhen shqipe. Tabelat e Artikujve/mallrave të kërkuarte paraqitura nga Autoriteti Kontraktor ne Shtojcën 9 (Specifikimet teknike) ne DT duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë zërat e riparimit që kërkojnë ne këto tabela. Te këto tabela nga ofertuesi duhet të plotësohet Emri i kompanisë prodhuese, Emërtimin e katalogut të artikullit/ produktit , Nr. i faqes se këtij katalogu si dhe kodin origjinal te pjesës se këmbimit që do të montohet gjatë riparimit te mjetit, për të gjithë zërat e riparimit të kërkuar ne Shtojcën 9 te DT. Mosplotësimi korrekt dhe i sakte i tabelës, është kusht skualifikues. Pra dokumentacioni vërtetues që vërteton kryerjen e veprimeve ekonomike, që në këtë marrëveshje kuadër është akti i verifikimit të riparimit të pjesëve të këmbimit të automjeteve, i nënshkruar nga një përfaqësues i KESH sh.a., dhe jo nga komisioni përkatës, i pa shoqëruar me aktet e hyrjeve në magazinën rekupero të pjesëve të zëvendësuar, pa pasur dokumente të tjera për të vërtetuar se pjesët e zëvendësuar plotësojnë kushtet teknike të kërkuara në procedurë, si emri i kompanisë prodhuese të paraqitur në ofertën e OE, emërtimi i katalogut, numri i pjesës së këmbimit në skemën origjinal të katalogut si dhe kodi origjinal i pjesës së këmbimit, elementë vërtetues që pjesët e këmbimit janë origjinale sipas ofertës.*

Kriteri:

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12 dhe 16.2.

Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011, i ndryshuar, ”Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, pika 52.

Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011, i ndryshuar, ”Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, ku citohet: “*Përgjegjësia e Titullarit të njësisë publike. 5. Titullari i njësisë publike është përgjegjës për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.*” 29. **Kufiri minimal** për pragun e vlerësimit të aktiveve afatgjata materiale **është 10000 leke dhe afat përdorimi mbi një vit.** Nëpunësi Autorizues i njësisë duhet të vendosë një prag të arsyeshëm për vlerësimin e aktiveve nga afatshkurtra në afatgjata nëse nuk plotësohet njëringa dy kushtet e mësipërme.

36. Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove

ligjore ose administrative¹². Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve. 37. Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë **verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit** (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, **referuar kushteve të përcaktuara në kontratë**). 42. Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues. 43. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushë s sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjës in me përgjegjësi materiale. 109. Aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillestare, gruposur ose djegur.

Në kreun V, Të tjera, të udhëzimit, pika 122, në Gjurmët Standarde të Auditit, germa c, Gjurma për marrjen në dorëzim të aktiveve, **përcakton se titullari i shoqërisë urdhëron ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të aktiveve, i cili kryen verifikimin fizik të sasisë, çmimit, si dhe verifikon përputhshmërinë me specifikimet e dakordësuara më parë.**

Ndikim/Efekti:

Deri më datë 31.12.2022, shoqëria “A” sh.p.k., i ka faturuar KESH sh.a., vlerën 156,544,680 lekë për riparime dhe shërbime të automjeteve. **Vlera 156,544,680 lekë përbën efekt ekonomik negativ për KESH sh.a.**

Shkaku

Mos vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore.

Rëndësia:

E lartë.

6.1.Rekomandimi:

Administratori i shoqërisë KESH sh.a., nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të zbatimit të kontratave për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve publike, **në vlerën 156,544,680 lekë, e cila përbën efekt ekonomik financiar negativ.** Administratori i shoqërisë të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive administrative, si për hartimin e procedurave dhe kontrolleve që verifikojnë shpenzimet e kryera për automjete.

Për sa më sipër mban përgjegjësi ish Administratori i KESH A. H për mos ngritjen e komisionit të pranimit të aktiveve dhe trajtimin e tyre si aktive afatgjata dhe Nëpunësi Zbatues, Drejtori i DEK znj. F. K për mos verifikimin e dokumenteve justifikues në pagesat e kryera.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me email, datë 04.01.2024, “Komente mbi gjetjet e evidentuara në Akt-Konstatimin nr. 6” nga z. A. H, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Ish administratori i shoqërisë z. A. H ka sjellë në vëmendje faktin që kontrata është lidhur më datë 12.11.2018 dhe se ai është larguar nga drejtimit i shoqërisë më datë 29.01.2019. Faturimet dhe pagesat për shërbime të marra nga KESH janë kryer pas datës që ai është larguar. Më pas subjekti pretendon se përgjegjësia e tij nuk qëndron pasi nuk ishte më në detyrë duke cituar dispozita ligjore të ndryshme dhe kërkon rishikimin e konkluzionit të grupit të auditimit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë që z. A. H është pjesë e akt konstatimit jo për periudhën që kontrata është zbatuar por për kontratën që ka lidhur me OE fitues “A” sh.p.k, për veprime jo në përputhje me ligjin ligjit Nr. 10 296, datë 08.07.2010 i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011, i ndryshuar, ”Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”.

-Në fund të vitit 2018, KESH ka kryer një procedurë prokurimi për mirëmbajtje të automjeteve, me afat 3 vjeçar dhe me fond limit 161,138,520 lekë me Tvsh. Në dokumentet standarde të tenderit të filluara në gusht 2018, është përcaktuar fondi limit 134,282,100 (Njëqind e tridhjetë e katër milion e dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e njëqind) lek pa Tvsh për tre vite, nga të cilat 44,760,700 Lek pa TVSH për vitin 2018, me afat kohor për dorëzimin e ofertave më 24.09.2018. Gjithashtu në DST, pika 2.9, kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin është parashikuar 36 muaj ose me mbarimin e fondit limit.

Në kushtet e përgjithshme të kontratës, neni 2.1, është cilësuar se “Kontratë do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktorit dhe përbëhet nga dokumentet e tenderit, duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentet e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

Më datë 12.11.2018 është lidhur kontrata me afat 3-vjeçar dhe me fond limit 161,138,520 lekë me Tvsh.

Grupi i auditimit ka shqyrtuar kontratën e lidhur nga z. A. H, për arsye të mos llogaritjes së saktë të fondit limit nga KESH sha, për shpenzime të riparimit të automjeteve në vitin 2018. Nëse përlllogaritjet do të ishin kryer me besueshmëri, kontrata do të kishte përfunduar brenda afatit 3 vjeçar dhe nuk do të zgjatej deri në vitin 2023.

Në DST e procedurës është përcaktuar se *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë katalogun e prodhuesit / prodhuesve apo distributorit të autorizuar si dhe skemat origjinale te montimit për pjesët e këmbimit që do të montohen gjatë riparimit për mallrat e paraqitura në Tabelën teknike bashkëlidhur DT, pjesët që i përkasin të dhënave teknike për këto artikuj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe. Tabelat e Artikujve/mallrave te kërkuarte paraqitura nga Autoriteti Kontraktor ne Shtojcën 9 (Specifikimet teknike) ne DT duhet te plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për te gjithë zërat e riparimit qe kërkohen ne këto tabela. Te këto tabela nga ofertuesi duhet te plotësohet Emri i kompanisë prodhuese, Emërtimin e katalogut te artikullit/ produktit, Nr. i faqes se këtij katalogu si dhe kodin origjinal te pjesës se këmbimit qe do te montohet gjate riparimit te mjetit, për te gjithë zërat e riparimit te kërkuar ne Shtojcën 9 te DT. Mosplotësimi korrekt dhe i sakte i tabelës, është kusht skualifikues.*

Në kontratën e lidhur mes palëve datë 12.11.2018, me nr. 4593/8 Prot., neni 6, Kushtet e dorëzimit të automjetit për tu riparuar, pika 6.2, përcaktohet se kontraktuesi do të fillojë menjëherë punën për riparim, dhe pas përfundimit të punës ai njofton AK se automjeti është riparuar dhe ky njoftim shoqërohet me faturën tatimore të shërbimit, situacionin përkatës të riparimit dhe shërbimit të kryer, i nënshkruar nga përfaqësuesi i KESH dhe përfaqësuesi i “A” sh.p.k për këtë kontratë, Akti i verifikimit të kryerjes së riparimit dhe shërbimit i nënshkruar nga përfaqësuesi i KESH dhe përfaqësuesi i “A” sh.p.k, proces verbali i marrjes

në dorëzim të automjetit përkatës dhe certifikata e garancisë së riparimit dhe shërbimit të kryer.

Në nenin 7, kushtet e pagesës keni përcaktuar faturën tatimore, situacionin përkatës të riparimit, aktin e verifikimit të kryerjes së riparimit dhe shërbimit, i nënshkruar nga përfaqësuesi i KESH dhe përfaqësuesi i “A” sh.p.k , proces verbali i marrjes në dorëzim të automjetit përkatës dhe certifikata e garancisë së riparimit dhe shërbimit të kryer.

Në përcaktimet sa më sipër administratori në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, në zbatim të Udhëzimit nr. 30, duhet të kishte ngritur së pari një komision për marrjen në dorëzim, dhe jo me një akt verifikimi i nënshkruar nga një person.

Në procesin e kryerjes së riparimit dhe shërbimit në nenin 6 keni përcaktuar se pas përfundimit të punës Kontraktuesi njofton AK se automjeti është riparuar dhe ky njoftim shoqërohet nga situacioni dhe akt verifikimi i kryerjes së riparimit ose shërbimit. Pra përfaqësuesi i KESH pas përfundimit të punës, mban një akt verifikimi për kryerjen e riparimit.

Në procedurën sa më sipër e përcaktuar në kontratë nga administratori i KESH nuk janë përfshirë elementët e kapacitetit teknik, mbi të cilët është shpallur fitues OE, procedura kontrolli për të vërtetuar se pjesët e zëvendësuara plotësojnë kushtet teknike të kërkuara në procedurë, si emri i kompanisë prodhuese të paraqitur në ofertën e OE, emërtimi i katalogut, numri i pjesës së këmbimit në skemën origjinal të katalogut si dhe kodi origjinal i pjesës së këmbimit, elementë vërtetues që pjesët e këmbimit janë origjinale sipas ofertës.

Në pikën 23 të nenit 4, të ligjit Nr. 10 296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, përcaktohet se në cilësinë e “Nëpunësit autorizues”, administratori është nëpunësi i nivelit më të lartë të menaxhimit në njësinë publike, përgjegjës për zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej tyre.

Observacioni nuk merret në konsideratë

III.2.5. Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

Për periudhën e auditimit janë realizuar 58 procedura prokurimi (33 në vitin 2021 dhe 25 në vitin 2022) me vlerë të fondit limit 4,015,560,832 lekë, me vlerë të kontratave të nënshkruara 3,864,744,488 lekë.

Nga 58 procedura të realizuara, 43 janë procedura të hapura, 12 procedura të hapura të thjeshtëzuara dhe 3 procedura kërkesë për propozim.

Për 58 procedura të realizuara në 22 procedura është paraqitur vetëm një ofertues. Në 20 procedura prokurimi, kanë marrë pjesë vetëm dy ofertues, ku në tre procedura, ofertuesi nuk ka paraqitur dokumente. Duke përjashtuar procedurat marrëveshje kuadër, në 7 procedura kanë marrë pjesë 3 ofertues, në 3 procedura 4 ofertues, në 2 procedura 5 ofertues dhe në 1 procedurë 9 ofertues.

Vlera e prokurimit me një ofertues rezulton në shumën 1,270 milionë lekë (548 milionë lekë për vitin 2021 dhe 722 milionë lekë për vitin 2022), ose 31.6 % e vlerës së prokuruar.

Nga sa më sipër konstatohet se në procedurat e prokurimit marrin pjesë në numër i vogël i operatorëve ekonomikë. Tabela e procedurave të realizuara, paraqitet në aneksin 5.1.

Nga auditimi u konstatuan mangësi të cilat paraqiten në vijim:

A. Mbi auditimin e procedurave të prokurimit.

1. Mbi auditimin e zbatimit të Procedurës së Prokurimit: “Rehabilitimi i ndërtesës së centralit HEC Koman”.

Nga auditimi konstatohet se:

Realizimi i procedurës “Rehabilitimi i ndërtesës së centralit HEC Koman”, është parashikuar në Programin Ekonomik të Shoqërisë për vitin 2021. Kërkesa për nisjen e procedurës është bërë nga DGG me shkresë nr. 1259 prot., datë 23.02.2021. Fondi limit është përlllogaritur me vlerë 127,000,000 lekë, nga hartuesi i projektit BOE “A SHPK, S. C. SHPK, dhe I. SHPK”, projekt i pranuar me shkresë nr. 1227/7 prot., datë 15.10.2019, nga grupi i punës i përbërë nga z. M. M, z. Z. Sh dhe z. F. Z, znj. E. S dhe z. I. Sh. Akordimi i fondit është bërë bazuar në shkresën nr. 1259/3 prot., datë 23.02.2021. Nga verifikimi i preventivit të punimeve sipas kontratës “Rehabilitimi i ndërtesës së centralit HEC Koman”, rezulton se sipas zërit II.2 “Shtresë betoni e lehtësuar për pjerrësi $t = 8$ cm (mes)”, është përcaktuar sasia 931 m³. Kjo sasi është përlllogaritur për sipërfaqen 931 m². Sasia e betonit respektive për sipërfaqe 931 m² dhe trashësi 8 cm rezulton në masën 74.5 m³. Sa më sipër, fondi limit është përlllogaritur më shumë me vlerë 6,995,232 lekë rrjedhimisht fondi limit duhet të ishte me vlerë 120,004,768 lekë. Ky gabim është rregulluar gjatë zbatimit të kontratës. Sasia e raportuar e punimeve sipas zërit II.2 “Shtresë betoni e lehtësuar për pjerrësi $t = 8$ cm (mes)”, është 74.5 m³.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

Procedura e Prokurimit: “Rehabilitimi i ndërtesës së centralit HEC Koman”.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 1259/4, prot., datë 23.02.2021.	3. njësia e prokurimit E.K B. K (spec.prok) I. Sh (spec.fushës)	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Urdhrit nr. 1259/5 prot., datë 23.02.2021. A. R K. H Y. N
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit E hapur (punë)		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 127,000,000 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 123,864,161 lekë	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 3,135,839 lekë
8. Data e hapjes së ofertave	9. Burimi i Financimit	10. Operatorët Ekonomikë

14.05.2021	Financim nga të ardhurat e KESH	1. Shoqëria “C” me vlerë oferte 123,864,161 lekë. 2. “J & C”, me vlerë oferte 106,093,642 lekë. 3. “E –V”, nuk ka paraqitur dokumentacion. b. Skualifikuar – 2 OE		
11. Ankimime “J & C” SHPK	12. Përgjigje e ankesës nga AK Nr. 2365/3 prot., datë 05.05.2021.	13. Përgjigje ankesës nga KPP -		
b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave				
14. lidhje e kontratës nr. 1259/8 prot., datë 28.05.2021	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 143,194,853 lekë	16. Likuiduar - lekë Pa likuiduar: - lekë		
17. Situacioni përfundimtar/faturë malli/shërbimi` Vlera 143,177,669 lekë	18. Afati i kontratës në ditë. Parashikuar 6 muaj Zbatuar: 8 muaj	19. Zgjatja e kontratës me ditë Shkresa (amendamenti) nr. Datë - nr. 634/5 prot., datë 25.02.2022.		
20. Mbikëqyrësi i punimeve “Gj& Co” SHPK	Licencë nr. MK 1735/18	Kontrata nr. 3257/3, datë 02.07.2021	Likuiduar	Pa likuiduar lekë
21. Kolaudatori i punimeve “A & E ”	Licencë nr. MK 1467/12	Kontrata nr. 2787/4, datë 14.06.2022	Likuiduar	Pa likuiduar
22. Aktkolaudimi 15.07.2022	23. Akti i marrjes në dorëzim. Nr. 293 prot., datë 10.08.2022	24. Fletë Hyrja		

Njoftimi i kontratës është botuar në Buletinin e APP nr. 29, datë 01.03.2021.

Mbi hartimin e dokumenteve të tenderit.

Dokumentet e tenderit janë përgatitur nga njësia e prokurimit, për të cilat nga ana e APP me email të datës 25.02.2021, janë paraqitur disa rekomandime për rishikimin kryesisht të kriterëve të veçanta. Nga ana e njësisë së prokurimit janë marrë në konsideratë një pjesë e rekomandimeve të APP.

- 1. Titulli i gjetjes:** Janë hartuar kriterë të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e punimeve të kontratës.
- Situata:** Nga shqyrtimi i kriterëve të veçanta sipas procedurës së prokurimit “Rehabilitimi i ndërtesës së centralit HEC Koman”, rezulton ndër të tjera se është përfshirë:
- a. Licenca sipas kategorive.**
- NP - 12 C “Punime të inxhinierisë së mjedisit”.
 - NS - 1 B “Punime për prishjen e ndërtimeve”.
 - NS - 14 C “Implante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.”.
 - Bazuar në preventivin përkatës, nuk ekzistojnë punime të cilat kanë të bëjnë me aspekte mjedisore. Materialet që dalin nga prishja e shtresave të betonit apo shtresa pllakash, nuk janë në vetvete punime të inxhinierisë së mjedisit, por mbetje inerte të cilat transportohen në landfille apo zona të miratuara. **Nuk argumentohet vendosja e këtij kriteri.**
 - Punimet e prishjes kanë të bëjnë me prishje shtresa suvaje, shtresa betoni, pllaka etj., por në asnjë rast nuk kanë të bëjnë me prishje ndërtimesh, strukturash etj., për të cilat kërkohet teknologji e caktuar, paraqesin rrezik etj. **Nuk argumentohet vendosja e këtij kriteri.**
 - Në preventiv nuk ka zëra punimesh të cilat kanë të bëjnë me

impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, tv etj., punimet elektrike të parashikuara nuk kanë të bëjnë me impiante.

Nuk argumentohet vendosja e këtij kriteri.

b. Staf teknik.

- 1 Inxhinier Ndërtimi, me eksperience pune te paktën 20 vjet
- 1 Inxhinier Gjeodet, me eksperience pune te paktën 15 vjet
- 1 Inxhinier Mekanik, me eksperience pune te paktën 10 vjet
- 1 Inxhinier Mjedisi, me eksperience pune te paktën 10 vjet.
- 1 Inxhinier Hidroteknik, me eksperience pune te paktën 15 vjet.
- 1 Inxhinier Elektrik, me eksperience pune te paktën 10 vjet.

Sa më sipër, bazuar në llojin e punimeve, vendosja e një inxhinieri hidroteknik është e pa argumentuar, pasi inxhinieri i ndërtimit mbulon të gjitha aspektet e rehabilitimit të ndërtesës. Inxhinieri gjeodet është i pa nevojshëm, pasi nuk kemi të bëjmë me punime topogjeodezike, po thjesht rikonstruksione. Inxhinieri i mjedisit nuk ka asnjë aspekt për të mbuluar në zërat e punimeve të parashikuara. Po ashtu, vendosja e eksperiencës së punës nga 10 deri 20 vjet **është e pa argumentuar**, për natyrën e punimeve të cilat do realizohen.

Krahas stafit të mësipërm, është kërkuar edhe staf mbështetës si më poshtë:

- 3 inxhinierë ndërtimi, profile strukturist.
- 1 inxhinier ndërtimi, profile gjeoteknik.
- 1 inxhinier ndërtimi, master menaxhim projektesh.
- 1 inxhinier gjeoinformatike/gjeomatike.
- 1 inxhinier mjedisi, profile energjetikë.

Kërkesa për stafin e mësipërm është absolutisht e pa argumentuar. Kontrata ka të bëjë me punime riparimesh, rikonstruksionesh, rrjeti elektrik, etj., dhe si pasojë **nuk nevojitet stafi i mësipërm**. Përcaktimi inxhinier ndërtimi, master menaxhim projektesh nuk është përcaktim i saktë.

c. Makineri (pronësi, ose me qira).

- Kamion vetëshkarkues, 12-30 ton 5 copë.
- Kamion vetëshkarkues, 3 deri 11 ton, 3 copë.
- Kamionçinë (deri 3.5 ton), 4 copë.
- Kamion me vinç deri 5 ton, 1 copë.

Nga verifikimi në mënyrë të përafërt i zërave të punimeve për realizim, volume i materialeve të parashikuar për transport, largim mbetjesh inerte, apo material ndërtimi nuk klon sasinë 2000 m³. Një kamion me peshëmbajtje 12 deri 30 ton, (duke marrë në konsideratë distance të përafërta transporti), mund të transportojë 60 m³ në ditë, ose mund të transportojë materialin për një periudhë 45 ditore. Nuk argumentohet në asnjë rrethanë kërkesa për 8 kamionë dhe 4 kamionçina dhe një kamion me vinç, duke marrë në konsideratë se kamioni me vinç mund të realizojë transportin a materialeve të parashikuara. Vendosja e numrit të automjeteve sa më sipër **është i pa argumentuar**.

Kriteri: VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i shfuqizuar), neni 26, pika 5.

Ndikimi: Kriteret jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, ulin pjesëmarrjen e OE në procedurën e prokurimit.

Shkaku Mos përlllogaritja e stafit dhe makinerive, sipas preventivit të punimeve që do realizohen.

Rëndësia: E lartë.
Nga ana e KESH, të merren masa për vendosjen e kritereve teknike
1.2.Rekomandimi: ekonomike në përputhje me volumin dhe natyrën e kontratës dhe që favorizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi anëtari i Njesisë së Prokurimit z. I. Sh (specialist i fushës).

Për sa është trajtuar në këtë pjesë, nga subjekti i audituar znj. E. M dhe z. Dh. T, është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2205/72 prot., datë 08.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 407/12, datë 17.01.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në bazë të ligjit për ndikimin në mjedis, përfshihet vlerësimi i ndikimit në mjedis dhe është vlerësuar se në objekt ka punime që lidhen me inxhinierinë e mjedisit. Në lidhje me transportin e mbetjeve përcaktohet transporti do të bëhet në një vend të autorizuar publik. Pretendohet se kërkesat janë vendosur për të plotësuar kërkesat që lindin nga projekti i zbatimit për aftësinë punëtore të operatorit në bazë të natyrës dhe volumit të punimeve që do të realizohen. Objekti i godinës së centralit konsiderohet disa objekte, pasi ka ndarje me fuga ndërmjet tyre.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Projekti i rikonstruksionit të një godine nuk ka lidhje me punime të inxhinierisë së mjedisit. Transporti është rregulluar me akte nënligjore, të cilat përcaktojnë mënyrën e transportit dhe depozitimin e tyre.

Në lidhje me stafin teknik, kërkesat janë shumë më të larta se sa kërkohet krahasuar me volumin e punimeve të parashikuara.

Mbi vlerësimin e ofertave.

Në tender kanë marrë pjesë 3 OE, nga të cilët 1 nuk ka paraqitur ofertë financiare.

BOE "J& C SHPK", kanë paraqitur ankesë për skualifikimin nga gara, protokolluar në KESH me nr. 2365 prot., datë 27.04.2021. Pas pezullimit të procedurës është bërë shqyrtimi i ankesës nga komisioni i përbërë nga z. B. K, z. R. H dhe znj. E. K. KSHA ka shqyrtuar animimin dhe ka marrë vendim për mos pranimin e ankesës. Njoftimi mbi shqyrtimin e ankesës është bërë me shkresë nr. 2365/3 prot., datë 25.05.2021. Njoftimi i fituesit është publikuar në Buletinin e APP nr. 79, datë 24.05.2021. Është shpallur fitues OE "C" SHPK, me vlerë të ofertës 123,864,161 lekë.

2. Mbi auditimin e ushtruar për zbatimin e Procedurës së Prokurimit: "F.V i sistemit të thithjes dhe largimit të gazrave pas shuarjes së zjarrit CO₂ në gjeneratorët e agregateve dhe hermetizim të dhomave të gjeneratorëve në HEC Fierzë dhe Koman".

Kërkesa për realizimin e procedurës së prokurimit është bërë nga Drejtori i Departamentit të Gjenerimit (DGJ) z. E.N. Termat e referencës janë përgatitur nga Grupi i Punës i përbërë nga z. Xh. B, z. Dh. T, znj. E. M, znj. R. A, kontrolluar nga z. T. D.

Në projektpreventivin e përgatitur është vendosur edhe fond rezervë në masën 5 %, ndërkohë që kontrata është konceptuar me çelësa në dorë.

Punimet kanë të bëjnë me ndërtimin e një sistemi të thithjes dhe largimit të gazit CO₂ i cili përdoret në raste të fikjes së zjarrit dhe futja e ajrit të freskët në dhomat e gjeneratorëve.

Për përllogaritjen e fondit limit është aplikuar studimi i tregut. Urdhri për ngritjen e grupit është me nr. 3258/1 prot., datë 21.06.2021, nga Drejtori i Prokurimeve znj. A. M. Në përbërje të grupit janë caktuar znj. E. M dhe znj. K. H.

Ftesa për ofertë i është drejtuar 4 OE dhe konkretisht: OE "AE" SHPK, "Sh I" SHPK, "J" SHPK dhe "E." SHPK, me shkresë nr. 3258/2 prot., datë 21.06.2021, transmetuar me anë të

email të datës 22.06.2021, si dhe 2 OE: “Gj” SHPK dhe “Sh A” SHPK, me anë të email të datës 01.07.2021.

Për katër operatorët e parë është kërkuar paraqitja e ofertës për datë 29.06.2021, ndërsa për dy operatorët e tjerë për datë 07.07.2021.

Bazuar në relacionin e përgatitur nga grupi i punës, fondi limit është përllogaritur me vlerë 37,895,025 lekë.

Me shkresë nr. 4136 prot., datë 10.08.2021, Drejtori i DGJ, ka kërkuar fillimin e procedurës për prokurimin “Furnizim montim tubacione metalike për largimin nga salla e droselave të CO₂ të sistemeve të MNZ të 4 agregateve në HEC Koman”.

Për këtë qëllim, është aplikuar studimi i tregut, nëpërmjet dërgimit të kërkesës për ofertë për 5 OE. Kanë kthyer përgjigje 3 OE. Nga përllogaritjet ka rezultuar vlera 22,174,600 lekë. Drejtorja e mësipërme, me shkresë nr. 4505 prot., datë 13.09.2021, ka kërkuar bashkimin e dy procedurave, duke qenë se kanë ngjashmëri. Fondi limit për procedurën e përbashkët është përcaktuar 60,000,000 lekë.

Mbi hartimin e dokumenteve të tenderit.

Njoftimi i shkurtuar i kontratës është bërë me nr. 3258/8 prot., 15.09.2021. Njoftimi është botuar në Buletinin e APP nr. 148, datë 11.10.2021.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

Procedura e Prokurimit: “Ndërhyrje për mirëmbajtjen e sistemeve të CO₂ në HEC Fierzë dhe HEC Koman”.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 3258/6, prot., datë 15.09.2021.	3. njësia e prokurimit E. M (spec.fushes) Dh. T (spec.fushës) K. H	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Urdhrit nr. 3258/7 prot., datë 15.09.2021. A. M A. K Xh. B
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit E hapur (punë) Kontratë me çelësa në dorë		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 60,000,000 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 57,750,000 lekë	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 2,250,000 lekë
8. Data e hapjes së ofertave 04.10.2021	9. Burimi i Financimit Financim nga të ardhurat e KESH	10. Operatorët Ekonomikë 1. Shoqëria “J” me vlerë oferte 57,750,000 lekë. b. Skualifikuar – 0 OE
11. Ankimime -	12. Përgjigje e ankesës nga AK -	13. Përgjigje ankesës nga KPP -
b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. lidhje e kontratës nr. 3258/10 prot., datë 18.10.2021	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 69,300,000 lekë	16. Likuiduar - lekë Pa likuiduar: - lekë

Kriteret e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga z. Dh. Tdhe znj. E. M.

1. Titulli i gjetjes:

Situata:

Kritere jo në përputhje me kontratën.

Sipas procedurës së prokurimit “Ndërhyrje për mirëmbajtjen e sistemeve të CO₂ në HEC Fierzë dhe HEC Koman”, në pikën 2.3.5 të kriterëve të veçanta është kërkuar: “1 inxhinier elektrik të certifikuar për realizimin e interfejsit dhe integrimin me sistemin e shuarjes së CO₂”. Në shtesën e dokumenteve të tenderit, pas rekomandimit të APP, ky kriter është sqaruar duke cilësuar: “Për inxhinierin elektrik duhet të paraqitet certifikata e kërkuar e lëshuar nga kompani prodhuese të sistemeve CO₂ ose ente të autorizuar për këto certifikime”.

Kriteri i mësipërm është argumentuar me përcaktimin: “Inxhinieri elektrik duhet të jetë i certifikuar nga kompani prodhuese të sistemeve CO₂, ose ente të autorizuar për këto certifikime”.

Sistemi i cili është parashikuar të ndërtohet sipas kësaj kontrate ka të

bëjë vetëm me vendosje tubacionesh për largimin e gazit karbonik i cili përdoret për shuarjen e zjarrit dhe futjen e ajrit natyror, pra një sistem i thjeshtë kondicionimi. Sa i përket sistemit të shuarjes së zjarrit me CO₂, ky sistem është ndërtuar nëpërmjet një kontrate të realizuar më parë. **Ky kriter nuk është i lidhur me objektin e kontratës dhe është i pa argumentuar.**

Në kriteret e veçanta është vendosur kërkesa për inxhinier mjedisi me argumentimin: “Është kërkuar në përputhje me objektin e kontratës, i cili konsiston në largimin e gazrave CO₂ nga ambientet e brendshme dhe emetimin e tyre në ambientet e jashtëmedhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 162/2014 “Mbi mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit”. Sistemi i cili është parashikuar për ndërtim nuk ka lidhje me çështje mjedisore, pasi gazrat CO₂ në raste zjarri, duhet të nxirren në ajër për të siguruar ambient të përshtatshëm pune për punonjësit, i cili shprehur thjesht është një sistem aspirimi. **Ky kriter nuk është i lidhur me objektin e kontratës dhe është i pa argumentuar.**

Kriteri: Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 77, pika 1.

Ndikimi: Vendosja e kriterëve specifike dhe të pa argumentuar, ndikon në nivelin e pjesëmarrjes së OE në procedurën e prokurimit.

Shkaku Mos analizim i duhur i kapaciteteve teknike të nevojshme për realizimin e kontratës.

Rëndësia: E lartë.

1.1.Rekomandimi: Nga ana e KESH, të merren masa për vendosjen e kriterëve teknike ekonomike në përputhje me volumnin dhe natyrën e kontratës dhe që favorizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi z. Dh. T dhe znj. E. M.

Mbi vlerësimin e ofertave.

Raporti përmbledhës është miratuar nga Titullari i AK z. E. V me datë 14.10.2021. kontrata është nënshkruar me datë 18.10.2021. Formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar është publikuar në Buletinin e APP nr. 154, datë 25.10.2021.

2. Titulli i gjetjes: Kualifikim i OE, megjithëse nuk plotëson kriteret e vendosura në DT.
Situata: Në tender ka marrë pjesë vetëm një OE, konkretisht “J” SHPK. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE “J” SHPK rezulton se në lidhje me kriterin “1 inxhinier elektrik të certifikuar për realizimin e interfejsit dhe integrimin me sistemin e shuarjes së CO₂”, ka paraqitur dokumentacionin për pjesëmarrje në trajnim me një cikël 40 orësh nga inxhinieri elektrik, por jo për certifikim të realizimit të këtyre sistemeve.

Kriteri: Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 92, pika 3.

Ndikimi: Nuk paraqet ndikim, pasi kriteri i pa plotësuar nuk ka lidhje me punimet e kontratës.

Shkaku Mos verifikimi i të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga OE.

Rëndësia: E mesme.

2.1.Rekomandimi: Nga ana e KESH SHA të merren masa për angazhimin e punonjësve me eksperiencë në fushën e prokurimit publik, në mënyrë që procedurat të zhvillohen duke plotësuar kërkesat e ligjit dhe parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë nga znj. A. M, znj. A. K dhe z. Xh. B.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë, nga subjekti i audituar znj. E. M dhe z. Dh. T, është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2205/68 prot., datë 08.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 407/12, datë 17.01.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Duke qenë se largimi i sistemit të gazrave në HEC Koman është i integruar në sistemin e shuarjes me CO₂, kërkohet që edhe në HEC Fierzë sistemi i largimit të gazrave nga gjeneratori të integrohet në sistemin e shuarjes së CO₂, duke qenë se këto sisteme janë automatike. Për këtë arsye është kërkuar që OE të ketë në stafin e tij një inxhinier elektrik të certifikuar për realizimin e interfejsit të sistemit të shuarjes së zjarrit.

Kërkesa për inxhinier mjedisi është bërë pasi kontrata i përket largimit të gazrave CO₂.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Sa i takon kërkesës për inxhinier elektrik të certifikuar për realizimin e interfejsit të shuarjes së zjarrit, sqarojmë se ky sistem është realizuar nëpërmjet një kontrate të ndarë nga kontrata e sistemit të thithjes dhe largimit të gazrave.

Sistemi i largimit të gazrave nga dhomat e gjeneratorëve nuk ka lidhje me çështje mjedisore, pasi gazrat e mundshme thjesht do të nxirren nga dhomat dhe shkarkohen në ajër. Punimet sipas kësaj kontrate janë të fushës elektromekanike dhe jo mjedisore.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë, nga subjekti i audituar znj. A. K dhe znj. A. M, është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2205/60 prot., datë 08.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 407/12, datë 17.01.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

KVO pretendon se është e pa qartë shkelja e konstatuar, pasi kriteri i vendosur nga Njësia e Prokurimit është konsideruar si i pa argumentuar, si dhe nuk ka patur ndikim. Në lidhje me vlerësimin e ofertave pretendohet se certifikata e trajnimit është e vlefshme me certifikatë realizimi, pasi kjo certifikatë jepet pasi realizohet një kurs trajnimi me një program të caktuar. Përderisa organi certifikues ka lëshuar një certifikatë për personin në fjalë do të thotë se i gjithë programi i trajnimit është ezauruar dhe personi është i aftë të realizojë punime në sisteme automatike të shuarjes së zjarrit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Nga auditimi kriteri është konsideruar i pa argumentuar, por nga ana e KVO nuk ka patur ndonjë vërejtje për këtë kriter dhe vlerësimi është bërë duke e konsideruar si kriter të argumentua. Certifikata e paraqitur titullohet “Certifikatë trajnimi” dhe vërteton temat e trajtuara për një periudhë 40 orë, por nuk certifikon aftësinë e punonjësit për realizimin e sistemeve të tilla. Bazuar në nenin LPP neni 92, pika 3, autoriteti ose enti kontraktor, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

3. Mbi auditimin e ushtruar për zbatimin e Procedurës së Prokurimit: “Rinovim i sistemit të mbrojtjes për dy agregate me vendosje konfigurim të releve të reja që zëvendësojnë ato ekzistuese REG, RET në HEC Fierzë”.

Termat e referencës për procedurën “Rinovim i sistemit të mbrojtjes për dy agregate me vendosje konfigurim të releve të reja që zëvendësojnë ato ekzistuese REG, RET në HEC Fierzë”, janë përgatitur nga z. T. D dhe z. A. M. Kërkesa për fillimin e procedurës drejtuar Drejtorisë së Prokurimeve është bërë nga DGJ me shkresë nr. 3718 prot., datë 09.07.2021. Argumentimi i remontit lidhet me faktin se reletë ekzistuese të agregatit 1 dhe 3 janë të vjetra (me sistem operativ DOS) dhe kanë shfaqur anomali herë pas here.

1. Titulli i gjetjes:	Pasaktësi në përlllogaritjen e fondit limit.
Situata:	Për përlllogaritjen e fondit limit sipas kontratës “Rinovim i sistemit të mbrojtjes për dy agregate me vendosje konfigurim të releve të reja që zëvendësojnë ato ekzistuese REG, RET në HEC Fierzë”, është aplikuar studimi i tregut duke i’u dërguar kërkesë për ofertë 3 OE që operojnë në këtë fushë. Fondi limit është përcaktuar me vlerën më të ulët të ofruar në shumën 75,000,000 lekë. Në ofertat e paraqitura nga studimi i tregut, konstatohet se OE kanë paraqitur vlerë shumë të lartë për zërin “Trajnim i plotë 3 ditor për konfigurimin e releve të reja, back-up e fileve dhe testet, sipas specifikimeve”, konkretisht 8,200,000 lekë, 7,840,000 lekë dhe 7,840,000 lekë. Vlerat e mësipërme kanë ndikuar negativisht në rritjen e fondit limit, për një proces i cili dukshëm nuk kërkon shpenzime në nivele të tilla. Theksojmë se, në ofertën e paraqitur në tenderin e mëparshëm të ngjashëm, për këtë zë është parashikuar vlera 300,000 lekë. Nga ana e komisionit nuk është marrë në konsideratë kontrata e ngjashme e realizuar në vitin 2020 “Rinovim i sistemit të mbrojtjes për dy agregate me vendosje/konfigurim të releve të reja që zëvendësojnë ato ekzistueset REG/RET, në Vaun e Dejës”. Në preventivin e tenderit, krahasuar me tenderin e mëparshëm, janë shtuar vetëm dy zëra, ofertat për të cilat janë paraqitur si më poshtë: - Testim i karakteristikave voltampere (kurbat e faturimit) të transformatorëve ekzistues të rrymës së neurit, të terminaleve 13.8 kV dhe zbarave 13.8 kV për funksionin 78G dhe funksionin 87 (B) për Ag.1 dhe Ag.3 (oferta mesatare 350,000 lekë/copë) - Demontimi i releve ekzistuese, konfigurimi dhe testimi i funksionit të releve të reja, instalimi dhe rilidhja në skemë e releve të reja, testimi për të dy sistemet e mbrojtjes Ag.1 dhe Ag.3 (oferta mesatare 260,000 lekë/copë). Duke marrë në konsideratë çmimet e kontratës së mëparshme të ngjashme të realizuar si dhe për dy zërat e mësipërm, nga përlllogaritjet rezulton se fondi limit duhet të ishte me vlerë 72,440,000 lekë. Sa më sipër, rezulton se fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 2,560,000 lekë (75,000,000 – 72,440,000). Duke marrë në konsideratë vlerën e ofertës së paraqitur në shumën 73,500,000 lekë, diferenca me vlerë 1,120,000 lekë, konsiderohet efekt negativ financiar për buxhetin e shoqërisë.
Kriteri:	VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 76, pika 1.
Ndikimi:	Rritja e fondit limit është shoqëruar me efekt negativ financiar me vlerë 1,120,000 lekë.
Shkaku	Mos marrja në konsideratë e të gjitha alternativave, në dokumentimin e përlllogaritjes së fondit limit.
Rëndësia:	E Lartë.
1.1.Rekomandimi:	Nga ana e Njësive të Prokurimit apo strukturave që ngarkohen në përlllogaritjen e fondit limit të merren masa për shqyrtimin e gjithë alternativave, duke përcaktuar vlerën e fondit limit sa më reale.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Grupi i punës i përbërë nga znj. E. M dhe z. B. K.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

Procedura e Prokurimit: “Rinovim i sistemit të mbrojtjes për dy agregatë me vendosje konfigurim të releve të reja që zëvendësojnë ato ekzistuese REG, RET në HEC Fierzë”.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 3718/6, prot., datë 04.08.2021.	3. njësia e prokurimit T. D (spec.fushes) E. M (spec.fushës) Y. N (përgj.prok)	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Urdhrit nr. 3718/7 prot., datë 04.08.2021. A. M E. M Xh. B
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit E hapur (mallra)		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 75,000,000 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 73,500,000 lekë	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 1,500,000 lekë
8. Data e hapjes së ofertave 13.09.2021	9. Burimi i Financimit Financim nga të ardhurat e KESH	10. Operatorët Ekonomikë 1. OE “N” me vlerë oferte 73,500,000 lekë. 2. OE “D” me vlerë oferte 74,400,000 lekë. 3. OE “IT”, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike. b. Skualifikuar – 1 OE
11. Ankimime -	12. Përgjigje e ankesës nga AK -	13. Përgjigje ankesës nga KPP -
b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. lidhje e kontratës nr. 3718/11 prot., datë 08.10.2021	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 88,200,000 lekë	16. Likuiduar - lekë Pa likuiduar: - lekë

Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit. Nga ana e APP janë rekomanduar disa masa për reflektim në dokumentet e tenderit, të cilat janë marrë në konsideratë në mënyrë të pjesshme.

2. Titulli i gjetjes: Situata:

Kriter në kundërshtim me natyrën dhe volumin e kontratës.

Sipas procedurës “Rinovim i sistemit të mbrojtjes për dy agregate me vendosje konfigurim të releve të reja që zëvendësojnë ato ekzistuese REG, RET në HEC Fierzë”, është vendosur kriteri për disponim licence sipas kategorisë NS 13 “Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni”, kriteri i cili është rekomanduar të hiqet edhe nga APP. Për vendosjen e këtij kriteri, njësia ka argumentuar për t’i dhënë siguri AK që OE ofertues të ketë kapacitetet teknike për të kryer me sukses këtë kontratë, ku përfshihen instalimet dhe konfigurimet e ndryshme sipas specifikimeve teknike. Nga verifikimi i specifikimeve dhe zërave të parashikuar, kjo kontratë nuk përmban punime të impianteve, linjave telefonie apo telekomunikacioni. Sa i përket argumentimit për t’i dhënë siguri AK për realizimin me sukses të kontratës, në kërkesat e veçanta është kërkuar realizim i kontratave të ngjashme dhe kërkesa të tjera të cilat përmbushin garancinë e realizimit me sukses. Kriteri i mësipërm është i pa argumentuar.

Kriteri:

Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 77, pika 1.

Ndikimi:

Vendosja e kriterëve jo në përputhje me volumin dhe natyrën e kontratës, ndikon në uljen e pjesëmarrjes së OE në procesin e prokurimit.

Shkaku

Mos analizimi i duhur i llojit të punimeve të kontratës.

Rëndësia:

E mesme.

2.2.Rekomandimi:

Nga ana e KESH, të merren masa për vendosjen e kriterëve teknike ekonomike në përputhje me volumin dhe natyrën e kontratës dhe që favorizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit e përbërë nga z. T. D, znj. E. M dhe znj. Y. N.

Tenderi është hapur me datë 13.09.2021. Në tender kanë marrë pjesë 3 OE, një nga të cilat nuk ka paraqitur dokumentacion. Është skualifikuar OE si më sipër. Është shpallur fitues oferta me vlerë më të vogël. Njoftimi i fituesit është botuar në Buletinin e APP nr. 142, datë 27.09.2021. Nënshkrimi i kontratës është bërë me datë 08.10.2021.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë, nga subjekti i audituar znj. E. M, z. B. K, z. T. D, znj. Y. N, është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2205/74 prot., datë 09.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 407/12, datë 17.01.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Për përllogaritjen e fondit limit, grupi i punës i është referuar studimit të tregut. Bazuar në kontratën e ngjashme të realizuar në HEC Vau i Dejës, fuqia e instaluar është 50 MW, ose 2.5 herë më i vogël se gjeneratorët e HEC Fierzë.

Kriteri për disponim licence në kategorinë NS 13 është i argumentuar.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me kapacitetin e gjeneratorëve theksojmë se pretendimi do ishte i vlefshëm në rast blerje apo riparim gjeneratori dhe jo sistemeve të testimit. Nga ana e grupit të punës nuk është treguar kujdesi i duhur, pasi në ofertat e paraqitura vihen re çmime shumë të larta në lidhje me trajnimet.

Në lidhje me licencimin sipas kategorisë NS 13, theksojmë se kontrata nuk përmban punime në lidhje me këto sisteme.

4. Mbi auditimin e ushtruar për zbatimin e Procedurës së Prokurimit: “Blerje mjet lundrues për pastrimin e biefit të sipërm nga akumulimet e materialeve dhe mbetjeve urbane për Hec Fierzë”.

Fondi limit është përcaktuar me vlerë 30,000,000 lekë, bazuar në studimin e tregut. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar 30 ditë.

Dokumentet e tenderit janë përgatitur nga njësia e prokurimit e përbërë nga z. F. Z, z. B. M dhe z. F. H.

1. Titulli i gjetjes: Vendosje e specifikimeve teknike pa diapazone.

Situata: Në dokumentet e tenderit sipas procedurës së prokurimit “Blerje mjet lundrues për pastrimin e biefit të sipërm nga akumulimet e materialeve dhe mbetjeve urbane për Hec Fierzë”, shtojca 5, specifikimet teknike është përcaktuar blerja e një mjeti me karakteristikat si më poshtë:

- Gjatësia 10 m.
- Gjerësia 2.5 m.
- Kapaciteti i konvejerit 5 m³.
- Kapaciteti i rezervuarit të motorit diesel 100 litra.
- Fuqia e motorit 90 hp.
- I pajisur me krahë fshirës.
- Prodhin i vitit 2021, me kilometrazh zero.

Rezulton se janë vendosur dimensione strikte si për nga përmasat, ashtu edhe sa i përket rezervuarit dhe fuqisë së motorit, duke pamundësuar furnizimin e mjeteve të cilat mund të kenë përmasa të përafërta dhe kapacitet të përafërt i cili realizon qëllimin e kryerjes së shërbimeve të parashikuara.

Kriteri: Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 36, pika 2.

	VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 2.
Ndikimi:	Vendosja e specifikimeve me parametra fikse redukton numrin e poseduesve të mjeteve dhe rrjedhimisht ul pjesëmarrjen e OE në procedurat e prokurimit.
Shkaku	Mos analizimi i parametrave të nevojshëm për blerje mjet lundrues.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga ana e KESH, të merren masa për vendosjen e kriterëve teknike ekonomike në përputhje me volumin dhe natyrën e kontratës dhe që favorizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga z. F. Z, z. B. M dhe z. F. H.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë, nga subjekti i audituar z. F. Z, z. B. M dhe z. F. H, është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2205/76 prot., datë 09.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 407/12, datë 17.01.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Pretendohet se dokumentet e tenderit janë përgatitur nga HEC Fierzë. Bashkëngjitur është paraqitur kërkesa e HEC Fierzë dhe specifikimet teknike përkatëse.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Sqarojmë se, specifikimet teknike të paraqitura janë të pa nënshkruara nga punonjës të cilët mund të jenë caktuar për këtë qëllim. Nga ana e njësisë së prokurimit duhet të verifikohen specifikimet teknike sa i takon përcaktimit të markave, dimensioneve fikse etj.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

Procedura e Prokurimit: “Blerje mjet lundrues për pastrimin e bieftit të sipërm nga akumulimet e materialeve dhe mbetjeve urbane për Hec Fierzë”.		
1. Urdhër Prokurimi nr.	3. njësia e prokurimit	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
2. lloji i Procedurës së Prokurimit E hapur (mallra)	F. Z B. M F. H	E. M L. S L. M
5. Fondi Limit (pa tvsh) 30,000,000 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 29,500,000 lekë	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 500,000 lekë
8. Data e hapjes së ofertave 01.10.2021	9. Burimi i Financimit Financim nga të ardhurat e KESH	10. Operatorët Ekonomikë 1. OE “N 20” me vlerë oferte 27,000,000 lekë. 2. OE “GTS” me vlerë oferte 29,500,000 lekë. b. Skualifikuar – 1 OE
11. Ankimime -Po	12. Përgjigje e ankesës nga AK -Po	13. Përgjigje ankesës nga KPP -Po
b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. lidhje e kontratës 15.03.2022	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 35,280,000 lekë	16. Likuiduar - lekë Pa likuiduar: - lekë

Në tender kanë marrë pjesë dy OE, nga të cilët është skualifikuar një. OE i skualifikuar ka bërë ankimim pranë AK dhe KPP dhe pas shqyrtimit të tyre ka rezultuar se skualifikimi është i drejtë.

Mbi zbatimin e kontratës së furnizimit.

Kontrata e furnizimit është nënshkruar me datë 15.03.2022 me OE “GTS”. Nga auditimi i dokumentacionit dhe verifikimit në terren të mjetit, nuk u konstatuan mangësi.

5. Mbi auditimin e ushtruar mbi zbatimin e Procedurës së Prokurimit: “Mbrotjtja e kullave të ekuilibrit nga çarja e shkëmbinjve mbi to dhe sistemimi i rrëshqitjes së kolvioneve mbi rrugën e digës HEC Koman”.

Procedura “Mbrotjtja e kullave të ekuilibrit nga çarja e shkëmbinjve mbi to dhe sistemimi i rrëshqitjes së kolvioneve mbi rrugën e digës HEC Koman”, është parashikuar në Programin Ekonomik të shoqërisë për vitin 2021.

Kërkesa për realizimin e procedurës së prokurimit është bërë nga Drejtori i Departamentit të Gjenerimit z. T. B, me shkresë nr. 1259 prot., datë 23.02.2021.

1. Titulli i gjetjes: Përlllogaritje të gabuara të preventivit të punimeve.

Situata: Fondi limit sipas procedurës “Mbrotjtja e kullave të ekuilibrit nga çarja e shkëmbinjve mbi to dhe sistemimi i rrëshqitjes së kolvioneve mbi rrugën e digës HEC Koman”, është përlllogaritur me vlerë 369,639,401 lekë. Fondi për këtë investim është akorduar sipas shkresës së drejtorisë ekonomike pranë KESH, nr. 1462/2 prot., datë 02.03.2021. Për përlllogaritjen e fondit limit, janë aplikuar ku ka qenë e mundur çmimet e manualeve, për zëra të tjerë është aplikuar studimi i tregut. Nga verifikimi çmimit të ofertës së paraqitur nga BOE “S & S” SHPK, rezulton se pajisjet me vlerë 5,356,510 lekë, megjithëse zë i ndarë, janë përfshirë në përlllogaritjen e vlerës së kontratës me TVSH. Vlera e kontratës me TVSH është përcaktuar në shumën 395,748,714 lekë, ndërkohë që duhet të llogaritej me vlerë 394,677,412 lekë. Vlera e TVSH e përcaktuar më tepër është me vlerë 1,071,302 lekë. Preventivi i përfshirë në tender është përcaktuar me këtë strukturë, e cila është ndjekur nga ana e ofertuesve.

Bazuar në Situacionin Përfundimtar të Punimeve, vlera e TVSH likuiduar kontraktorit është 65,958,119 lekë, ndërkohë që duhet të ishte 64,886,817 Lekë. Vlera 1,071,302 lekë (65,958,119 lekë - 64,886,817 lekë), konsiderohet si shpenzim i pa justifikuar, për të cilin kërkohen rregullimet përkatëse, para pagesë së garancisë së objektit.

Kriteri: Udhëzimin e KM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika A “Shpenzimet për materialet”.

Ndikimi: Në situacionin përfundimtar është përlllogaritur më shumë TVSH me vlerë 1,071,302 lekë.

Shkaku Përfshirja në tatimin mbi vlerën e shtuar të pajisjeve.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: KESH SHA të marrë masa për rilllogaritjen e vlerës së TVSH dhe zbritjen e vlerës **1,071,302 lekë**, për kontratën “Mbrotjtja e kullave të ekuilibrit nga çarja e shkëmbinjve mbi to dhe sistemimi i rrëshqitjes së kolvioneve mbi rrugën e digës HEC Koman”, përlllogaritur më tepër, si pasojë e mos klasifikimit të pajisjeve pa TVSH.

Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i punës i pranimit të projekt-zbatimit i përbërë nga z. I. H, z. F. Z dhe z. I. Sh.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

Procedura e Prokurimit: “Mbrotjtja e kullave të ekuilibrit nga çarja e shkëmbinjve mbi to dhe sistemimi i rrëshqitjes së kolvioneve mbi rrugën e digës HEC Koman”.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 1462/3, prot., datë 02.03.2021.	3. njësia e prokurimit Y. N	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Urdhrit nr. 1462/4 prot., datë 02.03.2021.
2. lloji i Procedurës së Prokurimit E hapur (punë)	A. L (spec.fushës) I. Sh (spec.fushës)	A. R K. H

		E. K
5. Fondi Limit (pa tvsh) 369,639,401 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 329,790,595.6 lekë	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 39,848,806 lekë
8. Data e hapjes së ofertave 14.05.2021	9. Burimi i Financimit Financim nga të ardhurat e KESH	10. Operatorët Ekonomikë 1. Shoqëria “A I G” me vlerë oferte 329,041,784.8 lekë. 2. “S”, me vlerë oferte 329,790,595.6 lekë. b. Skualifikuar – 1 OE
11. Ankimime - “R” SHPK (dok.tenderi) - “AI G. Nr. 2949 prot., datë 04.06.2021 - “S & S” Nr. 3305 prot., datë 17.06.2021.	12. Përgjigje e ankesës nga AK -nr. 1585/3, datë 10.03.2021. -Nr. 2949/2 prot., datë 10.06.2021. -nr. 3305/3 prot., datë 21.06.2021.	13. Përgjigje ankesës nga KPP - Nr. 172/2021 prot., datë 15.04.2021 Nr. 439/2021, datë 03.08.2021
b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. lidhje e kontratës nr. 1462/7 prot., datë 07.09.2021	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 395,748,714 lekë	16. Likuiduar - lekë Pa likuiduar: - lekë
17. Situacioni përfundimtar/faturë malli/shërbimi` Vlera 395,748,714 lekë	18. Afati i kontratës në ditë. Parashikuar 4 muaj Zbatuar: 8 muaj	19. Zgjatja e kontratës me ditë Shkresa (amendamenti) nr. Datë -Nr. 517/10 prot., datë 16.02.2022 - Nr. 517/27 prot., datë 21.04.2022
20. Mbikëqyrësi i punimeve N SHPK	Licencë nr. MK 3101/7	Kontrata nr. 4750/4, datë 14.10.2021
21. Kolaudatori i punimeve I. Sh	Licencë nr. MK-3325	Kontrata -
	Likuiduar	Pa likuiduar

Formulari i njoftimit të kontratës është hartuar me nr. 1462/5 prot., datë 02.03.2021 dhe është publikuar në Buletin e APP nr. 34, datë 08.03.2021. Dokumentet e tenderit janë hartuar sipas dokumentit nr. Extra, datë 02.03.2021, nga njësia e prokurimit.

Për dokumentet e tenderit është bërë ankesë nga OE “R” SHPK regjistruar në KESH me nr. 1585 prot., datë 08.03.2021.

Ankesa ka të bëjë me kategorinë e licencave, numrin e inxhinierëve, specialistëve, numrin e punonjësve, numrin e makinerive dhe automjeteve, etj.

Për sa më sipër Ish Titullari i AK z. B. B ka nxjerrë urdhrin nr. 1585/1 prot., datë 10.03.2021, për pezullimin e procedurës së prokurimit dhe shqyrtimin e ankesës nga komisioni i përbërë nga znj. A. R, znj. E. K dhe znj. K. H, të cilët janë edhe anëtarët e KVO. Komisioni i mësipërm nuk ka pranuar asnjë nga ankesat e OE dhe është njoftuar me shkresë nr. 1585/3 prot., datë 10.03.2021. Nga ana e OE është bërë ankesë në KPP, i cili ka pranuar pjesërisht animimin e OE “R” SHPK. Nga ana e KESH SHA janë bërë ndryshimet duke ngarkuar në sistem shtojcën përkatëse dhe nga ana e KPP është marrë vendimi për heqjen e pezullimit të tenderit me vendim nr. 172/5/2021.

Mbi vlerësimin e ofertave.

OE “A I G”, ka paraqitur ankesë në lidhje me vlerësimin e ofertave. Pas pezullimit të procedurës, komisioni i shqyrtimit të ankesës i përbërë nga z. I. Sh, z. A. L dhe znj. Y. N, ka pranuar ankesën. Pranë AK është paraqitur ankesë nga BOE “S& S” SHPK me shkresë nr. 3305 prot., datë 17.06.2021. Pas shqyrtimit të ankesës, KVO ka vendosur mos pranimin e saj. BOE “S& S” SHPK, ka paraqitur ankësë pranë KPP, e cila i është bërë e njohur KPP me shkresë nr. 66 prot., datë 28.06.2021. KPP me Vendim nr. 439/2021, datë 03.08.2021, ka vendosur pranimin e ankesës duke skualifikuar OE “A I G”. Njoftimi i fituesit është botuar në Buletin e APP nr. 130, datë 30.08.2021.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë, nga subjekti i audituar z. I. H, z. I. Sh dhe z. F. Z, është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2205/77 prot., datë 09.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 407/12, datë 17.01.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- Të gjitha analizat teknike të hartuara nga projektuesi “Shpenzimet për materialet” janë të vendosura në çmimin bazë, pa tatim mbi vlerën e shtuar. Gjithashtu, të gjitha ofertat e tregut të marra për këto materiale janë të ofertuara me çmim pa TVSH. Si rrjedhojë në preventivin e punimeve pajisjet me vlerë 5,356,510 lekë duhet të përfshihen në përllogaritjen e vlerës së kontratës me TVSH, sipas ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 2 fusha e zbatimit “...Tatimit mbi vlerën e shtuar i nënshtrohen: a) të gjitha furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, të kryera kundrejt pagesës, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nga një person i tatueshëm që vepron si i tillë; të gjitha importet e mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë...”.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Sqarojmë se:

- Sa i përket sigurisht edhe pajisjet i nënshtrohen tatimit mbi vlerën e shtuar, por ky proces realizohet në momentin e importimit nga organet doganore dhe përfshirja në preventiv paraqet një proces të realizuar dy herë.

6. Mbi auditimin e ushtruar për zbatimin e Procedurës së Prokurimit: “Blerje furnizim 40000 litra vaj T-68, për kushinetat e katër hidroagregateve në HEC Fierzë”.

Nga auditimi konstatohet:

HEC Fierzë SHA me shkresë nr. 245/1 prot., datë 16.03.2022, ka paraqitur nevojën për blerje vaji, për kushinetat e agregateve. Nga ana e Departamentit të Mirëmbajtjes pranë KESH i janë dërguar specifikimet teknike Drejtorisë së Prokurimit së bashku me relacionin teknik mbi gjendjen dhe nevojën për vaj hidraulik në HEC Fierzë.

Për përllogaritjen e fondit limit është aplikuar studimi i tregut. Komisioni përbëhet nga z. B. K dhe z. A. S. Nga administrimi i tre ofertave ka rezultuar fondi limit me vlerë 31,148,000 lekë.

Dokumentet e tenderit janë përgatitur nga njësia e prokurimit.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

Procedura e Prokurimit: “Blerje furnizim 40000 litra vaj T-68, për kushinetat e katër hidroagregateve në HEC Fierzë”.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 1845/7, prot., datë 02.06.2022.	3. njësia e prokurimit M. Sh (spec.fushes) B. K (spec.prok) F. Z (përgj.prok)	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Urdhrit nr. 1845/8 prot., datë 02.06.2022. L. M K. H B. M
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit E hapur (mallra) Kontratë me çelësa në dorë		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 31,148,000 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 26,600,000 lekë	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 4,548,000 lekë
8. Data e hapjes së ofertave 27.06.2022	9. Burimi i Financimit Financim nga të ardhurat e KESH	10. Operatorët Ekonomikë 1. Shoqëria “K O” me vlerë oferte 23,600,000 lekë. 2. OE “E” me vlerë të ofertës 20,000,000 lekë. 3. OE “T O”, me vlerë të ofertës 19,880,000 lekë. 4. “F L” me vlerë të ofertës 26,000,000 lekë. 5. “B&A” me vlerë të ofertës 26,600,000 lekë. 6. “A G”, me vlerë të ofertës 29,450,000 lekë. 7. “O-S”, me vlerë të ofertës 29,280,000 lekë. 8. “K O”, me vlerë të ofertës 29,200,000 lekë. 9. “E-O” nuk ka paraqitur ofertë. b. Skualifikuar – 5 OE

11. Ankimime -“T O” me nr. 3612 prot., datë 25.07.2022. - “K O”, me nr. 3503 prot., datë 19.07.2022.	12. Përgjigje e ankesës nga AK - nr. 3612/2 prot., datë 27.07.2022. nr. 3503/2 prot., datë 27.07.2022.	13. Përgjigje ankesës nga KPP Vendim nr. 790/2022, datë 15.08.2022
b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. lidhje e kontratës nr. 1845/12 prot., datë 02.09.2022	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 31,920,000 lekë	16. Likuiduar - lekë Pa likuiduar: - lekë

Njoftimi i kontratës është botuar në Buletinin e APP nr. 76, datë 13.06.2022.

OE “K O”, ka paraqitur ankesë pranë AK me nr. 3503 prot., datë 19.07.2022.

Ankimimi është bërë për s’kualifikimin sipas argumentimit si më poshtë:

-Nuk plotëson pikën 2.3.1 kapaciteti teknik, pasi nuk plotëson vlerën e kërkuar për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, pasi vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 12,459,200 Lekë.

-Kontrata e paraqitur nga ky operator nuk është e ngjashme pasi kontrata e lidhur midis Autoritetit Kontraktor “Posta Shqiptare” sh.a dhe “KO” sh.a, ka si objekt: “Blerje vaj, antifrizë, graso dhe alkool për automjete”.

-Faturat e paraqitura si furnizime të ngjashme nga ky operator janë fatura që kanë si objekt artikujt vaj makine, vaj transmisioni, graso, aditiv për automjete dhe nuk kanë lidhje me kontratën objekt prokurimi.

-Operatori ekonomik “K O” sh.p.k, nuk plotëson kriterin 2.3.3, pasi objekti i këtij autorizimi është “Blerje vaj lubrifikant”.

-Operatori ekonomik “K O” sh.p.k ka paraqitur formularin e ofertës (shtojca 1) me objekt: “Blerje vaj lubrifikant” dhe jo me objektin e prokurimit “Blerje vaj hidraulik T-68 për kushinetat e katër hidroagregatëve në HEC Fierzë”.

-Deklarata e paraqitur mbi transportin e mallrave mban datën 11.03.2022 dhe objekti për të cilin është lëshuar është “Blerje vajra lubrifikant”.

Pra argumenti kryesor mbështetet në faktin se furnizimet e ngjashme nuk janë për vaj T-68, por për vajra të ndryshme hidraulike.

Nga ana e KSHA të përbërë nga z. M. Sh, z. B. K dhe znj. E. K, nuk është marrë në konsideratë ankimimi me arsyetimin: *“Të gjitha vajrat kanë veti lubrifikuese, por për procese specifike, në funksion të rëndësishë që ka procesi teknologjik është e natyrshme të përdoren kriteret të veçanta emërtimi. Sqarojmë se kemi kërkuar vaj hidraulik duke u nisur nga funksioni i përdorimit të tij. Vaji i kërkuar shërben jo vetëm për lubrifikimin e kushinetave të turbinës në katër hidroagregatet e HEC Fierza, por shërben edhe për sistemin hidraulik që lidhet me funksionimin e rregullatorit të shpejtësisë në to. Pra duke gjykuar nga karakteristikat e skemës teknologjike rezulton që përdorimi i termit vaj hidraulik ka veti dalluese nga një vaj i zakonshëm lubrifikues në drejtim të vetive që lidhen me transmetimin e fuqisë në të gjithë sistemin hidraulik. Pra është një lubrifikant dhe njëkohësisht trupi i punës për transmetimin e energjisë”.*

OE “T O”, ka paraqitur ankesë pranë AK me nr. 3612/2 prot., datë 27.07.2022, paralelisht dhe në KPP. Pas pezullimit të procedurës, nga KSHA e përbërë nga z. M. Sh, z. B. K dhe znj. E. K, është shqyrtuar ankesa duke mos e pranuar atë. Skualifikimi është argumentuar si më poshtë:

Operatori Ekonomik “T.” sh.a, NIPT K.....1, me ofertë ekonomike 19,880,000 (Nëntëmbëdhjetë milion e tetëqind e tetëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH, pasinuk plotëson pikën 2.3.1 Kapaciteti teknik, ku përcaktohet “Kontratat e paraqitur nga ky operator nuk janë të ngjashme pasi kontrata e lidhur midis Autoritetit Kontraktor “Posta Shqiptare” sh.a dhe “T.” sh.a ka si objekt: “Blerje vaj, antifrizë, graso dhe alkool për automjete”. Nga ana e këtij OE është bërë ankesë në AK dhe KPP njëkohësisht.

-Kontrata lidhur midis Komandës Mbështetëse dhe “T.” sh.a, me objekt: “Blerje vaj lubrifikant”. Referuar artikujve të kësaj kontrate, rezulton se ky operator nuk plotëson vlerën e kërkuar për furnizimet e mëparshme të ngjashme për këtë kontratë, pasi ka zëra artikujsh të ndryshme si vaj motori për automjete, vaj kutie shpejtësie, vaj armësh, antifrizë motori etj. Pra ky operator nuk plotëson pikën 2.3.1 kapaciteti teknik, pasi vlera e kërkuar për furnizimet e kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, duhet të jetë jo më e vogël se 12,459,200 Lekë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky OE në sistemin elektronik të prokurimeve rezulton se ndër të tjera ka realizuar Kontratën me nr. 3288/4 prot, datë 20.07.2020, furnizimet sipas të cilës janë vajra lubrifikantë me vlerë 19,215,000 lekë, ndërsa vlera 1,309,000 lekë, ka të bëjë me furnizim antifrizë, graso, pastrues sistem gazrash. KPP, në lidhje me ankesat e 2 OE të mësipërme KPP ka marrë vendimin nr. 790/2022, duke mos i pranuar ato.

1. Titulli i gjetjes: Mangësi në shqyrtimin e ofertave të paraqitura nga OE në tender.

Situata: Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik sipas procedurës “Blerje furnizim 40000 litra vaj T-68, për kushinetat e katër hidroagregateve në HEC Fierzë”, rezulton se operatori ekonomik fitues, ka paraqitur mangësi në dokumentacionin e ofertës si më poshtë:

- Raporti i testimit i realizuar pranë ISHTI është paraqitur me parametra të cilat nuk përputhen me ato të kërkuara në specifikimet teknike.

- Katalogu dhe broshura e prodhuesit, të cilit i është marrë autorizimi, nuk përmbajnë vaj T-68, por vajra lubrifikantë të ndryshëm, përfshirë edhe vaj S-68, parametrat e të cilit nuk përputhen me ato të përcaktuara në specifikimet teknike.

- Në asnjë rast të përshkruar në kontratat e ngjashme, nuk rezulton tregtim vaji T-68, por vajra lubrifikantë për motorë,ambio automjetesh, graso, antifrizë etj., të ngjashme me ato të paraqitura nga OE të skualifikuara.

Kriteri: Ligjin 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 92, pika 3.

Ndikimi: Nuk konsiderohet se ka patur ndikim, pasi dhe operatorët e tjerë me vlerë oferte më të ulët nuk kanë plotësuar oferta sipas DST.

Shkaku Mos vlerësim i duhur i ofertave të paraqitura.

Rëndësia: E mesme.

Nga ana e KESH SHA të merren masa për angazhimin e punonjësve me eksperiencë në fushën e prokurimit publik, në mënyrë që procedurat të zhvillohen duke plotësuar kërkesat e ligjit dhe parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit.

Ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë nga z. L. M, z. B. M dhe znj. K. H.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë, nga subjekti i audituar z. L. M, z. B. M dhe znj. K. H, është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2205/73 prot., datë 09.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 407/12, datë 17.01.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Referuar analizave të ISHTI, rezultatet e testeve janë brenda tolerancave të lejuara dhe mund të pranohen si teste të suksesshme që plotësojnë kërkesat e specifikimeve teknike. Në kontratat e ngjashme të paraqitura nga operatori ekonomik fitues ka furnizime të ngjashme të vajrave lubrifikantë që i për afrohen shkallës së viskozitetit 68 mm²/s. Operatorët e skualifikuar nuk kanë paraqitur vajra lubrifikantë që i për afrohen shkallës së viskozitetit 68mm²/s, ose janë ekuivalente të vajit të turbinës T68.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Referuar pretendimeve të mësipërme, theksojmë se në dokumentet e tenderit është kërkuar vaj me specifikime të sakta për vetë natyrën e punës dhe rëndësinë që kanë mekanizmat. Vlerësimi nuk është bërë në mënyrë korrekte, pasi asnjë nga operatorët nuk ka patur eksperiencë të ngjashme.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë, nga subjekti i audituar znj. R. A, z. Dh. T, z. R. S, znj. F. K, z. M. Sh, z. F. H dhe z. R. P, është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2205/75Prot., datë 09.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 407/12, datë 17.01.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me përmbajtjen e elementëve të dëmshëm në dosjen e dorëzimit të mallit është deklarata e prodhuesit. Duke marrë në konsideratë që laborator i prodhuesit është i certifikuar dhe akredituar sipas standardeve përkatëse, grupi i marrjes në dorëzim nuk gjykoj të arsyeshme që të kërkonte prova laboratorike për këtë çështje. Nga fletët e analizave laboratorike të realizuara **për disa nga treguesit** e vajit të furnizuar, rezulton se vlerat e analizave janë të njëjta me ato që ka paraqitur prodhuesi nga analizat e laboratorit të tij. Nga sa më sipër nuk u gjykua e arsyeshme që të kërkohej analizë specifike e vajit për përmbajtjen e kimikateve të dëmshme.

Pretendohet se sasia e parashikuar është e saktë dhe nuk ka rrezik që sasia e porositur nuk do të përdoret brenda afatit 3 vjeçar.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Siç edhe përshkruhet në pretendimet e subjektit, kemi të bëjmë me neglizhencë të përmbushjes së detyrimeve të cilat përcaktohen në procesin e marrjes në dorëzim të produktit. Në lidhje me përdorimin e vajit të porositur, theksojmë se ai duhet përdorur vetëm në momentin kur vaji në përdorim në mekanizma humbet parametrat e nevojshëm për mirëfunksionimin e agregatit. Bazuar në konsumin e deritanishëm, është provuar që është planifikuar mbi nevoja.

7. Mbi auditimin e ushtruar për zbatimin e Procedurës së Prokurimit: “Demontimi i vinçit 100/5 ton në veprën e marrjes HEC Vau i Dejës”.

Fondi limit është përcaktuar me vlerë 20,000,000 lekë, bazuar në fondin e parashikuar në planin ekonomiko-financiar, pasi nga studimi i tregut ka rezultuar një vlerë e lartë e konkretisht 25,475,896 lekë.

Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit e përbërë nga z. B. M, z. M. Sh dhe znj. D. T.

1. Titulli i gjetjes:

Situata:

Kritere jo në përputhje me volumin e kontratës.

Sipas procedurës së prokurimit “Demontimi i vinçit 100/5 ton në veprën e marrjes HEC Vau i Dejës”, në pikën 2 “Kritere të veçanta të kualifikimit”, ndër të tjera është kërkuar disponimi i mekanizmave, si më poshtë:

- Autovinç me kapacitet mbajtës 70-100 ton, copë 1.

- Kamion me vinç me kapacitet 20-30 ton, copë 1.

Në pikën 7, të termave të referencës dhe specifikimeve teknike “Përshkrimi i metodologjisë së shërbimeve demontuese”, përcaktohet: *“Pjesët e pa-demontueshme të vinçit janë me përmasa gabarite dhe pesha të mëdha si dhe të pa - menaxhueshme pa operacionet mekanike me prerje”.*

Në pikën 10 “Transportimi për magazinim”, përcaktohet: *“Për transportimin e pjesëve të demontuara të vinçit 100/5 ton është e nevojshme që të përdoret një kamion me kapacitet 20-30 ton i pajisur*

me vinç”.

Sa më sipër kriteri për disponimin e një vinçi me peshëmbajtje 70 deri 100 ton është **i pa argumentuar**, pasi në asnjë rast nuk ka pesha që kalojnë 30 ton, kjo e detyrueshme për peshëmbajtjen e mjetit transportues, si dhe për faktin se demontimi është parashikuar me prerje.

Kërkesa për një mjet me kapacitet të tillë redukton ndjeshëm numrin e operatorëve pjesëmarrës, pasi ky lloj mekanizmi mund të disponohet nga një numër shumë i vogël i tyre.

Kriteri: Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 77, pika 1.

Ndikimi: Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kontratën, ndikon në pjesëmarrjen e OE në procedurat e prokurimit.

Shkaku Mos analizimi i duhur i nevojës për mekanizma, bazuar në proceset e demontimit të vinçit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga ana e KESH, të merren masa për vendosjen e kriterëve teknike ekonomike në përputhje me volumin dhe natyrën e kontratës dhe që favorizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Ngarkohen me përgjegjësi, anëtarëte njësisë së prokurimit, specialistë fushës z. M. Sh dhe znj. D. T.

Në tender ka marrë pjesë vetëm një operator ekonomik. Është shpallur fitues OE “J” SHPK me vlerë të ofertës 19,800,071 lekë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë, nga subjekti i audituar z. M. Sh dhe znj. D. T, është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2205/70 prot., datë 08.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 407/12, datë 17.01.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Pretendohet se sa më shumë të realizohet hapja e krahut të vinçit aq më e vogël është aftësia e ngritëse e vinçit. Po ashtu, pasi pjesët demontohen dhe ulen në sipërfaqen e parapërgatitur në kurorën e digës nga autovinçi 70-100 ton, vazhdojnë e demontohen përsëri në pjesë më të vogla për transport. Më pas kamioni me vinç 20-30 ton realizon procesin e ngarkimit të tyre në kamion dhe procesin e transportit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Sqarojmë se platforma për mbrojtjen e kurorës së digës dhe uljen e materialeve të prera më parë është ndërtuar në zonën e vendosjes së vinçit dhe nuk kërkohet hapja e krahëve të vinçit në distanca të tilla. Vinçi për demontim është i ndërtuar në elementë të cilat zmontohen dhe në raste kur është e pamundur priten (procesi teknologjik i parashikuar). Theksojmë se e gjithë pesha e vinçit për demontim është 150 ton, e cila mbështetet në katër kolona.

8. Mbi auditimin e procedurës së prokurimit “Ndërtimi i infrastrukturës së aksesimit dhe ankorimit për operimin e asetit gjenerues termik, në portin e peshkimit Triport - Vlorë”.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :, me nr. REF-40055-08-26-2022.		
1. Urdhër Prokurimi Nr.3502/12 prot., datë 25.08.2022	3. Përlogaritja e Vlerës së Fondit Limit Hartimi i Specifikimeve Teknike	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri i Brendshëm Nr. 3502/13 Prot. datë 25.08.2022

2.1 Lloji i Kontratës Projektimi dhe realizimi i punëve. Kontratë me çelësa në dorë 2.2 Lloji i Procedurës <i>“Procedurë e Hapur, nën kufirin e lartë monetar, format elektronik</i> 2.3. Kriteri i vlerësimit Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto	Urdhër Nr.3502/4 Prot. datë 04.08.2022 Njësia e Prokurimit Urdhër Prokurimi, Nr. 3502/12 prot., datë 25.08.2022 znj. K. H – Person përgjegjës për prokurimin/DP z. E. Q – Anëtar, Specialist i fushës/DGJ z. R. H, – Anëtar, Specialist i fushës/DP	z. E. E - Kryetar z. B. K - Anëtar z. E. N - Anëtar znj. A. R - Anëtare znj. Y. N - Anëtare
5. Fondi Limit (pa TVSh) <u>280,000,000 lekë</u> 5.1 Afati 100 ditë pune (72 ditë sipas ofertës) 5. Garancia 36 muaj (sipas ofertës)	6. Oferta e kualifikuar e para 257,200,000 lekë pa TVSH – S. sh.p.k, kontrata nr. 3502/16 prot., datë 04.10.2022	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) <u>22,800,000 lekë</u> (8.14 %)
8. Data e hapjes së tenderit 14.09.2022, ora 10:00	9. Burimi Financimit Buxheti i Shoqërisë 336,000,000 lekë me TVSH	10. Operatorët Ekonomikë (oferta lekë pa TVSH) Ssh.pk – 257,200,000 Vetëm një ofertë e ekonomike
11. Ankimime/Kërkesë	12. Përgjigje Kërkesës	

➤ ZHVILLIMI I PROCEDURËS SË PROKURIMIT

Në mënyrë të përmblendhur procedura e prokurimit është kryer sipas të dhënave të tabelës së mësipërme.

Sipas DT rezulton se kriteri i përzgjedhjes së fituesit është përcaktuar oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto duke përdorur sistemin me pikë.

Në fakt, referuar nenit 87 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, pika 4 citohet se: “Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese ...”. Gjithashtu, referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 3 citohet se: “Për punët/mallrat/shërbimet, që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave”.

Në gjykim të Grupit të Auditimit përzgjedhja e metodës bazuar në kosto nuk është në përputhje me parimet kryesore të Ligjit të Prokurimit Publik.

Kjo do të thotë se nga ana e AK do të duhet të ishin përcaktuar vetëm kriteret e veçanta të kualifikimit dhe oferta ekonomikisht më e favorshme të përzgjidhej në bazë të çmimit dhe jo të koston pasi punimet e ndërtimit janë me standarde të njohura kombëtare e ndërkombëtare e përveç çmimit OE pjesëmarrës, praktikisht nuk kanë se me çfarë të konkurrojnë tjetër.

Referuar procesverbalit të hartuar nga njësia e prokurimit “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” datë 26.08.2022 është përcaktuar që kjo kontratë të jetë me çelësa në dorë.

NË LIDHJE ME VLERËSIMIN E OFERTAVE

Në përfundim të vlerësimit të bërë nga ana e KVO rezulton se është shpallur fitues OE “S” sh.p.k. Sipas procesverbalit është bërë vlerësimi me pikë i OE të kualifikuar duke u bërë edhe një renditje si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta	Kategoria						Pikët totale
			Çmimi (50)	Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit (20)	Stafi/Organizimi i kompanisë (10)	Kapaciteti Teknik / Punime dhe volume specifike te	Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social (5)	Periudha e garancisë së objektit	

						kryera te realizuara (10)		(5)	
1	S sh.p.k	2,386,175,789. ²³	50	20	10	10	5	5	100

1. Titulli i gjetjes:

Situata:

Hartim i dokumenteve të tenderit me mangësi.

Sipas DT rezulton se kriteri i përzgjedhjes së fituesit është përcaktuar oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto duke përdorur sistemin me pikë.

Në fakt, referuar nenit 87 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, pika 4 citohet se: “Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese ...”. Gjithashtu, referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 3 citohet se: “Për punët/mallrat/shërbimet, që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave”.

Në gjykim të Grupit të Auditimit përzgjedhja e metodës bazuar në kosto nuk është në përputhje me parimet kryesore të Ligjit të Prokurimit Publik.

Kriteri:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 87, pika 4.

Ndikimi/Efekti:

Nuk konsiderohet se ka dhënë efekte.

Shkaku:

Mos shqyrtimi i duhur i kriterëve të përzgjedhjes.

Rëndësia:

E mesme.

1.1.Rekomandimi:

Nga ana e KESH, të merren masa për vendosjen e kriterëve teknike ekonomike në përputhje me volumin dhe natyrën e kontratës dhe që favorizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

B. Mbi auditimin e zbatimit të kontratave të punimeve civile dhe mallra.

Auditimi i zbatimit të kontratave është përqendruar në ato të punimeve civile si dhe të blerjes së materialeve. Sa i takon kontratave të punimeve civile, u audituan edhe dy kontrata për të cilat procedura e prokurimit dhe lidhja e kontratës ishin realizuar para periudhës në auditim. Nga vlera e kontratave të nënshkruara në shumën 4,486,417 mijë lekë, u audituan kontrata me vlerë 1,297,844 mijë lekë. Vlera e kontratave të nënshkruara për periudhën 2021-2022, në shumën 3,856,744 mijë lekë përbëhet nga prokurim punimesh me vlerë 1,499,925 mijë lekë, ose 38 %, mallra në shumën 665,196 mijë lekë, ose 17.2 % dhe pjesa tjetër në shumën 1,691,623 mijë lekë, ose 44.8 % prokurim shërbimesh.

Nga auditimi i kontratave të audituara, konstatohet si më poshtë:

1. Mbi auditimin e kontratës “Rehabilitimi i ndërtesës së centralit në HEC Koman”.

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1) Dosja teknike e zbatimit:

- Kontrata e zbatimit të punimeve midis KESH dhe OE “C” sh.p.k me Nr.1258/8Prot. datë 28.05.2021.

- *Projekti fillestar dhe projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit);*
 - *Pagesat pjesore deri në situacionin përfundimtar;*
 - *Librezat e masave pjesore deri në situacionin përfundimtar;*
- 2) *Kontrata e Mbikëqyrjes së punimeve midis KESH dhe OE “Gj” sh.p.k me Nr.3257/3Prot. datë 02.07.2021.*
- *Korrespondencat mes KESH dhe operatorit ekonomik që kryen supervizionimin OE “Gj” sh.p.k.*

Kontratat

Punimet kryhen sipas kontratës për punë publike me Nr.1258/8 Prot. datë 28.05.2021 me objekt “*Rehabilitimi i ndërtesës së centralit në HEC Koman*” të lidhur mes Autoritetit Kontraktor KESH, të përfaqësuar nga Administratori z. B. K dhe Operatorit Ekonomik “C” sh.p.k me përfaqësues z. F. C me licenca profesionale NZ.0005/25. Vlera e kontratës është 143,194,853 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 6 muaj nga data e fillimit të punimeve. Është përcaktuar se si datë e fillimit të punimeve do të jetë data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit. Me Amendament Kontrate nr.1, Nr.634/5Prot. datë 25.02.2022 afati i përfundimit të punimeve është ndryshuar duke e zgjatur me dy muaj duke përcaktuar si datë 11.04.2022.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit Nr.3257/3Prot. datë 02.07.2021, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “Gj” sh.p.k, me përfaqësues H. M, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.1735/19, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 1,341,960 lekë me TVSH.

Kolaudimi i punimeve është kryer nga OE “A” sh.p.k sipas aktit Nr.2787/4Prot. , Datë 14.06.2022 me përfaqësues E. Ç me nr. Licence për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh MK.1476/12, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 145,200 lekë me TVSH.

Hartimi i projektit

Projekti është hartuar nga BOE “A” dhe “S C I” sh.p.k ku ishin të parashikuara të kryhen punimet e rikonstruksionit të godinës ekzistuese ku përfshihen; pastrimi i suvave të mureve dhe tavaneve dhe riparimi i pjesëve të dëmtuara, prishja e shtresave të soletës, çmontimi i dritareve dhe zëvendësimi me të reja, prishja e shtresave të betonit të dyshemesë në pjesët e dëmtuara dhe rishtrimi i tyre, pastrimi dhe lyerja e mureve nga jashtë dhe brenda, hidroizolim tarracve, zëvendësim i shkallëve metalike, si dhe rikonstruksion i plotë i dhomës së monitorimit dhe komandimit.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, sipas njoftimeve përkatëse është bërë në datën 11.08.2021 dhe dokumentacioni është administruar në KESH me Nr.1259/14-18Prot. , datë 12.08.2021. Sipas njoftimit të kontraktorit Nr.44Prot. , datë 11.04.2022 dhe administruar në KESH me Nr.361/11Prot. datë 12.04.2022 punimet kanë përfunduar sipas afatit të përcaktuar në amendimin e kontratës.

Sipërmarrësi i punimeve me kërkesën përkatëse (kontraktori) drejtuar mbikëqyrësit të punimeve, për nevojat e ndryshme të punimeve brenda preventivit ofertues, ka paraqitur propozimet përkatëse të shoqëruara me relacionet teknike përkatëse. Bazuar në propozimet e kontraktorit dhe miratimit nga ana e tij mbikëqyrësi i punimeve i është drejtuar Autoritetit Kontraktor për miratimin e këtyre ndryshimeve.

Me procesverbalet përkatëse KESH ka miratuar kërkesa për ndryshime volumesh (+/-), si dhe preventivi i rishikuar me vlerë 11,184 lekë me TVSH, më pak se ai i kontratës fillestare ku në të është përfshirë edhe vlera e fondit rezervë.

Kolaudimi i punimeve është kryer më datë 15.07.2022 dhe marrja e përkohshme në dorëzim është kryer sipas aktit Nr.293Prot. , datë 10.08.2022.

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të dukshme të ndërtimit, në objektin ekzistues, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan

diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatuar (vizatimet sipas faktit) dhe specifikimet teknike, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **268,113.5 lekë pa TVSH**.

1. Titulli i gjetjes:

Situata:

Punime të situacionuara por të pakryera në fakt.

Në objektin “Rehabilitimi i ndërtesës së centralit në HEC Koman” sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Kontraktor KESH dhe Operatorit Ekonomik “C” sh.pme Nr.1258/8 Prot. datë 28.05.2021 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 143,194,853 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 6 muaj nga data dorëzimit të sheshit të ndërtimit, dhe zgjatje afati me Amendim Kontrate nr.1, Nr.634/5Prot. datë 25.02.2022, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konkretisht:

- Projekti fillestar;
- Projekti i Zbatimit pjesor (Vizatimet sipas faktit);
- Pagesat pjesore deri në situacionin përfundimtar;
- Librezat e masave pjesore deri në situacionin përfundimtar;
- Ndryshimet e miratuara nga AK;
- Korrespondencat midis KESH dhe OE që kryen supervizionimin “Gj” sh.p.k.

si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pakryera në fakt. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:

Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)
1	Punime prishje	Transport mbetje në një vend të autorizuar publik 7 km	90,063
2	Punime fasade	Pastrim i faqerve të murit nga ndotje e plasaritje suvaje	178,050
SHUMA			268,113

Kriteri:

Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 ku përcaktohet se: “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”

-Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1 ku përcaktohet se: “Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasitë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”.

-Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.

- Kontrata e shërbimit me objekt “Mbikëqyrje e punimeve për rehabilitimin e ndërtesës së centralit HEC Koman”, Nr.3257/3Prot. datë 02.07.2021.

Ndikimi/Efekti:

Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në shumën **268,113 lekë pa TVSH**.

Shkaku:

Certifikimi nga ana e mbikëqyrësit volume punimesh të pakryera në

fakt nga ana e sipërmarrësit.
Rëndësia: E lartë.
1.1.Rekomandimi: KESH të marri masa duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e shumës 268,113 Lekë pa TVSH, nga OE “C” sh.p.k për zëra punimesh të pa kryera sipas kontratës së lidhur me Nr.1258/8 Prot. datë 28.05.2021 “Rehabilitimi i ndërtesës së centralit në HEC Koman” vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i mbikëqyrësit OE “Gj” sh.p.k z. Xh. M. sipas kontratës së shërbimit Nr.3257/3Prot. datë 02.07.2021 me objekt: “Mbikëqyrje e punimeve për rehabilitimin e ndërtesës së centralit HEC Koman”.

2. Mbi auditimin e kontratës“Punime për mbrojtjen e shpatullës së djathtë mes veprës së marrjes dhe kreshtës së digës në HEC Koman”.

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1) Dosja teknike e zbatimit:

- Kontrata e zbatimit të punimeve midis KESH dhe OE “S” sh.p.k me Nr.4100/8Prot. datë 17.03.2021.
- Projekti fillestar dhe projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit);
- Pagesat pjesore deri në situacionin përfundimtar;
- Librezat e masave pjesore deri në situacionin përfundimtar;

2) Kontrata e Mbikëqyrjes së punimeve midis KESH dhe OE “N-G” sh.p.k meNr.2753/4Prot. datë 23.06.2021.

- Korrespondencat mes KESH dhe operatorit ekonomik që kryen supervizioniminOE “N-G” sh.p.k.

Kontratat

Punimet kryhen sipas kontratës për punë publike me Nr.4100/8Prot. datë 17.03.2021 me objekt “Punime për mbrojtjen e shpatullës së djathtë mes veprës së marrjes dhe kreshtës së digës në HEC Koman” të lidhur mes Autoritetit Kontraktor KESH, të përfaqësuar nga Administratori z. B. K dhe Operatorit Ekonomik “S” sh.p.k me përfaqësues z. L. S me licenca profesionale NZ.3091/19 me nënkontraktor të deklaruar OE “R U” sh.a. Vlera e kontratës është 629,617,663.81 lekë me TVSH. Afati zbatimit të përcaktuar në Kushteve të Veçanta të Kontratës është 5 muaj ku si data e fillimit të punimeve është data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit. Afati i përfundimit të punimeve është ndryshuar me amendimin kontrate Nr.1 me Nr.313/1Prot. datë 20.01.2022 ku janë shtyrë me katër muaj deri më 21.04.2022 dhe Amendim Kontrate Nr.2, Nr.139/7Prot. datë 21.04.2022 ku janë shtyrë me 57 ditë duke përcaktuar përfundimin e punimeve më 17.06.2022. Në përgjigje të shkresës së Nr.139/33Prot. datë 15.06.2022 të kontraktorit për shtyrje afati, bazuar në Aktin Normativ Nr.10 datë 18.05.2022, AK me shkresën Nr.139/34Prot. datë 17.06.2022 ka miratuar zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve deri më datë 15.10.2022.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit Nr.2753/4Prot. datë 23.06.2021, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “NG” sh.p.k, me përfaqësues V. B, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.3101/7, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 4,846,800 lekë me TVSH.

Kontrata e kolaudimit të punimeve është lidhur me OE “AE” sh.p.k sipas aktit Nr.3918/4Prot. datë 17.10.2022 me përfaqësues E. Ç me nr. Licence për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh MK.1476/12, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 456,000 lekë me TVSH.

Hartimi i projektit

Projekti është hartuar nga BOE “A” sh.p.k & “P” sh.p.k ku janë parashikuara të kryhen punimet në zonën e shpatit për mbrojtjen e tyre të cilat ndodhen mbi veprën e marrjes. Mbrojtja e shpatit do të behet duke vendosur ankera vetëshpues 3x3m të madhësive të

ndryshme (sipas terrenit) të lidhura këto me kavo çeliku dhe rrjetë metalike dopio tersion. Gjithashtu në varësi të kushteve të terrenit do të kryhet trokerim me beton ku te vendosen dhe tubat e kullimit.

Për mbrojtjen nga rënia e gurëve do të vendosen barriera me rrjetë metalike. Këto barriera do të jenë me unaza metalike të lidhura me kavo të cilat mbahen në struktura metalike të inkastruara. Inkastrimi i strukturave mbajtëse do të bëhet me ankerë veteshpues dhe të përforcuara me kavo spirale të lidhura me ankerë ku në to do të ketë edhe sistem frenimi për zbutjen e goditjeve në rastet e rënies së gurëve. Në këtë projekt është parashikuar vendosja e një platforme në sipërfaqen e ujit midis digës dhe veprës së marrjes. Kjo platformë do të beje të mundur pritjen e materialit shkëmbor gjatë punimeve dhe në të ardhmen e kështu shmang mbushjen e basenit ujqor.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, sipas njoftimeve përkatëse është bërë me shkresën Nr.64 Prot. datë 21.07.2021 datën 11.08.2021 dhe dokumentacioni është administruar në KESH me Nr.3944Prot. datë 21.07.2021.

Me shkresën Nr. Prot. 434/1 datë 27.11.2021 të administruar në KESH me Nr.2753/9Prot. datë 07.12.2021 mbikëqyrësi i punimeve njofton pezullimin e punimeve për shkak të kushteve klimaterike të pa favorshme të shoqëruar me procesverbalin përkatës.

Me shkresën Nr. Prot. 463 datë 09.12.2021 të administruar në KESH me Nr.3944/8Prot. datë 10.12.2021 mbikëqyrësi i punimeve ka kërkuar shtyrje të përfundimit të punimeve me 4 muaj pasi ka vonesa në furnizimin me materiale për shkak të pandemisë Covid-19.

Sipas kërkesës së kontraktorit mbikëqyrësi i punimeve me shkresën Nr.Prot. 149 datë 13.04.2022 të administruar në KESH me Nr.139/10Prot. datë 13.04.2022 për arsye të klimaterike (borë, temperatura të ulta dhe erë e fortë) kontraktori ka kërkuar shtyrjen e përfundimit të punimeve me 57 dite. Me shkresën Nr. Prot. 440/1 datë 30.11.2021 të administruar në KESH me Nr.3944/2Prot. datë 03.12.2021 mbikëqyrësi i punimeve ka kërkuar rishikimin e projektit ku për këtë KESH me shkresën Nr.3944/12Prot. datë 07.01.2022 nuk ka miratuar këto ndryshime pasi nuk është i shoqëruar me studimin gjeologjik dhe gjeoteknik që janë të rëndësishme për të llogaritur strukturore dhe argumentimin e tyre teknikisht. Pas plotësimit të studimeve dhe dokumentacionit të plotë nga ana e kontraktorit në të cilat mbështeten ndryshimet e projektit, KESH me shkresën Nr.139/7Prot. datë 08.04.2022 ka miratuar ndryshimet e paraqitura.

Me shkresën Nr.139/27Prot. datë 06.06.2022 mbikëqyrësi i punimeve referuar ndryshimeve në projekt ka kërkuar përdorimin e fondit rezervë ku nga ana e KESH është miratuar me shkresën Nr.139/34Prot. datë 17.06.2022. Referua shkresës së sipërmarrësit të punimeve mbikëqyrësi me shkresën Nr.Prot. 443 datë 14.10.2022 ka njoftuar autoritetin kontraktor për përfundimin e punimeve.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion nuk konstatohen gjurmë që nga e sipërmarrësit dhe mbikëqyrësi të punimeve të jetë dorëzuar dosja teknike pas përfundimit të punimeve dhe më pas kryerjen e kolaudimit të punimeve. Gjithashtu konstatohet se kolaudimi i punimeve nuk është kryer e për rrjedhojë nuk është përcaktuar data kur fillon garancia e punimeve. Mosdorëzimi i dosjes teknike pranë Autoritetit Kontraktor pas përfundimit të punimeve është në kundërshtim me ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, dhe Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2021 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu I, pika 15 ku citohet: “Sipërmarrësi duhet t’i njoftojë me shkrim mbikëqyrësit të punimeve përfundimin e punimeve. Me këtë rast, brenda 30 ditëve, ai i parqet mbikëqyrësit:

a. Kontratën dhe aktet që lidhen me të.

b. Regjistrimin e kontabilitetit.

c. Procesverbalet e fillimit, të ndërprerjes ose të zgjatjes dhe të përfundimit të punimeve.

ç. Certifikatat e provave të materialeve të përdorura, të lëshuara nga laboratorët e autorizuar për këtë qëllim.

d. Deklaratë se objekti është ndërtuar në përputhje me projektin dhe me kushtet teknike.

Si dhe Kreu II, pika 8 ku citohet: “Periudha e garancisë për punimet e ndërtim-montimit në objektet, publike dhe jopublike, të përfunduara, fillon nga data e aktit të kolaudimit të punimeve dhe zgjat nga një deri në dy vjet, gjë që përcaktohet në kontratë, për veprën në tërësi a për pjesë apo procese të veçanta, në varësi të llojit të objektit, kompleksitetit dhe shkallës së vështirësisë së punimeve të kryera”.

Gjithashtu nuk gjenden gjurmë shkresore që mbikëqyrësi i punimeve dhe ndjekësi i kontratës si personi përgjegjës nga ana e AK të kenë kërkuar nga ana e tyre arsyet e mosparaqitjes të dosjes teknike nga ana e sipërmarrësit dhe kolaudimin e punimeve.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve “NG” sh.p.k me përfaqësues z. V. B sipas kontratës dhe AK ndjekësi i kontratës z. F. Z.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të dukshme të ndërtimit, (verifikimi me sy të lirë pasi terreni është shumë i vështirë), rezultuan diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbatuar (vizatimet sipas faktit) dhe jo të realizuar sipas specifikimeve teknike, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe shoqërisë në vlerën **20,410,158 lekë pa TVSH**.

1. Titulli i gjetjes:

Situata:

Punime të situacionuara por të pakryera në fakt.

Në objektin “Punime për mbrojtjen e shpatullës së djathtë mes veprës së marrjes dhe kreshtës së digës në HEC Koman” sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Kontraktor KESH dhe Operatorit Ekonomik “S” sh.pme Nr.4100/8Prot. datë 17.03.2021 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 629,617,663.81 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 5 muaj nga data dorëzimit të sheshit të ndërtimit, dhe zgjatje afati me Amendim Kontrate Nr.1 me Nr.313/1Prot. datë 20.01.2022, Amendim Kontrate Nr.2, Nr.139/7Prot. datë 21.04.2022 dhe shkresës Nr.139/34Prot. datë 17.06.2022 ka miratuar zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve deri më datë 15.10.2022, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konkretisht:

- Projekti fillestar;
- Projekti i Zbatimit pjesor (Vizatimet sipas faktit);
- Pagesat pjesore deri në situacionin përfundimtar;
- Librezat e masave pjesore deri në situacionin përfundimtar;
- Ndryshimet e miratuara nga AK;
- Korrespondencat midis KESH dhe OE që kryen supervizionimin “NG” sh.p.k.

si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pakryera në fakt. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:

Nr .	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)
1	Masa mbrojtëse inxhinierike Nr. 4	F.V Ankerat veteshpues Ø 32 L=3m (3x3) α=100	144,182
2	Masa mbrojtëse inxhinierike Nr. 13	F.V Ankerat veteshpues Ø 32 L=3m (3x3) α=100	88,126
3	Masa mbrojtëse inxhinierike Nr. 15	F.V Ankerat veteshpues Ø 32 L=3m (3x3) α=100	177,870
SHUMA			410,158

Kriteri:	Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 <u>ku përcaktohet se:</u> “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit” -Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1 <u>ku përcaktohet se:</u> “Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasitë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës” -Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3. - Kontrata e shërbimit me objekt “Mbikëqyrje e punimeve për mbrojtjen e shpatullës së djathtë mes veprës së marrjes dhe kreshtës së digës në HEC Koman”, Nr.2753/4Prot. datë 23.06.2021.
Ndikimi/Efekti:	Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në shumën 410,158 lekë pa TVSH.
Shkaku:	Certifikimi nga ana e mbikëqyrësit volume punimesh të pakryera në fakt nga ana e sipërmarrësit.
Rëndësia:	E lartë.
1.1.Rekomandimi:	KESH të marri masa duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, për arkëtimin e shumës 410,158 Lekë pa TVSH, nga OE “S” sh.p.k për zëra punimesh të pa kryera sipas kontratës së lidhur me Nr.4100/8Prot. datë 17.03.2021 “Punime për mbrojtjen e shpatullës së djathtë mes veprës së marrjes dhe kreshtës së digës në HEC Koman” vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.
2. Titulli i gjetjes:	Punime të situacionuara por të pakryera sipas specifikimeve teknike.
Situata:	Në kontratën <u>“Punime për mbrojtjen e shpatullës së djathtë mes veprës së marrjes dhe kreshtës së digës në HEC Koman”</u> të lidhur midis Autoritetit Kontraktor KESH dhe Operatorit Ekonomik “S” sh.p.k me Nr.4100/8Prot. datë 17.03.2021 në projekt-preventiv është parashikuar një platformë e cila do të bëjë të mundur pritjen e materialeve duke shmangur mbushjen e basenit gjatë kryerjes së punimeve të kësaj kontrate dhe në të ardhmen. Referuar detajeve të projektit kjo platformë në sipërfaqen e saj duhet të mbulohet me binarë druri 10x10 për amortizimin e goditjeve. Nga vizita në terren, nga vëzhgimi me sy të lirë konstatohet se në një pjesë të saj kjo platformë nuk është e mbuluar me binarët e drutit. Gjithashtu platforma nuk është e ankoruar në afërsi të skarpatit për të kryer funksionin e saj pas përfundimit të projektit. Në preventivin fillestar dhe në ofertën e paraqitur nga kontraktori vlera e platformës është lump sum dhe nuk është e detajuar për cdo pjesë përbërëse të saj sipas detajeve të projektit. Vlera totale e saj është 20,000,000 lekë pa TVSH. Nisur nga fakti që platforma nuk është realizuar sipas specifikimeve të kërkuara dhe nga dokumentacioni i paraqitur nuk mund të vlerësohet vlera e detajeve të pa realizuara, e kështu vlera e saj prej 20,000,000 lekë pa TVSH konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe të shoqërisë deri në këtë fazë të auditimit.

Kriteri:	Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 <u>ku përcaktohet se: “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.</u> -Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1 <u>ku përcaktohet se: “Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasitë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”.</u> -Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3. - Kontrata e shërbimit me objekt “Mbikëqyrje e punimeve për mbrojtjen e shpatullës së djathtë mes veprës së marrjes dhe kreshtës së digës në HEC Koman”,Nr.2753/4Prot. datë 23.06.2021.
Ndikimi/Efekti:	Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në shumën 20,000,000 lekë pa TVSH pasi vlera e platformës nuk është e detajuar.
Shkaku:	Certifikimi nga ana e mbikëqyrësit të punimeve jo të kryera sipas detajeve të projektit.
Rëndësia:	E lartë.
2.1.Rekomandimi:	KESH në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marri masa, për plotësimin e platformës pluskuese me pjesët përbërëse sipas projektit. Në rast se plotësimi i saj nuk realizohet vlera prej 20,000,000 lekë pa TVSH të konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe të arkëtohet, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, nga OE “S” sh.p.k sipas kontratës së lidhur me Nr.4100/8Prot. datë 17.03.2021për realizimin e punimeve civile.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i mbikëqyrësit OE “NG” sh.p.k z.V. B sipas kontratës së shërbimit Nr.2753/4Prot. datë 23.06.2021me objekt: “Mbikëqyrje e punimeve për mbrojtjen e shpatullës së djathtë mes veprës së marrjes dhe kreshtës së digës në HEC Koman”.

3. Titulli i gjetjes:

Situata:

Kolaudimi i objektit nuk është kryer sipas afateve të përcaktuara. Në kontratën “Punime për mbrojtjen e shpatullës së djathtë mes veprës së marrjes dhe kreshtës së digës në HEC Koman” të lidhur midis Autoritetit Kontraktor KESH dhe Operatorit Ekonomik “S” sh.p.kme Nr.4100/8Prot. datë 17.03.2021, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion nuk konstatohen gjurmë që nga e sipërmarrësit dhe mbikëqyrësi të punimeve të jetë dorëzuar dosja teknike pas përfundimit të punimeve dhe më pas kryerjen e kolaudimit të punimeve. Gjithashtu konstatohet se kolaudimi i punimeve nuk është kryer dhe objekti nuk është marrë në dorzim nga ana e investitorit. Pas kolaudimit të punimeve fillon dhe afati i garancisë së tyre sipas kushteve të përcaktuara në kontratë por moskryerja e kolaudimit mund të krijoj mosmarrëveshje me sipërmarrësin për afatin e garancisë së punimeve të përcaktuar në kontratë. Gjithashtu nuk gjenden gjurmë shkresore që mbikëqyrësi i punimeve dhe ndjekësi i kontratës si personi përgjegjës nga ana e AK të kenë kërkuar nga ana e tyre arsyet

Kriteri:	e mosparaqitjes të dosjes teknike nga ana e sipërmarrësit dhe kolaudimin e punimeve. Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar. Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2021 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu I, pika 15 ku citohet: “Sipërmarrësi duhet t’i njoftojë me shkrim mbikëqyrësit të punimeve përfundimin e punimeve. Me këtë rast, brenda 30 ditëve, ai i parqet mbikëqyrësit: a. Kontratën dhe aktet që lidhen me të. b. Regjistrimin e kontabilitetit. c. Procesverbalet e fillimit, të ndërprerjes ose të zgjatjes dhe të përfundimit të punimeve. ç. Certifikatat e provave të materialeve të përdorura, të lëshuara nga laboratorët e autorizuar për këtë qëllim. d. Deklaratë se objekti është ndërtuar në përputhje me projektin dhe me kushtet teknike. Si dhe Kreu II, pika 8 ku citohet: “Periudha e garancisë për punimet e ndërtim-montimit në objektet, publike dhe jopublike, të përfunduara, fillon nga data e aktit të kolaudimit të punimeve dhe zgjat nga një deri në dy vjet, gjë që përcaktohet në kontratë, për veprën në tërësi a për pjesë apo procese të veçanta, në varësi të llojit të objektit, kompleksitetit dhe shkallës së vështirësisë së punimeve të kryera”.
Ndikimi/Efekti:	Mos kryerja e kolaudimit mund të sjell mosmarrëveshje me sipërmarrësin për afatin e garancisë së punimeve të përcaktuar në kontratë.
Shkaku:	Mos kolaudimi i objektit sipas afateve të përcaktuara në legjislacion.
Rëndësia:	E lartë.
3.1.Rekomandimi:	KESH në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të kryej verifikimin e dokumentacionit teknik, volumet e punimeve si dhe gjendjen e investimit dhe të kryej kolaudimin duke shmangur mosmarrëveshjet me sipërmarrësin e punimeve që mund të dalin nga tejkalimi i afateve të tij.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve “NG” sh.p.k me përfaqësues z. V. B sipas kontratës dhe AK ndjekësi i kontratës z. F. Z.

3. Mbi auditimin e ushtruar për zbatimin e Kontratës: “Mbrotjtja e kullave të ekuilibrit nga çarja e shkëmbinjve mbi to. Mbrotjtja dhe sistemimi nga rrëshqitja e koluvioneve në HEC Koman”.

Kontrata “Mbrotjtjen e kullave të ekuilibrit nga çarja e shkëmbinjve mbi to. Mbrotjtja dhe sistemimi nga rrëshqitja e koluvioneve në HEC Koman”, është nënshkruar me nr. 1462/7 prot., datë 07.09.2021, ndërmjet KESH dhe BOE “S dhe S”, me vlerë 395,748,714.7 lekë me TVSH. Kontrata është parashikuar të përfundojë për një periudhë 4 mujore. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur Shoqëria “NG” SHPK. Bazuar në Urdhrin nr. 1462/10 prot., datë 14.09.2021, personi përgjegjës për zbatimin e kontratës është emëruar z. I. H.

Kontrata përfshin punime për sistemimin e sipërfaqeve të çrregullta, mbrotjtjeje me barriera me rrjetë metalike, ankerime, të ndarë në tre zona A ,B dhe C. Për zonën A janë parashikuar shtatë masa, për zonën B tre masa dhe për zonën C dy masa. Qëllimi i investimit është mbrotjtja e kullave të ekuilibrit nga dëmtimi, si pasojë e rënies së shkëmbinjve nga shpati i malit mbi to.

Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit është mbajtur me datë 21.10.2021. Njoftimi për fillimin e punimeve është bërë sipas shkresës nr. 376 prot., datë 21.10.2021.

Kontratës i janë bërë dy amendamente. Amendamenti nr. 1, është bërë më nr. 517/10 prot., datë 16.02.2022. Ky amendament ka të bëjë me shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve për një periudhë 58 ditore (deri datë 21.04.2022), bazuar në vonesat e shkaktuara si shkak i motit me shira dhe ngrica. Amendamenti i dytë është miratuar me nr. 517/27 prot., datë 21.04.2022, i cili ka të bëjë me shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve deri datë 15.06.2022.

Njoftimi për përfundimin e punimeve është bërë me shkresë nr. 236 prot., datë 15.06.2022.

Gjatë zbatimit të punimeve, sipas shkresës së mbikëqyrësit të punimeve nr. 31, datë 31.01.2022, është kërkuar ndryshimi e një zëri të punimeve zonën A, masa 6. Ishte parashikuar “F.V anker ekspansivë PM24C I=15m/I 18 m, diametri i profilin Ø 37 mm, ndërsa diametri origjinal i tubit Ø 54 mm (7 rreshta me gjatësi 18 m çdo 2 m dhe 3 rreshta me gjatësi 15 m çdo dy metër), zë i cili është kërkuar të zëvendësohet me “F.V me anker vetëshpues Ø 32 mm, l=3 m (3 x 3), $\alpha = 10^0$ ”. Kontraktori me shkresë datë 28.01.2022 ka kërkuar zëvendësimin e tankerit ekspansiv, seksion tubuar me diametër të profilin Ø 32 mm e tubit 57 (Tip PM24C), me anker vetëshpues seksion tërthor të plotë me diametër Ø 38 mm, me aftësi mbajtëse në tërheqje 258 KN dhe në këputje 309 KN.

Nga verifikimi i situacionit përfundimtar rezulton se është aplikuar zëri “F.V anker vetëshpues I=15m/I 18 m, diametri i profilin Ø 32 mm, 7 rreshta me gjatësi 18 m çdo 2 m dhe 3 rreshta me gjatësi 15 m çdo dy metër”. Ndryshimi është argumentuar me faktin se në zonë ekziston një çarje e shkëmbit pasojë e të cilit, vendosja e ankerave tubularë nuk do të ishte efektive, pasi metodologjia e mbajtjes së ngarkesës varet nga presioni i tubit në gjatësi të tankerit, presion i cili nuk mund të ushtrohet në seksionin e çarjes i cili raportohet të jetë deri në dy metër.

Miratimi për rishikimin e projekt-preventivit dhe përdorimin e fondit rezervë është bërë nga Titullari i AK me shkresë nr. 517/37 prot., datë 10.05.2022.

Ndryshimi i mësipërm nuk është shoqëruar me:

- Analizën nëse ka qenë i domosdoshëm ndryshimi i metodologjisë së vendosjes së ankerave, për zonën A.6 si dhe cili variant i ankerave është më i pranueshëm si për nga cilësia ashtu dhe kostoja, por është marrë në konsideratë vetëm varianti i paraqitur nga sipërmarrësi.

Nëse kjo mangësi rezulton nga llogaritje të gabuara nga ana e projektuesit, nuk janë përcaktuar dëmet, ku minimalisht janë shkaktuar vonesa në realizimin e kontratës.

- Llogaritjen e kostonë së punimeve, për përcaktimin e çmimit, i cili i është referuar zërit “F.V me anker vetëshpues Ø 32 mm, l=3 m (3 x 3), $\alpha = 10^0$ ”, ndërkohë që në përcaktimin e situacionit përfundimtar gjatësia e ankerave është 15 dhe 18 m. Makineria e shpimit (e cila zë shpenzimin kryesor në realizimin e këtij zëri punimi) shpenzon kohë më të vogël për anker më gjatësi më të madhe, për arsye se nuk realizon të njëjtin numër zhvendosjesh.

Veprime mësipërme janë në kundërshtim me:

- Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I, pika 3.4, ku përcaktohet:

*“Sipërmarrësi, brenda një afati të pranuar nga palët paraqet kërkesë-propozimet për korrigjime, plotësime **apo përmirësime në projekt** dhe për mungesat e pasaktësitë, ligjore a kontraktuale të dokumentacionit të dorëzuar”.*

- Ligjin nr. 120/2020 “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ‘Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit’ i ndryshuar” neni 5/1, pika 3.a, ku përcaktohet:

“Çdo projektues ose grup projektimi është i detyruar të lidhë një kontratë të sigurimit të përgjegjësisë profesionale për çdo dëm që mund të shkaktohet si pasojë e veprimtarisë së tij dhe duhet të mbulojë të paktën dëmet e mëposhtme:

*a) çdo shpenzim të nevojshëm e të domosdoshëm **të projektimit të ri**, si dhe shpenzimet shtesë të kryera nga zhvilluesi ose organet e administratës publike, që kanë rrjedhur si*

pasojë e gabimeve në projektim”.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve Shoqëria “N G” SHPK.
Situacioni përfundimtar është certifikuar me vlerë 329,790,595.6 lekë pa TVSH. Për kolaudimin e punimeve është caktuar z. I. Sh, ndërsa për marrjen në dorëzim është ngritur grupi i përbërë nga z. D. S, z. L. B dhe z. I. A.

Nga verifikimi i librezës së masave konstatohet se sipas zërit Masa B3.1 “Shkallëzim intensiv (heqja e shkëmbinjve të vlerësuar si më potencial për ta shkëputur dhe rrokullisur)”, është certifikuar sasia 11979 m³ dhe përfshirë në situacion përfundimtar sasia 9339.8 m³, ndërkohë që në librin e masave nuk ka asnjë llogaritje për këtë volum, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4, ku përcaktohet:

“Libri i masave mbahet për çdo objekt e nën objekt, që ka preventiv dhe është dokument bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve. Në të pasqyrohen vëllimet metrike të punimeve, gradualisht me zhvillimin e tyre”.

- 1. Titulli i gjetjes:** Punime të certifikuara, por të pa realizuara.
- Situata:** Nga verifikimi i disa zërave të punimeve në objekt, sipas kontratës “Mbrotjtjen e kullave të ekuilibrit nga çarja e shkëmbinjve mbi to. Mbrotjtja dhe sistemimi nga rrëshqitja e koluvioneve në HEC Koman”, u konstatua se sipas zërit “Masa mbrotjtëse inxhinierike-Zona B”, “Muret gabion” është certifikuar sasia 210 m³, ndërsa sipas faktit në terren rezulton e realizuar sasia 147.5 m³. Sasia 52.5 m³ është certifikuar më tepër. **Vlera 231,000 lekë** (52.5 m³ x 4,400 lekë/m³), është përfituar padrejtësisht nga BOE “S dhe S” dhe përbën dëm ekonomik.
- Kriteri:** Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7.
Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.
- Ndikimi:** Përfitim i padrejtë me vlerë **231,000 lekë**.
- Shkaku** Mos raportimi me saktësi i volumit të punimeve të realizuara.
- Rëndësia:** E mesme.
- Rekomandimi:** KESH SHA, të nxjerrë aktet administrative përkatëse dhe të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit **231,000 lekë**, nga BOE “S dhe S”, për punime të certifikuara, por të pa realizuara.

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Shoqëria “NG” SHPK.

4. Mbi auditimin e ushtruar për zbatimin e Kontratës “Furnizim – Instalim ekskavator special dhe greifer hidraulik në HEC Koman”.

Kontrata “Furnizim – Instalim ekskavator special dhe greifer hidraulik në HEC Koman”, është nënshkruar me nr. 4179/13 prot., datë 09.03.2021, ndërmjet KESH, përfaqësuar nga z. B. B dhe OE “AS ” SHPK, përfaqësuar nga z. A. B, me vlerë 176,400,000 lekë. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar 3 muaj, referuar datës së nënshkrimit të kontratës. Për ndjekjen e kontratës është caktuar z. Dh. T.

Kontratës bazë i janë bërë tre amendamente si më poshtë:

- **Amendamenti nr. 4197/21 prot.**, datë 09.06.2021, nënshkruar nga Administratori i KESH SHA z. E. V, i cili ka të bëjë me shtesën e afatit të dorëzimit të mekanizmit konkretisht me dy muaj, duke shtyrë datën e dorëzimit për 09.08.2021. Shtesa e afatit është referuar në kërkesën

e kontraktorit nr. 4197/20 prot., datë 09.06.2021, me argumentin: “Për shkak të shpalljes së gjendjes së pandemisë në shkallë botërore nga OBSH, fabrikë tek e cila është bërë porosia, nuk ka punuar me kapacitet të plotë dhe për disa kohë e ka ndërprerë prodhimin e këtyre mjeteve të punës”.

- **Amendamenti nr. 4030/2 prot.**, datë 09.08.2021, nënshkruar nga Administratori i KESH SHA z. E. V, i cili ka të bëjë me shtesën e afatit të dorëzimit të mekanizmit për datë 15.09.2021. Shtesa e afatit është referuar në kërkesën e kontraktorit nr. 4030/20 prot., datë 29.07.2021, me argumentin: “Si pasojë e përmbytjeve të ndodhura në Gjermani, fabrika në të cilën është bërë porosia, ka patur vështirësi në transportimin e ekskavatorit special dhe grejderit hidraulik”.

- **Amendamenti nr. 4559/1 prot.**, datë 15.09.2021, nënshkruar nga Administratori i KESH SHA z. E. V, i cili ka të bëjë me shtesën e afatit të dorëzimit të mekanizmit për datë 15.10.2021. Shtesa e afatit është referuar në kërkesën e kontraktorit nr. 4557 prot., datë 09.06.2021, me argumentin se fabrika italiane e cila po monton krahun e vinçit ka njoftuar se do të ketë përsëri vonesë për dorëzimin me përcaktimin: “Për shkak të pandemisë Covid 19 e cila e goditi globin, fabrika nuk po punon me kapacitet të plotë dhe jemi të detyruar të reduktojmë stafin i cili do merrej me montimin e krahut të vinçit, për këtë arsye jemi të detyruar të zgjasim afatin e montimit”.

Bazuar në sa më sipër, kërkesa për shtyrje të afatit të dorëzimit është e pa mbështetur ligjërisht për arsye se:

- Prodhuesi ka kërkuar që afati i dorëzimit të bëhet me datë 05.09.2021 (bazuar në relacionin e amendamentit të parë), dhe vonesa përtej këtij afati nuk është e paparashikueshme.

- Në shtesën e dytë të afatit nuk përcaktohen vonesa për arsye të COVID 19, por përmbytje të ndodhura në Gjermani. Nuk argumentohet nëse përmbytjet e ndodhura atje, kanë ndikuar në transportin e mekanizmit.

- Në shtesën e tretë të afatit cilësohet se për arsye të COVID 19, është bërë reduktim i stafit dhe fabrika nuk punon në kapacitet të plotë. Reduktimi i stafit nuk përbën argument për të mos iu përgjigjur kontratave të nënshkruara. Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, krahu i ekskavatorit special si dhe disa aksesore të tjerë si bllokues, kundërpesha, greifer, ganxha dhe zinxhirë, janë marrë në dorëzim në Koman me datë 30.09.2021, ndërsa vetë ekskavatori është marrë në ruajtje në HEC Koman me datë 12.10.2021. Kontraktori duhet të kërkojë zbatimin e kontratës nga prodhuesi dhe të kërkojë dëmshpërblim për vonesat, veprim i cili duhet të kryhej edhe nga KESH, për mos plotësim të kërkesave kontraktore.

Sa më sipër, referuar datës së premtuar nga prodhuesi 05.09.2021 dhe datës së dërgimit në HEC Koman të Ekskavatorit 12.10.2021, zgjatja e afatit me 27 ditë është e pa argumentuar dhe jo në përputhje me nenin 22, pika 2 të kontratës ku përcaktohet:

“Forcë madhore do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin dhe **e paparashikueshme** nga ana e tij. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e autoritetit kontraktor qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo trazimit”.

1. Titulli i gjetjes: Shtesa të afatit të dorëzimit të furnizimit të pa argumentuara.

Situata: Kontrata “Furnizim – Instalim ekskavator special dhe greifer hidraulik në HEC Koman”, është amenduar tre herë, si më poshtë:

- Amendamenti nr. 4197/21 prot., datë 09.06.2021, nënshkruar nga Administratori i KESH SHA z. E. V, i cili ka të bëjë me shtesën e afatit të dorëzimit të mekanizmit konkretisht me dy muaj, duke shtyrë datën e dorëzimit për 09.08.2021. Shtesa e afatit është referuar në kërkesën e kontraktorit nr. 4197/20 prot., datë 09.06.2021, me argumentin: “Për shkak të shpalljes së gjendjes së pandemisë në shkallë botërore nga OBSH, fabrikë tek e cila është bërë porosia, nuk

ka punuar me kapacitet të plotë dhe për disa kohë e ka ndërprerë prodhimin e këtyre mjeteve të punës”.

- Amendamenti nr. 4030/2 prot., datë 09.08.2021, nënshkruar nga Administratori i KESH SHA z. E. V, i cili ka të bëjë me shtesën e afatit të dorëzimit të mekanizmit për datë 15.09.2021. Shtesa e afatit është referuar në kërkesën e kontraktorit nr. 4030/20 prot., datë 29.07.2021, me argumentin: *“Si pasojë e përmytjeve të ndodhura në Gjermani, fabrika në të cilën është bërë porosia, ka patur vështirësi në transportimin e ekskavatorit special dhe grejderit hidraulik”.*

- Amendamenti nr. 4559/1 prot., datë 15.09.2021, nënshkruar nga Administratori i KESH SHA z. E. V, i cili ka të bëjë me shtesën e afatit të dorëzimit të mekanizmit për datë 15.10.2021. Shtesa e afatit është referuar në kërkesën e kontraktorit nr. 4557 prot., datë 09.06.2021, me argumentin se fabrika italiane e cila po monton krahun e vinçit ka njoftuar se do të ketë përsëri vonesë për dorëzimin me përcaktimin: *“Për shkak të pandemisë Covid 19 e cila e goditi globin, fabrika nuk po punon me kapacitet të plotë dhe jemi të detyruar të reduktojmë stafin i cili do merrej me montimin e krahut të vinçit, për këtë arsye jemi të detyruar të zgjasim afatin e montimit”.*

Bazuar në sa më sipër, kërkesa për shtyrje të afatit të dorëzimit është e pa mbështetur ligjërisht për arsye se:

- Prodhuesi ka kërkuar që afati i dorëzimit të bëhet me datë 05.09.2021 (bazuar në relacionin e amendamentit të parë), dhe vonesa përtej këtij afati nuk është e paparashikueshme.

- Në shtesën e dytë të afatit nuk përcaktohen vonesa për arsye të COVID 19, por përmytje të ndodhura në Gjermani. Nuk argumentohet nëse përmytjet e ndodhura atje, kanë ndikuar në transportin e mekanizmit.

- Në shtesën e tretë të afatit cilësohet se për arsye të COVID 19, është bërë reduktim i stafit dhe fabrika nuk punon në kapacitet të plotë. Reduktimi i stafit nuk përbën argument për të mos iu përgjigjur kontratave të nënshkruara. Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, krahu i ekskavatorit special si dhe disa aksesore të tjerë si bllokues, kundërpesha, greifer, ganxha dhe zinxhirë, janë marrë në dorëzim në Koman me datë 30.09.2021, ndërsa vetë ekskavatori është marrë në ruajtje në HEC Koman me datë 12.10.2021. Kontraktori duhet të kërkojë zbatimin e kontratës nga prodhuesi dhe të kërkojë dëmshpërblim për vonesat, veprim i cili duhet të kryhej edhe nga KESH, për mos plotësim të kërkesave kontraktore.

Sa më sipër, referuar datës së premtuar nga prodhuesi 05.09.2021 dhe datës së dërgimit në HEC Koman të Ekskavatorit 12.10.2021, zgjatja e afatit me 27 ditë është e pa argumentuar dhe jo në përputhje me nenin 22, pika 2 të kontratës.

Kriteri:

Kontrata e furnizimit, neni 22, pika 2.

Ndikimi:

Vënie me vonesë në aktivitetin e pastrimit të mekanizmit.

Shkaku

Vonesa të shkaktuara nga subjekte të kontraktuara nga furnitori.

Rëndësia:

E mesme.

Nga ana e KESH SHA të merren masa për monitorimin e vazhdueshëm e në mënyrë profesionale të kontratave të furnizimit, punimeve civile apo shërbimeve. Të shqyrtohen në mënyrë profesionale dhe në përputhje me termat e kontratave pretendimet e kontraktorëve, duke mbrojtur interesat e institucionit, si dhe

1.1.Rekomandimi:

shmangien e penaliteteve të mundshme nga interpretime të gabuara.

Nga ana e komisionit të kolaudit dhe marrjes në dorëzim të përbërë nga z. F. H, z. E. A, z. K. N dhe magazinierit znj. E. M, është mbajtur procesverbal nr. 249 prot., datë 30.09.2021, sipas të cilit janë marrë në ruajtje pjesë përbërëse të vinçit si krahë, bllokues, kundrapesha, greifer, ganxha dhe zinxhirë.

Procesverbal mbi marrjen në ruajtje të ekskavatorit special Model 655 me numër identifikimi 655.304, prodhuar nga “Sennebogen Maschinenfabrik” GMBH, prodhim i vitit 2021, është mbajtur me nr. 275 prot., datë 12.10.2021.

Akti i kolauditimi është mbajtur me nr. 320 prot., datë 11.11.2021, nga grupi i përbërë nga z. F. H, z. E. A dhe z. K. N, nënshkruar dhe nga ndjekësi i kontratës z. Dh. T.

Certifikata e marrjes në dorëzim të mallrave është lëshuar me nr. 320/1 prot., datë 11.11.2021, nga i njëjti komision si dhe ndjekësi i kontratës z. Dh. T.

Bazuar në relacionin teknik nr. 320/2 prot., datë 11.11.2021, provat në ngarkesë janë realizuar në periudhën nga data 04.11.2021 deri me datë 13.11.2021. Në këtë relacion përshkruhet se kontraktori ka njoftuar përfundimin e provës me datë 11.11.2021.

Fletë hyrja e vinçit në magazinën e HEC Koman është bërë me nr. 16, datë 11.11.2021.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Administratori z. E. V dhe punonjësi i ngarkuar me ndjekjen e kontratës z. Dh. T.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë, nga subjekti i audituar z. E. V dhe z. Dh. T, është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2205/82 prot., datë 15.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 407/12, datë 17.01.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Amendimet e kontratës janë bazuar në kërkesat e kontraktorit. Këto kërkesa janë mbështetur në njoftimet e bëra nga prodhues dhe në të gjitha rastet janë parashtruar shkaqet e vonës së pajisjeve objekt kontrate.

Sipas amendamentit nr. 1, kontraktori ka paraqitur dy shkresa të cilat mbështeten në faktin e ditur publikisht të vonësve në zinxhirin e prodhimit të shkaktuara nga pandemia Covid-19.

Sipas amendamentit nr. 2, nga ana e kontraktorit është paraqitur shkresa e datës 02.08.2021, ku është kërkuar zgjatja e afatit për një periudhë 1 mujore me argumentin se prodhuesi ka kërkuar shtyrjen e afatit deri me datë 15.09.2021, me argumentin e vështirësive të krijuara nga pandemia Covid-19 dhe vështirësive të hasura nga prodhuesi për transportin e pjesëve me dimensione të mëdha në kushtet e përmbytjeve të ndodhura në Gjermani.

Sipas amendamentit nr. 3, kontraktori me anë të shkresës datë 15.09.2021, është kërkuar zgjatja e afatit me 1 muaj, për arsye të problematikave të prodhuesit për shkak të pandemisë. Shtesat janë bazuar në nenin 22 të kontratës “Forcë madhore”.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me pretendimet e paraqitura sqarojmë se nga ana e KESH duhet të bëheshin interpretime të sakta të neneve të kontratës, në mënyrë që shtesat e afatit të dorëzimit të ishin të mirë argumentuara. Nëse për vonesa për arsye të pandemisë, ka argumente të qëndrueshme, në rastin e përmbytjeve të pretenduara në Gjermani të cilat kanë sjellë vonesa në transport, duhet të kërkohej dokumentacion shtesë mbi këtë fakt, duke argumentuar nëse ka qenë i pamundur transporti në rrjete rrugore alternative.

5. Mbi auditimin e ushtruar për zbatimin e Kontratës: “Ndërhyrje për mirëmbajtjen e sistemeve të CO₂ në HEC Fierzë dhe HEC Koman”.

Kontrata “Ndërhyrje për mirëmbajtjen e sistemeve të CO₂ në HEC Fierzë dhe HEC Koman”, është nënshkruar me nr. 3258/10 prot., datë 18.10.2021, ndërmjet KESH SHA përfaqësuar nga z. E. V dhe OE “J” SHPK përfaqësuar nga z. D. M, me vlerë 69,300,000 lekë. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur Shoqëria “I C” SHPK.

Në nenin 7 të kontratës përcaktohet: *“Çmimi i kontratës do të jetë i pa ndryshueshëm përgjatë kohëzgjatjes së realizimit të kontratës, përveç rasteve të parashikuara në nenin 24”*.

Në nenin 24 përcaktohet: *“Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe dikton kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës”*.

Në nenin 10 të Kontratës përcaktohet: *“Kjo kontratë është me çelësa në dorë, ku përfshihet hartimi i një projekti e më pas faza e punimeve e cila do të situacionohet me çmim njësie të bazuar në çmimet e njësisë të shprehura në preventivin njësi”*.

Afati i përfundimit të kontratës është përcaktuar 12 muaj, periudhë e cila është ndarë 2 muaj për realizimin e projektit dhe 10 muaj për fazën e zbatimit.

Kontratës bazë i janë bërë 2 amendamente si më poshtë:

Amendamenti nr. 1, nr. 4989/3 prot., datë 04.11.2022, sipas të cilit shtyhet afati i përfundimit të punimeve me 38 ditë.

Amendamenti nr. 2, nr. 1726/5 prot., datë 16.05.2023, sipas të cilit shtyhet afati i përfundimit të punimeve me 30 ditë. Në këtë amendament është miratuar edhe ndryshimi sipas zërit 5, ku sasia prej 4 panele është rritur në 8, me argumentimin se çdo pajisje ventilimi dhe aspirimi të ketë komandim më vete, si dhe zërit 6, i cili ka të bëjë me zëvendësimin e panelit qendror të kontrollit me një panel qendror ushqimi.

Për shqyrtimin dhe miratimin e projektit të detajuar teknik dhe preventivit të punimeve me Urdhër të titullarit të AK nr. 3258/14 prot., datë 25.10.2021, është ngritur grupi teknik i përbërë nga z. F. H, z. R. P dhe znj. R. A. Miratimi i projektit të detajuar është bërë sipas aktit nr. 3258/16 prot., datë 07.12.2021.

Njoftimi i fillimit të punimeve të zbatimit për HEC Koman është bërë me datë 05.01.2022, ndërsa për HEC Fierzë me datë 10.01.2022.

Njoftimi i përfundimit të punimeve është bërë sipas shkresës regjistruar në KESH me nr. 1726/13 prot., datë 13.07.2023. Shtesat në afatin e përfundimit të punimeve janë argumentuar me vonesën në dhënien e aksesit në punimet në dhomat e gjeneratorëve. Duke marrë në konsideratë shtesën e afatit, punimet kanë përfunduar sipas afatit të përcaktuar në kontratë.

Situacioni nr. 1 (punime për periudhën 05.01.2022 deri 31.02.2022), është dorëzuar nga Kontraktori me nr. 14 prot., datë 07.02.2022, me vlerë 46,920,000 lekë. Në këtë situacion paraqiten të pa realizuar vetëm zërat 3, 5, 6, 9,10,11,12 dhe 13, të punimeve të përcaktuara për HEC Fierzë.

Me shkresë nr. 11.554-310-2D prot., datë 05.04.2022, mbikëqyrësi i punimeve ka kërkuar aprovimin për dyert e aksesit të cilat kërkonin zgjerim. Miratimi është dhënë nga KESH me shkresë nr. 276/8 prot., datë 07.04.2022.

Situacioni nr. 2, me vlerë 10,728,000 lekë, është paraqitur për pagesë me datë 10.06.2022. Sipas këtij relacioni, janë realizuar zërat 3, 9 dhe 11.

Mbi përdorimin e fondit rezervë.

Në lidhje me përdorimin e fondit rezervë, mbikëqyrësi i punimeve me shkresë nr. 11.646-310-1D, datë 31.03.2023, drejtuar Kontraktorit “J” SHPK dhe për dijeni ndjekësit të kontratës z. D. T, ka vënë në dijeni kontraktorin se, ndër të tjera, duke qenë se tipi i kontratës është me çelësa në dorë, projekti i detajuar teknik bashkë me preventivin i hartuar nga kontraktori, duhet të ketë marrë aprovimin e KESH, më parë, pra duhet një preventiv i ndryshuar dhe i miratuar zyrtarisht, në mënyrë që ne të japim autorizimin për përdorimin e fondit rezervë sipas kontratës.

Relacioni për përdorimin e fondit rezervë është paraqitur nga mbikëqyrësi i punimeve me shkresë nr. ICE-11.650-310-6D, datë 26.04.2023. Në relacion përcaktohet: *“Në si mbikëqyrës punimesh japim miratimin për ekzekutimin e projektit, duke qenë se projektuesi ka paraqitur një projekt, i cili është miratuar dhe ky projekt ka ndryshime në anën funksionale të operimit. Po kështu, ky projekt është shoqëruar me preventiv, analizat e çmimeve të reja si dhe relacionin teknik për ndryshimet”*. Për përdorimin e fondit rezervë, kërkohet që të merret aprovimi nga KESH SHA.

Shoqëria projektuese “G C” SHPK, në një dokument pa numër dhe pa datë, ka dhënë sqarime në lidhje me ndryshimin e kërkuar. Sipas projektuesit, arsyeja kryesore që lidhet me këtë ndryshim është në pikëpamjen e sigurisë së funksionimit të sistemit. Nisur nga parimi i funksionimit duhet që pasi të ketë mbaruar fikja e zjarrit në dhomën e gjeneratorit, të fillojë procesi i largimit të CO₂ dhe vetëm pasi të jetë pastruar dhoma e gjeneratorit nga pastrimi i CO₂ do të duhet të fillojë procesi i furnizimit me ajër të freskët. Pra puna e aspiratorit dhe e ventilatorit duhet të jenë të shfaruara në kohë. Në rast se ventilatori i ajrit të freskët do të vendoset në funksionim përpara aspiratorit të largimit të CO₂ në dhomën e gjeneratorit do të krijohet një presion manometrik dhe rritet probabiliteti që CO₂ të dalë në ambientet e sallës së makinerive duke rrezikuar shëndetin e punonjësve. Duke ditur që manovrimi i ventilatorit apo aspiratorit do të realizohet nga personeli në kushtet e emergjencës duke vendosur një panel komandimi të përbashkët ekziston rreziku që personeli të ngatërrojë radhën e komandimit të tyre. Për këtë arsye rekomandohet që panelet e komandimit të jenë të ndara. Amendamenti nr. 2, është miratuar nga titullari i KESH me nr. 1726/5 prot., datë 16.05.2023, duke miratuar edhe ndryshimin e numrit të paneleve nga 4 në 8 copë.

Sa më sipër rezulton se:

- Projekti i zbatimit është miratuar me datë 07.12.2021. Në relacionin përkatës, nuk përmendet në asnjë rast ndryshimi i skemës, apo zërit nr. 5.
- Situacioni nr. 2, i paraqitur në muajin maj 2022, është hartuar duke marrë në konsideratë zërin 5, me katër panele dhe jo 8 panele, nga ku vërtetohet se nevoja për vendosjen e 8 paneleve, është përcaktuar pas miratimit të projektit teknik të detajuar.
- Në situacionin nr. 3, i paraqitur në muajin maj 2022 (data e kontraktorit 31.05.2022, protokolluar në KESH me nr. 1726/7 prot., datë 07.06.2023), ka paraqitur ndryshimin e zërit nr. 5, nga 4 panele në 8 panele.

Duke qenë se kemi të bëjmë me kontratë me çelësa në dorë, risku për shtesa në sasi dhe vlerë i mbetet kontraktorit dhe bazuar në nenin 7 të kontratës, çmimi i kontratës duhet të mbetet i pa ndryshuar, megjithëse panelet janë përcaktuar në preventiv me numër dhe jo një njësi që përcakton funksionin e paneleve pa numër të caktuar.

- Përfshirja e fondit rezervë në këtë lloj kontrate, është bërë në mënyrë të gabuar (cilësuar në procedurën e prokurimit të audituar).

Vlera e fondit rezervë në shumën 2,750,000 lekë konsiderohet si shpenzim pa efektivitet, pasi procesi i komandimit mund të realizohej edhe me 4 panele siç ishte parashikuar. Nuk ka një analizë sipas të cilës të identifikohet nevoja e shpenzimit për vendosjen e paneleve, apo trajnimi i punonjësve që angazhohen në procesin e komandimit në raste të rënies së zjarrit. Është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 39, pika 1.b.i, ku përcaktohet:

Pika 1.b.i: *“Punët publike mund të prokurohen me kontratë me çelësa në dorë, ku vëllimi i punëve i parashikuar në projekt-preventiv, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit. Në këtë rast, kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi”*.

Pika 1.b.ii: *Punët publike mund të prokurohen me kontratë me çelësa në dorë, kur autoriteti kontraktor nuk ka hartuar projekt-preventiv, por ka vetëm një projektide, apo detyrë projektimi dhe terma reference për objektin që prokuron.*

Në këtë rast, autoriteti kontraktor kërkon nga kontraktori hartimin e projekt-preventivit, si dhe realizimin e punimeve të zbatimit të këtij projekti, pas miratimit paraprak të tij nga autoriteti kontraktor.

Në këtë rast kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, sipas projekt-preventivit të miratuar paraprakisht nga autoriteti kontraktor, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

Me datë 21.09.2023, u verifikuan disa zëra të punimeve të realizuara në objekt. Nga verifikimi sipas zërit 2 "Punime civile për hapjen e dritareve për kalimin e tubacioneve të futjes së ajrit të freskët në gjenerator për ventilim dhe instalimi i bazamentit të ventilatorit, sipas specifikimeve teknike", rezulton se tubacioni nuk është vendosur jashtë godinës, por brenda saj, duke shmangur hapjen e një dritareje për gjenerator. Ky veprim është në kundërshtim me specifikimet teknike ku përcaktohet:

"Projekti i plotë i detajuar teknik, duhet të përmbajë të paktën, por jo e kufizuar në: ...Punimet ndërtimore për hapjen e dritareve në taracat e sallave të turbinave dhe makinerive dhe faqet e mureve anësore të ndërtesës së centralit për kalimin e tubacioneve deri në kuotën 182.7 s.l (Për thithjen e ajrit të pastër nga atmosfera dhe 197 s.l (për thithjen e gazrave CO₂), në taracën e ndërtesës së centralit..."

1. Titulli i gjetjes:

Situata:

Mos menaxhim i duhur i kontratës.

Në lidhje me përdorimin e fondit rezervë, sipas kontratës "Ndërhyrje për mirëmbajtjen e sistemeve të CO₂ në HEC Fierzë dhe HEC Koman", mbikëqyrësi i punimeve me shkresë nr. 11.646-310-1D, datë 31.03.2023, ka vënë në dijeni kontraktorin se, ndër të tjera, duke qenë se tipi i kontratës është me çelësa në dorë, projekti i detajuar teknik bashkë me preventivin i hartuar nga kontraktori, duhet të ketë marrë aprovimin e KESH, më parë, pra duhet një preventiv i ndryshuar dhe i miratuar zyrtarisht, në mënyrë që ne të japim autorizimin për përdorimin e fondit rezervë sipas kontratës.

Shoqëria projektuese "G C" SHPK, në një dokument pa numër dhe pa datë, ka dhënë sqarime në lidhje me ndryshimin e kërkuar. Sipas projektuesit, arsyeja kryesore që lidhet me këtë ndryshim është në pikëpamjen e sigurisë së funksionimit të sistemit. Nisur nga parimi i funksionimit duhet që pasi të ketë mbaruar fikja e zjarrit në dhomën e gjeneratorit, të fillojë procesi i largimit të CO₂ dhe vetëm pasi të jetë pastruar dhoma e gjeneratorit nga pastrimi i CO₂ do të duhet të fillojë procesi i furnizimit me ajër të freskët. Pra puna e aspiratorit dhe e ventilatorit duhet të jenë të shfaruara në kohë. Në rast se ventilatori i ajrit të freskët do të vendoset në funksionim përpara aspiratorit të largimit të CO₂ në dhomën e gjeneratorit do të krijohet një presion manometrik dhe rritet probabiliteti që CO₂ të dalë në ambientet e sallës së makinerive duke rrezikuar shëndetin e punonjësve. Duke ditur që manovrimi i ventilatorit apo aspiratorit do të realizohet nga personeli në kushtet e emergjencës duke vendosur një panel komandimi të përbashkët ekziston rreziku që personeli të ngatërrojë radhën e komandimit të tyre. Për këtë arsye rekomandohet që panelet e komandimit të jenë të ndara.

Amendamenti nr. 2, është miratuar nga titullari i KESH me nr. 1726/5 prot., datë 16.05.2023, duke miratuar edhe ndryshimin e numrit të paneleve nga 4 në 8 copë.

Vlera e fondit rezervë në shumën 2,750,000 lekë konsiderohet si shpenzim pa efektivitet, pasi procesi i komandimit mund të realizohej edhe me 4 panele siç ishte parashikuar. Nuk ka një analizë

	sipas të cilës të identifikohet nevoja e shpenzimit për vendosjen e paneleve, apo trajnimi i punonjësve që angazhohen në procesin e komandimit në raste të rënies së zjarrit.
Kriteri:	VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 39, pika 1.b.i.
Ndikimi:	Janë realizuar shpenzime të pa efektivitet.
Shkaku	Mungesa e një parashikimi të saktë i sistemeve.
Rëndësia:	E mesme.
1.1.Rekomandimi:	Nga ana e KESH SHA, për kontrata me çelësa në dorë, të merren masa për pranimin e preventivëve, pa përfshirë fond rezervë, pasi nga vetë lloji i këtyre kontratave, punimet duhet të realizohen brenda vlerës së parashikuar dhe projektit të miratuar.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Mbikëqyrësi i punimeve Shoqëria “I C” SHPK, si dhe z. Dh. T, në cilësinë e ndjekësit të kontratës.

Në fazën e auditimit, objekti ishte në fazën e kolauditimit.

6. Mbi auditimin e ushtruar për zbatimin e Kontratës “Blerje vaj hidraulik T-68 për kushinetat e katër hidroagregateve në HEC Fierzë”.

Kontrata e furnizimit nr. 1845/12 prot., datë 02.09.2022 “Blerje vaj hidraulik T-68 për kushinetat e katër hidroagregateve në HEC Fierzë, është nënshkruar ndërmjet KESH dhe OE “BA” SHA me vlerë 31,920,000 lekë. Afati i furnizimit është përcaktuar 3 muaj. Me Urdhër të Titullarit të AK nr. 1845/15 prot., datë 07.09.2022, personi përgjegjës për zbatimin e kontratës është caktuar znj. R. A. Për kolauditimin dhe marrjen në dorëzim të vajit është caktuar komisioni i përbërë nga z. D. T, z. R. S dhe znj. F. K.

Akti i kolauditimit të vajit është mbajtur nga komisioni përkatës dhe ndjekësi i kontratës me nr. 829/1 prot., datë 10.10.2022. Certifikata e marrjes në dorëzim është lëshuar me nr. 829/2 prot., datë 10.10.2022.

Nga ana e Kontraktorit është paraqitur raporti i testimit të vajit i datës 20.09.2022 (realizuar nga laborator i kësaj kompanie). Bazuar në këtë raport si dhe specifikimet teknike, nuk jepen të dhëna në lidhje me viskozitetin e vajit në temperaturë 100⁰, indeksi i viskozitetit paraqitet në masën 115, ndërsa në specifikimet teknike paraqitet 98. Nuk jepen të dhëna në lidhje me pikën e ndezjes në enë të mbyllur, po ashtu nuk paraqitet nëse përmban PCB. Marrja në dorëzim e vajit, pa siguruar përmbushjen e specifikimeve teknike në tërësi dhe elementë të veçanta është në kundërshtim me kontratën e furnizimit, neni 6, ku përcaktohet:

“Furnizuesi do të jetë përgjegjës për furnizimin e të gjitha mallrave dhe shërbimeve të lidhura me to të përfshira në objektin e furnizimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Në nenin 6, pika 6.1, të kushteve të veçanta të kontratës, përcaktohet: “Blerësi (KESH) para marrjes në dorëzim të mallit mund të dërgojë për verifikim të treguesve fiziko-kimikë disa kampione të vajit të furnizuar nga furnizuesi në një laborator ndërkombëtar të certifikuar. Të gjitha shpenzimet për kryerjen e testimeve do të mbulohen nga furnizuesi”. Në nenin 7.2.3 “Dorëzimet”, të Kushteve të Veçanta të Kontratës Përcaktohet: “Mallrat do të shoqërohen me dokumentet e mëposhtëm ‘Certifikata/at e analizave fiziko/kimike të uzinës prodhuese nga një laborator i certifikuar, ku të tregohen rezultatet për parametrat e pikës 4, të specifikimeve teknike”.

Nga ana e KESH duhet të kërkohej një analizë e tillë, për arsye se raporti i testimit të paraqitur i përket laboratorit të furnizuesit, si dhe në këtë raport nuk paraqiten të gjitha të dhënat e kërkuara në specifikimet teknike. Veprime në kundërshtim me specifikimet teknike.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi znj. R. A si dhe komisioni i përbërë nga z. Dh. T, z. R. S dhe znj. F. Kj.

Me datë 21.09.2023, në HEC Fierzë u verifikua produkti i furnizuar sa i takon ambalazhimit dhe sasisë së furnizuar. Rezulton se një sasi e vajit është hedhur në tankerët e gjeneratorëve, prej nga nuk mund të bëhej një bilanc i saktë i sasisë së furnizuar. Në ambientet e HEC ndodheshin afërsisht 28000 litra vaj e pa përdorur akoma. Duke marrë në konsideratë faktin se nga data e marrjes në dorëzim (datë 10.10.2022) ka kaluar gati një vit dhe sasia e përdorur është në masën afërsisht 28 %, konsiderohet se janë furnizuar sasi të konsiderueshme dhe mbi nevojat. Në ambalazhet përkatëse përcaktohet data e mbushjes (09.2022) dhe data e skadencës (09.2025). **Duke marrë në konsideratë faktin se ky produkt skadon për një afat 3 vjeçar, në rast mos përdorimi ky produkt do të bëhej i pa përdorshëm duke reflektuar me humbje ekonomike.** Në relacionin teknik nr. 245 prot., datë 16.03.2022 “Mbi gjendjen dhe nevojën për vaj hidraulik T68, në HEC Fierzë”, nuk është përcaktuar sasia e duhur për furnizim, por vetëm gjendja e vajit të përdorshëm në sasinë 4907 litra dhe vaj me mundësi trajtimi në sasinë 18000 litra. Në specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës i përbërë nga z. M. Sh, z. F. H dhe z. R. P, pika 5 “Preventivi”, është përcaktuar sasia 40000 litra.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 25.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i punës i përbërë nga z. M. Sh, z. F. H dhe z. R. P.

1. Titulli i gjetjes: Furnizime pa garantuar specifikimet teknike, si dhe programim i pa studiuar i sasisë së nevojshme.

Situata: Nga ana e Kontraktorit është paraqitur raporti i testimit të vajit i datës 20.09.2022 (realizuar nga laborator i kësaj kompanie). Bazuar në këtë raport si dhe specifikimet teknike, nuk jepen të dhëna në lidhje me viskozitetin e vajit në temperaturë 100⁰, indeksi i viskozitetit paraqitet në masën 115, ndërsa në specifikimet teknike paraqitet 98. Nuk jepen të dhëna në lidhje me pikën e ndezjes në enë të mbyllur, po ashtu nuk paraqitet nëse përmban PCB.

Në nenin 6, pika 6.1, të kushteve të veçanta të kontratës, përcaktohet: “Blerësi (KESH) para marrjes në dorëzim të mallit mund të dërgojë për verifikim të treguesve fiziko-kimikë disa kampione të vajit të furnizuar nga furnizuesi në një laborator ndërkombëtar të certifikuar. Të gjitha shpenzimet për kryerjen e testimeve do të mbulohen nga furnizuesi”. Në nenin 7.2.3 “Dorëzimet”, të Kushteve të Veçanta të Kontratës Përcaktohet: “Mallrat do të shoqërohen me dokumentet e mëposhtëm ‘Certifikata/at e analizave fiziko/kimike të uzinës prodhuese nga një laborator i certifikuar, ku të tregohen rezultatet për parametrat e pikës 4, të specifikimeve teknike’”.

Duke marrë në konsideratë faktin se nga data e marrjes në dorëzim (datë 10.10.2022) ka kaluar gati një vit dhe sasia e përdorur është në masën afërsisht 28 %, konsiderohet se janë furnizuar sasi të konsiderueshme dhe mbi nevojat. Në ambalazhet përkatëse përcaktohet data e mbushjes (09.2022) dhe data e skadencës (09.2025). **Duke marrë në konsideratë faktin se ky produkt skadon për një afat 3 vjeçar, në rast mos përdorimi ky produkt do të bëhej i pa përdorshëm duke reflektuar me humbje ekonomike.**

Kriteri: Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 25.

Ndikimi:	Krijimi i rezervave të pa nevojshme.
Shkaku	Mos parashikimi mbi bazë të nevojave reale.
Rëndësia:	E mesme.
1.1.Rekomandimi:	Nga ana e KESH SHA, për furnizime me vajra hidraulike, të merren masa për realizimin e provave laboratorike për produktin e furnizuar, për të saktësuar përputhshmërinë me specifikimet teknike dhe jo të mjaftohet me provat laboratorike që paraqiten nga furnizuesit.
1.2.Rekomandimi:	Të merren masa për parashikimin e nevojave për furnizime, mbi bazë të nevojave reale, për të shmangur krijimin e stokut, mallrave me qarkullim të ngadalshëm dhe mundësinë e skadimit të tyre, të cilat në rastin e vajrave, minimalisht rritet kostoja për ri trajtimin.

7. Mbi auditimin e ushtruar për zbatimin e Kontratës: "Furnizim instalim elemente bateri stacionare akumulatore acide, elemente 2VDC, 300Ah, për dy sallat 48V në ndërtesën e centralit dhe për një salle 220VDC në N/Stacionin 220kV, me aksesoret përkatës të montimit dhe instalimit, për HEC Fierzë".

Kontrata "Furnizim instalim elemente bateri stacionare akumulatore acide, elemente 2VDC, 300Ah, për dy sallat 48V..., HEC Fierzë", është nënshkruar me nr. 3553/4 prot., datë 20.09.2021, me OE "A Co" SHPK, me vlerë 17,280,000 lekë. Afati i dorëzimit është përcaktuar 6 muaj, referuar datës së nënshkrimit të kontratës. Nga ana e kontraktorit është bërë kërkesë për dorëzimin e furnizimit me shkresë nr. 3553/8 prot., datë 13.12.2021. Komisioni i kolaudit është ngritur me Urdhër nr. 3553/7 prot., datë 13.10.2021, me përbërje z. P. V, z. R. Gj dhe z. P. M.

Aktkolauidimi është mbajtur me datë 20.12.2021. Certifikata e marrjes në dorëzim është lëshuar me datë 20.12.2021, nga i njëjti komision. Në komision nuk është përfshirë punonjësi me përgjegjësi materiale, në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik", i ndryshuar, (Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara) pika 43, ku përcaktohet:

"Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi material".

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi znj. F. K (në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë Ekonomike deri në mars 2023).

Materialet janë bërë hyrje në magazinë me dokument nr. 79, datë 20.12.2021. Referuar dokumentacionit të kolaudit, marrjes në dorëzim dhe hyrjes në magazinë, furnizimi është bërë brenda afatit të përcaktuar në kontratë. Hyrja në magazinë është bërë në mënyrë të grupuar dhe jo sipas përcaktimeve në listën e materialeve të përcaktuara për furnizim. Kështu, nuk janë bërë hyrje elementët e baterive me numër, markë dhe elemente të tjera, nuk janë bërë hyrje bazamentet me numër, si dhe materialet e tjera, në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik", i ndryshuar, (Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara) pika 37, ku përcaktohet:

"Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë)".

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi magazinieri i Njësisë HEC Fierzë z. A. L.

Me datë 22.09.2023, në ambientet e HEC Fierzë u verifikuan bateritë e furnizuara, nga ku rezultoi se kanë markën e paraqitur në ofertë dhe parametrat e kërkuar.

1. Titulli i gjetjes:	Mos menaxhim i duhur i aktiveve.
Situata:	Kontrata "Furnizim instalim elemente bateri stacionare akumulatore acide, elemente 2VDC, 300Ah, për dy sallat 48V..., HEC Fierzë", është nënshkruar me nr. 3553/4 prot., datë 20.09.2021, me OE "A Co" SHPK, me vlerë 17,280,000 lekë. Afati i dorëzimit është përcaktuar 6 muaj, referuar datës së nënshkrimit të kontratës. Nga ana e kontraktorit është bërë kërkesë për dorëzimin e furnizimit me shkresë nr. 3553/8 prot., datë 13.12.2021. Komisioni i kolaudimit është ngritur me Urdhër nr. 3553/7 prot., datë 13.10.2021, me përbërje z. P. V, z. R. Gj dhe z. P. M. Aktkolaudimi është mbajtur me datë 20.12.2021. Certifikata e marrjes në dorëzim është lëshuar me datë 20.12.2021, nga i njëjti komision. Në komision nuk është përfshirë punonjësi me përgjegjësi material. Hyrja në magazinë është bërë në mënyrë të grupuar dhe jo sipas përcaktimeve në listën e materialeve të përcaktuara për furnizim. Kështu, nuk janë bërë hyrje elementët e baterive me numër, markë dhe elemente të tjera, nuk janë bërë hyrje bazamentet me numër, si dhe materialet e tjera.
Kriteri:	Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik", i ndryshuar, (Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara) pika 37 dhe 43.
Ndikimi:	Vështirësi në regjistrimin aktivëve dhe inventarin fizik të materialeve.
Shkaku	Mos respektimi i praktikave ligjore.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Nga ana e KESH, për furnizimet në të ardhmen, të merren masa për përfshirjen në komisionet e marrjes në dorëzim të punonjësit me përgjegjësi materiale, si dhe magazinimin sipas praktikave ligjore.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë, nga subjekti i audituar z. A. L, është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2205/82 prot., datë 15.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 407/12, datë 17.01.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Asdetet ekzistuese përbëhen nga disa elementë, të cilat pasi asemblohen në sallat përkatëse kryejnë funksionin teknik si një i vetëm. Në të njëjtën mënyrë është konceptuar edhe kontrata në fjalë, pra është është parashikuar furnizimi i të gjithë elementëve dhe aksesoreve përkatës të tre aseteve të mësipërme.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Pavarësisht sa pretendohet, në kontratë është përcaktuar specifikimi për bateri dhe numri përkatës, po ashtu edhe i bazamenteve të tyre, dhe hyrja në magazinë duhej bërë në të njëjtën mënyrë dhe jo i grupuar.

III.2.6. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale.

Nga auditimi konstatohet se:

1. Titulli i gjetjes:	KESH sha nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm nga KLSH sa i takon dhënies së ambienteve me qira.
Situata:	Marrja me qira për qëllim parkimi të automjeteve, e truallit me sipërfaqe 360 m² në oborrin përpara selisë qendrore të KESH sh.a. Në kundërshtim me nenin 11, pika 11.1, paragrafi V I, të Statutit të shoqërisë KESH SH. A, kjo kontratë qiraje nuk ka marrë aprovimin e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë. -Marrja me qira për qëllim ambient për zyrë në qytetin e Shkodrës, me sipërfaqe 60 m² -Dhënia me qira për arsye të instalimit të antenës telefonike “V” sh.a me sipërfaqe 20 m². -Dhënia me qira për arsye shërbimi ndaj punonjësve të HEC Fierzë të objektit “<i>mensë</i>” me sipërfaqe 79 m². -Nga auditimi i procedurave të qirave, rezulton se KESH SHA nuk ka ndjekur ndonjë procedurë të hapur apo me buletine në gazetë kombëtare apo mediat e shkruara, për ofrimin e ambienteve sa më të përshtatshme dhe me çmim konkurrues, por është nisur dhe ka vazhduar procedurat me propozimet e ardhura nga njësitë respektive sipas rretheve, më tej ka ndjekur një procedurë negocimi çmimi, sipërfaqeje, kushtet e duhura, etj. -Sa i takon negocimit, grupit të auditimit nuk i janë vendosur në dispozicion dokumente justifikuese. Po ashtu nuk ka rezultuar dokumentacion lidhur me personat përgjegjës për mbikëqyrjen e kontratave të qerasë. -Lidhja e kontratave të qerasë sa më sipër rezulton të jetë kryer në kundërshtim me: 1. Germën b), pika 1. kapitulli II i V.K.M nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" ku përcaktohet që: 1.Institucioni shtetëror, ndërmarrja apo shoqëria shtetërore, që ka në administrim objektin që do të jepet me qira ose enfiteozë, përtëgjitharastet, përgatit dokumentacionin si më poshtë vijon: b) vendimin e organit drejtues të institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore (Këshilli Mbikëqyrës, Këshilli Drejtues, Bordi Drejtuesetj.).
Kriteri:	Germa b), pika 1. kapitulli II i V.K.M nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" dhe nenin 11, pika 11.1, paragrafi VI, të Statutit të shoqërisë KESH SH. A, kjo kontratë qiraje nuk ka marrë aprovimin e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë.
Ndikimi:	Mos përdorimi i duhur i pronës.
Shkaku	KESH sha nuk kanë vlerësuar zbatimin korrekt të legjislacionit në

- fuqi.
- Rëndësia:** E lartë.
- Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i KESH SHA të marrin masat për miratimin paraprak të angazhimeve për krijimin e
- 1.1.Rekomandimi:** detyrimeve financiare me qëllim përdorimin ligjor, ekonomik, efikas, dhe efektiv të burimeve të veta, që jepen me qira si edhe objekteve private, të cilat merren me qira.

III.2.7. Mbi zbatimin e rregullave dhe procedurave të shitblerjes të energjisë elektrike.

Nga auditimi konstatohet:

a. Mbi zbatimin e rregullave dhe procedurave të shitblerjes së energjisë elektrike.

Shitja dhe blerja e energjisë elektrike bazohet në Rregulloren e Tregtimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendim nr. 2762/8, datë 06.06.2018 i ndryshuar me Vendim e Këshillit Mbikëqyrës nr. 04, datë 24.04.2019.

Rregullorja e tregtimit të energjisë elektrike është hartuar në zbatim të VKM nr. 244/2016 “Për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar pika 4/1, dhe i miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i KESH dhe Asambleja e Aksionarëve me shkresë nr. 2762/8, atë 06.06.2018.

Në këtë rregullore janë bërë ndryshime të cilat janë miratuar me Vendim e Këshillit Mbikëqyrës nr. 04, datë 24.04.2019. Me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 8180/2, datë 27.10.2022, është miratuar rregullore e re e tregtimit të energjisë elektrike.

Për periudhën objekt auditimi, janë realizuar procedura të tregtimit të energjisë elektrike si më poshtë:

Tabela nr. 8 tregtimi i energjisë elektrike për vitin 2021.

Muaji	Sasia (MWh)		Çmimi (mes) (Euro/MWh)		Vlera (Euro) pa TVSH	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Janar	214830	-	38.6	-	8,300,018	-
Shkurt	276687	-	29.0	-	8,035,950	-
Mars	165803	-	47.1	-	7,821,695	-
Prill	158674	-	55.5	-	8,809,886	-
Maj	267553	-	58	-	15,520,219	-
Qershor	24100	-	75.1	-	1,810,809	-
Korrik	-	-	-	-	-	-
Gusht	-	-	-	-	-	-
Shtator	-	-	-	-	-	-
Tetor	-	-	-	-	-	-
Nëntor	-	-	-	-	-	-
Dhjetor	18180	-	214.5	-	3,899,689	-
Shuma:					54,198,266	

Burimi: KESH SHA

Sa më sipër rezulton se janë krijuar të ardhura nga shitja e energjisë elektrike në kushtet e prurjeve të mëdha me vlerë 54,198,266 Euro.

Po për vitin 2021, krahas shitjes së energjisë elektrike në kushtet e prurjeve të mëdha, është shitur dhe blerë energji për optimizim, si më poshtë:

Tabela nr. 9 Optimizimi i energjisë elektrike për vitin 2021.

Muaji	Sasia (MWh)		Çmimi (mes) (Euro/MWh)		Vlera (Euro) pa TVSH	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Janar	-	-	-	-	-	-
Shkurt	-	-	-	-	-	-
Mars	-	-	-	-	-	-
Prill	-	-	-	-	-	-
Maj	-	-	-	-	-	-
Qershor	300	1470	111.1	97.6	33,333	143,521

Korrik	5650	6608	117.1	90.6	661941	599,286
Gusht	3600	3158	146.7	101	528,156	318,993
Shtator	3192	1920	53.5	149.7	170,940	287,481
Tetor	3300	3867	222.1	185.5	731,995	717,681
Nëntor	-	8107	-	192.8	-	1,563,605
Dhjetor	240	29364	450	236.4	108,000	6,943,026
Shuma:	16289	54,449			2,234,365	10,573,593

Burimi: KESH SHA

Sa i takon optimizimit për vitin 2021, janë shitur 16289 MWh me vlerë 2,234,365 Euro dhe janë blerë 54494 MWh me vlerë 10,573,593 Euro.

Viti 2022.

Për vitin 2022 është bërë shitje dhe blerje e energjisë elektrike si më poshtë:

Tabela nr. 10 Tregtimi i energjisë elektrike për vitin 2022.

Muaji	Sasia (MWh)		Çmimi (mes) (Euro/MWh)		Vlera (Euro) pa TVSH	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Janar	840	137750	338.5	237.2	284,400	32,667,830
Shkurt	-	209736	-	230.3	-	48,311,803
Mars	-	165655	-	237.8	-	39,408,782
Prill	11850	44328	142.5	209.6	1,688,884	9,291,902
Maj	-	76864	-	210.5	-	16,184,914
Qershor	-	117448	-	230.9	-	27,125,130
Korrik	-	170381	-	439.1	-	74,829,131
Gusht	-	120030	-	482.2	-	57,893,382
Shtator	-	125256	-	479.2	-	60026234
Tetor	-	144016	-	339.3	-	48,871,988
Nëntor	47,550	148973	196.3	220.4	9,334,770	31,354,418
Dhjetor	135,136	-	168.7	-	22,800,882	-
Shuma:	195376	1460437			34,108,936	445,965,514

Burimi: KESH SHA

Rezulton se KESH SHA ka shitur energji elektrike në sasinë 195376 MWh, me vlerë 34,108,936 Euro, si dhe ka blerë energji elektrike në sasinë 1460437 MWh, me vlerë 445,965,514 Euro.

Për vitin 2022, krahas shitjes së energjisë elektrike, në kushtet e prurjeve të mëdha, është shitur dhe blerë energji për optimizim, si më poshtë:

Tabela nr. 11 Optimizimi i energjisë elektrike për vitin 2022.

Muaji	Sasia (MWh)		Çmimi (mes) (Euro/MWh)		Vlera (Euro) pa TVSH	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Janar	-	-	-	-	-	-
Shkurt	-	-	-	-	-	-
Mars	-	-	-	-	-	-
Prill	-	-	-	-	-	-
Maj	-	-	-	-	-	-
Qershor	1740	1740	398.2	291.3	692,931	506,983
Korrik	-	-	-	-	-	-
Gusht	900	720	600.9	538.2	540,821	378,495
Shtator	600	780	600.9	525.8	360,547	410,160
Tetor	-	-	-	-	-	-
Nëntor	-	132	-	157.7	-	20,811
Dhjetor	-	-	-	-	-	-
Shuma:						

Burimi: KESH SHA

Nga procedurat e realizuara, u përzgjedhën për auditim periudha janar-shkurt 2021, procedurat për optimizmin e energjisë për muajin shtator 2021, si dhe procedura e tregtimit të energjisë elektrike për muajt prill dhe nëntor 2022, nga ku u konstatua si më poshtë:

Për muajin janar 2021, janë realizuar procedura tregtimi të energjisë elektrike të cilat paraqiten në aneksin nr. 1. Nga auditimi i disa procedurave për muajin janar, konstatohet si më poshtë:

Për periudhën 01-02 janar 2021.

Komisioni i tregtimit të energjisë elektrike, përbëhet nga znj. E. B, znj. R. Ll dhe z. A. M. Ftesa për ofertë është bërë me nr. 4292/1 prot., datë 31.12.2020, drejtuar 17 shoqërive tregtare të energjisë elektrike, të cilat kanë plotësuar kriterin e parashikuar në nenin 5, të Vendimit të Asamblesë nr. 5233/1, datë 12.06.2019 “Për miratimin e rregullave të përgjithshme të organizimit të aktivitetit tregtar nga KESH SHA”.

Ftesa për ofertë është bërë për dy lote si më poshtë:

Lot 1	Periudha	profili	Fuqia MW	Sasia MWh	Transmetimi
Shitje	01-02.01.2021	23 ⁰⁰ - 24 ⁰⁰ dhe 00 ⁰⁰ -07 ⁰⁰	Deri 300	4800	Blerësi

Lot 2	Periudha	profili	Fuqia MW	Sasia MWh	Transmetimi
Shitje	01-02.01.2021	00 ⁰⁰ - 06 ⁰⁰	Deri 400	4800	Blerësi

Për lot 1, janë paraqitur 3 oferta, ndërsa për lot 2, 4 oferta. Bazuar në sasi të e ofruara, si dhe çmimin duke filluar nga çmimi më i lartë, është kontraktuar për shitje të energjisë elektrike për lot 1, në sasinë 400 MWh dhe lot 2, në sasinë 4500 MWh. Për lot 1 është ofruar çmimi 27.69 Euro/ MWh, ndërsa për lot 2, çmimi 21.27 Euro/MWh.

Bazuar në bursën HUPX, për profilet e mësipërme, çmimi mesatar për lot 1 paraqitet 41.7 Euro/MWh, ndërsa për lot 2 çmimi paraqitet 38.6 Euro/MWh. Referuar çmimit të bursës HUPX, për lot 1, energjia është shitur me çmim më të ulët rreth 33 % për lot 1 dhe rreth 45 % për lot 2 (nuk është përfshirë kosto e transmetimit).

Për periudhën 05-06 janar 2021.

Komisioni i tregtimit të energjisë elektrike, përbëhet nga znj. E. B, znj. R. Ll dhe z. A. M. Ftesa për ofertë është bërë me nr. 25/1 prot., datë 05.01.2021, drejtuar 17 shoqërive tregtare të energjisë elektrike.

Për këtë periudhë kërkesa për shitje të energjisë elektrike është bërë për 4 lote (dy lotë datë 05 dhe 2 lote datë 06), me profil 00⁰⁰ - 24⁰⁰ për sasinë 2280 MWh/ditë, me profil 00⁰⁰ - 16⁰⁰ dhe 22⁰⁰ - 24⁰⁰ për sasinë 1800 MWh/ditë. Ftesa për ofertë i është dërguar 17 shoqërive që operojnë në këtë fushë. Për datë 05.01.2021, janë paraqitur 3 oferta për lot 1 dhe 2 oferta për lot 2, ndërsa për datë 06.01.2021, janë paraqitur 6 oferta për lot 1 dhe 5 oferta për lot 2.

Janë shpallur fitues ofertat për lot 1 (datë 05), me çmim 43 Euro/MWh dhe për lot 2 dhe 2.1 (datë 05) me çmim 51.56 Euro/MWh dhe 46.37 Euro/MWh.

Bazuar në Bursën HUPX, për datën 05.01.2021 (profil 00⁰⁰ - 24⁰⁰) rezulton se çmimi i shitjes është 52.3 Euro/MWh ose 8 % më i shtrenjtë. Për datën 06.01.2021, çmimi në bursë është 52.07 Euro (profil 00⁰⁰ - 24⁰⁰) nga ku rezulton se çmimi i përfituar është i përafërt me atë të bursës.

Për periudhën 27-31 janar 2021.

Komisioni i tregtimit të energjisë elektrike, përbëhet nga znj. E. B, znj. R. Ll dhe z. E. B. Ftesa për ofertë është bërë me nr. 568/6 prot., datë 25.01.2021, drejtuar 17 shoqërive tregtare të energjisë elektrike, të cilat kanë plotësuar kriterin e parashikuar në nenin 5, të Vendimit të

Asamblesë nr. 5233/1, datë 12.06.2019 “Për miratimin e rregullave të përgjithshme të organizimit të aktivitetit tregtar nga KESH SHA”.

Ftesa për ofertë është bërë për dy lotë si më poshtë:

Lot 1	Periudha	profili	Fuqia MW	Sasia MWh	Transmetimi
Shitje	27-31.01.2021	00 ⁰⁰ - 24 ⁰⁰	Deri 150	18000	Blerësi

Lot 2	Periudha	profili	Fuqia MW	Sasia MWh	Transmetimi
Shitje	27-31.01.2021	00 ⁰⁰ - 07 ⁰⁰	Deri 150	5250	Blerësi

Kriteri i vendosur është çmimi më i lartë në shitje dhe çmimi më i ulët në blerje. Ftesa për ofertë është publikuar në sitin e KESH dhe paraqitja e ofertës është kërkuar të bëhet nëpërmjet email.

Për lot 1, kanë paraqitur ofertë 6 shoqëri, ndërsa për lot 2, kanë paraqitur ofertë 3 shoqëri.

Në përfundim të përzgjedhjes së ofertave, janë kontraktuar 4 shoqëri për lot 1 dhe 1 shoqëri për lot 2. Vlera e kontraktuar e shitjes është në shumën 561,395.4 Euro. Çmimi mesatar i shitjes në profilin 00⁰⁰ - 24⁰⁰ është 29.48 Euro/MWh, ndërsa në profilin 00⁰⁰ - 07⁰⁰, është 8.79 Euro/MWh. Raporti Përmbledhës është miratuar nga Ish-Titullari i AK z. B. B, me nr. 568/6 prot., datë 25.01.2021.

Bazuar në bursën e energjisë elektrike HUPX, rezulton se për profilin 00⁰⁰ - 24⁰⁰, për periudhën nga data 27.03.2021 deri me datë 31.01.2021, energjia elektrike është tregtuar me çmim mesatar 51.67 Euro/MWh (Për datë 27.01.2021- 59.3 Euro/MWh, për datë 28.01.2021- 55.61 Euro/MWh, për datë 29.01.2021-52.12 Euro/MWh, për datë 30.01.2021-46.17 Euro/MWh, për datë 31.01.2021-45.15 Euro/MWh).

Bazuar në bursën e energjisë elektrike HUPX, rezulton se për profilin 00⁰⁰ - 07⁰⁰, për periudhën nga data 27.03.2021 deri me datë 31.01.2021, energjia elektrike është tregtuar me çmim mesatar 40.4 Euro/MWh (Për datë 27.01.2021- 44.8 Euro/MWh, për datë 28.01.2021- 43.7 Euro/MWh, për datë 29.01.2021-41.4 Euro/MWh, për datë 30.01.2021-35.3 Euro/MWh, për datë 31.01.2021-37 Euro/MWh).

Referuar bursës së mësipërme, duke marrë në konsideratë koston e transmetimit 2.5 Euro/MWh (me përafërsi), sasia e energjisë e njëjtë me atë të tregtuar nga KESH SHA për të njëjtin profil, është tregtuar me vlerë 1,084,035 Euro (18000 MWh x 51.67 Euro/MWh + 5250 MWh x 40.4 Euro/MWh – 23250 MWh x 2.5 Euro/MWh). Nga ana e KESH është përfituar më pak vlera 522,639 Euro (1,084,035 Euro- 561,395.4 Euro).

Për datën 31.01.2021.

Komisioni i tregtimit të energjisë elektrike, përbëhet nga znj. E. B, znj. R. Ll dhe z. E. B. Ftesa për ofertë është bërë me nr. 568/7 prot., datë 30.01.2021, drejtuar 17 shoqërive tregtare të energjisë elektrike. Është kërkuar shitje e energjisë për datën 31.01.2021, për orarin 08⁰⁰ deri 23⁰⁰, për fuqinë deri 100 MW, në sasinë 1,500 MWh. Kriteri i vendosur është çmimi më i lartë në shitje dhe çmimi më i ulët në blerje. Ftesa për ofertë është publikuar në sitin e KESH dhe paraqitja e ofertës është kërkuar të bëhet nëpërmjet email.

Kanë paraqitur ofertat subjektet si më poshtë:

Subekti “ET” ka paraqitur ofertë për orarin nga ora 17⁰⁰ deri 22⁰⁰

orari	17	18	19	20	21	22	Çmimi Euro/MWh	Shuma MWh:
sasia	30	50	50	70	70	50	18.35	320

Subjekti “H”, ka paraqitur ofertë për blerjen e gjithë sasisë me kushtin e sigurimit të kapaciteteve me çmim 38 Euro/ MWh.

Subjekti “G-I”, ka paraqitur ofertë për blerjen e gjithë sasisë së energjisë së ofruar me çmim 39.3 Euro/MWh.

Komisioni ka konsideruar si ofertë të vlefshme të dy shoqërive “H” dhe “G-I”, nga të cilat ka shpallur fituese çmimin më të lartë atë të Shoqërisë “G-I”, me çmim 39.3 Euro/ MWh, me vlerë totale 58,950 Euro.

Për vitin 2022, u verifikuan procedurat e ndjekura për tregtimin e energjisë elektrike për muajt prill dhe nëntor, si dhe një procedurë për blerje energjie elektrike afatgjatë, realizuar në muajin shkurt.

Në procedurën e zhvilluar datë 03.02.2022, me anëtar të komisionit të përbërë nga znj. R. Ll, znj. A. B dhe z. G. K, është kërkuar blerje energjie, sipas skedulit më poshtë:

Lot 1	Periudha	Orari	Fuqia MW	Sasia	Çmimi	CBC
	01.03-31.03.2022	00:00-24:00	deri 100	74300		shitësi
Lot 2	Periudha	Orari	Fuqia	Sasia	Çmimi	CBC
	01.04-30.06.2022	00:00-24:00	deri 50	109200		shitësi
Lot 3	Periudha	Orari	Fuqia	Sasia	Çmimi	CBC
	01.07-31.12.2023	00:00-24:00	deri 100	441700		shitësi
Lot 4	Periudha	Orari	Fuqia	Sasia	Çmimi	CBC
	01.01.2023 deri 31.12.2023	00:00-24:00	deri 100	876000		shitësi
Lot 5	Periudha	Orari	Fuqia	Sasia	Çmimi	CBC
	01.01.2024 deri 31.12.2024	00:00-24:00	deri 100	878400		shitësi

Janë paraqitur oferta nga subjekte të ndryshme për të pesë lotet, me çmimet përkatëse. Vetëm një subjekt, ka kushtëzuar çmimin mbi variacionin e çmimit të bursës për secilin lot.

Në mënyrë të përmbledhur, ofertat e paraqitura me çmimet përkatëse, për Lot 1, Lot 2 dhe Lot 3, të cilët përfaqësojnë periudhën deri në fund të vitit 2022, paraqiten si më poshtë:

	Periudha	Sasia MWh	çmimi ofruar 03.02.2022 Euro/MWh	Çmimi sipas blerjes (fakt) Euro/MWh	Çmimi sipas HUPX Euro/MWh	vlera sipas ofertave Euro	vlera sipas blerjes	vlera sipas bursës Euro
Lot 1	01.03.2022 deri 31.03.2022	74300	218.2	237.8	285.58	16,212,260	17,668,540	21,218,594
Lot 2	01.04.2022 deri 30.06.2022	109000	212.12	220	210.2 (mes)	23,121,080	23,980,000	20,620,620
Lot 3	01.07.2022 deri 31.12.2022	441700	210.3	385	322.5 (mes)	92,889,510	170,054,500	142,448,250
Lot 4	01.01.2023 deri 31.12.2023	876,000	185	-	109	162,060,000	-	95,484,000
Lot 5	01.01.2024 deri 31.12.2024	878,400	147	-	-	-	-	-

Sa më sipër, nga ana e komisionit është propozuar rritja e sasisë për lot 1 si dhe mos pranimi i asnjë oferte për lot 3, lot 4 dhe lot 5, me argumentin: “Për shkak se çmimet e bursës hungareze të publikuara ditën e hapjes së procedurës parashikohen 226.25 Euro/MWh, dhe ku kemi mundësi teknike për absorbimin e energjisë, Komisioni i Tregtimit propozon që të kontraktohet 150 MW, nga 100 MW të parashikuar. Ndërsa për lotet 3, 4 dhe 5, të mos pranohet asnjë ofertë për shkak të periudhës së gjatë që këto lotë përfaqësojnë (Lot 2, Lot 3 dhe Lot 4), duke bërë në këtë mënyrë ndjekjen e situatës energjetike dhe çmimeve të energjisë në dinamikë, ndjekjen e kërkesës së FSHU/FTL në dinamikë dhe në bazë të kësaj kërkesë, hapjen e procedurave afatshkurtra të tregtimit”.

Për lot 1, është kontraktuar sasia 37250 MWh, me fashë orare 00:00 deri 24:00 (01.03.2022

deri 31.03.2022), me çmim 219.4 Euro dhe sasia 74300 MWh, me çmim 218.22 Euro/MWh. Në muajin mars është blerë energji krahas kontraktimit me çmim mesatar 277.5 Euro/MWh, ndërkohë që çmimi i bursës HUPX ishte 285.6 Euro/MWh.

Për lot 2, është kontraktuar sasia 109,200 MWh, me fashë orare 00:00 deri 24:00 (01.04.2022 deri 30.06.2022), me çmim 212.12 Euro/MWh.

Në muajin prill është blerë energji krahas kontraktimit me çmim mesatar 198.7 Euro/MWh, ndërkohë që çmimi i bursës ishte 204.8 Euro/MWh.

Në muajin maj është blerë energji krahas kontraktimit me çmim mesatar 209.1 Euro/MWh, ndërkohë që çmimi i bursës ishte 236.7 Euro/MWh..

Në muajin qershor është blerë energji krahas kontraktimit me çmim mesatar 239.2 Euro/MWh, ndërkohë që çmimi i bursës ishte 371.1 Euro/MWh.

Për lot 3, 4 dhe 5, janë paraqitur oferta, por nuk është kontraktuar sasi energjie për blerje. Nga analizimi i lotit 3, pasi lot 4 dhe lot 5 i përkasin vitit 2023 dhe 2024, rezulton se ofertat e paraqitura në procedurën e datës 03.02.2022, kanë qenë shumë të leverdishme. Referuar statistikave, në periudhën korrik-shtator, ka sistematikisht rritje të çmimit të energjisë në bursa për arsye të thatësirave që shoqërojnë me prodhim të vogël të energjisë nga impiantet hidrike. Për Lot 3 është ofruar sasia e energjisë elektrike në shumën 441,700 MW, me çmim 210.2 Euro/MWh, sipas të cilit do të blihej energji me vlerë 92,889,510 milionë Euro. Nga verifikimi i të dhënave të blerjes për periudhën korrik-dhjetor 2022 rezulton se e njëjta sasi është blerë me vlerë 170,054,500 Euro. Edhe çmimi i energjisë elektrike të tregtuar sipas Bursës HUPX rezulton me çmim shumë më të lartë se ai i ofruar. Nga anulimi i blerjes së energjisë për Lot 3, KESH, si pasojë e blerjes së të njëjtës sasi energjie, KESH ka shpenzuar më tepër vlerën 77,164,990 Euro (170,054,500 Euro - 92,889,510 Euro). Bazuar në Bursën HUPX për vitin 2023 (janar-tetor), çmimi mesatar paraqitet 109.9 Euro/MWh, çmim më i ulët se ai i ofruar në procedurën e mësipërme 185 Euro/MWh. Në këto kushte, blerja e asaj energjie do të shkaktonte përsëri humbje për KESH SHA me vlerë 66.5 milionë Euro.

Lëvizja e çmimit të energjisë elektrike në bursa nuk mund të ketë parashikim të saktë, por në këtë rast, anulimi i blerjes së energjisë të paktën për Lot 3, ka rezultuar veprim i gabuar, ndërkohë që anulimi i lot 4 rezulton veprim i drejtë duke mbrojtur interesat e KESH.

Për këtë procedurë, nuk është bërë njoftim në website të KESH SHA, si dhe nuk janë paraqitur rezultatet dhe sasi të energjisë të kontraktuar.

Nga realizimi i procedurës së mësipërme, rezulton se blerja e energjisë elektrike në afate relativisht të gjata mund ta ekspozojë Shoqërinë KESH SHA në situata të papritura, si me përfitime, por edhe me humbje.

Krahas energjisë së kontraktuar sipas procedurës, për muajin prill 2022, janë realizuar edhe procedura të tjera.

Procedura e zhvilluar me datë 15.04.2022.

Është kërkuar blerje e energjisë elektrike sipas skedulit të mëposhtëm:

Lot 1	Periudha	Orari	Fuqia (MW)	Sasia (MWh)	Çmimi Euro/(MWh)	CBC
	16.04.2022	07:00-24:00	deri 50	850		shitësi
Lot 2	Periudha	Orari	Fuqia MW	Sasia (MWh)	Çmimi Euro/(MWh)	CBC
	17-18.04.2022	07:00-17:00	deri 100	2000		shitësi
Lot3	Periudha	Orari	Fuqia MW	Sasia (MWh)	Çmimi Euro/(MWh)	CBC
	19-21.04.2022	07:00-17:00	deri 100	3000		shitësi
Lot4	Periudha	Orari	Fuqia MW	Sasia (MWh)	Çmimi Euro/(MWh)	CBC
	17-18.04.2022	11:00-18:00	deri 100	1400		shitësi
Lot 5	Periudha	Orari	Fuqia MW	Sasia (MWh)	Çmimi Euro/(MWh)	CBC
	19-21.04.2022	11:00-18:00	deri 100	2100		shitësi

Janë paraqitur oferta për të gjitha lotet. Për lot 1, është propozuar mos blerja e energjisë me

argumentin se energjia e kuotuar në bursën hungarezë HUPX për të njëjtin profil është 33.43 Euro/MWh më e ulët. Po ashtu, referuar çmimeve të larta të paraqitura për lot 3, sasia e energjisë e parashikuar për këtë lot është marrë në Lot 4.

Procedura e zhvilluar me datë 22.04.2022.

Është kërkuar blerje e energjisë elektrike sipas skedulit të mëposhtëm:

Lot 1	Periudha	Orari	Fuqia (MW)	Sasia (MWh)	Çmimi Euro/(MWh)	CBC
	23.04.2022	12:00-17:00	deri 50	1000		shitësi
Lot 2	Periudha	Orari	Fuqia (MW)	Sasia (MWh)	Çmimi Euro/(MWh)	CBC
	24.04.2022	06:00-24:00	deri 50	900		shitësi
Lot 3	Periudha	Orari	Fuqia (MW)	Sasia (MWh)	Çmimi Euro/(MWh)	CBC
	24.04.2022	12:00-16:00	deri 150	600		shitësi
Lot 4	Periudha	Orari	Fuqia (MW)	Sasia (MWh)	Çmimi Euro/(MWh)	CBC
	25.04.2022	06:00-17:00	deri 100	1100		shitësi
Lot 5	Periudha	Orari	Fuqia (MW)	Sasia (MWh)	Çmimi Euro/(MWh)	CBC
	25.04.2022	11:00-17:00	deri 150	900		shitësi

Janë paraqitur oferta për të gjithë lotet, përjashtuar Lot 1. Është propozuar që për Lot 4 të mos kontraktohen sasi të për arsye të çmimeve të larta, ndërsa për lot 5, sasia e energjisë është kontraktuar e pjesshme po për arsye të çmimeve të larta të paraqitura nga subjektet pjesëmarrëse në procedurë.

Nga auditimi i disa procedurave të tregtimit të energjisë elektrike konstatohet se në mënyrë të rregullt në dosjen e procedurës paraqitet shkresa për mundësinë e shitjes së energjisë elektrike e përgatitur nga Departamenti i Operacioneve Tregtare dhe Departamenti i Planifikimit të Gjenerimit & Operimit, ftesa për ofertë zakonisht drejtuar 17 operatorëve që operojnë në fushën e energjisë, relacioni i procedurës së mbledhjes së të dhënave për përdoruesin trading@kesh.al, ofertat e printuara, raporti përmbledhës, marrëveshjet, etj.

b. Mbi shkëmbimin e energjisë elektrike me Shoqërinë “N E” SHPK.

Marrëveshja përkatëse ndërmjet KESH SHA përfaqësuar nga z. B. K dhe “N E” SHPK, përfaqësuar nga znj. A. K, është nënshkruar me nr. 2350/1 ptot., datë 04.05.2021, marrëveshje e cila është përgatitur para marrjes së detyrës nga z. B. K, si Administrator i Shoqërisë, por që është finalizuar në periudhën që ka qenë në detyrën e Administratorit.

Në nenin 1 të marrëveshjes përcaktohet:

Pika 1.1 Lëvrimi (dhënia e energjisë elektrike nga KESH/rikthimi i energjisë elektrike nga N E) me kapacitet lëvrimi deri 50 MW, me vëllim deri në 40000 MWh/muaj dhe pikë lëvrimi “Zona e kontrollit të sistemit të transmetimit”.

Pika 1.2 “Tarifimi në bazë njoftimi paraprak”, palët dakordësojnë mbi skemën vijuese të tarifave, të cilat, i paguhen KESH, në bazë të njoftimit paraprak para fillimit të shkëmbimit të energjisë elektrike.

Skema e dakordësuar e tarifave kur “N E” lëvron energji është:

- Me njoftim paraprak jo më vonë se 10 ditë përpara fillimit të lëvrimin, “N E” do të dorëzojë XX MWh/h + një tarifë prej 0.2 Euro/MWh;
- Me njoftim paraprak jo më vonë se 10 ditë deri 48 orë përpara fillimit të lëvrimin, “N E” do të dorëzojë XX MWh/h + një tarifë prej 0.7 Euro/MWh;
- Me njoftim paraprak jo më vonë se 48 orë deri 24 orë përpara fillimit të lëvrimin, “N E” do të dorëzojë XX MWh/h + një tarifë prej 0.8 Euro/MWh;
- Me njoftim ndërditor, NAO do të dorëzojë XX MWh/h + një tarifë prej 1 Euro/MWh;

Skema e dakordësuar e tarifave kur “N E” pranon energji është:

- Me njoftim paraprak jo më vonë se 10 ditë përpara fillimit të lëvrimit, “N E” do të dorëzojë XX MË/h + një tarifë prej 0.25 Euro/MWh;
- Me njoftim paraprak jo më vonë se 10 ditë deri 48 orë përpara fillimit të lëvrimit, “N E” do të dorëzojë XX MË/h + një tarifë prej 0.75 Euro/MWh;
- Me njoftim paraprak jo më vonë se 48 orë deri 24 orë përpara fillimit të lëvrimit, “N E” do të dorëzojë XX MË/h + një tarifë prej 0.85 Euro/MWh;
- Me njoftim ndërditor, NAO do të dorëzojë XX MWh/h + një tarifë prej 1 Euro/MWh.

Në nenin 6 të marrëveshjes është përcaktuar: *“Kur KESH SHA nuk u përgjigjet, tërësisht apo pjesërisht, kërkesave të paraqitura nga “N E” për lëvrim energjie sipas kushteve të kësaj kontrate, KESH detyrohet t’i paguajë “N E” të gjitha dëmet dhe kostot e prodhuara nga marrëdhëniet/marrëveshjet/kontratat e “N E” me të tretë për qarkullimin e energjisë elektrike, të bazuara në këtë kontratë”.*

- Në kontratën e mësipërme nuk është përcaktuar minimalisht tarifa e lartë nga dita e hënë deri të shtunë (ora 06⁰⁰ deri 22⁰⁰) dhe tarifa e ulët nga dita e hënë deri të shtunë (ora 2200 deri ora 06⁰⁰), si dhe ditë e diel (nga ora 00⁰⁰ deri ora 24⁰⁰), duke ditur faktin që energjia elektrike kuotohet në bursë në fashë orare. Nuk është përcaktuar sezoni i dimrit (01 tetor deri 31 mars dhe sezoni i verës nga data 01 prill deri 30 shtator, për përllogaritjen e energjisë elektrike të lëvruara dhe pranuar nga palët, duke krijuar mundësinë e shkëmbimit në mënyrë jo të drejtë. Një ndryshim i rëndësishëm nga drafti i marrëveshjes me atë të miratuar është ndryshimi i afatit të vlefshmërisë nga 4 vjet që ishte parashikuar në një vit.

Në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshje, për transaksionet e realizuara deri në muajin tetor 2021, është trajtuar në auditimin e mëparshëm.

Deri me datë 31.12.2022, gjendja e shkëmbimit të energjisë elektrike paraqitet në dhënie sasia 149442 MWh, ndërsa në marrje sasia 132002 MWh, me një diferencë në shumën 17440 MWh. Për vitin 2022, nga Shoqëria “N E”, është marrë sasia 2546 MWh, nga e cila sasia 2398 MWh është marrë me datë 01.04.2022. Brenda kësaj dite, sasia më e madhë e energjisë në shumën 2278 MWh, është marrë në periudhë jo piku, ku çmimi i energjisë në bursë është shumë i ulët.

Bazuar në të dhënat në dispozicion, KESH SHA për vitin 2022, ka blerë energji elektrike në sasinë 1,460,437 MWh, me çmim mesatar nga 209.6 Euro/MWh deri në 482.2 Euro/MWh. Diferenca në sasinë 17440 MWh, duhet të merrej gjatë kësaj periudhe ku çmimi në bursë rezulton i lartë. Referuar bursës HUPX për vitin 2022, për të njëjtin profil, çmimi mesatar i tregtimit të energjisë elektrike ishte 271.6 Euro/MWh.

Referuar çmimit mesatar të blerjes së energjisë elektrike dhe çmimit të bursës për vitin 2022 (për profile të ngjashme), si pasojë e mos marrjes së energjisë elektrike të rezervuar pranë Kompanisë ““N E”” SHPK për këtë vit, KESH SHA rezulton me humbje me vlerë **2,774,536 Euro [(271.6 MWh – 115.2 MWh) x 17740 MWh], vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Shoqërinë. Nga ana e KESH SHA duhet të merreshin masa për tërheqjen e energjisë elektrike në periudhën kur çmimi në bursa është i lartë, për të shmangur shpenzimet e larta për blerje të saj.**

Energjia elektrike në sasinë 17440 MWh, është tërhequr në periudhën janar-korrik 2023 respektivisht në muajin janar 2009 MWh, në mars 2311 MWh, prill 3129 MWh, maj 3827 MWh, qershor 3893 dhe korrik 2271 MWh. Bazuar në çmimin e bursës për vitin 2023 (janar-nëntor), marrja e energjisë elektrike të rezervuar e thellon më tej bilancin negativ, pasi çmimi në bursa ka ardhur në rënie. Bazuar në të dhënat e faqes elektronike të KESH, nga data 01.01.2023 deri me datë 15.07.2023, nga ana e KESH është shitur energji elektrike si dhe ka patur kërkesa për rezervim, por në asnjë rast blerje. **Marrja e energjisë së rezervuar në periudhën kur shitet energji elektrike dhe mos marrja e sasisë së rezervuar në periudhë kur blihet me çmime të larta përbën keq menaxhim të procesit të optimizimit të energjisë elektrike.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me “Rregullat e përgjithshme të organizimit të aktivitetit tregtar nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare SHA”, miratuar me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 5233/1 prot., datë 12.06.2019 dhe Këshillit Mbikëqyrës nr. 12 prot., datë 20.10.2022, neni 4, pika 2, ku përcaktohet:

“Tregtimi i energjisë elektrike duhet të synojë përdorimin me efikasitet të të ardhurave, optimizimin e portofolit të KESH me qëllim përmbushjen e detyrimit për shërbim publik”.

Krahas kontratës së mësipërme, bazuar në VKM nr. 60, datë 22.10.2021 “Për miratimin e kushteve, për vendosjen e detyrimit të shërbimit ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike dhe për përballimin e saj”, i ndryshuar, për periudhën nga data 21.11.2022 deri me datë 24.11.2022, i është dhënë energji elektrike Shoqërisë “N E” SHPK në sasinë 1920 MWh, me kushtin e kthimit të kësaj energjie në periudhën nga data 01.06.2023 deri me datë 30.06.2023. Nga verifikimi i sasisë orare të dhënë rezulton se ajo i përket profilit nga ora 00⁰⁰ deri 24⁰⁰, me sasi të njëjtë orare nga 20 MWh për orë, në sasi ditore 480 MWh. Duke marrë në konsideratë se në periudhën e mësipërme KESH SHA ka realizuar shitje energjie në kushtet e prurjeve të mëdha, dhënia e energjisë elektrike në shkëmbim në sasinë 1920 MWh, për ta rimarrë në muajin qershor 2023, përbën një veprim i cili është në dobi të shoqërisë, por duhet konsideruar që marrja e energjisë duhet të bëhet në kushte të njëjta, ose në sasi dhe orar të njëjtë, për të shmangur humbjet që vijnë nga ndryshimi orar i energjisë elektrike në bursa.

1. Titulli i gjetjes: Shkëmbim energjie elektrike, jo mbi bazë proporcionale.

Situata: KESH SHA ka shkëmbyer energji elektrike me Kompaninë “N E” SHPK, sipas marrëveshjes së nënshkruar me nr. 2350/1 ptot., datë 04.05.2021.

Deri me datë 31.12.2022, gjendja e shkëmbimit të energjisë elektrike paraqitet në dhënie sasia 149442 MWh, ndërsa në marrje sasia 132002 MWh, me një diferencë në shumën 17440 MWh. Për vitin 2022, nga Shoqëria “N E”, është marrë sasia 2546 MWh, nga e cila sasia 2398 MWh është marrë me datë 01.04.2022. Brenda kësaj dite, sasia më e madhe e energjisë në shumën 2278 MWh, është marrë në periudhë jo piku, ku çmimi i energjisë në bursë është shumë i ulët.

Bazuar në të dhënat në dispozicion, KESH SHA për vitin 2022, ka blerë energji elektrike në sasinë 1,460,437 MWh, me çmim mesatar nga 209.6 Euro/MWh deri në 482.2 Euro/MWh. Diferenca në sasinë 17440 MWh, duhet të merrej gjatë kësaj periudhe ku çmimi në bursë rezulton i lartë. Referuar bursës HUPX për vitin 2022, për të njëjtin profil, çmimi mesatar i tregtimit të energjisë elektrike ishte 271.6 Euro/MWh.

Referuar çmimit mesatar të blerjes së energjisë elektrike dhe çmimit të bursës për vitin 2022 (për profile të ngjashme), si pasojë e mos marrjes së energjisë elektrike të rezervuar pranë Kompanisë “N E” SHPK për këtë vit, KESH SHA rezulton me humbje me vlerë **2,774,536 Euro** $[(271.6 \text{ MWh} - 115.2 \text{ MWh}) \times 17740 \text{ MWh}]$, **vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Shoqërinë. Nga ana e KESH SHA duhet të merreshin masa për tërheqjen e energjisë elektrike në periudhën kur çmimi në bursa është i lartë, për të shmangur shpenzimet e larta për blerje të saj.**

Energjia elektrike në sasinë 17440 MWh, është tërhequr në periudhën janar-korrik 2023 respektivisht në muajin janar 2009 MWh, në mars 2311 MWh, prill 3129 MWh, maj 3827 MWh, qershor 3893 dhe korrik 2271 MWh. Bazuar në çmimin e bursës për vitin 2023 (janar-

nentor), marrja e energjisë elektrike të rezervuar e thellon më tej bilancin negativ, pasi çmimi në bursa ka ardhur në rënie. Bazuar në të dhënat e faqes elektronike të KESH, nga data 01.01.2023 deri me datë 15.07.2023, nga ana e KESH është shitur energji elektrike si dhe ka patur kërkesa për rezervim, por në asnjë rast blerje. **Marrja e energjisë së rezervuar në periudhën kur shitet energji elektrike dhe mos marrja e sasisë së rezervuar në periudhë kur blihet me çmime të larta përbën keqmenaxhim të procesit të optimizimit të energjisë elektrike.**

Kriteri: Vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 5233/1 prot., datë 12.06.2019 dhe Këshillit Mbikëqyrës nr. 12 prot., datë 20.10.2022, neni 4, pika 2.

Ndikimi: Shkëmbi i energjisë elektrike jo në profile të njëjta, ndikon në optimizimin e saj, duke mos marrë përfitime optimale nga të tilla operacione.

Shkaku Përcaktime jo të duhura në kontratën përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

KESH SHA, për kontrata shkëmbi të energjisë elektrike në të ardhmen, të marrë masa për përcaktimin e detajuar të shkëmbimit, duke vendosur marrjen dhe dhënien në profile të njëjta dhe në fasha orare të njëjta.

1.1.Rekomandimi:

Për të mbrojtur interesat e ndërsjella, në këto kontrata duhet përcaktuar edhe referenca e çmimit në bursa, në mënyrë që ndikimi i luhatjes së çmimit mos të ketë ndikim negativ, referuar periudhave në të cilat realizohet shkëmbimi.

c. Mbi shkëmbimin e energjisë elektrike me KEK Kosovë.

KESH SHA ka nënshkruar Marrëveshjen nr. 15, datë 12.02.2015 “Për shkëmbimin/depozitimin e energjisë elektrike me Korporatën Energjetike të Kosovës, e cila ka pësuar disa ndryshime sipas marrëveshjes së nënshkruar me nr. 3259 prot., datë 12.06.2018.

Për periudhën objekt auditimi, sipas marrëveshjes me KEK Kosovë është bërë shkëmbimi i energjisë elektrike si më poshtë:

Shkurt 2021 MWh		Shkurt 2022 MWh		Qershor 2022 MWh		Shtator 2022 MWh		Tetor 2022 MWh	
dhënie	marrje	dhënie	marrje	dhënie	marrje	dhënie	Marrje	dhënie	marrje
185	706	-	5772	1944	67585	6894	17069	6300	-

Marrja e një sasive të konsiderueshme të energjisë elektrike nga KEK Kosovë, ndërkohë që KESH SHA shet energji, përbën keqmanaxhim të burimeve.

Veprimet e mësipërme janë në mospërmbushje të marrëveshjes së shkëmbimit të energjisë elektrike me KEK Kosovë, neni 1, ku përcaktohet:

“Kjo marrëveshje ka për qëllim krijimin e kushteve për optimizimin e kapaciteteve gjeneruese, përmirësimin e furnizimit të klientëve fundorë me energji elektrike dhe cilësisë së punës për të dy sistemet elektroenergjetike. Kjo marrëveshje përcakton parimet bazë dhe teknikalitetet e tjera të bashkëpunimit në fushat e mëposhtme:

-Shkëmbimi/depozitimi i energjisë elektrike për efekt të përmbushjes së detyrimeve për shërbimin publik që të dyja palët kanë referuar legjislacioneve përkatëse në fushën e energjisë elektrike.

- Ndhmës së ndërsjellë në rast situatash emergjente, përfshirë këtu rastet e avarive dhe kushtet e vështira hidrologjike (prurjet e mëdha që mund të shkaktojnë katastrofa natyrore si përmytje, etj) që mund të cenojnë sigurinë e dy sistemeve elektroenergjetike”.

Konkluzion:

Nga auditimi i këtyre procedurave arrihet në konkluzioni se:

- Nga ana e KESH nuk arrihet përfitimi i duhur nga shitja e energjisë elektrike, kjo referuar çmimit të shitjes së energjisë në bursa për sasi dhe profile të njëjta.
- Shitja e energjisë elektrike në profile ku çmimi i energjisë në bursa në mënyrë të përhershme është më i ulët, përbën keq menaxhim të burimeve financiare të shoqërisë.
- Ftesat për pjesëmarrje u dërgohen periodikisht të gjitha kompanive të regjistruara, por në këto procedura (referuar procedurave të audituara), marrin pjesë një numër i ulët i shoqërive nga 3 deri në 6 shoqëri.
- Shkëmbimi i energjisë elektrike nuk është bërë në mënyrë optimale për të gjitha rastet.
- Kërkesa për blerje të energjisë elektrike me afate relativisht të gjata, shoqërohet me devijime të konsiderueshme të çmimit të parashikuar, me atë që rezulton në fakt, duke konsideruar nevojën për studim të detajuar të lëvizjes së çmimit të energjisë elektrike në periudha të ndryshme, për sasi të ndryshme si dhe profile të ndryshme.
- Shkëmbimi i energjisë elektrike nuk bëhet në mënyrë të optimizuar në të gjitha rastet, pasi merret energji, ndërkohë që shitet.

2. Titulli i gjetjes:	Shkëmbi energjie jo në përputhje me marrëveshjen përkatëse.
Situata:	KESH SHA ka nënshkruar Marrëveshjen nr. 15, datë 12.02.2015 “Për shkëmbimin/depozitimin e energjisë elektrike me Korporatën Energjetike të Kosovës, e cila ka pësuar disa ndryshime sipas marrëveshjes së nënshkruar me nr. 3259 prot., datë 12.06.2018. Nga verifikimi i sasive të energjisë elektrike të shkëmbyer për periudhën në auditim rezulton se në disa raste është marrë energji elektrike, ndërkohë që KESH realizon shitje të saj, për arsye të prurjeve të mëdha.
Kriteri:	Marrëveshja e shkëmbimit të energjisë elektrike, neni 1.
Ndikimi:	Marrja e energjisë elektrike në periudha me prurje të mëdha shoqërohet me humbe nga ana e KESH, pasi çmimi i energjisë elektrike në bursa në periudha të tilla është i ulët.
Shkaku	Mos respektimi i marrëveshjes.
Rëndësia:	E lartë.
2.1.Rekomandimi:	KESH SHA të marrë masat e duhura duke negociuar me Kompaninë KEK, për shkëmbimin e energjisë elektrike në periudhat më të nevojshme dhe të dobishme për të dy kompanitë. Njoftimi për marrje apo dhënie të energjisë duhet të bëhet në periudhë mjaftueshmërisht në kohë, si dhe konfirmimet për këto transaksione duhet të bëhen po në kohën e duhur, për t'i dhënë mundësi të dy kompanive të bëjnë programimet e duhura.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë, nga subjekti i audituar z. E. E, është paraqitur observacioni me shkresë nr. 2205/78 prot., datë 09.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 407/12, datë 17.01.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

-Në kontratën e shkëmbimit të energjisë elektrike, në asnjë nen nuk citohet mënyra e kthimit të energjisë elektrike dhe aq më pak profili apo periudha, por kontrata bazohet thelbësisht në parimin “*Me njoftim paraprak, mundësi për livrim*”.

Pavarësisht kërkesës së KESH për kthimin e sasisë së energjisë elektrike referuar termave kontraktualë, kompania nuk dorëzuar pranë KESH asnjë kërkesë për kthimin e sasisë gjatë periudhës së cituar në Projektraport të Auditimit dhe si fakt i tillë ishte i pamundur të minimizohej risku i marrjes së energjisë elektrike në një moment kur i nevojitej. Nëse do të kishte parashikim kontraktual apo kuadër ligjor për të cilin KESH është audituar për

përputhshmëri, do të realizoheshin të gjitha përpjekjet për kthimin e sasisë në momentet më të përshtatshme.

- Lidhur me konstatimin se KESH SHA ka marrë energji gjatë kohës që ka qenë në kushtet e shitjes së energjisë, sqarojmë se KESH SHA në muajin shkurt 2021, ka marrë energji elektrike vetëm në rastet kur nga Drejtoria e Shfrytëzimit është vlerësuar si e nevojshme për menaxhimin e kaskadës. Marrja e energjisë elektrike në periudhën e shitjes, është bërë me qëllim që të minimizohen shkarkimet e ujit nga HEC Fierza në HEC Koman, duke bërë që nga marrja e energjisë në KEK, të shkëputet nga puna një agregat në Fierzë e rrjedhimisht do të kemi më pak prurje nga Fierza në Koman. Në këto kushte kemi menaxhuar prurjet anësore dhe ato që vijnë nga HEC Fierzë për në HEC Koman, duke shmangur ose minimizuar shkarkimet nga HEC Koman në HEC Vau i Dejës. Gjithashtu KESH SHA në vitin 2022 ka marrë energji nga KEK me qëllim rritjen e rezervës energjitike të kaskadës së Drinit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Merret në konsideratë fakti se në kontratë nuk përcaktohet mënyra e kthimit të energjisë elektrike me profile apo periudha. Po ashtu sa i takon përgjegjësisë së z. E. E. Gjithsesi theksojmë se në mungësë të këtyre përcaktimeve nuk i jep të drejtë kompanisë kontraktore të marrë dhe të kthejë energjinë në profilin kur ajo është më e interesuar. Shkëmbimi i energjisë nuk është bërë në kushtet e përfitimeve të ndërsjella. Llogaritja e efektit financiar ka lidhje me këtë mungesë përfitimi, pasi në rastin e shkëmbimit të energjisë elektrike në kushte të njëjta mbron KESH SHA nga humbjet, duke ditur se në periudhat e shkëmbimit është bërë edhe tregtin i energjisë elektrike.

Sa i përket shkëmbimit të energjisë elektrike me KEK Kosovë, duhen bërë përpjekje për respektim të dy anshëm të marrëveshjes për optimizimin dhe shmangien e ndërsjellë të situatave problematike.

III.2.8. Auditimi i organizimit dhe mbajtja e evidencës kontabël, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e pasqyrave financiare nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi e miratimi i tij në institucionet eprorë. analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit. Inventarizimi fizik i pasurisë, zbatimi i afateve, cilësia e inventarizimeve, si dhe mbyllja e sistemimi i rezultateve në pasqyrat financiare vjetore.

Në zbatim të pikës 9 së Programit të Auditimit nr. 407/1 prot, datë 05.06.2023, i ndryshuar, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- *Dokumentacioni i regjistrimit të llogarive kontabël.*
- *Dokumentacioni i mbajtur mbi përllogaritjen, njohjen, pagesën dhe regjistrimin e detyrimeve fiskale.*
- *Dokumentacioni i mbajtur mbi detyrimet.*
- *Afatet e hartimit, aprovimit dhe deklarimit të pasqyrave financiare.*

Përgatitja dhe paraqitja e pasqyrave financiare është bërë përgjithësisht në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe statutit të shoqërisë. Kuadri kontabël i aplikuar është i bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, (SNRF). Shoqëria i ka përgatitur pasqyrat financiare në bazë të parimit të vijimësisë që supozon se shoqëria do ti përmbushë kërkesat e veta për financime, apo për të paguar detyrimet e saj në kohën kur kërkohen dhe për të vazhduar aktivitetet e saj në të ardhmen. Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç rasteve kur SNRF kërkon baza të tjera matje.

1. Titulli i gjetjes: Depozitime me vonesë të pasqyrave financiare.

Situata: KESH sha, ka kryer vetëm deklaratën e tatim fitimit për periudhën 2021 e 2022 brenda afatit.

-Pasqyrat financiare nuk janë hartuar dhe aprovuar nga Administratori, Këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të KESH sh.a. KESH sha nuk ka dorëzuar pasqyrat financiare sipas afatit në QKB. Asambleja e Ortakëve ka detyrimin për të aprovuar pasqyrat financiare të shoqërisë në afatin e caktuar nga ligji nr. 8483 datë 28.12.1998, i ndryshuar “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 33/1.

Kriteri: -Ligji nr.9901, date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, neni 135, pika 3, Neni 154, pika 1, neni 158, neni 164, neni 167.

-Ligji nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 11, citon: *Qëllimi i pasqyrave financiare 1. Pasqyrat financiare hartohen në mënyrë të qartë, në përputhje me këtë ligj dhe standardet e aplikueshme të raportimit financiar, si dhe paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të njësive ekonomike.2. Pasqyrat financiare në këtë ligj u referohen pasqyrave financiare individuale dhe pasqyrave financiare të konsoliduara.*

Neni 23, Përgjegjësitë, citon: 1. *Organi i drejtimit ekzekutiv të njësisë ekonomike dhe organi mbikëqyrës, në varësi të kompetencave që u njeh ligji, janë përgjegjës solidarë për të siguruar që pasqyrat*

financiare vjetore dhe raporti i ecurisë së veprimtarisë/raporti i konsoliduar i ecurisë së veprimtarisë të njësive ekonomike, të hartohen dhe të publikohen në përputhje me kërkesat e këtij ligji, aktet në zbatim të tij dhe standardet e miratuara të kontabilitetit. 2. Auditimi ligjor i pasqyrave financiare nuk e çliron organin e drejtimit ekzekutiv dhe atë mbikëqyrës të njësive ekonomike nga përgjegjësitë, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni. 3. Pasqyrat financiare nënshkruhen nga përfaqësuesi ligjor i njësive ekonomike dhe personi përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare.

Asambleja e Ortakëve ka detyrimin për të aprovuar pasqyrat financiare të shoqërisë në afatin e caktuar nga ligji nr. 8483 datë 28.12.1998, i ndryshuar “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 33/1 ku citohet: “Depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit 1. Shoqëritë tregtare, sipas ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asambleenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinonjë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi”.

Mos depozitimet në Qendrën Kombëtare të Biznesit QKB, si dhe kryerjet jashtë afateve ligjore janë në kundërshtim me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, neni 43, Regjistrimet e tjera të detyrueshme dhe neni 46 ku citohet : “....3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse, si më poshtë: a) pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme; Neni 46, Regjistrimi i pasqyrave financiare, 1. Subjektet, që kanë detyrimin e hartimit të dokumenteve, sipas shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 43, të këtij ligji, dhe që nuk i kanë depozituar më parë, në përputhje me afatin e parashikuar në pikën 5, të nenit 22, të këtij ligji, detyrohen në çdo rast t’i depozitojnë këto dokumente jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar”.

Ndikim/Efekti:

Vonesat në hartimin, aprovimin dhe depozitimin kanë pasoja në vlerësimin e gjendjes financiare të shoqërisë, vlerësimin e performancës ekonomike si dhe për vendim-marrjet e palëve të interesuara.

Qendra Kombëtare e Biznesit ka bllokuar njoftimet e shoqërisë KESH sha, në regjistrin e shoqërive. Si pasojë në ekstraktin e shoqërisë nuk pasqyrohen ndryshimet e bëra në statut, etj.

Shkak

Jo vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore.

Rëndësia:

E lartë.

1.1.Rekomandimi:

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të merren masa që në të ardhmen, pasqyrat financiare të hartohen, të depozitohen, të aprovohen brenda afateve ligjore, duke mundësuar vlerësimin e gjendjes financiare të shoqërisë, vlerësimin e performancës ekonomike lidhur me vendim-marrjet që duhet të marrin palët e interesuara, si asambleja e ortakëve, institute kredi

dhënie etj.

Për sa më sipër mban përgjegjësi Asambleja e Ortakëve, Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë.

- 2. Titulli i gjetjes:** Mos plotësimi i regjistrit të aktiveve me kërkesat minimale.
- Situata:** Shoqëria KESH sh.a nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat minimale që duhet të përmbajë ky regjistër.
- Nga auditimi i kontabilizimeve të aktiveve të blera u konstatua se emërtimet me të cilat regjistrohej emërtimi nuk përfshinte markën, shpjegime më të qarta duke e bërë të vështirë identifikimin në periudhat e mëpasshme për inventarizimet periodike.
- Kriteri:** Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 30, ku përcaktohet: *“Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia”.*
- Ndikim/Efekti:** Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivitetet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj. Mos plotësimi i regjistrit të aktiveve sjell risk i lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së shoqërisë, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion.
- Shkaku** Jo vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore.
- Rëndësia:** E lartë.
- 2.1.Rekomandimi:** Administratori i shoqërisë, dhe Nëpunësi Zbatues duhet të marrin masa për kryerjen e inventarizimeve vjetore të aktiveve fizike të shoqërisë, si dhe për plotësimin e regjistrit të aktiveve që shoqëria zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.

Për sa më sipër mban përgjegjësi Nëpunësi Zbatues, Drejtori i DEK znj. F. K.

- 3. Titulli i gjetjes:** Mos inventarizimi i plotë i detyrimeve.
- Situata:** KESH sh.a. nuk ka kryer inventarizimin e plotë të detyrimeve për periudhat 2021 e 2022 duke mos kryer verifikimin e ekzistencës fizike si dhe vlerësimin e gjendjes së tyre, të detyrimeve, të drejtave dhe dokumentacionit mbështetës përkatës.
- Kriteri:** ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, i ndryshuar, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15, Inventari i aktiveve dhe detyrimeve 1. *Njësitë ekonomike, subjekt i këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë gjatë periudhës raportuese, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të*

kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumenteve kontabël përkatëse në përputhje me rregulloren e inventarizimit të hartuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. 2. Organi i drejtimit të njësisë ekonomike mban përgjegjësi për procedurat e ndjekura për inventarizimin e aktiveve dhe detyrimeve, me qëllim paraqitjen me vërtetësi dhe besueshmëri të elementeve të aktivitetit dhe detyrimeve në pasqyrat financiare.” dhe pika 74 e Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës”.

Ndikim/Efekti: Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj”.

Shkaku Jo vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore.

Rëndësia: E lartë.

3.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë, dhe Nëpunësi Zbatues për të ulur riskun e zvogëlimit të aseteve së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre duhet të marrin masa për kryerjen e inventarizimit të plotë të detyrimeve për periudhat, 2021 e 2022 duke kryer verifikimin e ekzistencës fizike si dhe vlerësimin e gjendjes së tyre, të detyrimeve, të drejtave dhe dokumentacionit mbështetës përkatës. procedura rakordimi dhe dakortësimi për saldot vjetore, shoqëruar me relacionet përkatëse.

Për sa më sipër mban përgjegjësi Nëpunësi Zbatues, Drejtori i DEK znj. F. K.

4. Titulli i gjetjes: Mungesa e deklaratës së mirë administrimit.

Situata: Në raportet e ecursisë së veprimtarisë së shoqërisë dhe dokumenteve shpjegues, mungonte deklarata e miradministrimit të shoqërisë, praktikrat e ndjekura prej saj si dhe profili i administratorëve dhe anëtarëve të këshillave ku shpjegohen elementët dhe faktet që i kualifikojnë për kryerjen e detyrave të caktuara nga shoqëria.

Kriteri: Neni 134, të ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Neni 134, të ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ku citohet: “2. Shoqëritë aksionare, në raportin e ecursisë së veprimtarisë dhe pasqyrat financiare vjetore duhet të përshijnë një dokument shpjegues, ku trajtohen e shpjegohen parimet e rregullat e miradministrimit dhe të drejtimit të brendshëm të shoqërisë dhe praktikrat, që ndiqen prej saj, në zbatim të dispozitave të këtij ligji. Deklarata e miradministrimit të shoqërisë duhet të përmbajë një profil të administratorëve dhe të anëtarëve të këshillave, si dhe të shpjegojë elementet e faktet, për të cilat këta individë janë të kualifikuar për të kryer detyrat, që i janë caktuar nga shoqëria. Kjo deklaratë vendoset edhe në faqen e internetit të shoqërisë”.

Ndikim/Efekti: Këto veprime zvogëlojnë transparencën e menaxhimit të shoqërisë.

Shkaku Jo vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore.

Rëndësia: E mesme

4.1.Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa për plotësimin e deklaratave të miradministrimit të shoqërisë, praktikrat e ndjekura prej saj si dhe

profilet e administratorit dhe anëtarëve të këshillave ku shpjegohen elementët dhe faktet që i kualifikojnë për kryerjen e detyrave të caktuara nga shoqëria, për të rritur transparencën e menaxhimit të shoqërisë.

Për sa më sipër mban përgjegjësi administratori i shoqërisë.

5. Titulli i gjetjes: Mos paraqitja e informacioneve sqaruese.

Situata:

Në shënimet shpjeguese nga drejtimi i shoqërisë nuk janë paraqitur informacione sqaruese lidhur me vlerësimet dhe arsyet e përcaktimit të jetës së dobishme së AAM-ve, pra për normat e amortizimit të aplikuara në pasqyrat financiare të periudhës ushtrimore në kundërshtim me pikat 75 të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16, Aktivitet Afatgjatë Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje).

-Në lidhje me përlogaritjen e shpenzimeve të amortizimit, shoqëria përdor norma menaxheriale si dhe normat fiskale, duke paraqitur diferencën në shpenzimet e pazbritshme, të rezultatit të periudhës ushtrimore.

-Shoqëria nuk ka shqyrtuar në fund të periudhës ushtrimore vlerën e mbetur dhe jetën e dobishme të AAM-ve me vlera materiale të cilat ndikojnë në rezultatin e shoqërisë.

Kriteri:

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me pikën 51, të SNK 16, ku citohet: *“Vlera e mbetur dhe jeta e dobishme e një aktivi do të rishihet të paktën çdo fund-viti financiar dhe nëse pritshmëria ndryshon nga parashikimet e mëparshme, ndryshimet do të trajtohen si ndryshime në vlerësimet kontabël në përputhje me SNK 8, Politikat kontabël, Ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet.”*

Pika 75 të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16, Aktivitet Afatgjatë Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) ku citohet: *“Zgjedhja e metodës së amortizimit dhe vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve është çështje gjykimi. Prandaj dhënia e informacioneve shpjeguese për metodat e përdorura dhe vlerësimet e jetëve të dobishme ose të normave të amortizimit, u siguron përdoruesve të pasqyrave financiare informacion që i lejon ata të shqyrtojnë politikat e zgjedhura nga drejtimi dhe mundëson krahasimin me njësi të tjera ekonomike., dhe 76 “Në përputhje me SNK 8 një njësi ekonomike jep informacion shpjegues për natyrën dhe efektin e një ndryshimi në vlerësimin kontabël që ka efekt në periudhën aktuale ose pritët të ketë efekt në periudhat e mëpasshme. Dhënia e këtyre informacioneve shpjeguese për aktivet afatgjatë materiale mund vijë nga ndryshimet në lidhje me: (a) vlerat e mbetura; (b) kostot e vlerësuara të zëbërthimit, heqjes ose rikrijimit të zërave të aktiveve afatgjatë materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje); (c) jetët e dobishme; dhe (d) metodat e amortizimit.”*

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 23, shkronja d, e Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ku citohet: *Përcaktimin e sistemeve dhe procedurave për zëvendësimin apo shtimin e aktiveve afatgjatë. Planifikimi në avancë për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të tyre të jetës është një tjetër mënyrë për parandalimin e mosfunksionimit të papritur të ndonjë aktivi. Jetëgjatësia standarde që jepet në regjistrin e aktiveve afatgjatë nëpërmjet normave të amortizimit është një tregues se kur një aktiv*

duhet te zëvendësohet. Është e rëndësishme që jetëgjatësia standarde të mos ndiqet verbazi, pasi aktiviteti mund të vazhdojë të jetë në gjendje pune dhe njëkohësisht i nevojshëm ose i dobishëm për plotësimin e objektivave të njësisë. Dobishmëria e çdo aktiviteti duhet vlerësuar nga komisioni i vlerësimit të aktiveve, i cili ngrihet dhe funksionon sipas kriterëve të këtij udhëzimi.

Ndikim/Efekti: Duke mos përdorur norma menaxheriale të mirë argumentuara nga specialistët përkatës dhe duke mos e përcaktuar me fleksibilitet jetëgjatësinë e aktiveve, duke vlerësuar dhe zhvillimin e teknologjisë, shoqëria rrezikon të mos kryej me sukses planifikimin në avancë për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre.

Shkaku Jo vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore.

Rëndësia: E lartë.

5.1.Rekomandimi: Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të merren masa për vlerësimin e jetëgjatësisë së aktiveve, duke përdorur fleksibilitet dhe relacione të mirë argumentuara nga specialistët përkatës, për klasa specifike të aktiveve dhe jo të përgjithshme, për planifikimin në kohë të zëvendësimit të aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre.

Për sa më sipër mban përgjegjësi Nëpunësi Zbatues, Drejtori i DEK znj. F. K.

Kërkesat e pagueshme dhe të arkëtueshme të KESH Sha.

Tabela 12

Nr	Përshkrimi i detyrimit	Detyrimet më 31.12.2020	Detyrimet më 31.12.2021	Detyrimet më 31.12.2022
1	Shuma e Detyrimit OSHEE sha ndaj KESH			
	Detyrim për transferim Asete OSHEE	17,400,414	17,400,414	17,400,414
	Për energjinë elektrike	38,366,172,742	32,195,092,079	32,195,092,079
	Për Humbjet	204,426,439	0	0
	Shitje nga importi	626,252,671		
	Penalitete	17,983,918,805	16,907,088,168	16,907,088,168
	OSHEE - Shitje materiale	16,864,433	16,864,433	16,864,433
	Diferenca të tjera	-2,858,932	-2,858,932	-2,858,932
	VKM 482 date 05.06.2015	-222,670,735	-222,670,735	-222,670,735
	Kredi Afatgjatë	12,529,428,004	12,439,849,786	11,959,582,827
2	Shuma e Detyrimit FSHU sha ndaj KESH			
	Për energjinë elektrike		2,441,154,600	6,856,771,959
	Penalitete			112,441,764
3	Shuma e Detyrimit OST sha ndaj KESH			
	Shitje energji elektrike+ shërbimet ndihmese	4,640,760,755	6,599,974,505	9,155,125,911
	Penalitete për moslikujdim fature (fatura të paparanuara)	3,728,924	3,728,924	1,283,100,142
	Kredi Afatgjatë	9,113,840,105	9,065,874,213	8,767,049,336
	TOTAL të arkëtueshme	83,277,263,625	79,461,497,455	87,044,987,366
1	Hua nga Banka (IBRD, EBRD, KFË etj)	42,699,909,437	39,692,137,582	37,671,010,640
2	Hua Ministria e Financave	27,796,845,006	29,745,559,559	36,481,762,488
	Pjesa Afatgjatë e huave	45,838,970,071	41,638,709,415	42,222,038,572
	Pjesa afatshkurtër e huave	24,657,784,372	27,798,987,726	31,930,734,556
3	OVD	7,312,083,652	4,965,174,635	5,267,674,638
4	Furnitorë	7,442,374,058	1,729,263,515	10,379,795,835
5	Detyrime ndaj Tatimeve	536,070,024	522,292,841	12,317,808
	Total të pagueshme	85,787,282,177	76,654,428,132	89,812,561,409

Burimi: KESH SHA

-Në mënyrë të detajuar detyrimet paraqiten si më poshtë:

-Mos shlyerja e detyrimit për energjinë elektrike të furnizuar nga OSHEE sha

Detyrimi i akumuluar i pashlyer nga OSHEE sh.a më 31.12.2022, i cili lidhet me faturat për energjinë elektrike që KESH sh.a. ka furnizuar OSHEE, rezulton në vlerën 31,972,421,355 Lekë.

Detyrimi i akumuluar i pashlyer nga FSHU sha sh.a më 31.12.2022, i cili lidhet me faturat për energjinë elektrike që KESH sh.a. ka furnizuar FSHU sha, rezulton në vlerën 6,857,231,692 Lekë.

-Fatura për kamatëvonesa në pagesat e OSHEE sha ndaj KESH sha.

Si pasojë e mosrespektimit në kohë të detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me energji elektrike, në zbatim VKM-së apo Vendimeve të ERE-s janë lëshuar faturat nga KESH sh.a, sipas tabelës:

Tabela 13.

Nr. Faturës	Data	Vlera (lek)	Përshkrimi
		16,811,437,094	Penalitete të mbartura para viti 2020
486 (OSHEE)	31.03.2021	95,651,066	Penalitet për vonesa në pagesë
139/2022 (FSHU)	24.05.2022	112,441,764	Penalitet për vonesa në pagesë
Totali		17,019,529,923	

Burimi: KESH SHA

- Mos shlyerje e detyrimeve të OSHEE ndaj KESH për huatë afatgjatë.

Me ndarjen e aktivitetit të KESH sh.a dhe krijimin e dy shoqërive OST sh.a dhe OSSH sh.a., më 10 Mars 2019 nënshkruhet “Marrëveshja e Ripagimit të Kredive Afatgjata”, ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a.) dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.), sot OSHEE sh.a, e cila përmban dhe Aneksin 1, ku sipas skeduleve të çdo kredie të transferuar, janë përcaktuar vlerat e principaleve dhe interesave që duhen paguar në periudhat e caktuara.

Për vitin 2020 detyrimi i akumuluar për huatë afatgjata (principal + interes) është në vlerën 12,529,428,003.75 lekë.

Për vitin 2021 detyrimi i akumuluar për huatë afatgjata (principal + interesa) është në vlerën 12,439,849,785.71 lekë.

Për vitin 2022 detyrimi i akumuluar për huatë afatgjata (principal + interesa) është në vlerën 11,959,582,827.12 lekë.

-Transferimi i aseteve.

Detyrimi për transferimin e aseteve nga KESH sh.a në CEZ Shpërndarje (OSHEE sha), është në vlerën 17,400,414 lekë.

Detyrim ky i cili është njohur dhe pranuar nga palët, por ende i pashlyer nga CEZ Shpërndarje sh.a (OSHEE sha.) përkatësisht fatura nr. 5 dhe fatura nr.8, datë 31.12.2010 të lëshuara nga KESH sha.

-Mos shlyerja e detyrimeve të OSHEE, detyron KESH sh.a të marrë kredi afatshkurtra dhe hua shtetërore.

Për të përballuar gjendjen e vështirë financiare dhe një mungesë të theksuar likuiditetesh KESH sh.a, duke filluar nga viti 2007 e në vazhdim ka kërkuar mbështetjen si të buxhetit të shtetit ashtu edhe atë të bankave të nivelit të dytë, që operojnë në vendin tonë, nëpërmjet kredive afat shkurtra (njëvjeçare) si over draft, si dhe për përdorimin e tyre për lëshimin e garancive bankare/letër kredive për kontratat e importit të energjisë.

Totali i limitit të linjave të Overdrafteve të KESH sh.a në bankat e nivelit të dytë për vitin 2022 është në vlerën 5,996,291,332 lekë, nga të cilat 2,740,336,332 lekë, janë të garantuar me Garanci Qeveritare dhe 3,255,955,000 lekë janë të miratuara me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë dhe janë të siguruara kundrejt llogarive të arkëtueshme, që rrjedhin nga faturat e shitjes që KESH sh.a ka lëshuar për OSHEE sha.

Ndërkohë gjendja e linjave të overdrafteve të KESH sh.a në bankat e nivelit të dytë në 31.12.2022 është në vlerën 5,267,674,638 lekë.

-Problematika të krijuara momentin e ndarjes/privatizimit të OSSH-së.

Kjo problematikë është e lidhur me detyrimet që rrjedhin nga marrëdhëniet tranzitore midis KESH sh.a dhe OSSH sh.a. Në momentin e ndarjes së dy shoqërive në zbatim të Urdhrit të Ministrit (METE) nr.500, datë 01.07.2015 “Për ndarjen e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet KESH sh.a dhe OSSH sh.a dhe marrëdhënieve tranzitore ndërmjet dy shoqërive”, si dhe VKM nr. 862, datë 20.12.2006 “Për krijimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, të cilat janë të pasqyruara në Pasqyrat Financiare të KESH sh.a. Këto detyrime të OSSH/CEZ Shpërndarje/OSHEE ndaj KESH sh.a lidhen me balancat nga marrëdhëniet tranzitore midis KESH sh.a dhe OSSH sh.a për periudhën 30.06.2008 deri më 31.12.2008 në vlerën 1,884,044,485 lekë. Kjo vlerë rrjedh nga pika nr. 2 e Urdhrit nr. 500, datë 01.07.2015 ku citohet: “.... Të gjitha të ardhurat e realizuara nga arkëtimet e energjisë elektrike të emetuara nga KESH sh.a për llogari të periudhës deri më 30.06.2008, të derdhen në llogaritë e KESH sh.a.....”.

-Mos përmbushja e zbatimit të VKM nr. 126, datë 11.02.2015 për shuarje me kompensim të detyrimeve.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 126, datë 11.02.2015 "Mbi përcaktimin e shumave të shuarjes me kompensim të detyrimeve ndërmjet institucioneve buxhetore dhe jo buxhetore që financohen nga buxheti, KESH sh.a., OSHEE sh.a dhe Ministria e Financave", mundësonte shuarjen me kompensim të detyrimeve të OSHEE ndaj KESH deri në **vlerën 9 miliardë** lekë ndërkohë që KESH zbriste detyrimin që kishte ndaj Ministrisë së Financave **në të njëjtën masë**.

Në zbatim të VKM është firmosur Akt Rakordimi nga Administratorët e shoqërive, në të cilin janë të përcaktuara faturat që do të preken nga procesi i shuarjes me kompensim të detyrimeve. Nga KESH sh.a., është reflektuar nga njëra anë si zvogëlim i detyrimit që KESH sh.a ka ndaj Ministrisë së Financave (nëpërmjet akt-rakordimit me Ministrinë e Financave, pjesë integrale e VKM-së) dhe nga ana tjetër, si ulje e të drejtës për arkëtim kundrejt OSHEE sh.a në vlerën 8 miliard lekë.

-Gjendja e detyrimeve të ndërsjella OST-s ndaj KESH sh.a.

Në zbatim të kuadrit rregullator të tregut të energjisë elektrike në vendin tonë dhe në zbatim të Vendimeve të ERE-s, për miratimin e tarifave të energjisë elektrike për mbulimin e disbalancave, aktivizimit të rezervës, humbjeve në rrjetin e transmetimit, shërbimet ndihmëse të dy shoqëritë kanë bashkëpunuar në zbatimin me rigorozitet të rregullave dhe vendimeve përkatëse, për të siguruar një furnizim normal dhe brenda gjithë standardeve të energjisë elektrike deri tek konsumatorët fundorë. Si rrjedhojë e këtyre marrëdhënieve, janë krijuar detyrime ndërmjet palëve që kanë të bëjnë me detyrime për energjinë elektrike që nevojitet për mbulimin e disbalancave në furnizimin me energji elektrike, si dhe detyrime për energjinë elektrike që nevojitet nga OST sh.a. për mbulimin e humbjeve në rrjetin e saj të transmetimit dhe energjisë balancuese. Në të gjitha rastet, këto detyrime janë formalizuar me faturat tatimore për periudhën përkatëse dhe llojin e detyrimit.

Detyrimi i OST sh.a. deri më 31.12.2022, kundrejt KESH sh.a. për energjinë elektrike të furnizuar e faturuar për mbulimin e disbalancave, aktivizimit të rezervës për balancim dhe humbjeve në rrjetin e transmetimit paraqitet si më poshtë:

Tabela 14.

Emertimi i llogarise	2020	2021	2022
OST shitje energjie per disbalancat	2,406,852,091.00	2,385,257,471.00	2,244,850,704.00
OST shitje energjie per aktivizim rezerve	2,211,197,956.00	3,439,329,518.00	6,527,258,336.65
OST per faturat e humbjeve	43,665.00	454,174,715.00	225,350,422.86
OST per shërbimet ndihmëse	22,667,040.00	313,863,641.00	157,666,448.00
OST Penalitete	3,728,924.00	3,728,924.00	1,283,100,142.00
TOTAL Detyrimi	4,644,491,696.00	6,596,356,290.00	10,438,226,053.51

Burimi: KESH SHA

Në fund të vitit 2022 shoqëria OST sh.a. rezulton debitore ndaj shoqërisë KESH sh.a në vlerën e 10,438,226,053 lekë, shumë që i korrespondon faturave (detyrimeve të pashlyera) për energjinë elektrike, për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit, faturave të penaliteteve si dhe faturave për shërbimet ndihmëse dhe energjisë balancuese. Këto detyrime janë rakorduar dhe pranuar nga palët.

Gjithashtu në zbatim të “Marrëveshja e Ripagimit të Kredive Afatgjata” nënshkruar më datë 25.05.2009 ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a.) dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), e cila përmban dhe Aneksin 1, ku sipas skeduleve të çdo kredie të transferuar, janë përcaktuar vlerat e principaleve dhe interesave që duhen paguar në periudhat e caktuara. Theksojmë se detyrimet janë të rakorduara mes të dy shoqërive. Aktualisht detyrimet e pashlyera të OST sh.a për huatë afatgjata deri më 31.12.2021 dhe 31.12.2022 janë:

Tabela 15.

Përshkrimi	Gjendja 01.01.2021 (Lek)	Detyrimi për pagesë në vitin 2021 (Lek)	Pagesa në vitin 2021 (Lek)	Disbursime në vitin2021 (Lek)	Gjendja në 31.12.2021 (Lek)
Principal	4,159,520,879.96	389,618,706.90	0	0	4,549,139,586.86
Interesa	580,103,918.67	87,195,661.79	0	0	667,299,580.46
Totali	4,739,624,798.63	476,814,368.69	0	0	5,216,439,167.31

Përshkrimi	Gjendja 01.01.2022 (Lek)	Detyrimi për pagesë në vitin 2022 (Lek)	Pagesa në vitin 2022 (Lek)	Disbursime në vitin2022 (Lek)	Gjendja në 31.12.2022 (Lek)
Principal	4,477,181,074.32	298,815,006.46	0	0	4,775,996,080.78
Interesa	653,563,530.48	64,447,629.87	0	0	718,011,160.35
Totali	5,130,744,604.80	363,262,636.33	0	0	5,494,007,241.13

Burimi: KESH SHA

Aktualisht këstet e detyrimeve të pashlyera të OST sh.a për huatë afatgjata për vitin 2022 (pricipal + interes) janë në vlerën 5,494,007,241.13 lekë.

Sic edhe theksohet më sipër, këto detyrime të akumuluar për periudhën 2021-2022 si për energjinë ashtu dhe huatë afatgjata janë rakorduar dhe pranuar nga palët, por të pashlyera.

-Situata lidhur me dividentin e KESH sh.a. ndaj Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Aktualisht KESH sh.a ka një detyrim prej 2,438,609 mije lekë ndaj Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, që daton më 1996 deri në 2004.

-Situata e detyrimeve ndërmjet KESH sh.a. ndaj Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Energjisë, Tregtisë dhe Energjetikës nr. 4, datë 09.01.2012 “Mbi përcaktimin e mënyrës së shlyerjes së detyrimit për pagesën e tarifës konçensionare të prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet e dhëna me koncesion”, ku KESH sha, është caktuar në rolin e agentit të mbledhjes së saj. KESH sha ka aplikuar ndalesën e kësaj tarife nga detyrimet për çdo fature prodhimi/shitje të energjisë elektrike nga PPE&PVE dhe deri në 31.12.2022 i ka likuiduar të gjitha detyrimet.

-Situata e detyrimeve ndërmjet KESH dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Në pasqyrat financiare të KESH sha rezulton me një detyrim në vlerën 1,330,000,000 lekë ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Detajet e këtij detyrimi shtjellohen si më poshtë:

Në vitet 1999-2001 KESH sh.a. ka nënshkruar tre marrëveshje huaje me sot Ministria e Financave dhe Ekonomisë, konkretisht:

-Në vitin 1999 -Marrëveshje huaje të brendshme në vlerën 650 milionë lekë me objekt “Përballimi i kostove të huaja të importit të energjisë elektrike dhe transportit të transformatorëve të HEC Fierze”.

-Në vitin 2000 -Marrëveshje huaje të brendshme në vlerën 240 milionë lekë me objekt “Përballimi i borxhit të vjetër ndaj kompanisë Greke nga KESH-i, si rezultat i bilancit negativ në shkëmbimin e energjisë elektrike”.

-Në vitin 2001 -Marrëveshje huaje të brendshme në vlerën 440 milionë lekë me objekt “Përballimi i borxhit të vjetër ndaj kompanisë Greke nga KESH-i, si rezultat i bilancit negativ në shkëmbimin e energjisë elektrike”.

Nga rakordimet e herëpashershme që KESH sh.a ka me Drejtorinë e Përgjithshme e Borxhit Publik, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë lidhur me portofolin e kredive të sipërpërmendura, këto tre Marrëveshje nuk rezultonin në listën e tyre të huave të marra nga KESH sh.a. dhe nga periudha e nënshkrimit të Marrëveshjeve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nuk ishte dërguar asnjë njoftim për shlyerjen e këtyre detyrimeve.

Kjo situatë u qartësua dhe mes palëve në 31.12.2022 dhe u dakordësua vlera e huasë 1,330,000,000 lekë,

-Situata e detyrimeve ndërmjet KESH dhe Tatim Taksat.

Në fund të vitit 2022, detyrimet ndaj organeve tatimore rezultojnë në vlerën 12,317,808 lekë, të cilat janë të pasqyruara në pasqyrat financiare të shoqërisë. Këto detyrime tatimore rezultojnë të regjistruara në bazë të njoftim vlerësimeve, akt-kontrolleve të mbajtura në vite (2012), TVSH-së me vetë deklaram dhe tatim fitim deri më 31.12.2022, përfshirë gjoba dhe interesa të cilat janë të kontabilizuara dhe të pasqyruara në bilancin e KESH sh.a.

Tabela 16. Viti 2020

Periudha	Lloje detyrimit	Principa I	Gjoba të Regjistruara	Kamata	Balanca 31.12.2020
viti 2020	TVSH		407,661,759.00	102,280,611	509,942,370
viti 2020	Tatim Fitim		19,153,403.00		19,153,403
viti 2020	Tatim ne burim		4,789,846.00		4,789,846
viti 2020	Kontribute sigshoq.		10,000.00		10,000
viti 2020	globale-gjobe		2,174,405.00		2,174,405
Total 2020		-	433,789,413.00	102,280,611	536,070,024

Burimi: KESH SHA

Tabela 17. Viti 2021

Periudha	Lloje detyrimit	Principal	Gjoba të Regjistruara	Kamata	Balanca 31.12.2021
viti 2021	TVSH		407,661,759	2,280,611	409,942,370
viti 2021	Tatim Fitim		105,366,220		105,366,220
viti 2021	Tatim ne burim		4,789,846		4,789,846
viti 2021	Kontribute sigshoq.		20,000		20,000
viti 2021	globale-gjobe		2,174,405		2,174,405
Total 2021		-	520,012,230	2,280,611	522,292,841

Burimi: KESH SHA

Tabela 18. Viti 2022

Periudha	Lloje detyrimit	Principal	Gjoba të Regjistruara	Kamata	Balanca 31.12.2022
viti 2022	TVSH				-
viti 2022	Tatim Fitim		10,143,403		10,143,403
viti 2022	Tatim ne burim		0		-
viti 2022	Kontribute sigshoq.		0		-
viti 2022	globale-gjobe		2,174,405		2,174,405

Total 2022		-	12,317,808	-	12,317,808
------------	--	---	------------	---	------------

Burimi: KESH SHA

Masat e ndërmarrja në kuadër të zgjidhjes së problematikave të evidentuara në sektorin e energjisë elektrike.

Me VKM nr. 171, datë 25.02.2015, “Për Miratimin e Planit të Rimëkëmbjes Financiare të sektorit të energjisë elektrike”, botuar në fletoren zyrtare nr. 30, Mars 2015, është miratuar plani i masave për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike, për disiplinimin financiar të tij. Qëllimi i planit është të ofrojë një pamje të plotë dhe të detajuar të situatës financiare të sektorit të energjisë elektrike, shkaqet kryesore, si dhe të propozojë një plan të rimëkëmbjes financiare shoqëruar me një plan veprimi për 5 vitet e ardhshme me mbështetjen e Bankës Botërore. Gjithashtu, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr.74, datë 27.05.2015 “Për ngritjen e grupit ndër institucional të punës për evidentimin dhe adresimin e problematikave, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja, në sektorin e energjisë elektrike”, po ndërmerren hapa për evidentimin dhe gjetjen e zgjidhjeve për problematikat ndërmjet operatorëve të sektorit. Situata e rakordimeve mes palëve është e sistemuar.

-Mes palëve KESH sh.a dhe OST sh.a është rakorduar dhe dakortësuar për të gjitha detyrimet e ndërsjella, dhe ka mosdakortësi vetëm për penalitetet e aplikuara për pagesë të vonuar.

-Mes palëve KESH sh.a dhe OSHEE grup, a është rakorduar dhe dakortësuar për të gjitha të gjitha detyrimet, dhe ka mosdakortësi vetëm për penalitetet e aplikuara për pagesë të vonuar me FSHU sh.a.

Situata e llogarive të arkëtueshme në fund të periudhës 2022 është rritur në vlerën 7,583,489,911 lekë. Pjesa më e madhe ka ardhur nga shitjet për energji elektrike, dhe rritja e detyrimeve të FSHU-së ndaj KESH.

Situata e llogarive të pagueshme është përkeqësuar gjatë periudhës 2022, duke u thelluar në vlerën 13,158,133,277 lekë, në zërin e furnitorëve për energji elektrike. Rritja e kësaj difference ka ardhur si pasojë e blerjeve për energji elektrike që KESH ka kryer në treg me çmimet e bursës dhe i'a ka shitur Furnizuesit të Shërbimit Universal me tarifat e miratuara nga ERRE, duke absorbuar diferencën e çmimit.

Në tetor të vitit 2021, me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 584, date 08.10.2021, u shpall gjendja e emergjencës në furnizimin me energji elektrike. Këshilli i Ministrave nëpërmjet VKM nr.757 datë 09.12.2021, për ndryshimin e VKM Nr. 620/2021, ngarkoi KESH sh.a., me detyrimin për të furnizuar FSHU me të gjithë sasinë e nevojshme, për qëllime të plotësimit të kërkesës së plotë të saj.

Nëpërmjet shkresës Nr. 471 Prot, shoqëria KESH sh.a. i drejtohet MFE dhe MIE për nevojën për mbështetje buxhetore për veprimtarinë që kjo shoqëri po ushtron me qëllim përmbushjen e detyrimit për shërbim publik të ngarkuar. Kjo mbështetje e kërkuar është alokuar për shoqërinë nga ana e Ministrisë së financave dhe Ekonomisë nëpërmjet një Huaje Buxhetore në vlerën totale të rreth 68 Mln Euro, në muajin mars 2022. Ndërkohë për përmbushjen e detyrimit sipas VKM Nr. 620/2021 e ndryshuar, KESH sh.a. kishte filluar blerjen e energjisë që në muajin Janar 2022, pa ndryshuar çmimet e shitjes së energjisë në përmbushje të Detyrimit për shërbim publik.

Nëpërmjet Aktit Normativ Nr. 3, datë 12.03.2022, miratuar me Ligjin Nr. 31/2022, për sektorin e energjisë elektrike, konkretisht neni 3, pika 3, në buxhetin e vitit 2022 është shtuar *“Fondi prej 20,000 milionë lekësh për mbështetjen e sektorit energjetik përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe ministrit përgjegjës për financat.”.*

Për nga forma ligjore ky fond planifikohet në Buxhetin e Shtetit të shpërndahet si mbështetje me miratime nga ana e Këshillit të Ministrave. Shoqëria KESH sh.a. bazuar në rezultatet e periudhës dhe pritshmërinë e periudhës vijuese, me shkresë Nr. 2902 Prot., date 15.06.2022, ka kërkuar më MFE mbështetje financiare. Nga ana e Këshillit të Ministrave me Vendim nr. 498/2022, u miratua mbështetje e sektorit energjetik me vlerën 8 mld Lekë.

Në vijim nga ana e Asamblesë së Aksionarit të KESH sh.a. u realizua nëpërmjet Vendimit Nr. 5875, datë 01.08.2022, zmadhimi i kapitalit në vlerën e 5 Mld Lekë, sipas VKM Nr. 498/2022.

Në vijim, nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 603, datë 14.09.2022, u miratua mbështetje e dytë e sektorit energjetik, me vlerën 8 Mld lekë.

Në vijim Asambleja e Aksionarit me Vendim nr. 7447, datë 05.10.2022, miratoi zmadhimin e kapitalit për shoqërinë në vlerën 8 Mld Lekë. Injektimi i fundit i mbështetjes për sektorin energjetik u realizua nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 875, datë 27.12.2022, në vlerën prej 4 Mld Lekë.

Me vendimin nr. 5875 datë 01.08.2022, Asambleja e Ortakëve ka miratuar zmadhimin e kapitalit në vlerën 8,000,000,000 lekë, duke e rritur kapitalin themeltar të shoqërisë në vlerën 28,162,798,762 lekë.

Me vendimin nr. 7447 datë 05.10.2022, Asambleja e Ortakëve ka miratuar zmadhimin e kapitalit në vlerën 8,000,000,000 lekë, duke e rritur kapitalin themeltar të shoqërisë në vlerën 36,162,798,762 lekë.

Me vendimin nr. 10254 datë 30.12.2022, Asambleja e Ortakëve ka miratuar zmadhimin e kapitalit në vlerën 8,000,000,000 lekë, duke e rritur kapitalin themeltar të shoqërisë në vlerën 40,162,798,762 lekë.

Veprimet e ndërmarra nga Këshilli i Ministrave duke zmadhuar kapitalin themeltar, janë kryer për të rritur stabilitetin financiar të shoqërisë.

III.2.9. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

Nga auditimi konstatohet se:

- 1. Titulli i gjetjes:** Mos kryerja e funksioneve të Komitetit të Riskut dhe Auditit.
- Situata:** Nga auditimi konstatohet se Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 13, datë 10.09.2020 për “Krijimin e Komitetit të Riskut dhe Auditimit të shoqërisë KESH SHA”, është krijuar ky komitet i përbërë nga: Th. Xh (Kryetar), E. M (Anëtar) dhe L. P (Anëtar). Referuar dokumentacionit të administruar konstatohet se Komiteti i Riskut dhe Auditit nuk është mbledhur, nuk ka vlerësuar performancën e departamentit të Auditimit të Brendshëm të shoqërisë, nuk ka kryer funksionin e vetë këshillimor dhe ka përcaktuar prioritetet e këtij departamenti, duke ju referuar funksioneve të përcaktuara në statutin e kësaj shoqërie. Po ashtu nga grupi i auditimit konstatohet se nga ana e Këshillit Mbikëqyrës nuk është hartuar dokumenti i veçantë lidhur me funksionet dhe përgjegjësitë e Komitetit të Riskut dhe Auditit.
- Kriteri:** Statuti i KESH SHA (miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit me vendim nr. 7854/1 prot, datë 18.10.2019), neni 11.1, 11.5, 12.1, 12.2.
- Ndikim/Efekti:** Mos kryerja e funksioneve të Komitetit të Riskut dhe Auditit sjell për pasojë mos përmbushjen e funksioneve të përcaktuara në Statutin e shoqërisë dhe mos vlerësimin e prioritetëve dhe performancës të Auditit të Brendshëm në KESH SHA.
- Shkaku** Komiteti i Riskut dhe Auditit nuk është mbledhur, nuk ka vlerësuar performancën e departamentit të Auditimit të Brendshëm të shoqërisë, nuk ka kryer funksionin e vetë këshillimor dhe ka përcaktuar prioritetet e këtij departamenti.
- Rëndësia:** E lartë.
- 1.1.Rekomandimi:** Nga Komiteti i Riskut dhe Auditit dhe Administratori i shoqërisë të merren masa lidhur me hartimin e dokumentit të veçantë lidhur me funksionimin dhe përgjegjësitë e këtij komiteti, si dhe hartimin e prioritetëve të Auditit të Brendshëm dhe analizën e performancës të këtij departamenti.

Për sa më sipër mban përgjegjësi Nëpunësi Autorizues, Administratori znj. E. V.

III.2.10. Trajtim ankese.

Shoqëria “A” SHPK, ka paraqitur shkresën nr. 4729 prot., datë 25.05.2023 “Kthim përgjigje shkresës së KESH SHA nr. 2222 prot., datë 04.05.2023” sipas të cilës dëmi ekonomik i konstatuar nuk qëndron. Në këtë shkresë citohet se projekti i hartuar nga ana e tyre i është nënshtruar opionencës teknike, nga ku janë sqaruar edhe mospërputhjet e çmimeve të disa zërave të punimeve me manualët teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit, të përcaktuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH.


Pretendohet se nga tenderi i zhvilluar, oferta e shpallur fituese është me vlerë 21,066,523 lekë më e vogël se fondi limit, pasojë e të cilit eliminohet efekti i mundshëm nga përlllogaritja e gabuar e fondit limit.

Pavarësisht pretendimit të paraqitur se mospërputhjet për disa zëra të punimeve janë sqaruar në dokumentacionin e opionencës teknike, nga ana e grupit të auditimit u auditua

dokumentacioni teknik në sistemin elektronik të prokurimeve, i cili u krahasua me përshkrimet në pretendimet e paraqitura, nga ku rezultoi:


- Për zërin 3.338/An “Gabion me rrjetë teli të zinkuar gurë kave “1 x 2 x 0.5 m”, në manual paraqitet çmimi 6,232 lekë/m³, ndërsa çmimi i aplikuar është 7,135 lekë/m³. Në analizën e çmimit sipas manualit karkasa e rrjetës është parashikuar me hekur Ø 6 mm, ndërsa në projekt është parashikuar hekur Ø 10 mm. Diferenca e trajtuar në fondin limit për këtë zë punimi është me vlerë 353,037 lekë. Po ashtu, për zërin 3.333/An “Gabion me rrjetë teli të zinkuar gurë kave “1 x 1 x 2 m”, në manual paraqitet çmimi 4,490 lekë/m³, ndërsa çmimi i aplikuar është 5,721 lekë/m³. Në analizën e çmimit sipas manualit, karkasa e rrjetës është parashikuar me hekur Ø 6 mm, ndërsa në projekt është parashikuar hekur Ø 10 mm. Rritja e dimensionit të hekurit ka rritur edhe sasinë e tij në kg dhe rrjedhimisht çmimin për këto dy zëra punimesh, **nga ku rezulton se analiza e çmimit është e argumentuar me rritjen përkatëse.**

Vizatimi paraqitet si më poshtë:



- Në lidhje me zërin 3.837/An “Rrethimi i kishës me kolona b/a +rrjetë teli zinkato”, në manual paraqitet çmimi 1,766 lekë/m³, ndërsa çmimi i aplikuar është 3,210 lekë/m³. Diferenca e trajtuar në fondin limit për këtë zë punimi është me vlerë 132,848 lekë. Në analizën e çmimit sipas manualit është parashikuar vendosja e rrjetës së telit e cila lidhet në kolonat beton arme, ndërsa sipas vizatimeve (pjesë e dokumenteve të tenderit), rrjeta është parashikuar të lidhet përveç kolonave edhe nga një karkasë me hekur betoni Ø 20 mm, **nga ku rezulton se analiza e çmimit është e argumentuar me rritjen përkatëse.**

Vizatimi paraqitet si më poshtë:



- Në lidhje me zërin 3.248/An “Struktura monolite betoni me çakull C 30/37, për platin e ankorimit”, në manual paraqitet çmimi 15,386 lekë/m³, ndërsa çmimi i aplikuar është 17,715 lekë/m³. Diferenca e trajtuar në fondin limit për këtë zë punimi është me vlerë 39,593 lekë. Rritja e çmimit argumentohet me faktin se në manual është parashikuar realizimi i betonit në objekt, ndërsa analiza e hartuar i përket realizimit të betonit në nyje betoni dhe çmimi i betonit 30/37 është nxjerrë si mesatare e dy klasave C 25/30 dhe C 37/45. Nuk argumentohet nevoja për ndryshimin e teknologjisë së prodhimit të betonit.

Sa më sipër, arrihet në konkluzionin se nga ana e projektuesit janë hartuar analiza të reja çmimesh, bazuar në përcaktimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit, duke përshtatur vetëm çmimin e materialit për të cilin ndryshon specifikimi (gabionet), shtesës në çmim për karkasë hekuri në rastin e rrethimit dhe ndryshimit të teknologjisë së realizimit të betonit nga beton i realizuar në vend, në beton të realizuar në nyje betoni. Konstatohet se diferenca e pa argumentuar në fondin limit të hartuar nga Projektuesi Shoqëria “A” SHPK, është 39,593 lekë.

Duke marrë në konsideratë faktin se nga zhvillimi i procedurës së prokurimit, oferta e shpallur fituese është me një vlerë të konsiderueshme më të ulët nga fondi limit, grupi i auditimit vlerëson se diferenca në fondin limit nuk ka prodhuar pasoja financiare.

1. Titulli i gjetjes: Trajtim ankese.

Situata: Shoqëria “A” SHPK, ka paraqitur shkresën nr. 4729 prot., datë 25.05.2023 “Kthim përgjigje shkresës së KESH SHA nr. 2222 prot., datë 04.05.2023”, sipas të cilës dëmi ekonomik i konstatuar nuk qëndron. Në këtë shkresë citohet se projekti i hartuar nga ana e tyre i është nënshtruar opionencës teknike, nga ku janë sqaruar edhe mospërputhjet e çmimeve të disa zërave të punimeve me manualen teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit, të përcaktuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH.

Pretendohet se nga tenderi i zhvilluar, oferta e shpallur fituese është me vlerë 21,066,523 lekë më e vogël se fondi limit, pasojë e të cilit eliminohet efekti i mundshëm nga përlllogaritja e gabuar e fondit limit.

Pavarësisht pretendimit të paraqitur se mospërputhjet për disa zëra të punimeve janë sqaruar në dokumentacionin e opionencës teknike, nga ana e grupit të auditimit u auditua dokumentacioni teknik në sistemin elektronik të prokurimeve, i cili u krahasua me përshkrimet në

	pretendimet e paraqitura, nga ku rezultoi se: -Për zërin 3.338/An “Gabion me rrjetë teli të zinkuar gurë kave “1 x 2 x 0.5 m”, në manual paraqitet çmimi 6,232 lekë/m³, ndërsa çmimi i aplikuar është 7,135 lekë/m³. Në analizën e çmimit sipas manualit karkasa e rrjetës është parashikuar me hekur Ø 6 mm, ndërsa në projekt është parashikuar hekur Ø 10 mm. Diferenca e trajtuar në fondin limit për këtë zë punimi është me vlerë 353,037 lekë. Po ashtu, për zërin 3.333/An “Gabion me rrjetë teli të zinkuar gurë kave “1 x 1 x 2 m”, në manual paraqitet çmimi 4,490 lekë/m³, ndërsa çmimi i aplikuar është 5,721 lekë/m³. Në analizën e çmimit sipas manualit, karkasa e rrjetës është parashikuar me hekur Ø 6 mm, ndërsa në projekt është parashikuar hekur Ø 10 mm. Rritja e dimensionit të hekurit ka rritur edhe sasinë e tij në kg dhe rrjedhimisht çmimin për këto dy zëra punimesh, nga ku rezulton se analiza e çmimit është e argumentuar me rritjen përkatëse. - Në lidhje me zërin 3.837/An “Rrethimi i kishës me kolona b/a +rrjetë teli zinkato”, në manual paraqitet çmimi 1,766 lekë/m³, ndërsa çmimi i aplikuar është 3,210 lekë/m³. Diferenca e trajtuar në fondin limit për këtë zë punimi është me vlerë 132,848 lekë. Në analizën e çmimit sipas manualit është parashikuar vendosja e rrjetës së telit e cila lidhet në kolonat beton arme, ndërsa sipas vizatimeve (pjesë e dokumenteve të tenderit), rrjeta është parashikuar të lidhet përveç kolonave edhe nga një karkasë me hekur betoni Ø 20 mm, nga ku rezulton se analiza e çmimit është e argumentuar me rritjen përkatëse. - Në lidhje me zërin 3.248/An “Struktura monolite betoni me çakull C 30/37, për platin e ankorimit”, në manual paraqitet çmimi 15,386 lekë/m³, ndërsa çmimi i aplikuar është 17,715 lekë/m³. Diferenca e trajtuar në fondin limit për këtë zë punimi është me vlerë 39,593 lekë. Rritja e çmimit argumentohet me faktin se në manual është parashikuar realizimi i betonit në objekt, ndërsa analiza e hartuar i përket realizimit të betonit në nyje betoni dhe çmimi i betonit 30/37 është nxjerrë si mesatare e dy klasave C 25/30 dhe C 37/45. Nga auditimi rezulton se nuk argumentohet nevoja për ndryshimin e teknologjisë së prodhimit të betonit.
Kriteri:	Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15. Nga ana e projektuesit janë hartuar analiza të reja çmimesh, bazuar në përcaktimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit, duke përshtatur vetëm çmimin e materialit për të cilin ndryshon specifikimi (gabionet), shtesës në çmim për karkasë hekuri në rastin e rrethimit dhe ndryshimit të teknologjisë së realizimit të betonit nga beton i realizuar në vend, në beton të realizuar në nyje betoni. Konstatohet se
Ndikim/Efekti:	diferenca e pa argumentuar në fondin limit të hartuar nga Projektuesi Shoqëria “A” SHPK, është 39,593 lekë. Duke marrë në konsideratë faktin se nga zhvillimi i procedurës së prokurimit, oferta e shpallur fituese është me një vlerë të konsiderueshme më të ulët nga fondi limit, rezulton se diferenca në fondin limit nuk është materiale dhe nuk ka prodhuar pasoja financiare.
Shkaku	Nuk është marrë referencë e saktë në përcaktimin e çmimit të një zëri punimi.

Rëndësia:

E mesme.

1.1.Rekomandimi:

KESH SHA të marrë masa për rishikimin e gjetjes së auditimit, trajtuar në auditimin e mëparshëm, duke mos e konsideruar dëm ekonomik vlerën 1,206,190 lekë, në përgjegjësinë e Shoqërisë “A” SHPK.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASAT ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se Urdhri i administratorit për iniciimin e procesit të parashikimit dhe përlogaritjeve të shpenzimeve, të ardhurave e investimeve. u është drejtuar departamenteve pa cilësuar personat përgjegjës për kryerjen e detyrave .

-Komunikimi ndërmjet punonjësve që kanë dërguar informacionin në Divizionin e Programimit dhe Menaxhimit Strategjik, është mbajtur në formë elektronike, dhe jo në formë shkresore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se kërkesat nga drejtoritë përkatëse *nuk argumentonin me raportime, shpjegime, arsyet dhe llogaritje të kontrollueshme shpenzimet e kërkuara, si dhe duke mos plotësuar elementët e dokumentit financiar dhe të tjera elementë që i japin dokumentit vlerën administrative.*

Rritjet e elementëve të koston nuk janë justifikuar me relacionet përkatëse, ku të sqaroheshin arsyet, rritja e numrit, e strukturës etj.

Ky veprim është në kundërshtim me pikën 26 e nenit 4, neni 16 dhe neni 23 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe Udhëzimi i MZHETS nr. 15, datë 2.5.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 16-29, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

1.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa që procesi i hartimit të programit ekonomik financiar, të të ardhurave dhe shpenzimeve të pritshme, të kryhen bazuar në metodat ekonomike, në relacione të detajuara me qëllim realizimin e objektivave të shoqërisë.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se për vitin 2021, se lidhur me realizimin për vitin 2021, rezulton me **84%** realizim lidhur me planifikimin përfundimtar (dhe **69,5%** me planifikimin fillestar).

Konkretisht paraqiten dy rishikime buxheti, ku totali i investimeve në rishikimin e parë rritet me 829,491 mijë lekë (shkon në 7,191,757 mijë lekë), e shprehur në përqindje rezulton me një rritje prej 13%.

Sa i takon rishikimit të dytë rezulton me ulje në vlerën prej 1,932,218 mijë lekë (shkon në 5,259,539 mijë lekë), e shprehur në përqindje ulja rezulton në 26.9% krahasuar kjo me rishikimin e parë dhe me vlerë 1,102,727 mijë lekë, ose me një ulje prej 17% krahasuar me planifikimin fillestar të buxhetit të investimeve.

Nga vlera gjithsej e *parashikuar*, lidhur me investimet prej **6,362,266 mijë lekë**, nga e cila: vlera prej 1,974,155 mijë lekë me fonde të huaja dhe vlera prej 4,049,700 mijë lekë me fondet e shoqërisë. Janë *realizuar* nga parashikimi vlera **4,388,111 mijë lekë** investime, nga të cilat: vlera 1,072,425 mijë lekë nga kostot e huaja dhe vlera 3,346,916 mijë lekë nga fondet e veta dhe kosto lokale.

Për vitin 2022: Nga grupi i auditimit konstatohet se lidhur me realizimin për vitin 2022, rezulton me **60%** realizim.

Konkretisht: është rishikuar parashikimi fillestar i buxhetit, me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 5, datë 26.07.2022 “Për miratimin e të investimeve të KESH SHA për vitin 2022”, ku ndryshimet kryesore konsistojnë në rialokimin e programimit të investimeve për vitin 2022, nga 5,134,096 lekë, në 5,107,995 lekë, pra me zbritje prej 1%, e cila paraqitet si më poshtë:

1. Totali i investimeve për KESH Gjenerimin nga 1,950,019 lekë në 1,460,619 lekë, pra me një zbritje prej 25%, e cila konsiston në:

- ulja e investimeve në HEC Fierzë nga 818,879 mijë lekë në 531,979 mijë lekë, pra -35%;

- ulja e investimeve në HEC Koman nga 575,000 mijë lekë në 504,000 mijë lekë, pra -12%;
- ulja e investimeve në HEC Vau i Dejës nga 556,140 mijë lekë në 424,640 mijë lekë, pra – 24%.

2. Totali i investimeve në KESH Qendër, përfshirë këtu dhe TEC Vlora nga 1,945,000 mijë lekë në 2,408,300 mijë lekë, pra me një rritje prej 24%.

Nga vlera gjithsej e parashikuar prej **5,134,096 mijë lekë**, nga të cilat: vlera prej 1,032,564 mijë lekë me fonde të huaja dhe vlera prej 4,101,532 mijë lekë me fondet e shoqërisë. Janë realizuar nga parashikimi vlera **2,752,643 mijë lekë** investime, nga të cilat: vlera 426,562 mijë lekë nga kostot e huaja dhe vlera 2,326,080 mijë lekë nga fondet e veta dhe kosto lokale. Mos realizimi i investimeve të planifikuara ka ndikuar në s mosrealizimin e objektivave kryesorë të shoqërisë për periudhat audituese dhe rezultatin financiar duke mos realizuar të ardhurat e planifikuara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 16-29, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

2.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa që në të ardhmen, të analizojë shkaqet dhe arsyet e mos realizimit të investimeve të planifikuara për lidhur me investimet. Drejtimi i shoqërisë të marrë masa që në të ardhmen, procesi i investimeve të shikohet me përparësi si një premisë kryesore për realizimin e objektivave kryesorë të shoqërisë për periudhat e ardhshme.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të administruar për periudhën objekt auditimi konstatohet se:

-Është miratuar me nr. 892 prot, datë 17.02.2022 Manuali “Për funksionimin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore”.

- Rregullorja e përgjithshme nuk është azhurnuar me ndryshimet në strukturë dhe si e tillë përshkrimi i vendeve të punës dhe detyrat e secilit pozicion aktual nuk ka përputhshmëri me këtë strukturë.

-Nuk është bërë për asnjë rast shpallja e vendeve vakante dhe as intervistimi apo testimi i kandidatëve.

-Për mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve për punë, nga Burimet Njerëzore, pranë KESH SHA nuk ka asnjë informacion apo gjurmë si janë kryer këto procedura.

Po ashtu procedura e ndjekur gjatë kësaj përzgjedhje nuk është e qartë dhe transparente, sepse nuk ka të dokumentuar asnjë nga hapat që duhet të ndiqen për rekrutimin e punonjësve të rinj.

-Nga auditimi konstatohet se gjatë periudhës objekt auditimi në total janë dhënë 110 masa disiplinore, në KESH SHA, mëposhtme nga këto 96 “Vërejtje”, 13 masa “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, 1 masë “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna dhe kalim në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët” dhe 0 masa “Pushim nga puna”.

Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se nuk ka procedura transparente, dhe nuk ka komision apelimi.

Mos zbatimi i procedurave të rekrutimit të marrëdhëniesve të punës sipas ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015 sjell parregullsi dhe mangësi në punësimin e punonjësve për shoqërinë KESH SHA.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-34, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

4.1.Rekomandimi:Nga Administratori dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore, të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të rekrutimit të punonjësve të rinj, dhe hartimi dhe miratimi i rregullores së brendshme të shoqërisë KESH SHA.

4.2. Rekomandimi: Nga Administratori dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore, të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi dhe transparencë të procedurave të dhënies të masave disiplinore, si dhe ngritjen e komisionit të apelimit lidhur me masat disiplinore në shoqërinë KESH SHA.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, niveli i pagave është përcaktuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 09, datë 17.10.2019 për “Miratimin e dokumentacionit të unifikuar të klasifikimit dhe trajtimit të punonjësve të KESH SHA”.

Niveli i shkallëve në këtë vendim është bërë në 6 grupe nga 1 më i ulëti te 4 më i larti, por në këtë klasifikim nuk janë përcaktuar kriteret që i diferencojnë qartë këto shkallë. Nga auditimi konstatohet se për të njëjtën pozicion pune, në disa raste punonjësit trajtohen me paga të ndryshme. *Sa më sipërnuk ka kriteret të përcaktuara qartë dhe praktika e krijuar ka qenë klasifikimi nga 1 , si shkalla me e ulët në 6, si shkalla më e lartë, duke ju lenë në dorë drejtuesve në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore (duke ruajtur fondin e pagave), sipas aftësive dhe përgjegjësisë, detyrave dhe shkalles se vështirësisë në kryerjen e tyre, si dhe volumit të punës që punonjësit kanë.*

Sa më sipër bie në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1, shkronja (a), *ku citohet se organe kolegjiale drejtuese të njësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50% shtetëror, miratojnë: a) nivelet e pagave të punonjësve të tyre, brenda kufirit minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga ministri përkatës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-34, të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të marrë masat e duhura, lidhur me përcaktimin dhe miratimin e kriterëve për klasifikimin e pagave sipas secilit nivel.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: - Marrëdhëniet e punës janë të rregulluara me kontratën kolektive nr. 2399 prot., datë 23.05.2019 midis KESH SHA të përfaqësuar nga Administratori B. B dhe Federatës Sindikale të Punonjësve të Industrisë të Shqipërisë (FSPISH) të përfaqësuar nga T. K, për një periudhë tre vjeçare, sipas Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar ,neni 176, pika 1: *“Organizatat sindikale dhe organizatat e punëdhënësve janë organizata shoqërore të pavarura, që krijohen si bashkime vullnetare të punëmarrësve ose punëdhënësve, qëllimi i të cilave është përfaqësimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe interesave ekonomikë, profesionalë dhe shoqërorë të anëtarëve të tyre”.*

Nga auditimi rezulton se kësaj kontrate i ka mbaruar afati i vlefshmërisë dhe nuk është rinovuar. Nga viti 2022 deri në përfundimin e auditimit nuk rezulton të ketë kontratë kolektive të re.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-34, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

6.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë të marrë masa lidhur me rinovimin e kontratës kolektive me Federatën Sindikale të Punonjësve të Industrisë të Shqipërisë (FSPISH).

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Referuar dokumentacionit të administruar konstatohet se Komiteti i Riskut dhe Auditit krijuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 13, datë 10.09.2020 nuk është mbledhur dhe nuk ka vlerësuar performancën e departamentit të Auditimit të Brendshëm të shoqërisë. Nuk ka kryer funksionin e vetë këshillimor dhe nuk ka përcaktuar prioritetet e këtij departamenti, duke ju referuar funksioneve të përcaktuara në statutin e kësaj shoqërie.

Gjithashtu konstatohet se nga ana e Këshillit Mbikëqyrës nuk është hartuar dokumenti i veçantë lidhur me funksionet dhe përgjegjësitë e Komitetit të Riskut dhe Auditit.

Sa më sipër bie në kundërshtim me Statutin e KESH SHA (miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit me vendim nr. 7854/1 prot, datë 18.10.2019), neni 11, 12.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 9, faqe 112-112, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

7.1. Rekomandimi: Nga Komiteti i Riskut dhe Auditit dhe Administratori i shoqërisë të merren masa lidhur me hartimin e dokumentit të veçantë lidhur me funksionimin dhe përgjegjësitë e këtij komiteti, si dhe hartimin e prioriteteve të Auditit të Brendshëm dhe analizën e performancës të këtij departamenti.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Në zbatim të kontratës “Blerje 40000 litra vaj hidraulik për agregatet e HEC Fierzë”, nga ana e Kontraktorit është paraqitur raporti i testimit të vajit i datës 20.09.2022 *(realizuar nga laborator i kësaj kompanie)*. Bazuar në këtë raport si dhe specifikimet teknike, nuk jepen të dhëna në lidhje me viskozitetin e vajit në temperaturë 100⁰, indeksi i viskozitetit paraqitet në masën 115, ndërsa në specifikimet teknike paraqitet 98. Nuk jepen të dhëna në lidhje me pikën e ndezjes në enë të mbyllur, po ashtu nuk paraqitet nëse përmban PCB. Sa më lart është në kundërshtim me kushtet e veçanta të kontratës nenin 7.2.3 ku kërkohet që mallrat do të shoqërohen me Certifikatat e analizave fiziko/kimike të uzinës prodhuese nga një laborator i certifikuar, ku të tregohen rezultatet për parametrat e pikës 4, të specifikimeve teknike.

Duke marrë në konsideratë faktin se nga data e marrjes në dorëzim e sasisë së vajit (data 10.10.2022) ka kaluar gati një vit dhe sasia e përdorur është në masën afërsisht 28 %, konsiderohet se janë furnizuar dhe janë gjendje sasi të konsiderueshme dhe mbi nevojat. Duke marrë në konsideratë faktin se ky produkt skadon për një afat 3 vjeçar, *(data e mbushjes në ambalazhin (09.2022) dhe data e skadencës (09.2025))* në rast mos përdorimi ky produkt do të bëhej i pa përdorshëm duke reflektuar me humbje ekonomike. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e asetëve në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 25.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 45-85, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

8.1. Rekomandimi: Nga ana e KESH SHA dhe njësive përkatëse të merren masa për parashikimin e nevojave për furnizime, mbi bazë të nevojave reale, për të shmangur krijimin e stokut, mallrave me qarkullim të ngadalshëm dhe mundësinë e skadimit të tyre.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në disa procedura prokurimi të audituara rezulton se janë vendosur kritere të cilat nuk janë në përputhje me volumin dhe natyrën e kontratës, kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë si: *kritere për licencimin për kategori që nuk kanë lidhje me punimet e parashikuara në preventiv, kërkuar staf teknik mbi nevojat e punimeve të parashikuara; janë vendosur kriteri për disponim licence për kategori punimesh që nuk janë parashikuar në preventiv etj si më poshtë:*

- Procedura e prokurimit “Rehabilitimi i ndërtesës së centralit HEC Koman”;
- Procedura e prokurimit “Ndërhyrje për mirëmbajtjen e sistemeve të CO₂ në HEC Fierzë dhe HEC Koman”;
- Procedura e prokurimit “Rinovim i sistemit të mbrojtjes për dy agregatë me vendosje konfigurim të releve të reja që zëvendësojnë ato ekzistuese REG, RET në HEC Fierzë”;
- Procedura e prokurimit “Demontimi i vinçit 100/5 ton në veprën e marrjes HEC Vau i Dejës”;
- Procedura e prokurimit “Blerje mjet lundrues për pastrimin e biefit të sipërm nga akumulimet e materialeve dhe mbetjeve urbane për Hec Fierzë”;
- Procedura e prokurimit “Ndërtim i infrastrukturës së aksesimit dhe ankorimit për operimin e asetit gjenerues termik, në portin e peshkimit Triport-Vlorë”;

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i shfuqizuar), neni 26, pika 5, Ligjin nr.

162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 77, pika 1, 87, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 45-84, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

9.1. Rekomandimi: Nga ana e KESH, të merren masa për vendosjen e kriterëve teknike ekonomike në përputhje me volumin dhe natyrën e kontratës dhe që favorizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit janë konstatuar mangësi në lidhje me procesin e vlerësimit të ofertave.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik sipas procedurës “Blerje furnizim 40000 litra vaj T-68, për kushinetat e katër hidroagregateve në HEC Fierzë”, rezulton se operatori ekonomik fitues, ka paraqitur mangësi në dokumentacionin e ofertës pasi raporti i testimit i realizuar pranë ISHTI është paraqitur me parametra të cilat nuk përputhen me ato të kërkuara në specifikimet teknike, katalogu dhe broshura e prodhuesit, të cilit i është marrë autorizimi, nuk përmbajnë vaj T-68, por vajra lubrifikantë të ndryshëm, përfshirë edhe vaj S-68, parametrat e të cilit nuk përputhen me ato të përcaktuara në specifikimet teknike. Në asnjë rast të përshkruar në kontratat e ngjashme, nuk rezulton tregtim vaji T-68, por vajra lubrifikantë për motorë,ambio automjesh, graso, antifrizë etj., të ngjashme me ato të paraqitura nga OE të skualifikuara. Kualifikimi i këtij operatori është bërë pa plotësuar kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit.

- Sipas procedurës “Ndërhyrje për mirëmbajtjen e sistemeve të CO₂ në HEC Fierzë dhe HEC Koman”, në tender ka marrë pjesë vetëm një operator ekonomik. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator, rezulton se në lidhje me kriterin “1 inxhinier elektrik të certifikuar për realizimin e interfejsit dhe integrimin me sistemin e shuarjes së CO₂”, ka paraqitur dokumentacionin për pjesëmarrje në trajnim me një cikël 40 orësh nga inxhinieri elektrik, por jo për certifikim të realizimit të këtyre sistemeve. Kualifikimi i këtij operatori është bërë pa plotësuar kriteret, megjithëse ky kriter ishte i pa argumentuar.

Kualifikimi i operatorëve ekonomikë pa plotësuar kriteret teknike, përveç shkeljeve ligjore, ndikon në realizimin e kontratës, pasi mungesa e eksperiencës nuk jep garanci për zbatim të suksesshëm të kontratës përkatëse.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 92, pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 45-85, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

10.1. Rekomandimi: Nga ana e KESH SHA të merren masa për angazhimin e punonjësve me eksperiencë në fushën e prokurimit publik, në mënyrë që procedurat të zhvillohen duke plotësuar kërkesat e ligjit dhe poarimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Kontrata “Furnizim – Instalim ekskavator special dhe greifer hidraulik në HEC Koman”, është amenduar tre herë, si më poshtë:

- Amendamenti nr. 4197/21 prot., datë 09.06.2021, nënshkruar nga Administratori i KESH SHA z. E. V, i cili ka të bëjë me shtesën e afatit të dorëzimit të mekanizmit konkretisht me dy muaj, duke shtyrë datën e dorëzimit për 09.08.2021. Shtesa e afatit është referuar në kërkesën e kontraktorit nr. 4197/20 prot., datë 09.06.2021, me argumentin: “Për shkak të shpalljes së gjendjes së pandemisë në shkallë botërore nga OBSH, fabrikë tek e cila është bërë porosia, nuk ka punuar me kapacitet të plotë dhe për disa kohë e ka ndërprerë prodhimin e këtyre mjeteve të punës”.

- Amendamenti nr. 4030/2 prot., datë 09.08.2021, nënshkruar nga Administratori i KESH SHA z. E. V, i cili ka të bëjë me shtesën e afatit të dorëzimit të mekanizmit për datë 15.09.2021. Shtesa e afatit është referuar në kërkesën e kontraktorit nr. 4030/20 prot., datë 29.07.2021, me argumentin: “Si pasojë e përmbajtjeve të ndodhura në Gjermani, fabrika në të

cilën është bërë porosia, ka patur vështirësi në transportimin e ekskavatorit special dhe grejderit hidraulik”.

- Amendamenti nr. 4559/1 prot., datë 15.09.2021, nënshkruar nga Administratori i KESH SHA z. E. V, i cili ka të bëjë me shtesën e afatit të dorëzimit të mekanizmit për datë 15.10.2021. Shtesa e afatit është referuar në kërkesën e kontraktorit nr. 4557 prot., datë 09.06.2021, me argumentin se fabrika italiane e cila po monton krahun e vinçit ka njoftuar se do të ketë përsëri vonesë për dorëzimin.

Bazuar në sa më sipër, kërkesa për shtyrje të afatit të dorëzimit është e pa mbështetur ligjërisht për arsye se:

- Prodhuesi ka kërkuar që afati i dorëzimit të bëhet me datë 05.09.2021 (bazuar në relacionin e amendamentit të parë), dhe vonesa përtej këtij afati nuk është e paparashikueshme.

- Në shtesën e dytë të afatit nuk përcaktohen vonesa për arsye të COVID 19, por përmbytje të ndodhura në Gjermani. Nuk argumentohet nëse përmbytjet e ndodhura atje, kanë ndikuar në transportin e mekanizmit.

- Në shtesën e tretë të afatit cilësohet se për arsye të COVID 19, është bërë reduktim i stafit dhe fabrika nuk punon në kapacitet të plotë. Reduktimi i stafit nuk përbën argument për të mos iu përgjigjur kontratave të nënshkruara. Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, krahu i ekskavatorit special si dhe disa aksesore të tjerë si bllokues, kundërpesha, greifer, ganxha dhe zinxhirë, janë marrë në dorëzim në Koman me datë 30.09.2021, ndërsa vetë ekskavatori është marrë në ruajtje në HEC Koman me datë 12.10.2021. Kontraktori duhet të kërkojë zbatimin e kontratës nga prodhuesi dhe të kërkojë dëmshpërblim për vonesat, veprim i cili duhet të kryhej edhe nga KESH, për mos plotësim të kërkesave kontraktore.

Sa më sipër, referuar datës së premtuar nga prodhuesi 05.09.2021 dhe datës së dërgimit në HEC Koman të Ekskavatorit 12.10.2021, zgjatja e afatit me 27 ditë është e pa argumentuar dhe jo në përputhje me nenin 22, pika 2 të kontratës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 45-85, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

11.1. Rekomandimi: Nga ana e KESH SHA të merren masa për monitorimin e vazhdueshëm e në mënyrë profesionale të kontratave të furnizimit, punimeve civile apo shërbimeve. Të shqyrtohen në mënyrë profesionale dhe në përputhje me termat e kontratave pretendimet e kontraktorëve, duke mbrojtur interesat e institucionit, si dhe shmangien e penalteteve të mundshme nga interpretime të gabuara.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Kontrata *"Furnizim instalim elemente bateri stacionare akumulatore acide, elemente 2VDC, 300Ah, për dy sallat 48V..., HEC Fierzë"*, është nënshkruar me nr. 3553/4 prot., datë 20.09.2021, me OE "A C" SHPK, me vlerë 17,280,000 lekë. Afati i dorëzimit është përcaktuar 6 muaj, referuar datës së nënshkrimit të kontratës. Nga ana e kontraktorit është bërë kërkesë për dorëzimin e furnizimit me shkresë nr. 3553/8 prot., datë 13.12.2021. Komisioni i kolaudimit është ngritur me Urdhër nr. 3553/7 prot., datë 13.10.2021, me përbërje z. P. V, z. R. Gj dhe z. P. M.

Atkolaudimi është mbajtur me datë 20.12.2021. Certifikata e marrjes në dorëzim është lëshuar me datë 20.12.2021, nga i njëjti komision. Në komision nuk është përfshirë punonjësi me përgjegjësi material.

Hyrja në magazinë është bërë në mënyrë të grupuar dhe jo sipas përcaktimeve në listën e materialeve të përcaktuara për furnizim. Kështu, nuk janë bërë hyrje elementët e baterive me numër, markë dhe elemente të tjera, nuk janë bërë hyrje bazamentet me numër, si dhe materialet e tjera. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"*, i ndryshuar, (Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara) pika 37 dhe 43.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 45-85, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

12.1. Rekomandimi: Nga ana e KESH, për furnizimet në të ardhmen, të merren masa për përfshirjen në komisionet e marrjes në dorëzim të punonjësit me përgjegjësi materiale, si dhe magazinimin sipas praktikave ligjore.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: KESH SHA ka nënshkruar Marrëveshjen nr. 15, datë 12.02.2015 “Për shkëmbimin/depozitimin e energjisë elektrike me Korporatën Energjetike të Kosovës”, e cila ka pësuar disa ndryshime sipas marrëveshjes së nënshkruar me nr. 3259 prot., datë 12.06.2018.

Nga verifikimi i sasive të energjisë elektrike të shkëmbyer për periudhën në auditim rezulton se në disa raste është marrë energji elektrike, ndërkohë që KESH realizon shitje të saj, për arsye të prurjeve të mëdha. Marrja e energjisë elektrike në periudha me prurje të mëdha shoqërohet me humbe nga ana e KESH, pasi çmimi i energjisë elektrike në bursa në periudha të tilla është i ulët. Veprimi i mësipërm nuk është në përputhje me marrëveshja e shkëmbimit të energjisë elektrike, neni 1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 88-99, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

13.1. Rekomandimi: KESH SHA të marrë masat e duhura duke negociuar me Kompaninë KEK, për shkëmbimin e energjisë elektrike në periudhat më të nevojshme dhe të dobishme për të dy kompanitë. Njoftimi për marrje apo dhënie të energjisë duhet të bëhet në periudhë mjaftueshmërisht në kohë, si dhe konfirmimet për këto transaksione duhet të bëhen po në kohën e duhur, për t’i dhënë mundësi të dy kompanive të bëjnë programimet e duhura.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: KESH sha, ka kryer vetëm deklaratën e tatimit fitimit për periudhën 2021 e 2022 brenda afatit. Pasqyrat financiare nuk janë hartuar dhe aprovuar nga Administratori, Këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të KESH sh.a. KESH sha nuk ka dorëzuar pasqyrat financiare sipas afatit në QKB. Asambleja e Ortakëve ka detyrimin për të aprovuar pasqyrat financiare të shoqërisë në afatin e caktuar nga ligji nr. 8483 datë 28.12.1998, i ndryshuar “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 33/1.

Mos depozitimet në Qendrën Kombëtare të Biznesit QKB, si dhe kryerjet jashtë afateve ligjore janë në kundërshtim me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, neni 43, Regjistrimet e tjera të detyrueshme dhe neni 46.

Vonesat në hartimin, aprovimin dhe depozitimin kanë pasoja në vlerësimin e gjendjes financiare të shoqërisë, vlerësimin e performancës ekonomike si dhe për vendim-marrjet e palëve të interesuara.

Qendra Kombëtare e Biznesit ka bllokuar njoftimet e shoqërisë KESH sha, në regjistrin e shoqërive. Si pasoje në ekstraktin e shoqërisë nuk pasqyrohen ndryshimet e bëra në statut, etj. Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me Ligjin nr.9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Neni 135, pika 3, Neni 154, pika 1, Neni 158, Neni 167, si dhe Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 11, 23. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 88-99, të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

14.1 Rekomandimi: Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të merren masa që në të ardhmen, pasqyrat financiare të hartohen, të depozitohen, të aprovohen brenda afateve ligjore, duke mundësuar vlerësimin e gjendjes financiare të shoqërisë, vlerësimin e performancës ekonomike lidhur me vendim-marrjet që duhet të marrin palët e interesuara, si asambleja e ortakëve, institute kredi dhënie etj.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i regjistrave të aktiveve të blera u konstatua se në emërtimet me të cilat regjistroheshin në kontabilitet, mungonin përshkrimet e aktiveve si marka, data e daljes në përdorim, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të

mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar e amortizimit, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar e shpenzimeve të mirëmbajtjes, data e daljes nga pronësia.

Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 30.

Mos regjistrimi i saktë dhe jo i plotë, vështirëson identifikimin në periudhat e mëpasshme për inventarizimet periodike.

Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj. Mos plotësimi i regjistrimit të aktiveve sjell risk i lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së shoqërisë, si humbje, vjedhje, shkatërime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 100-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

15.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë, dhe Nëpunësi Zbatues duhet të marrin masa për kryerjen e inventarizimeve vjetore të aktiveve fizike të shoqërisë, si dhe për plotësimin e regjistrimit të aktiveve që shoqëria zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: KESH sh.a. nuk ka kryer inventarizimin e plotë të aktiveve dhe vlerësimin e detyrimeve dhe të drejtave për periudhat 2021 e 2022 për verifikimin e ekzistencës fizike si dhe vlerësimin e gjendjes së tyre. Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj.

Këto veprime janë bërë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, i ndryshuar, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15, “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve” pika 1 dhe pika 74 e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 100-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

16.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë, dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për kryerjen e inventarizimit të plotë të aktiveve dhe vlerësimin e detyrimeve, të drejtave për periudhat, 2021 e 2022 duke kryer verifikimin e ekzistencës fizike si dhe vlerësimin e gjendjes së tyre, për të ulur riskun e zvogëlimit të aseteve të shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Në raportet e ecures së veprimtarisë së shoqërisë dhe dokumenteve shpjegues, mungonte deklarata e mirëadministrimit të shoqërisë, praktikat e ndjekura prej saj si dhe profili i administratorëve dhe anëtarëve të këshillave ku shpjegohen elementët dhe faktet që i kualifikojnë për kryerjen e detyrave të caktuara nga shoqëria. Mungesa e deklaratave, raporteve të ecures së veprimtarisë së shoqërisë zvogëlojnë transparencën e menaxhimit të shoqërisë.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me nenin 134, pika 2, të ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 100-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

17.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa për plotësimin e deklaratave të mirëadministrimit të shoqërisë, praktikat e ndjekura prej saj si dhe publikimin e profileve të administratorit dhe anëtarëve të këshillave ku shpjegohen elementët dhe faktet që i kualifikojnë për kryerjen e detyrave të caktuara nga shoqëria, për të rritur transparencën e menaxhimit të shoqërisë.

18. Gjetje nga auditimi: Në shënimet shpjeguese nga drejtimi i shoqërisë nuk janë paraqitur informacione sqaruese lidhur me vlerësimet dhe arsyet e përcaktimit të jetës së dobishme të AAM-ve, pra për normat e amortizimit të aplikuara në pasqyrat financiare të periudhës ushtrimore në kundërshtim me pikat 75 të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16, Aktivitet Afatgjatë Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje).

-Në lidhje me përlogaritjen e shpenzimeve të amortizimit, shoqëria përdor norma menaxheriale si dhe normat fiskale, duke paraqitur diferencën në shpenzimet e pazbritshme, të rezultatit të periudhës ushtrimore.

-Shoqëria nuk ka shqyrtuar në fund të periudhës ushtrimore vlerën e mbetur dhe jetën e dobishme të AAM-ve me vlera materiale të cilat ndikojnë në rezultatin e shoqërisë.

Duke mos përdorur norma menaxheriale të mire argumentuara nga specialistët përkatës dhe duke mos e përcaktuar me fleksibilitet jetëgjatësinë e aktiveve, duke vlerësuar dhe zhvillimin e teknologjisë, shoqëria rrezikon të mos kryej me sukses planifikimin në avancë për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me pikën 51 dhe 75, të SNK 16, si dhe me pikën 23, shkronja d, e Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, 100-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

18.1 Rekomandimi: Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të merren masa për vlerësimin e jetëgjatësisë së aktiveve, duke përdorur fleksibilitet dhe relacione të mirë argumentuara nga specialistët përkatës, për klasa specifike të aktiveve dhe jo të përgjithshme, për planifikimin në kohë të zëvendësimit të aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre.

19. Gjetje nga auditimi: Situata e llogarive të pagueshme është përkeqësuar gjatë periudhës 2022, duke u thelluar në vlerën 13,158,133,277 lekë, në zërin e furnitorëve për energji elektrike. Rritja e kësaj difference ka ardhur si pasojë e blerjeve për energji elektrike që KESH ka kryer në treg me çmimet e bursës dhe i’a ka shitur Furnizuesit të Shërbimit Universal me tarifat e miratuara nga ERRE, duke absorbuar diferencën e çmimit.

Në tetor të vitit 2021, me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 584, datë 08.10.2021, u shpall gjendja e emergjencës në furnizimin me energji elektrike. Këshilli i Ministrave nëpërmjet VKM nr.757 datë 09.12.2021, për ndryshimin e VKM Nr. 620/2021, ngarkoi KESH sh.a., me detyrimin për të furnizuar FSHU me të gjithë sasinë e nevojshme, për qëllime të plotësimit të kërkesës së plotë të saj.

Nëpërmjet shkresës Nr. 471 Prot, shoqëria KESH sh.a. i ka kërkuar MFE dhe MIE për nevojën për mbështetje buxhetore për veprimtarinë që kjo shoqëri po ushtron me qëllim përmbushjen e detyrimit për shërbim publik të ngarkuar. Kjo mbështetje e kërkuar është alokuar për shoqërinë nga ana e Ministrisë së financave dhe Ekonomisë nëpërmjet një Huaje Buxhetore në vlerën totale të rreth 68 Mln Euro, në muajin mars 2022. Ndërkohë për përmbushjen e detyrimit sipas VKM Nr. 620/2021 e ndryshuar, KESH sh.a. kishte filluar blerjen e energjisë që në muajin Janar 2022, pa ndryshuar çmimet e shitjes së energjisë në përmbushje të Detyrimit për shërbim publik.

Nëpërmjet Aktit Normativ Nr. 3, datë 12.03.2022, miratuar me Ligjin Nr. 31/2022, për sektorin e energjisë elektrike, konkretisht neni 3, pika 3, në buxhetin e vitit 2022 është shtuar “Fondi prej 20,000 milionë lekësh për mbështetjen e sektorit energjetik përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe ministrit përgjegjës për financat.”.

Shoqëria KESH sh.a. bazuar në rezultatet e periudhës dhe pritshmërinë e periudhës vijuese, me shkresë Nr. 2902 Prot., datë 15.06.2022, ka kërkuar më MFE mbështetje financiare. Nga ana e Këshillit të Ministrave me Vendim nr. 498/2022, u miratua mbështetje e sektorit

energjetik me vlerën 8 mld Lekë. Në vijim nga ana e Asamblesë së Aksionarit të KESH sh.a. u realizua nëpërmjet Vendimit Nr. 5875, datë 01.08.2022, zmadhimi i kapitalit në vlerën e 5 Mld Lekë, sipas VKM Nr. 498/2022, me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 603, datë 14.09.2022, u miratua mbështetje e dytë e sektorit energjetik, me vlerën 8 Mld lekë, me Vendimin nr. 7447, datë 05.10.2022, miratoi zmadhimin e kapitalit për shoqërinë në vlerën 8 Mld Lekë. Injektimi i fundit i mbështetjes për sektorin energjetik u realizua nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 875, datë 27.12.2022, në vlerën prej 4 Mld Lekë. Në vendimin nr. 5875 datë 01.08.2022, Asambleja e Ortakëve ka miratuar zmadhimin e kapitalit në vlerën 8,000,000,000 lekë, duke e rritur kapitalin themeltar të shoqërisë në vlerën 28,162,798,762 lekë. Me vendimin nr. 7447 datë 05.10.2022, Asambleja e Ortakëve ka miratuar zmadhimin e kapitalit në vlerën 8,000,000,000 lekë, duke e rritur kapitalin themeltar të shoqërisë në vlerën 36,162,798,762 lekë.

Me vendimin nr. 10254 datë 30.12.2022, Asambleja e Ortakëve ka miratuar zmadhimin e kapitalit në vlerën 8,000,000,000 lekë, duke e rritur kapitalin themeltar të shoqërisë në vlerën 40,162,798,762 lekë.

Veprimet e ndërmarra nga Këshilli i Ministrave duke zmadhuar kapitalin themeltar, janë kryer për të rritur stabilitetin financiar të shoqërisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 100-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

19.1 Rekomandimi:Strukturat drejtuese të shoqërisë duhet të marrin masa në përmirësimin e situatës debitore të shoqërisë duke rritur të ardhurat kryesore, mbledhjen e llogarive të pagueshme nga klientët, uljen e kostove, negocimin e kushteve më të mira me institucionet e kreditit si dhe shtimin e kapitalit të shoqërisë.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi:Më datë 27.05.2019, administratori i KESH sha, i përfaqësuar nga A. G ka lidhur kontratën me “V” sha, me nr. 1985/4 Prot., për një periudhë 2 vjeçare, duke marrë përsipër pagesën minimalisht të vlerës 256,200 lekë, ku përfshihen 74 numra me shërbim të telefonisë dhe internet dhe 50 numra për shërbimin e GPS.

Më datë 20.06.2019, administratori i shoqërisë B. B, ka nxjerrë urdhrin nr. 52, “Për pajisjen me numër telefoni celular të punonjësve të strukturave të KESH dhe pagesën e faturave tatimore të operatorit të telefonisë së kontraktuar”. Në listën e aprovuar përveç drejtuesve ka shefa sektori si dhe specialistë, që nuk justifikojnë mbulimin e shpenzimeve nga shoqëria.

Mos kryerja e procedurave të prokurimit zvogëlon ekonomikitetin e menaxhimit të fondeve të shoqërisë. Lidhja e kontratës është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, neni 4, “Fusha e zbatimit”, si dhe VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publik”, i ndryshuar,

Lidhja e kontratës së shërbimit është kryer pa zhvilluar procedura prokurimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 100-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

20.1 Rekomandimi:AK duhet të tregojë kujdesin e duhur për realizimin dhe menaxhimin e procedurave të prokurimit si dhe të marrë masa për trajnimin e punonjësve që kryejnë procedurat e prokurimit, duke ndikuar në rritjen e kapaciteteve të brendshme për menaxhimin e fondeve publike me efikasitet dhe ekonomikitet.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: -Nga verifikimi i pagesave të furnitorëve u konstatua se nga Departamenti Ekonomik dhe i Financës nuk është ngritur një sistem i monitorimit të afateve të skadencave të detyrimeve të pagueshme, për të garantuar pagesën e të gjithë kreditorëve në kohë si dhe për të dokumentuar që pagesat kryhen sipas skadencave kronologjike.

Mos monitorimi në kohë i detyrimeve të pagueshme rrit riskun për krijimin e penalteteve ndaj shoqërisë.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për

menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 100-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

21.1 Rekomandimi: Nga administratori i shoqërisë të merren masa për hartimin e një sistemi të monitorimit të afateve të skadencave të detyrimeve të pagueshme, për të garantuar pagesën e të gjithë kreditorëve në kohë. Ky sistem do të shërbej për uljen e riskut të shoqërisë për krijimin e penaliteteve për mos pagesa në afat.

Në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: -Në procesin e dokumentimit të shpenzimeve për karburant, u konstatua mungesa e ngritjes së sistemeve të kontrollit, ndarjes së përgjegjësi si dhe verifikimeve. Shpërndarja e sasive të karburantit kryhej me karta elektronike dhe sasitë e përshkuara verifikoheshin me sistemin GPS nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, por grupit të auditimit nuk iu vunë në dispozicion rregullore, urdhra të titullarëve, etj, në lidhje me organizimin e logjistikës së menaxhimit të mjeteve të shoqërisë, shpërndarjes së karburantit si dhe sistemeve të kontroleve dhe verifikimeve përkatëse. Mungesa e sistemeve të kontrollit rrit riskun e zvogëlimit të aktiveve të shoqërisë.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikat 35, 45 të Udhëzimit nr.30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 100-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

22.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për hartimin e rregullores së procedurave të menaxhimit të shpenzimeve për karburant, ngritjen e sistemeve të kontrollit, verifikimeve përkatëse dhe urdhrat e delegimit të përgjegjësi menaxheriale.

Në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me procedurat e prokurimit me vlerë të vogël në periudhën 2022, u konstatua se për shërbimin e vendosjes së linjave të fibrave optike është bërë copëzimi i fondit të kontraktuar. Më datë 27.05.2022 është hapur procedura për Fibrë Optike, HEC Vau i Dejës-Rragam, me vlerë 400,000 lekë pa tvsh dhe me datë 27.05.2022, procedurën për “Shërbimi i lidhjes backup Data të Kesh sh.a. me OST sha.” me vlerë 700,000 lekë pa tvsh. Në të dyja procedurat e mësipërme megjithëse emërimet e objektit të prokurimeve janë të ndryshëm në thelb kërkesa është e njëjtë, pra ofrimi i fijeve optike të pandërprera me të njëjtat specifikime teknike për lidhjen e serverëve.

Ndarja e fondit limit dhe përdorimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, ul ekonomikitetin, efektivitetin dhe eficiencën e menaxhimit të fondeve të shoqërisë.

Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021, pika 5 ku citohet: “Autoriteti kontraktor nuk është i detyruar të prokurojë njëherësh të gjithë sasinë e mallrave, shërbimeve apo punëve për plotësimin e nevojave të veta. Autoriteti kontraktor mund të realizojë disa procedura prokurimit me vlerë të vogël gjatë vitit kalendarik, në varësi të nevojave dhe mundësive të tij, por vlera e përllogaritur në total e këtyre procedurave për të njëjtin mall/shërbim/punë ose grup mallrash/shërbimesh/punësh, nuk duhet të jetë më e madhe se 1.000.000 lekë në vit.”

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 100-111, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

23.1 Rekomandimi: AK duhet të marrë masa për trajnimin e punonjësve që kryejnë procedurat e prokurimit, duke ndikuar në rritjen e kapaciteteve të brendshme. Komisioni i blerjeve me vlera të vogla në zhvillimin e procedurave duhet të vlerësojë pjesën thelbësore të shërbimit të kërkuar, për menaxhimin e fondeve publike me efikasitet dhe ekonomikitet.

Në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Administratori i KESH sha nuk ka dërguar informacion (Planin e Masave) mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së, brenda afatit 20 ditor.

Në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, nga KESH sha nuk është raportuar me shkrim për zbatimin e rekomandimeve të lëna, brenda 6 muajve nga dërgimi i shkresës së KLSH-së.

KESH sha nuk i ka trajtuar me korrektësi rekomandimet e lëna nga auditimi i KLSH dhe në lidhje me to ka zbatuar si më poshtë vijon:

-Janë rekomanduar 20 masa organizative, nga të cilat nuk janë zbatuar 9 masa, janë në proces realizimi 3 masa dhe 8 masa janë zbatuar.

-Janë rekomanduar 9 masa për shpërblim dëmi, në vlerën 63,223,634 lekë, nga të cilat 8 masa janë në proces zbatimi dhe 1 masa nuk është zbatuar,

-Janë rekomanduar 14 masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, nga të cilat janë në proces realizimi 10 masa, 2 masa janë zbatuar dhe 2 masa nuk janë zbatuar.

-Janë rekomanduar 4 masa të ardhura të munguara, 4 masa janë në proces realizimi.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-15, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

24.1. Rekomandimi: KESH sha, të marri masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara, si më poshtë:

-Masa organizative nr. 1.1, 2.1, 3.1, 4.1, 8.1, 10.1, 11.1, 12.1 dhe 13.1.

- Masa shpërblim dëmi nr. 8.1.

-Masa për eliminimin e efekteve negative nr. 12.1 dhe 13.1

Në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Marrja me qira për qëllim parkimi të automjeteve, e trullit me sipërfaqe 360 m² në oborrin përpara selisë qendrore të KESH sh.a, është bërë pa marrë aprovimin e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë, në kundërshtim me Statutine shoqërisë KESH SHA, Paragrafi VI, neni 11, pika 11.1.

Nga auditimi i procedurave të qirave për ambient për zyrë në qytetin e Shkodrës, me sipërfaqe 60 m², për instalimin e antenës telefonike “V” sh.a me sipërfaqe 20 m² dhe shërbimin ndaj punonjësve të HEC Fierzë të objektit “mensë” me sipërfaqe 79 m², rezulton se KESH SHA nuk ka ndjekur ndonjë procedurë të hapur apo me buletine në gazetë kombëtare apo mediat e shkruara, për ofrimin e ambienteve sa më të përshtatshme dhe me çmim konkurrues, por është nisur dhe ka vazhduar procedurat me propozimet e ardhura nga njësitë respektive sipas rretheve, më tej ka ndjekur një procedurë negocimi çmimi, sipërfaqeje, kushtet e duhura, etj.

-Sa i takon negocimit, grupit të auditimit nuk i janë vendosur në dispozicion dokumente justifikuese. Po ashtu nuk ka rezultuar dokumentacion lidhur me personat përgjegjës për mbikëqyrjen e kontratave të qerasë.

-Lidhja e kontratave të qerasë sa më sipër rezulton të jetë kryer në kundërshtim me:

1. Germën b), pika 1. kapitulli II i V.K.M nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” ku përcaktohet që:

1. Institucioni shtetëror, ndërmarrja apo shoqëria shtetërore, që ka në administrim objektin që do të jepet me qira ose enfiteozë, për të gjitha rastet, përgatit dokumentacionin si mëposhtë vijon:

b) vendimin e organit drejtues të institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore (Këshilli Mbikëqyrës, Këshilli Drejtues, Bordi Drejtuesetj.).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 86-87, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

25.1. Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i KESH SHA të marrin masat për miratimin paraprak të angazhimeve për krijimin e detyrimeve financiare me qëllim përdorimin ligjor, ekonomik, efikas, dhe efektiv të burimeve të veta, që jepen me qira si edhe objekteve private, të cilat merren me qira.

Në vijimësi

26. Gjetja nga auditimi: Në kontratën “*Punime për mbrojtjen e shpatullës së djathtë mes veprës së marrjes dhe kreshtës së digës në HEC Koman*” të lidhur midis Autoritetit Kontraktor KESH dhe Operatorit Ekonomik “S” sh.p.kme Nr.4100/8Prot. datë 17.03.2021, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion nuk konstatohen gjurmë që nga e sipërmarrësit dhe mbikëqyrësi të punimeve të jetë dorëzuar dosja teknike pas përfundimit të punimeve dhe më pas kryerjen e kolaudimit të punimeve. Gjithashtu konstatohet se kolaudimi i punimeve nuk është kryer dhe objekti nuk është marrë në dorëzim nga ana e investitorit. Pas kolaudimit të punimeve fillon dhe afati i garancisë së tyre sipas kushteve të përcaktuara në kontratë por moskryerja e kolaudimit mund të krijoj mosmarrëveshje me sipërmarrësin për afatin e garancisë së punimeve të përcaktuar në kontratë. Gjithashtu nuk gjenden gjurmë shkresore që mbikëqyrësi i punimeve dhe ndjekësi i kontratës si personi përgjegjës nga ana e AK të kenë kërkuar nga ana e tyre arsyet e mosparaqitjes të dosjes teknike nga ana e sipërmarrësit dhe kolaudimin e punimeve. Mos dorëzimi i dosjes teknike dhe kolaudimi i punimeve është në kundërshtim me nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2021 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, Kreu I, pika 15.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 45-85, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

26.1 Rekomandimi: KESH në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të kryej verifikimin e dokumentacionit teknik, volumet e punimeve si dhe gjendjen e investimit dhe të kryej kolaudimin duke shmangur mosmarrëveshjet me sipërmarrësin e punimeve që mund të dalin nga tejkalimi i afateve të tij.

Menjëherë

27. Gjetje nga auditimi: Shoqëria “A” SHPK, ka paraqitur shkresën nr. 4729 prot., datë 25.05.2023 “*Kthim përgjigje shkresës së KESH SHA nr. 2222 prot., datë 04.05.2023*”. Në këtë shkresë citohet se projekti i hartuar nga ana e tyre i është nënshtruar oponencës teknike, nga ku janë sqaruar edhe mospërputhjet e çmimeve të disa zërave të punimeve me manualet teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit, të përcaktuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH.

Pretendohet se nga tenderi i zhvilluar, oferta e shpallur fituese është me vlerë 21,066,523 lekë më e vogël se fondi limit, pasojë e të cilit eliminohet efekti i mundshëm nga përlllogaritja e gabuar e fondit limit.

Pavarësisht pretendimit të paraqitur se mospërputhjet për disa zëra të punimeve janë sqaruar në dokumentacionin e oponencës teknike, nga ana e grupit të auditimit u auditua dokumentacioni teknik në sistemin elektronik të prokurimeve, i cili u krahasua me përshkrimet në pretendimet e paraqitura, nga ku rezultoi se:

-Për zërin 3.338/An “*Gabion me rretë teli të zinkuar gurë kave “1 x 2 x 0.5 m”*”, analiza e çmimit është e argumentuar me rritjen përkatëse.

- Në lidhje me zërin 3.837/An “*Rrethimi i kishës me kolona b/a +rrjetë teli zinkato*”, analiza e çmimit është e argumentuar me rritjen përkatëse.

- Në lidhje me zërin 3.248/An “*Struktura monolite betoni me çakull C 30/37, për platin e ankorimit*”, në manual paraqitet çmimi 15,386 lekë/m³, ndërsa çmimi i aplikuar është 17,715 lekë/m³. Diferenca e trajtuar në fondin limit për këtë zë punimi është me vlerë 39,593 lekë. Rritja e çmimit argumentohet me faktin se në manual është parashikuar realizimi i betonit në objekt, ndërsa analiza e hartuar i përket realizimit të betonit në nyje betoni dhe çmimi i betonit 30/37 është nxjerrë si mesatare e dy klasave C 25/30 dhe C 37/45. Nga auditimi rezulton se nuk argumentohet nevoja për ndryshimin e teknologjisë së prodhimit të betonit. Konstatohet se diferenca e pa argumentuar në fondin limit të hartuar nga Projektuesi Shoqëria “A.4” SHPK, është 39,593 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 10, faqe 113-116, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

27.1. Rekomandimi: KESH SHA të marrë masa për shqyrtimin me korrektësi të dokumentacionit që paraqitet nga shoqëritë e kontraktuara për realizimin e projekt preventivave, si për sa i takon përllogaritjes së vlerës së preventivit, vlerë e cila aplikohet për përllogaritjen e fondit limit, ashtu dhe sa i takon, specifikimeve teknike, apo kriterëve të veçanta.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

1. Gjetje nga Auditimi: Në kontratën “*Punime për mbrojtjen e shpatullës së djathtë mes veprës së marrjes dhe kreshtës së digës në HEC Koman*” të lidhur midis Autoritetit Kontraktor KESH dhe Operatorit Ekonomik “S” sh.p.k me Nr.4100/8Prot. datë 17.03.2021 në projekt-preventiv është parashikuar një platformë e cila do të bëjë të mundur pritjen e materialeve duke shmangur mbushjen e basenit gjatë kryerjes së punimeve të kësaj kontrate dhe në të ardhmen. Referuar detajeve të projektit kjo platformë në sipërfaqen e saj duhet të mbulohet me binarë druri 10x10 për amortizimin e goditjeve. Nga vizita në terren, konstatohet se në një pjesë të saj kjo platformë nuk është e mbuluar me binarët e drurit. Gjithashtu platforma nuk është e ankoruar në afërsi të skarpatit për të kryer funksionin e saj pas përfundimit të projektit. Në preventivin fillestar dhe në ofertën e paraqitur nga kontraktori vlera e platformës është lump sum dhe nuk është e detajuar për çdo pjesë përbërëse të saj sipas detajeve të projektit. Vlera totale e saj është 20,000,000 lekë pa TVSH. Nisur nga fakti që platforma nuk është realizuar sipas specifikimeve të kërkuara dhe nga dokumentacioni i paraqitur nuk mund të vlerësohet vlera e detajeve të pa realizuara, e kështu vlera e saj prej 20,000,000 lekë pa TVSH konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe të shoqërisë deri në këtë fazë të auditimit. Bazuar në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontratën e shërbimit Nr.2753/4Prot. datë 23.06.2021 me objekt: “*Mbikëqyrje e punimeve për mbrojtjen e shpatullës së djathtë mes veprës së marrjes dhe kreshtës së digës në HEC Koman*”, Neni 7 “*Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit*”.(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 45-85, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

1.1 Rekomandimi:KESH në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marri masa, për plotësimin e platformës pluskuese me pjesët përbërëse sipas projektit, konkretisht binarët e drurit. Në rast se plotësimi i saj nuk realizohet vlera prej 20,000,000 lekë pa TVSH të konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe të arkëtohet, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, nga OE “S” sh.p.k sipas kontratës së lidhur me Nr.4100/8Prot. datë 17.03.2021për realizimin e punimeve civile.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Fondi limit sipas procedurës “*Mbrojtja e kullave të ekuilibrit nga çarja e shkëmbinjve mbi to dhe sistemimi i rrëshqitjes së koluvioneve mbi rrugën e digës HEC Koman*”, është përllogaritur me vlerë 369,639,401 lekë. Fondi për këtë investim është akorduar sipas shkresës së drejtorisë ekonomike pranë KESH, nr. 1462/2 prot., datë 02.03.2021. Për përllogaritjen e fondit limit, janë aplikuar ku ka qenë e mundur çmimet e manualeve, për zëra të tjerë është aplikuar studimi i tregut.

Nga verifikimi çmimit të ofertës së paraqitur nga BOE “S& S” SHPK, rezulton se pajisjet me vlerë 5,356,510 lekë, megjithëse zë i ndarë, janë përfshirë në përllogaritjen e vlerës së kontratës me TVSH. Vlera e kontratës me TVSH është përcaktuar në shumën 395,748,714 lekë, ndërkohë që duhet të llogaritej me vlerë 394,677,412 lekë. Vlera e TVSH e përcaktuar më tepër është me vlerë 1,071,302 lekë. Preventivi i përfshirë në tender është përcaktuar me këtë strukturë, e cila është ndjekur nga ana e ofertuesve.

Bazuar në Situacionin Përfundimtar të Punimeve, vlera e TVSH likuiduar kontraktorit është 65,958,119 lekë, ndërkohë që duhet të ishte 64,886,817 Lekë. Vlera 1,071,302 lekë (65,958,119 lekë - 64,886,817 lekë), konsiderohet si shpenzim i pa justifikuar, për të cilin kërkohen rregullimet përkatëse, para pagesë së garancisë së objektit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika A “Shpenzimet për materialet”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 45-85, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

2.1. Rekomandimi: KESH SHA të marrë masa për rrillogaritjen e vlerës së TVSH dhe zbritjen e vlerës **1,071,302 lekë**, për kontratën “Mbrotjtja e kullave të ekuilibrit nga çarja e shkëmbinjve mbi to dhe sistemimi i rrëshqitjes së koluvioneve mbi rrugën e digës HEC Koman”, përlllogaritur më tepër, si pasojë e mos klasifikimit të pajisjeve pa TVSH.

Brenda periudhës së garancisë së kontratës.

3. Gjetje nga Auditimi: Në objektin “Punime për mbrotjtjen e shpatullës së djathtë mes veprës së marrjes dhe kreshtës së digës në HEC Koman” sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Kontraktor KESH dhe Operatorit Ekonomik “S” sh.pme Nr.4100/8Prot. datë 17.03.2021 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 629,617,663.81 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 5 muaj nga data dorëzimit të sheshit të ndërtimit, dhe zgjatje afati me Amendim Kontrate Nr.1 me Nr.313/1Prot. datë 20.01.2022, Amendim Kontrate Nr.2, Nr.139/7Prot. datë 21.04.2022 dhe shkresës Nr.139/34Prot. datë 17.06.2022 ka miratuar zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve deri më datë 15.10.2022, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe vizitës në terren të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH në prezencë të përfaqësuesit të mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave dhe vizatimet sipas faktit volume pune të pakryera, për 3 (tre) zëra punimesh në shumën 410,158 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe shoqërisë. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontratën e shërbimit Nr.2753/4Prot. datë 23.06.2021 me objekt: “Mbikëqyrje e punimeve për mbrotjtjen e shpatullës së djathtë mes veprës së marrjes dhe kreshtës së digës në HEC Koman”, Neni 7 “Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 45-85, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

3.1 Rekomandimi: KESH të marri masa duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, për arkëtimin e shumës 410,158 Lekë pa TVSH, nga OE “S” sh.p.k për zëra punimesh të pa kryera sipas kontratës së lidhur me Nr.4100/8Prot. datë 17.03.2021 “Punime për mbrotjtjen e shpatullës së djathtë mes veprës së marrjes dhe kreshtës së digës në HEC Koman” vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Menjëherë

4. Gjetje nga Auditimi Në objektin “Rehabilitimi i ndërtesës së centralit në HEC Koman” sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Kontraktor KESH dhe Operatorit Ekonomik “C” sh.pme Nr.1258/8 Prot. datë 28.05.2021 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 143,194,853 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 6 muaj nga data dorëzimit të sheshit të ndërtimit, dhe zgjatje afati me Amendim Kontrate nr.1, Nr.634/5Prot. datë 25.02.2022, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe vizitës në terren të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH në prezencë të përfaqësuesit të mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të pa kryera në fakt për 2 (dy) zëra punimesh në shumën 268,113 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe shoqërisë. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë

10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3;- Kontratën e shërbimit Nr.3257/3Prot. datë 02.07.2021. me objekt: “Mbikëqyrje e punimeve për rehabilitimin e ndërtesës së centralit HEC Koman”,Neni 7 “Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 45-85, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

4.1 Rekomandimi:KESH të marri masa duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyimit, për arkëtimin e shumës 268,113 Lekë pa TVSH, nga OE “C” sh.p.k për zëra punimesh të pa kryera sipas kontratës së lidhur me Nr.1258/8 Prot. datë 28.05.2021 “Rehabilitimi i ndërtesës së centralit në HEC Koman” vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi.Nga verifikimi i disa zërave të punimeve në objekt, sipas kontratës “Mbrojtjen e kullave të ekuilibrit nga çarja e shkëmbinjve mbi to. Mbrojtja dhe sistemimi nga rrëshqitja e koluvioneve në HEC Koman”, u konstatua se sipas zërit “Masa mbrojtëse inxhinierike-Zona B”, “Muret gabion” është certifikuar sasina 210 m³, ndërsa sipas faktit në terren rezulton e realizuar sasina 147.5 m³. Sasina 52.5 m³ është certifikuar më tepër. **Vlera 231,000 lekë** (52.5 m³ x 4,400 lekë/m³), është përfituar padrejtësisht nga BOE “S& S” dhe përbën dëm ekonomik. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 45-85, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

5.1. Rekomandimi: KESH SHA, të nxjerrë aktet administrative përkatëse dhe të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit **231,000 lekë**, nga BOE “S& S”, për punime të certifikuara, por të pa realizuara.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi:KESH SHA ka shkëmbyer energji elektrike me Kompaninë “N E” SHPK, sipas marrëveshjes së nënshkruar me nr. 2350/1 ptot., datë 04.05.2021.Deri me datë 31.12.2022, gjendja e shkëmbimit të energjisë elektrike paraqitet në dhënie sasina 149442 MWh, ndërsa në marrje sasina 132002 MWh, me një diferencë në shumën 17440 MWh. Për vitin 2022, nga Shoqëria “N E”, është marrë sasina 2546 MWh, nga e cila sasina 2398 MWh është marrë me datë 01.04.2022. Brenda kësaj dite, sasina më e madhe e energjisë në shumën 2278 MWh, është marrë në periudhë jo piku, ku çmimi i energjisë në bursë është shumë i ulët.

Bazuar në të dhënat në dispozicion, KESH SHA për vitin 2022, ka blerë energji elektrike në sasinë 1,460,437 MWh, me çmim mesatar nga 209.6 Euro/MWh deri në 482.2 Euro/MWh. Diferenca në sasinë 17440 MWh, duhet të merrej gjatë kësaj periudhe ku çmimi në bursë rezulton i lartë. Referuar bursës HUPX për vitin 2022, për të njëjtin profil, çmimi mesatar i tregtimit të energjisë elektrike ishte 271.6 Euro/MWh.

Referuar çmimit mesatar të blerjes së energjisë elektrike dhe çmimit të bursës për vitin 2022 (për profile të ngjashme), si pasojë e mos marrjes së energjisë elektrike të rezervuar pranë Kompanisë “N E” SHPK për këtë vit, KESH SHA rezulton me humbje me vlerë **2,774,536**

Euro $[(271.6 \text{ MWh} - 115.2 \text{ MWh}) \times 17740 \text{ MWh}]$, **vlerë e cila konsiderohet efekt financiar.** Nga ana e KESH SHA duhet të merreshin masa për tërheqjen e energjisë elektrike në periudhën kur çmimi në bursa është i lartë, për të shmangur shpenzimet e larta për blerje të saj.

Energjia elektrike në sasinë 17440 MWh, është tërhequr në periudhën janar-korrik 2023 respektivisht në muajin janar 2009 MWh, në mars 2311 MWh, prill 3129 MWh, maj 3827 MWh, qershor 3893 dhe korrik 2271 MWh. Bazuar në çmimin e bursës për vitin 2023 (janar-ntor), marrja e energjisë elektrike të rezervuar e thellon më tej bilancin negativ, pasi çmimi në bursa ka ardhur në rënie. Bazuar në të dhënat e faqes elektronike të KESH, nga data 01.01.2023 deri me datë 15.07.2023, nga ana e KESH është shitur energji elektrike si dhe ka patur kërkesa për rezervim, por në asnjë rast blerje. Marrja e energjisë së rezervuar në periudhën kur shitet energji elektrike dhe mos marrja e sasisë së rezervuar në periudhë kur blihet me çmime të larta përbën keq menaxhim të procesit të optimizimit të energjisë elektrike. Shkëmbi i energjisë elektrike jo në profile të njëjta, ndikon në jo optimizimin e saj, duke mos marrë përfitime optimale nga të tilla operacione. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 5233/1 prot., datë 12.06.2019 dhe Këshillit Mbikëqyrës nr. 12 prot., datë 20.10.2022, neni 4, pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 88-99, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

1.1. Rekomandimi: KESH SHA, për kontrata shkëmbi të energjisë elektrike në të ardhmen, të marrë masa për përcaktimin e detajuar të shkëmbimit, duke vendosur marrjen dhe dhënien në profile të njëjta dhe në fasha orare të njëjta.

Për të mbrojtur interesat e ndërsjella, në këto kontrata duhet përcaktuar edhe referenca e çmimit në bursa, në mënyrë që ndikimi i luhatjes së çmimit mos të ketë ndikim negativ, referuar periudhave në të cilat realizohet shkëmbimi.

Në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës për shërbime riparimi të automjeteve të shoqërisë rezultoi se KESH ka bërë pagesa ndaj Operatorit Ekonomik, “A” sh.p.k. Këto pagesa janë mbështetur në marrëdhënien kontraktore të lidhur mes palëve më datë 12.11.2018, marrëveshje kuadër me objekt “*Riparimin e automjeteve*” të KESH sh.a. për një periudhë 3 vjeçare me vlerë 161,138,520 lekë me Tvsh. Pas përfundimit të periudhës 3 vjeçare KESH sh.a., kontrata është amenduar për pjesën e mbetur të vlerës së kontratës. Në procesin e dokumentimit të shpenzimeve për riparime automjeteve u konstatuan parregullsi. Nga nëpunësi zbatues nuk janë zbatuar veprimet që duhet të kryejnë strukturat e nëpunësit zbatues. Në procedurat e pagesave mungonin dokumentet justifikues të marrjes në dorëzim si proces verbalet e firmosura nga komisioni, certifikatat për origjinalitetin dhe cilësinë e pjesëve që ishin ndërruar.

Në kontratën mes palëve është rënë dakord vetëm për një përfaqësues të KESH sh.a. për të nënshkruar aktin e verifikimit të kryerjes së riparimit dhe shërbimit.

Pra dokumentacioni vërtetues që vërteton kryerjen e veprimeve ekonomike, që në këtë marrëveshje kuadër është akti i verifikimit të riparimit të pjesëve të këmbimit të automjeteve, i nënshkruar nga një përfaqësues i KESH sh.a., dhe jo nga komisioni përkatës, pa pasur dokumente të tjera për të vërtetuar se pjesët e zëvendësuara plotësojnë kushtet teknike të kërkuara në procedurë, si emri i kompanisë prodhuese të paraqitur në ofertën e OE, emërtimi i katalogut, numri i pjesës së këmbimit në skemën origjinal të katalogut si dhe kodi origjinal i pjesës së këmbimit, elementë vërtetues që pjesët e këmbimit janë origjinale sipas ofertës.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 12, 16 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar dhe me pikën 52, të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, i ndryshuar, “*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*”,

Deri më datë 31.12.2022, shoqëria “A” sh.p.k., i ka faturuar KESH sh.a., vlerën 156,544,680 lekë për riparime dhe shërbime të automjeteve vlerë e cila e cila konsiderohet pa efektivitet.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 35-44, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

2.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë KESH sh.a., nëpërmjet strukturave

përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të zbatimit të kontratave për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin pa efektivitet, të fondeve publike. Administratori i shoqërisë të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjëseve administrative, si për hartimin e procedurave dhe kontrolleve që verifikojnë shpenzimet e kryera për automjete.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të listë pagesave për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022 rezultoi se; me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. Nr. 68, datë 7.02.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfutur në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, pika 2, germa a), kjo dietë është caktuar deri në masën 300 lekë në vakt/ditë pune. Nga ana e Administratorit të Shoqërisë, Drejtorisë Juridike, Drejtorisë së Burimeve njerëzore nuk janë marrë masat për reflektimin e ndryshimeve ligjorë për caktimin e dietës ushqimorë në përputhje me legjislacionin e sipërpërmendur, dhe paga në natyrë (dieta) për trajtim ushqimor është paguar në masën 500 lekë vakt/ditë pune. Ky fenomen është konstatuar edhe nga auditimet e mëparshme të KLSH për të cilin janë dhënë rekomandimet përkatëse të cilat përsëri konstatohet se nuk janë bërë reflektimet e duhura për përditësimin e legjislacionit dhe ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive. Nga llogaritja e listëpagesave të periudhës 01.01.2021 - 31.12.2022 rezulton se ky përfitim është në masën 170,018,888 lekë, nga 102,011,333 lekë që duhej të ishte pra është paguar më tepër shuma prej **68,007,555 lekë cila konsiderohet si shpenzim pa ekonomicitet** për buxhetin e shoqërisë.

Sa më sipër bie në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. Nr. 68, datë 7.2.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfutur në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, pika 2, germa a).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-34, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

3.1. Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të marrin masat e duhura, për azhurnimin e legjislacionit, dhe të ndiqen procedurat administrative për personat përgjegjës, bazuar në Kodin e Punës dhe Rregulloren e brendshme të Shoqërisë. Administratori i Shoqërisë, Departamenti Ligjor të marrin masat e duhura dhe të kryejnë ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive, duke nxjerrë aktet përkatës për mos vazhdimin e dietës ushqimore më tepër nga përcaktimet ligjore.

Deri me 31.03.2024

4. Gjetje nga auditimi: Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të KESH SHA nr. 6 prot, datë 26.02.2021 “Për dhënien e shpërblimit për disa punonjës të KESH SHA, pas periudhës të gatishmërisë dhjetor 2020 – shkurt 2021”, është miratuar dhënia e shpërblimit në masën 50,000 (pesëdhjetë mijë) Lekë, për disa punonjës të KESH SHA, në strukturat, si më poshtë:

- punonjës të Departamentit të Gjenerimit,

- punonjës të Drejtorisë së Operacioneve Tregtare.

Duke qenë se shoqëria nuk ka një analizë të realizimit të objektivave, vlera **3,300,000 lekë**, e akorduar për këtë shpërblim, konsiderohet **shpenzim pa ekonomicitet** për buxhetin e shoqërisë.

-Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të KESH SHA nr. 6295 prot, datë 29.12.2021 “Për dhënien e një shpërblimi të veçantë mbi pagë në fund të vitit për punonjësit e KESH SHA”, janë dhënë shpërblime me vlerën 61,402 mijë lekë.

Duke qenë se shoqëria nuk ka një analizë të realizimit të objektivave, vlera **61,402,000 lekë** konsiderohet **si shpenzim pa ekonomicitet** për buxhetin e shoqërisë.

Sa më sipër bie në kundërshtim me nenin 32 të Kontratës Kolektive “Për një kategori të caktuar punonjësish, Administratori mund të japë shpërblime shtesë (deri në dy paga mujore në vit) në përputhje me realizimin e objektivave të ngarkuara”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-34, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

4.1. Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të analizojnë situatën dhe të marrin masa lidhur me dhënien e shpërblimeve konform rezultateve financiare të shoqërisë.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Me vendimin nr. 13, datë 01.07.2021, të Këshillit Mbikëqyrës, është vendosur për miratimin e krijimit të fondit të pensionit profesional për punonjësit e KESH sh.a.

Për vitin 2021 janë transferuar 5,780,802 lekë dhe për vitin 2022 janë transferuar 15,378,310 lekë për këtë fond.

Aprovimi i këtij fondi që është një formë shpërblimi për punonjësit rezulton në kundërshtim me Ligjin nr.10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr.10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6 “Kompetencat e organeve kolegjiale”, pika 1/a.

Vlera **5,780,802 lekë** për periudhën 2021 dhe vlera **15,378,310 lekë** përbëjnë efekt ekonomik negativ për shoqërinë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-34, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

5.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të KESH sh.a. të analizojnë vlerën 21,159,112 lekë, e cila përbën efekt financiar negativ dhe në të ardhmen nga shoqëria të akordohet dhënia e shpërblimeve me miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se lidhur me proceset gjyqësorë në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 81 çështje gjyqësorë në apel, nga ku janë humbur 3 çështje gjyqësorë në Gjykatat e Shkallës të Lartë dhe në Gjykatat e Apelit, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën 2,375,484 lekë si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbartimore. Për periudhën objekt auditimi, janë në proces gjykimi 7 çështje gjyqësorë në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, në vlerën 1,810,437 lekë si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbartimore. Në total, vlera **4,185,921 lekë**, konsiderohet si shpenzim pa ekonomicitet për buxhetin e shoqërisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 30-34, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

6.1.Rekomandimi: Nga Administratori, Departamenti Juridik dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore të shoqërisë të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të shkëputjes të marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me përdorimin e fondit rezervë, sipas kontratës “Ndërhyrje për mirëmbajtjen e sistemeve të CO₂ në HEC Fierzë dhe HEC Koman”, mbikëqyrësi i punimeve me shkresë nr. 11.646-310-1D, datë 31.03.2023, ka vënë në dijeni kontraktorin se, ndër të tjera, duke qenë se tipi i kontratës është me çelësa në dorë, projekti i detajuar teknik bashkë me preventivin i hartuar nga kontraktori, duhet të ketë marrë aprovimin e KESH, më parë, pra duhet një preventiv i ndryshuar dhe i miratuar zyrtarisht, në mënyrë që ne të japim autorizimin për përdorimin e fondit rezervë sipas kontratës.

Shoqëria projektuese “G C” SHPK, në një dokument pa numër dhe pa datë, ka dhënë sqarime në lidhje me ndryshimin e kërkuar. Sipas projektuesit, arsyeja kryesore që lidhet me këtë ndryshim është në pikëpamjen e sigurisë së funksionimit të sistemit. Nisur nga parimi i funksionimit duhet që pasi të ketë mbaruar fikja e zjarrit në dhomën e gjeneratorit, të fillojë

procesi i largimit të CO₂ dhe vetëm pasi të jetë pastruar dhoma e gjeneratorit nga pastrimi i CO₂ do të duhet të fillojë procesi i furnizimit me ajër të freskët. Pra puna e aspiratorit dhe e ventilatorit duhet të jenë të shfazuara në kohë. Në rast se ventilatori i ajrit të freskët do të vendoset në funksionim përpara aspiratorit të largimit të CO₂ në dhomën e gjeneratorit do të krijohet një presion manometrik dhe rritet probabiliteti që CO₂ të dalë në ambientet e sallës së makinerive duke rrezikuar shëndetin e punonjësve. Duke ditur që manovrimi i ventilatorit apo aspiratorit do të realizohet nga personeli në kushtet e emergjencës duke vendosur një panel komandimi të përbashkët ekziston rreziku që personeli të ngatërrojë radhën e komandimit të tyre. Për këtë arsye rekomandohet që panelet e komandimit të jenë të ndara. Amendamenti nr. 2, është miratuar nga titullari i KESH me nr. 1726/5 prot., datë 16.05.2023, duke miratuar edhe ndryshimin e numrit të paneleve nga 4 në 8 copë.

Vlera e fondit rezervë në shumën **2,750,000 lekë** konsiderohet si shpenzim pa efektivitet, pasi procesi i komandimit mund të realizohej edhe me 4 panele siç ishte parashikuar. Nuk ka një analizë sipas të cilës të identifikohet nevoja e shpenzimit për vendosjen e paneleve, apo trajnimi i punonjësve që angazhohen në procesin e komandimit në raste të rënies së zjarrit.

Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 39, pika 1.b.i.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 45-85, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

7.1. Rekomandimi: Nga ana e KESH SHA, për kontrata me çelësa në dorë, të merren masa për pranimin e preventivëve, pa përfshirë fond rezervë, pasi nga vetë lloji i këtyre kontratave, punimet duhet të realizohen brenda vlerës së parashikuar dhe projektit të miratuar.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Për përllogaritjen e fondit limit sipas kontratës “Rinovim i sistemit të mbrojtjes për dy agregatë me vendosje konfigurim të releve të reja që zëvendësojnë ato ekzistuese REG, RET në HEC Fierzë”, është aplikuar studimi i tregut duke i'u dërguar kërkesë për ofertë 3 OE që operojnë në këtë fushë. Fondi limit është përcaktuar me vlerën më të ulët të ofruar në shumën 75,000,000 lekë. Në ofertat e paraqitura nga studimi i tregut, konstatohet se OE kanë paraqitur vlerë shumë të lartë për zërin “Trajnim i plotë 3 ditor për konfigurimin e releve të reja, back-up e fileve dhe testet, sipas specifikimeve”, konkretisht 8,200,000 lekë, 7,840,000 lekë dhe 7,840,000 lekë. Vlerat e mësipërme kanë ndikuar negativisht në rritjen e fondit limit, për një proces i cili dukshëm nuk kërkon shpenzime në nivele të tilla. Theksojmë se, në ofertën e paraqitur në tenderin e mëparshëm të ngjashëm, për këtë zë është parashikuar vlera 300,000 lekë.

Nga ana e komisionit nuk është marrë në konsideratë kontrata e ngjashme e realizuar në vitin 2020 “Rinovim i sistemit të mbrojtjes për dy agregate me vendosje/konfigurim të releve të reja që zëvendësojnë ato ekzistueset REG/RET, në Vaun e Dejës”. Në preventivin e tenderit, krahasuar me tenderin e mëparshëm, janë shtuar vetëm dy zëra, ofertat për të cilat janë paraqitur si më poshtë:

- Testim i karakteristikave voltampere (kurbat e faturimit) të transformatorëve ekzistues të rrymës së neurit, të terminaleve 13.8 kV dhe zbarave 13.8 kV për funksionin 78G dhe funksionin 87 (B) për Ag.1 dhe Ag.3 (oferta mesatare 350,000 lekë/copë)

- Demontimi i releve ekzistuese, konfigurimi dhe testimi i funksionit të releve të reja, instalimi dhe rilidhja në skemë e releve të reja, testimi për të dy sistemet e mbrojtjes Ag.1 dhe Ag.3 (oferta mesatare 260,000 lekë/copë). Duke marrë në konsideratë çmimet e kontratës së mëparshme të ngjashme të realizuar si dhe për dy zërat e mësipërm, nga përllogaritjet rezulton se fondi limit duhet të ishte me vlerë 72,440,000 lekë. Sa më sipër, rezulton se fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 2,560,000 lekë (75,000,000 – 72,440,000). Duke marrë në konsideratë vlerën e ofertës së paraqitur në shumën 73,500,000 lekë, **diferenca me vlerë 1,120,000 lekë**, konsiderohet si shpenzim pa ekonomikitet për buxhetin e shoqërisë. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 76, pika 1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 45-85, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

8.1. Rekomandimi: Nga ana e Njësisë të Prokurimit apo strukturave që ngarkohen në përllogaritjen e fondit limit të merren masa për shqyrtimin e gjithë alternativave, duke përcaktuar vlerën e fondit limit sa më reale.

Në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Bazuar e në referim të nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe kontratës individuale të punës, neni 13, Pika 13.3.a, i kërkojmë Administratorit të KESH SHA fillimin e procedurave për dhënie masë disiplinore, si më poshtë:

“Vërejtje me shkrim”, për:

1. z. I. Sh, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit (specialist i fushës), për arsye se:

- Sipas Procedurës së Prokurimit: “Rehabilitimi i ndërtesës së centralit HEC Koman”, janë hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me madhësinë dhe llojin e punimeve, si për disponim licence, staf teknik ashtu dhe makineri, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i shfuqizuar), neni 26, pika 5.
- Në preventivin e punimeve sipas kontratës “Mbrojtja e kullave të ekuilibrit nga çarja e shkëmbinjve mbi to dhe sistemimi i rrëshqitjes së kolvioneve mbi rrugën e digës HEC Koman”, nuk janë ndarë nga tatimi i TVSH pajisje makineri, nga ku ka rezultuar përllogaritje e gabuar e tatimit mbi vlerën e shtuar me vlerë 1,071,302 lekë, në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika A “Shpenzimet për materialet”.

2. z. Dh. T në cilësinë e punonjësit të ngarkuar me ndjekjen e kontratës, si dhe të anëtarit të njësisë së prokurimit, për arsye se:

- Sipas kontratës “Furnizim – Instalim ekskavator special dhe greifer hidraulik në HEC Koman”, nuk janë argumentuar në mënyrën e duhur shtesat në afatin e dorëzimit të mekanizmit.

Sipas Kontratës “Ndërhyrje për mirëmbajtjen e sistemeve të CO₂ në HEC Fierzë dhe HEC Koman”, në situacionin përfundimtar të punimeve është përfshirë fondi rezervë, megjithëse kemi të bëjmë me kontratë me çelësa në dorë, duke bërë shpenzime pa efektivitet me vlerë 2,750,000 lekë.

- Sipas Procedurës së Prokurimit: “F.V i sistemit të thithjes dhe largimit të gazrave pas shuarjes së zjarrit CO₂ në gjeneratorët e aggregateve dhe hermetizim të dhomave të gjeneratorëve në HEC Fierzë dhe Koman”, kanë vendosur kritere të cilat nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit, sa i takon stafit teknik, në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 77, pika 1.

3. znj. E. M, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për arsye se:

Sipas Procedurës së Prokurimit: “F.V i sistemit të thithjes dhe largimit të gazrave pas shuarjes së zjarrit CO₂ në gjeneratorët e aggregateve dhe hermetizim të dhomave të gjeneratorëve në HEC Fierzë dhe Koman”, ka vendosur kritere të cilat nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit, sa i takon stafit teknik, në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 77, pika 1.

4. znj. E. M

5. z. B. K, në cilësinë e anëtarëve të grupit të përllogaritjes së fondit limit, për arsye se:

Sipas Procedurës së Prokurimit: “Rinovim i sistemit të mbrojtjes për dy aggregate me vendosje konfigurim të releve të reja që zëvendësojnë ato ekzistuese REG, RET në HEC Fierzë”, nuk kanë dokumentuar në mënyrë të plotë përllogaritjen e fondit limit, si dhe nuk kanë marrë në konsideratë kontratat e ngjashme të realizuara nga autoriteti kontraktor, në kundërshtim me

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 76, pika 1.

Znj. E. M, sipas Procedurës së Prokurimit: “Rinovim i sistemit të mbrojtjes për dy agregate me vendosje konfigurim të releve të reja që zëvendësojnë ato ekzistuese REG, RET në HEC Fierzë”, ka vendosur kriteret për disponim licence për punime të cilat nuk kanë lidhje me objektin e kontratës, në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 77, pika 1.

6. z. F. Z,

7. z. B. M

8. z. F. H, në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit, për arsye se:

Sipas Procedurës së Prokurimit: “Blerje mjet lundrues për pastrimin e biefit të sipërm nga akumulimet e materialeve dhe mbetjeve urbane për Hec Fierzë”, kanë vendosur specifikime teknike (dimensione fikse), pa diapazone, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 2.

z. B. M, në cilësinë e anëtarit të KVO, sipas Procedurës së Prokurimit: “Blerje furnizim 40000 litra vaj T-68, për kushinetat e katër hidroagregateve në HEC Fierzë” ka kualifikuar një operator edhe pse nuk plotëson kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, veprim në kundërshtim me Ligjin 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 92, pika 3.

D.1. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për z. A. H, z. Gj. B, znj. F. K dhe z. R. P, masa disiplinore konsiderohet e ezauruar, pasi kanë ndërprerë marrëdhëniet punës me këtë institucion.

Shënim:

Për punonjësit znj. A. M, znj. A. K, z. T. D, znj. Y. N, z. I. H, z. F. Z, z. L. M, znj. K. H, z. M. Sh, z. E. D, z. A. N, z. A. H dhe znj. D. T, mendojmë të mos propozojmë masë disiplinore, pasi mangësitë e konstatuara për këto punonjës nuk janë të përhapura dhe materiale.

Për mbikëqyrësit e punimeve Shoqëritë “NG” SHPK dhe “I C” SHPK, mendojmë të mos propozojmë masa administrative, pasi mangësitë e konstatuara nuk janë të përhapura dhe materiale.

SHËNIM:

Në zbatim të VKM nr. 620, datë 22.10.2021, “Për miratimin e kushteve, për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike dhe për përballimin e parandalimin e saj”, ndryshuar me VKM nr. 757, datë 09.12.2021, Kreu IV, Pika 1, Par 2, KESH SHA ka realizuar procedurën dhe ka nënshkruar kontratën për marrjen me qira të asetit gjenerues termik. Kontrata përkatëse e qirasë (Bareboat), ndërmjet KESH SHA dhe bashkimit të kompanive “Ax” LLC dhe “Re” S.P.A, është nënshkruar me nr. 1660/1 prot., datë 04.04.2022. Kjo kontratë është amenduar me nr. 1660/7 prot., datë 07.04.2022. Për zhvillimin e procedurës, nënshkrimin e kontratës dhe amendimin e saj, janë dhënë miratimet përkatëse nga asambleja e aksionarit. Deklarata mjedisore është lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit me nr. AN13072022006, datë 22.08.2022. Leja e mjedisit Tipi A, është dhënë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me nr. 1665 prot., datë 03.03.2023.

Bazuar në raportet progresive të punimeve për vënien në gatishmëri, asetet termike (anijet gjenerator) kanë arritur në vend dhe janë dorëzuar me datë 11.09.2022. Deri me datë 17.11.2023, që përkon me mbylljen e auditimit në terren, asetet gjeneruese nuk janë vënë në funksion.

Duke u nisur nga vlera e konsiderueshme financiare, faktin se asetet nuk janë vënë akoma në funksion, sensibiliteti i lartë mediatik, si dhe të përfshirjes së disa aktorëve në proces, me

qëllim realizimin e një auditimi të plotë dhe gjithëpërfshirës, KLSH do të auditojë në një auditim të veçantë procesin e marrjes me qira të aseteve termike duke përfshirë përveç KESH SHA edhe institucionet të tjera të cilat kanë marrë pjesë në këtë proces, si për sa i takon vendimmarrjes, miratimeve, ashtu dhe të dhënies së lejeve apo licencave përkatëse.

V. ANEKSE

Aneksi 1.

Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lena në auditimin e mëparshëm.

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë KESH SHA, të analizojë situatën e mos zbatimit të plotë të Rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të marrë masa për zbatimin e të gjitha masave e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre, *respektivisht:*

a-Për 6 masa organizative;

b-Për 4 masë shpërblim dëmi në vlerën 1,306,500 mijë lekë.

c- Për masat disiplinore për punonjësit e trajtuar në material.

Menjëherë

Komenti i subjektit: Menaxhimi i shoqërisë merr përsipër zbatimin e rekomandimit në përputhje me planin e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, për veprimet për realizimin e rekomandimeve të lena nga KLSH.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Deri në momentin e mbajtjes së akt konstatimit nuk është paraqitur asnjë dokumentacion justifikues mbi realizimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

2.1. Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA, të merren masa që në të ardhmen procesi i hartimit të programit ekonomik financiar të të ardhurave dhe shpenzimeve të pritshme, të kryhen të bazuara në metoda ekonomike, në relacione të detajuara dhe të verifikueshme, rritjen e shpenzimeve ta argumentojë me dokumente justifikues duke mbajtur përgjegjësi për informacionin e dhënë. Drejtimi i shoqërisë të kryejë analiza të mëtijshme për mos realizimin e objektivave, dhe nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Menaxhimi i shoqërisë do të hartojë një manual për hartimin e programit ekonomik financiar të shoqërisë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Deri në momentin e mbajtjes së akt konstatimit nuk është paraqitur asnjë dokumentacion justifikues mbi realizimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

3.1 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA, të merren masa që në të ardhmen, të analizojë shkaqet dhe arsyet e mos realizimit të investimeve të planifikuara për mirëmbajtjen e pajisjeve, makinerive, zgjerimin, modernizimin dhe riparimin e objekteve energjetike dhe rrjetit të pajisjeve përkatëse.

Në të ardhmen, procesi i investimeve të shikohet me përparësi si një premisë kryesore për realizimin e objektivave kryesorë të shoqërisë për periudhat e ardhshme.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Shoqëria merr përsipër që si pjesë e raporti vjetor të veprimtarisë për organet drejtuese të realizojë edhe një seksion të analizës së kërkuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Deri në momentin e mbajtjes së akt konstatimit nuk është paraqitur asnjë dokumentacion justifikues mbi realizimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Prokurimeve KESH SHA (njësia e prokurimit me vlerë të vogël), të marrë masa, për:

-Inventarizim dhe arkivimin e të gjitha dosjet të prokurimit të përfunduara për periudhën 2018 – 2020, si dhe për procedurat në vijimësi.

-Pavarësisht faktit nëse do të prokurohen apo jo, të bëjë planifikimin e të gjitha objekteve të prokurimit dhe vlerat përkatëse, duke i pasqyruar ato në regjistrin e parashikimeve dhe realizimeve të procedurave të prokurimit publik.

-Të gjitha rastet e parashikuara, si procedure prokurimi “blerje shkresore” nën 100,000 lekë, duhet të mbajnë procesverbal për vërtetimin e situatës emergjente apo domosdoshmërisë së kryerjes së shpenzimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Shoqëria merr përsipër realizimin e rekomandimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Deri në momentin e mbajtjes së akt konstatimit nuk është paraqitur asnjë dokumentacion justifikues mbi realizimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

5.1.Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA, të merren masa:

-Që në të ardhmen, procesi i pagimit të orëve të punës jashtë orarit, të kryhet vetëm në rastet kur është verifikuar dhe argumentuar, si dhe të shikohet mundësia e kompensimit me ditë pushimi, për një përdorim me efektiv të fondeve të KESH SHA.

- Për miratimin e formularit TIP të hartuar nga institucioni, duke bashkëlidhë në mënyrë kronologjike të gjithë dokumentacionin autorizues dhe vërtetues mbi kryerjen e punës jashtë orarit nga punonjësit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Orët jashtë orari jepen sipas një procedure të konsoliduar e cila përfshin propozimin, evidentimin, miratimin dhe dokumentimin e tyre.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion rekomandimi është zbatuar.

Rekomandimi është zbatuar

6.1.Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA, të merren masa që:

-Në të ardhmen procesi i planifikimit të burimeve njerëzore të kryhet me përgjegjësi, për të siguruar një përshtatje eficiente, cilësore dhe sasiore të burimeve njerëzore të nevojshme për realizimin e objektivave të miratuara.

- Në të ardhmen procesi i rekrutimit të brendshëm i burimeve njerëzore me qëllim, motivimin e punonjësve që kanë performancë të mirë brenda korporatës, si dhe marrjen e masave për dokumentimin e procesit të përzgjedhjes së kandidatëve të punësuar rishtas për të siguruar transparencë në menaxhimin e burimeve njerëzore.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Në zbatim të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 25.11.2019 për miratimin e dokumentit për politikat e burimeve njerëzore të shoqërisë KESH sha në fillim të vitit 2022 është përpiluar nga DBNJ dhe miratuar nga Administratortri dokumenti i planifikimit të burimeve njerëzore për vitin 2022 i cili lejon një përshtatje efikase e të vazhdueshme.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion rekomandimi është zbatuar.

Rekomandimi është zbatuar

7.1. Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA, të merren masa për rishikimin e rregullores së tregtimit të energjisë elektrike, duke rikthyer sanksionet për subjektet të cilat nuk zbatojnë rregullat e përcaktuara. Të përcaktohet kritere duke ndjekur parimin bli lirë dhe shit shtrenjtë. Për rritjen e transparencës, duhet të përcaktohen saktë rregullat për ngritjen e komisioneve të tregtimit dhe strukturave përkatëse që duhet të përfshihen në këto komisione.

Brenda muajt Maj 2022

Komenti i subjektit: Rishikuar rregullorja dhe miratuar me ndryshime nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr. 12.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

Rekomandimi është zbatuar

8.1. Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA, të merren masa për realizimin e një studimi bazuar në rezultatet e tregtimit të energjisë elektrike në vite, si për rastet e zhvilluara duke marrë për referencë bursën e energjisë, ashtu edhe për rastet e kërkesës për ofertë me çmime fikse, duke përzgjedhur kërkesën për ofertë e cila është më me leverdi, për zhvillimin sa më optimal të tregtimit të energjisë elektrike.

Brenda muajit Maj 2022

Komenti i subjektit: Shoqëria merr përsipër realizimin e studimit bazuar edhe në nevojat e shoqërisë për studimin e tregut.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Deri në momentin e mbajtjes së akt konstatimit nuk është paraqitur asnjë dokumentacion justifikues mbi realizimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

9.1. Rekomandimi: KESH SHA të bëjë përpjekjet e duhura për zbatimin e marrëveshjes së shkëmbimit të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë përfitimet e të dy palëve, duke kërkuar të njëjtën gjë edhe nga pala tjetër, me synim përballimin e problematikave dhe optimizimin e shkëmbimit të energjisë elektrike, për të dy kompanitë.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Shoqëria merr përsipër zbatimin e rekomandimit si dhe vlerëson se nga muaji Janar i vitit 2022 ka rivënë në zbatim rregullisht këtë marrëdhënie me shoqërinë KEK.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces

10.1. Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA, të merren masa për zhvillimin e procedurave të tregtimit të energjisë elektrike vetëm për qëllime optimizimi, duke shmangur kontrata të shkëmbimit të energjisë elektrike të cilat deformojnë rregullat e tregut.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Shoqëria në kontekstin e ri rregullator të tregut të energjisë vlerëson që për periudhën nga muaji Janar 2022 dhe atë vijuese do të vijojë të realizojë procedura të tregtimit të energjisë kryesisht në blerje për shkak të detyrimit për shërbimin publik si dhe do të aplikojë transaksione optimizimi.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Deri në momentin e mbajtjes së akt konstatimit nuk është paraqitur asnjë dokumentacion justifikues mbi realizimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

11.1. Rekomandimi: KESH SHA, në rastet e nënshkrimit të marrëveshjeve të cilat dalin të nevojshme për shkëmbimin e energjisë elektrike, të marrë në konsideratë parimet dhe rregullat për mos prishjen e tregut, duke respektuar edhe parimin e leverdishmërisë ekonomike dhe energjetike.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Shoqëria merr përsipër realizimin e rekomandimit. Rekomandimi do të zbatohet në frymën e parashikimeve të akteve rregullatorë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Deri në momentin e mbajtjes së akt konstatimit nuk është paraqitur asnjë dokumentacion justifikues mbi realizimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

12.1 Rekomandimi: KESH SHA, të analizojë dhe të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive për vonesat në hartimin dhe miratimin e Pasqyrave Financiare brenda afateve ligjore, me qëllim raportimin pa vonesa mbi ecurinë e veprimtarisë dhe raportin e auditimit për tu dhënë

mundësinë Drejtuesve të KESH SHA, ku nëpërmjet një analize gjithëpërfshirëse, të informohen për zhvillimin dhe performancën e njësisë ekonomike, shoqëruar me një përshkrim të risqeve dhe pasigurive kryesore, me të cilat KESH SHA mund të përballlet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Shoqëria merr përsipër realizimin e rekomandimit dhe do të ngrejë një grup pune për evidentimin e shkaqeve të cilat do të prezantohen në Këshillin Mbikëqyrës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Deri në momentin e mbajtjes së akt konstatimit nuk është paraqitur asnjë dokumentacion justifikues mbi realizimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

12.1 Rekomandimi: KESH SHA të marrë masat e duhura për rishikimin e pozicionit të strukturës të koordinatorit të riskut me qëllim rritjen e përgjegjësisë në zbatimin, kontrollin, rishikimin dhe raportimin e sistemeve të risqeve që kërcënojnë shoqërinë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Është ndryshuar pozicionin në strukturën organizative të sektorit të menaxhimit të riskut. Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 18, datë 09.12.2022.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi është zbatuar.

Rekomandimi është zbatuar

13.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i KESH SHA të marrin masat për miratimin paraprak të angazhimeve për krijimin e detyrimeve financiare me qëllim përdorimin ligjor, ekonomik, efikas, dhe efektiv të burimeve të veta, që jepen me qira si edhe objekteve private, të cilat merren me qira.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Shoqëria merr përsipër realizimin e rekomandimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Deri në momentin e mbajtjes së akt konstatimit nuk është paraqitur asnjë dokumentacion justifikues mbi realizimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

13.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë KESH SHA, të negociojë me subjektin privat z. G. A, si pronar i ligjshëm i pasurisë 3/237, ZK 8270, Volumi 38, Faqe 53, Truall me sipërfaqe 360 m², të marrë me qira për parkimin e mjeteve të administratës së KESH SHA, për blerjen dhe kalimin në pronësi të kësaj sipërfaqe sipas çmimeve të tregut të miratuara në dispozitat përkatëse ligjore, me qëllim uljen e shpenzimeve financiare të përvitshme, vlerë e cila ndryshon nga njëra periudhë në tjetrën sipas pretendimeve të subjektit, si dhe krijimin e mundësive për kryerjen e investimeve sipas nevojave të vetë shoqërisë KESH SHA.

Brenda muajt Qershor 2022

Komenti i subjektit: Shoqëria merr përsipër realizimin e rekomandimit për blerjen e pasurisë së paluajtshme bazuar në pozicionin financiar të shoqërisë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Deri në momentin e mbajtjes së akt konstatimit nuk është paraqitur asnjë dokumentacion justifikues mbi realizimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi është i pazbatuar

14.1 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA, të merren masa që, gjatë marrjes ofertave për përcaktimin e fondit limit, përzgjedhja e OE të kryhet në raport të drejtë me objektin e prokurimit, specifikave, natyrë dhe nevojat e investimit, me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet dhe sigurimin e një konkurrence efektive gjatë procesit të prokurimit.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Shoqëria merr përsipër realizimin e rekomandimit me sa me shumë efikasitet në procedurat e ardhshme.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi do të konsiderohet në proces.

Rekomandimi është në proces

15.1 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA, të merren masa që, për çdo procedurë prokurimi, pjesë e dosjes të jetë edhe kërkesa për këtë shërbim, kjo e nevojshme për argumentimin e domosdoshmërisë së kryerjes së shpenzimit pasi në të kundërt nuk identifikohet nevoja konkrete.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Në fazën e parashikimit të shpenzimit në PEF si dhe kërkesën e argumentuar nga secili departament të kërkuar për kryerjen e prokurimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

Rekomandimi është zbatuar

16.1 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA, të merren masa që, gjatë marrjes ofertave për përcaktimin e fondit limit, përzgjedhja e OE të kryhet në raport të drejtë me objektin e prokurimit dhe specifikave dhe natyrë së tij, me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Shoqëria merr përsipër realizimin e rekomandimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces

17.1 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA, të merren masa që, për çdo procedurë prokurimi, pjesë e dosjes të jetë edhe kërkesa për këtë shërbim, kjo e nevojshme për argumentimin e domosdoshmërinë së kryerjes së kësaj procedure prokurimi pasi në të kundërt nuk identifikohet nevoja konkrete e kryerjes së kësaj praktike.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Në fazën e parashikimit të shpenzimit në PEF si dhe kërkesën e argumentuar nga secili departament të kërkuar për kryerjen e prokurimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

Rekomandimi është zbatuar

18.1 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA, të merren masa për kryerjen e pagesave paraprake ndaj OE vetëm nëse ky kusht është parashikuar Kushtet për zbatimin e kontratës. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës të lidhur me OE nuk duhet të ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit.

Menjëherë dhe vazhdimësi

Komenti i subjektit: KESH sha ka marrë masat e nevojshme për realizimin e rekomandimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

Rekomandimi është zbatuar

19.1 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA të merren masa në të ardhmen për argumentimin e plotë teknik të ndryshimeve në preventiv si dhe respektimin e kuadrit përkatës ligjor e rregullator, konkretisht marrjes së opionencës teknike në rastet e ndryshimeve thelbësore të projektit të zbatimit me qëllim garantimin e rezistencës dhe qëndrueshmërisë mekanike dhe sigurisë në përdorim.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: KESH sha ka marrë masat e nevojshme për realizimin e rekomandimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

Rekomandimi është zbatuar

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga auditimi i veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) sh.a të periudhës së aktivitetit 01.07.2018 – 31.12.2020, kanë rezultuar shkelje të kuadrit ligjor dhe rregullator me pasojë **dëm ekonomik për buxhetin e KESH SHA, në vlerën gjithsej 63,223,634 lekë**, si më poshtë:

1.1 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA të merren masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e vlerës **4,744,743 lekë pa TVSH**, ndaj sipërmarrësit “A S” ShPK për punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 3957/5 prot., datë 19.10.2018 me objekt *‘Punime mbrojtëse tek krahu i majtë i kanalit të daljes nga ndërtesa e centralit deri tek ura si dhe veshja me beton e faqeve anësore të kanalit në HEC KOMAN’*.

Brenda datës 30.06.2022

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ana e Administratorit të KESH sh.a z. E. V me shkresën nr. 2218 prot., datë 04.05.2023, me lëndë “Mbi pagesën e detyrimeve që rezultojnë nga masat e rekomanduara në Raportin e Auditimit KLSH” bërë njoftimi i operatorit ekonomik “A S” sh.p.k mbi masën e zhdëmtimit në vlerën 4,744,743 lekë pa TVSH, për punime të pakryera. Me shkresën nr. 2218/1 prot., datë 19.05.2023 me lëndë “Kërkesë për informacion në lidhje me subjektin Alb Star sh.p.k”, Drejtoria Juridike i kërkon informacion Drejtorisë Ekonomike. Me shkresën nr. 2218/2 prot., datë 23.05.2023 Drejtoria Ekonomike kthen përgjigje ku informon se nga ana e operatorit ekonomik nuk është kryer asnjë pagesë. Është iniciuar procesi gjyqësor përmes kërkesë padisë me nr. 3789 prot., datë 27.07.2023, duke kërkuar nga pala e paditur “A S” shpk kthimin e shumës në vlerën 4,744,743 lekë.

Rekomandimi konsiderohet në proces

2.1 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA të merren masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e vlerës **5,292,925lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit “S.” ShPK, për punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 4036/5 prot., datë 04.10.2018 me objekt *‘Evadimi i materialeve të ngurta në zonën poshtë urës deri tek bashkimi me lumin e Valbonës në HEC Fierzë’*.

Brenda datës 30.06.2022

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ana e Administratorit të KESH sh.a z. E. V me shkresën nr. 2226 prot., datë 04.05.2023, me lëndë “Mbi pagesën e detyrimeve që rezultojnë nga masat e rekomanduara në Raportin e Auditimit KLSH” bërë njoftimi i operatorit ekonomik “S.” sh.p.k mbi masën e zhdëmtimit në vlerën 5,292,925 lekë pa TVSH. Me shkresën nr. 2226/1 prot., datë 18.05.2023 me lëndë “Kërkesë për informacion në lidhje me subjektin S.M.O sh.p.k”, Drejtoria Juridike i kërkon iformacion Drejtorisë Ekonomike. Me shkresën nr. 2226/2 prot., datë 19.05.2023 Drejtoria Ekonomike kthen përgjigje ku informon se nga ana e operatorit ekonomik nuk është kryer asnjë pagesë. Është iniciuar procesi gjyqësor përmes kërkesë padisë me nr. 3614 prot., datë 17.07.2023, duke kërkuar nga pala e paditur “S.” kthimin e shumës në vlerën 5,292,925 lekë.

Rekomandimi konsiderohet në proces

3.1 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA të merren masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **21,487,373lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit “GJ K”, si dëm ekonomik i shkaktuar buxhetit të KESH SHA prej ndryshimeve të projektit në kundërshtim me kuadrin përkatës teknik e ligjor të përshkruar më sipër si dhe punimeve të pakryera por të likuiduara në fakt në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 5480/6 prot., datë 18.01.2019 me objekt “Mbrotja e shpatit të malit mbi daljet e tuneleve të shkarkimit nr. 3 dhe nr. 4 HEC Fierzë”.

Brenda datës 30.06.2022

3.2. Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA, ndryshimet e projekteve të shoqërohen me analiza të detajuara tekniko – ekonomike mbi vlerësimin e efektshmërisë së këtyre ndryshimeve si dhe me marrjen e oponencës teknike në institucionin përkatës, kjo me qëllim shmangien e praktikave abuzive me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të KESH SHA.

Në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ana e Administratorit të KESH sh.a z. E. V me shkresën nr. 2224 prot., datë 04.05.2023, me lëndë “Mbi pagesën e detyrimeve që rezultojnë nga masat e rekomanduara në Raportin e Auditimit KLSH” bërë njoftimi i operatorit ekonomik “GJ K” sh.a mbi masën e zhdëmtimit në vlerën 21,487,373 lekë pa TVSH. Me shkresën nr. 2224/2 prot., datë 18.05.2023 me lëndë “Kërkesë për informacion në lidhje me subjektin “GJ K”, Drejtoria Juridike i kërkon informacion Drejtorisë Ekonomike. Me shkresën nr. 2224/3 prot., datë 19.05.2023 Drejtoria Ekonomike kthen përgjigje ku informon se nga ana e operatorit ekonomik nuk është kryer asnjë pagesë. Është iniciuar procesi gjyqësor përmes kërkesë padisë me nr. 3615 prot., datë 17.07.2023, duke kërkuar nga pala e paditur “Gj K” sh.a kthimin e shumës në vlerën 21,487,373 lekë.

Rekomandimi konsiderohet në proces

4.1 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA të merren masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **1,296,000lekë** ndaj sipërmarrësit “VS” ShPK si penalitet për vonesa në realizimin e kontratës së sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 2410/6 prot., datë 28.10.2019 me objekt “Auditimi i mjedisit, sigurisë dhe shëndetit në punë 3 Njësitë Prodhuese nën Administrimin e KESH”.

Brenda datës 30.06.2022

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ana e Administratorit të KESH sh.a z. E. V me shkresën nr. 2220 prot., datë 04.05.2023, me lëndë “Mbi pagesën e detyrimeve që rezultojnë nga masat e rekomanduara në Raportin e Auditimit KLSH” bërë njoftimi i operatorit ekonomik “V S” sh.p.k mbi masën e zhdëmtimit në vlerën 1,296,000 lekë pa TVSH. Me shkresën nr. 2220/1 prot., datë 19.05.2023 me lëndë “Kërkesë për informacion në lidhje me subjektin V. S.”, Drejtoria Juridike i kërkon informacion Drejtorisë Ekonomike. Me shkresën nr. 2220/2 prot., datë 23.05.2023 Drejtoria Ekonomike kthen përgjigje ku informon se nga ana e operatorit ekonomik nuk është kryer asnjë pagesë. Është iniciuar procesi gjyqësor përmes kërkesë padisë me nr. 3786 prot., datë 27.07.2023, duke kërkuar nga pala e paditur “V S” kthimin e shumës në vlerën 1,296,000 lekë.

Rekomandimi konsiderohet në proces

5.1 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHAtë merren masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **1,363,175lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit “S.” ShPK për

punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 4127/7 prot., datë 21.08.2018 me objekt “Mbroytja e anës së majtë të Biefit të sipërm të digës së Fierzës dhe ndërtimi i vendparkimit të mjeteve lundruese në HEC Fierzë”.

Brenda datës 30.06.2022

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ana e Administratorit të KESH sh.a z. E. V me shkresën nr. 2219 prot., datë 04.05.2023, me lëndë “Mbi pagesën e detyrimeve që rezultojnë nga masat e rekomanduara në Raportin e Auditimit KLSH” bërë njoftimi i operatorit ekonomik “S.” sh.p.k mbi masën e zhdëmtimit në vlerën 1,363,175 lekë pa TVSH, për punime të pakryera. Me shkresën nr. 2219/1 prot., datë 19.05.2023 me lëndë “Kërkesë për informacion në lidhje me subjektin “S.” sh.p.k, Drejtoria Juridike i kërkon informacion Drejtorisë Ekonomike. Me shkresën nr. 2219/2 prot., datë 23.05.2023 Drejtoria Ekonomike kthen përgjigje ku informon se nga ana e operatorit ekonomik nuk është kryer asnjë pagesë. Operatori Ekonomik “S.” sh.p.k me shkresën nr. 606 prot., datë 23.05.2023, protokolluar në KESH sh.a me nr. 2219/3 prot., datë 24.05.2023, ka kërkuar dokumentacionin e plotë mbi rekomandimin e lënë nga KLSH. Është iniciuar procesi gjyqësor përmes kërkesë padisë me nr. 3930 prot., datë 02.08.2023, duke kërkuar nga pala e paditur “S.” kthimin e shumës në vlerën 1,363,175 lekë.

Rekomandimi konsiderohet në proces

6.1 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA të merren masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **2,483,500lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit bashkimi i OE “B”“ & 2T & Z” ShPK për punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 3374/7 prot., datë 29.01.2021 me objekt “Rehabilitimi i rrugës së Aksesit për tek kullat e ekuilibrit në HEC Koman”.

Brenda datës 30.06.2022

6.2 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA, ti kërkohet mbikëqyrësit dhe sipërmarrësit të punimeve azhurnimi i dokumentacionit teknik në lidhje me zërin *Mbrojtja e shpateve nga rënia e gurëve me rrjete teli heksagonal 6x8 dhe diameter 2.4 mm te veshur me galfan (Zn-5%Al) me bordaturë anësore Ø 3.4 mm*” dhe në vijim, të ngrihet një grup pune me qëllim verifikimin e saktësisë së volumit të pasqyruar në librezën e masave me atë të situacionuar e të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor. Në rast të konstatimit të diferencave në volume pune të pakryera, nga ana e AK të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës koresponduese të volumeve të kryera me diferencë në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 3374/7 prot., datë 29.01.2021 me objekt ‘Rehabilitimi i rrugës së Aksesit për tek kullat e ekuilibrit në HEC Koman’.

Menjëherë

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ana e Administratorit të KESH sh.a z. E. V me shkresën nr. 2217 prot., datë 04.05.2023, me lëndë “Mbi pagesën e detyrimeve që rezultojnë nga masat e rekomanduara në Raportin e Auditimit KLSH” bërë njoftimi i operatorit ekonomik “B”“ & 2T & Z” sh.p.k mbi masën e zhdëmtimit në vlerën 2,483,500 lekë pa TVSH, për punime të pakryera. Operatori Ekonomik “B”“ & 2T & Z” sh.p.k me shkresën nr. 56 prot., datë 09.05.2023, protokolluar në KESH sh.a me nr. 2217/1 prot., datë 12.05.2023, ka kërkuar dokumentacionin e plotë mbi rekomandimin e lënë nga KLSH dhe nuk pranon vlerën e konsideruar dëm ekonomik nga KLSH. Është iniciuar procesi gjyqësor përmes kërkesë padisë me nr. 3931 prot., datë 02.08.2023, duke kërkuar nga pala e paditur “B” “& 2T dhe Z” shpk kthimin e shumës në vlerën 2,483,500 lekë.

7.1 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA, të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej **3,615,789** lekë pa TVSh, e cila ka rritur fondin limit të kontratave, pasi nga projektuesit e hartimit të fondit limit të kontratës zërat e preventivit nuk janë hartuar referuar manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, të rishikuara, që do të përdoren në përcaktimin e fondit limit të objekteve në ndërtim, sipas tabelave që i bashkëlidhen VKM nr. 629, datë 15.07.2015 i ndryshuar, *respektivisht*:

- **Vlera 1,997,730 lekë**, nga shoqëria “F C” ShPK për hartimin e fondit limit të kontratës me objekt “Mbrotja e shpatit të malit mbi daljet e tuneleve të shkarkimit nr. 3 dhe nr. 4 në HEC Fierzë”.

- **Vlera 1,206,190 lekë**, nga shoqëria “A” ShPK për hartimin e fondit limit të kontratës me objekt “Punime mbrojtëse tek krahu i majtë i kanalit të daljes nga ndërtesa e centralit deri tek ura si dhe veshja me beton e faqeve anësore të kanalit në HEC Koman”.

- **Vlera 117,003 lekë**, nga shoqëria “E” ShPK për hartimin e fondit limit të kontratës me objekt “Evadimi i materialeve të ngurta në zonën poshtë urës së Drinit deri te bashkimi i tij me Lumin e Valbonës në HEC Fierzë”.

- **Vlera 294,866 lekë**, nga shoqëria “Z & Co” ShPK për hartimin e fondit limit të kontratës me objekt “Mbrotja e anës së majtë të Biefit të sipërm të digës së Fierzës dhe ndërtimi i vendparkimit të mjeteve lundruese në HEC Fierzë”.

Menjëherë

Komenti i subjektit: Shoqëria merr përsipër realizimin e rekomandimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me vlerën 1,206,190 lekë, në ngarkim të Shoqërisë “A. 4” SHPK, trajtimi i ankesës së këtij subjekti është trajtuar në pikën 10.

Është iniciuar procesi gjyqësor përmes kërkesë padisë me nr. 3617 prot., datë 17.07.2023, duke kërkuar nga pala e paditur “A” shpk kthimin e shumës në vlerën 1,296,000 lekë.

Është iniciuar procesi gjyqësor përmes kërkesë padisë me nr. 3618 prot., datë 17.07.2023, duke kërkuar nga pala e paditur “E” shpk kthimin e shumës në vlerën 117,003 lekë.

Është iniciuar procesi gjyqësor përmes kërkesë padisë me nr. 3619 prot., datë 17.07.2023, duke kërkuar nga pala e paditur “F C” shpk kthimin e shumës në vlerën 1,997,730 lekë.

Është iniciuar procesi gjyqësor përmes kërkesë padisë me nr. 3616 prot., datë 17.07.2023, duke kërkuar nga pala e paditur “Z & Co” shpk kthimin e shumës në vlerën 294,866 lekë.

Rekomandimi konsiderohet në proces

8.1.Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA të merren të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit të vlerën **22,940,129 lekë**, ndajë të gjithë punonjësve të cilat kanë përfituar kompensimin ushqimorë gjatë periudhës së lejeve vjetore.

Brenda datës 30.07.2022

Komenti i subjektit: Shoqëria vlerëson se kërkitimi i kthimit të kësaj vlere përbën një veprim në mospërputhje të parashikimeve të VKM nr. 68/2018.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi do konsiderohet i pazbatuar.

Rekomandimi është i pazbatuar

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA, të merren masa për përcaktimin dhe saktësimin e personave përgjegjës në llogaritjen e fondit limit në procedurën me objekt: “Furnizim instalim 5 (pesë) copë çelësa 3 polar u – 245 kv me gaz sf6 për zëvendësimin e

çelësive të blloqeve gjenerator - transformator, 4 në HEC Koman dhe 1 (një) në HEC Fierzë”, me qëllim arritjen e objektivave të kontratave të prokuruar, si dhe shmangien e efekteve negative në shumën prej **61,436,885 lekë pa TVSh**, për mos ezaurimin e të gjitha hapësirave ligjore në përcaktimin e fondit limit në mungesë të manualeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Shoqëria merr përsipër realizimin e rekomandimit duke reflektuar në ngritje të grupeve për llogaritje fondi me eksperte dhe specialist të fushave përkatëse.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar dokumentacionit justifikues rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

Rekomandimi është zbatuar

2.1 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA, pas identifikimit të nevojave konkrete nga ana e sektorëve/drejtorive/departamenteve për shërbime të caktuara, të marrë në konsideratë funksionet e punonjësve të institucionit me qëllim përfshirjen në kërkesat ndaj konsulentëve të sa më pak detyrave, kjo si për shfrytëzimin optimal të burimeve të saj njerëzore, ashtu edhe për të ulur kostot e fondeve të vëna në dispozicion të procedurave të prokurimit për këto shërbime.

2.2 Rekomandimi: Nga ana e Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratori i KESH sh.a, të merren masa për të shmangur përdorimin pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve që vijnë si rezultat i prokurimit të shërbimeve të pa studiuar mirë apo të shërbimeve prokurimi i të cilave nuk ka ardhur nga një domosdoshmëri konkrete por mbi të gjitha të atyre shërbimeve zbatimi i të cilave nuk garantohet paraprakisht nga ana e Aksionarit.

Në vijimësi

Komenti i subjektit: Shoqëria merr përsipër realizimin e rekomandimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces

3.1 Rekomandimi: Nga ana e Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorit të KESH SHA, të kërkohej në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për rishikimin e kontratës së lidhur sipas aktit me nr. 721/8 prot., datë 05.05.2020 me BOE “Si” & “Si” & “Si& IN”. Këto hapa duhet të merren me qëllim zvogëlimin e impaktit negativ të shpenzimeve të parashikuara nën këtë kontratë si rrjedhojë e prokurimit të këtij shërbimi.

Menjëherë dhe vazhdimësi

Komenti i subjektit: Shoqëria ka marrë përsipër realizimin e rekomandimit duke reflektuar atë edhe në minitenderin nr. 3 dhe të fundit për realizimin e këtij shërbimi.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces

4.1 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA, të merren masa për një monitorim efektiv të kontratave me qëllim arritjen e objektivave të kontratave për të cilat këto punë/mallra/shërbime janë prokuruar si dhe shmangien e efekteve negative siç është ai në shumën prej **44,840,000 lekë pa TVSh** për punime të kryera jo në mënyrë jo të efektshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Shoqëria ka marrë përsipër realizimin e rekomandimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces

5.1 Rekomandimi: Nga ana e Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratori i KESH Sh.A, të merren masa për të shmangur përdorimin pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve që vijnë si rezultat i prokurimit të shërbimeve me vlera fondesh të vëna në dispozicion të pa studiuar mirë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Shoqëria ka marrë përsipër realizimin e rekomandimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces

6.1 Rekomandimi: Organet drejtuese, Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë KESH SHA, të marrin masat e nevojshme për rregullimin e situatës ligjore në të cilën ndodhet shoqëria “T.V.” sha, si edhe përcaktimin e protokollit të konservimit të “T. V.” sha, me qëllim reduktimin dhe heqjen tërësisht të përdorimit pa efektivitet të shpenzimeve me vlerë **420,480 mijë lekë**.

Menjëherë

Komenti i subjektit: Nga ana e MIE është iniciuar procesi i vlersimit të asetit T. V., nëpërmjet memorandumit të bashkëpunimit lidhur me MIE dhe shoqërive Excelerate dhe Exxon mobil.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces

7.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës, Administratori i Shoqërisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të marrin masa për:

- Të kontraktuar një konsulent ligjor për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve ndërmjet shoqërisë KESH SHA dhe shoqërisë “E.” në lidhje me dëmshpërblimin e disbalancave të energjisë elektrike referuar Kontratës për Koordinimin e Kaskadës (CCA).
- Të rinegociuar marrëveshjen me shoqërinë “E.” me qëllimin e rikuperimit në vitet në vazhdim të vlerës prej të **222,016,320 lekë ose 1,748,160 euro**, si dhe shtimin e prodhimit të energjisë elektrike në Kaskadën e Drinit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Shoqëria ka marrë përsipër realizimin e rekomandimit duke dërguar materialin organeve subjekt në marrëdhëniet me koncensionarin.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces

8.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës, Administratori i Shoqërisë të kërkojnë rinegocim të kontratës së shitblerjes së energjisë mes KESH SHA dhe OSHEE sha, duke e lidhur atë në frymën e bashkëpunimit të mirë dhe brenda mundësive të secilës palë, për mënjanimin apo shmangien e situatave të tilla që cenojnë njërin apo tjetrin pale dhe shmangur penalitetet në vlerën **6,899,288 mijë lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Nga ana e shoqërisë do të synohet që në zbatim të kuadrit rregullator të negociohet parashikime kontraktore në frymën e rekomandimit të dhënë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces

9.1. Rekomandimi: Administratori KESH SHA në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë grup pune me specialistë të fushës (*sipas llojit të procedurës*), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve në përputhje me procedurën e zhvilluar, me synim rritjen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë, duke eliminuar praktikën e zhvillimit të procedurave me një OE, me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet.

Të bëhet argumentimi teknik për secilin kriter, duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve dhe dokumentacioni i argumentimit të kriterëve të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit.

9.2. Rekomandimi: Administratori KESH SHA në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të të gjitha kritereve të DST të miratuara nga AK, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publik me vlerë **1,347,062 mijë lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Shoqëria do të vazhdojë në vijimësi me ngritjen e grupeve të punës me specialist të fushës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces

10.1. Rekomandimi: Administratori KESH SHA, të ngrejë një grup punë dhe të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë e personave përkatës mbi mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël prej **2,966,420 lekë**, veprime të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve paefektivitet ekonomikitet dhe efikasë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Shoqëria pranon dhënien e masave disiplinore sipas rekomandimeve të dhëna.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

Rekomandimi është zbatuar

11.1 Rekomandimi: Shoqëria KESH SHA, të marrë masa duke ndjekur me përgjegjësi procedurat e zgjidhjeve të marrëdhënieve të punësimit me justifikimet përkatëse të dokumentuara dhe zbatimin e afateve ligjore për ndërprerjen e marrëdhënieve me punonjësit, si dhe të dalë përgjegjësi individuale e personave përgjegjës për zgjidhje padrejtësisht të kontratave të punës me punonjës, duke krijuar një efekt negativ në buxhet në vlerën **15,770,397 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Shoqëria ka marrë përsipër që të ndjekë procedurat për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës në përputhje me kuadrin ligjor rregullator.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces

12.1 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA, të marrë masa:

- Për të sanksionuar në kontratën e përgjithshme dhe individuale të punonjësve orarin zyrtar të pushimit për të cilin punonjësit do të paguhet për trajtim ushqimor dhe të evidentohet rastet kur nuk mund të përfitohet në respektim të dispozitave ligjore e nënligjore përkatëse.

- Që, shpërblimi për trajtimin ushqimor të korrigjohet në masën 300 lekë për një vakt në ditë, në përputhje me VKM-në përkatëse ose ta indeksojë dhe miratojë atë sipas normave të inflacionit çdo fillim viti.

- Për nxjerrjen e përgjegjësive dhe eliminimin e shkeljeve me pasojë efekte financiare negative në administrimin e fondeve nga KESH SHA, në vlerën **80,244,979 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Shoqëria ka marrë përsipër të zbatojë rekomandimin e lënë duke përcaktuar oraret e pushimit për ditë pune.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

Rekomandimi është i pazbatuar

13.1.Rekomandimi: Organet drejtuese të shoqërisë, Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori KESH SHA, të marrin masa që në të ardhmen, në lidhje me shpërblimet e personelit dhe të

Këshillit Mbikëqyrës, të vlerësojnë me rëndësi situatën ekonomike financiare, duke pasur aprovimin e rezultatit financiar dhe të shpërblimit nga asambleja e ortakëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Në vazhdimësi është mbajtur qëndrim lidhur me shpërblimin e fundvitit i cili është zbatuar në përputhje me përcaktimet e parashikimeve të nenit 114 të Kodit të Punës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar

Rekomandimi është i pazbatuar

C. TË ARDHURA TË MUNGUARA

1.1. Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA të merren masa për tregtimin e energjisë elektrike për qëllim optimizimi financiar dhe energjetik. Në rastet e shkëmbimit të energjisë elektrike e cila bëhet e domosdoshme, të respektohen përfitimet e ndërsjella, duke shkëmbyer energjinë në të njëjtat kushte sinë dhënie dhe në marrje.

1.2. Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA të analizohet situata e shkëmbimit të energjisë elektrike me Shoqërinë “N E”, duke argumentuar arsyet e dhënies së energjisë elektrike në periudhë piku, ku çmimi në bursa është i lartë dhe marrjen e saj në fashë orare ku çmimi në bursa është i ulët. Në raste të shkëmbimit të energjisë elektrike duhet të respektohet parimi i leverdshmërisë financiare dhe energjetike, duke shkëmbyer energjinë elektrike në kushte të njëjta si në dhënie dhe në marrje, duke i dhënë prioritet optimizimi dhe jo shkëmbimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i subjektit: Shoqëria ka marrë përsipër realizimin e rekomandimit në përputhje me aktet rregullatorë të sistemit dhe dinamikat e prodhimit dhe kontratave që duhet të përmbushë, bazuar në VKM nr. 620/2021, e ndryshuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces

2.1. Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë KESH SHA, të merren të gjitha masat administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit të faturave të shitjes së energjisë elektrike në shumën **2,288,338.9 Euro** ndaj kompanisë “N. B.”, si dhe të llogarisë kamatëvonesat deri në momentin e arkëtimit të plotë të vlerës.

Menjëherë

2.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë KESH sh.a, në të ardhmen të mos marrë angazhimeve në shitje të energjisë elektrike në shoqëri të cilat garantojnë pagesën e energjisë së shitur, si dhe përpara lidhjes së kontratës për shitje energjie të kërkojë dhe bllokojë garanci bankare nëvlerën e faturës së shitjes, në rast mos likuidimi të faturave në vijim.

Nëvijimësi

Komenti i subjektit: Shoqëria ka marrë përsipër realizimin e rekomandimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces

D. MASA ADMINISTRATIVE

F/1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pikën 2.5 faqe 69-217 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenet 23- *Kompetencat e Agjencisë së Prokurimit Publik* dhe 132- *Kundërvajtjet administrative*, ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”

dhe nenet 15 shkronja (c, ç) dhe 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për 26 (njëzetegjashtë) punonjësve dhe ish-punonjësve, si më poshtë:

1. **Z. A. H**, me funksion ish- Administrator KESH SHA, në cilësinë e Titullarit të AK.
2. **Z. B. D** me funksion ish- Drejtor i Prokurimeve.
3. **Znj. V. K**, me pozicion Drejtor në Drejtorinë e Prokurimeve..

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

Rekomandimi nuk është zbatuar

4. **Znj. A. R**, me funksion Shef Sektori në Drejtorinë e Prokurimeve..
-Me Urdhrin nr. 1555 prot., datë 17.03.2023 është urdhëruar vjelja e gjobës së vendosur nga APP në vlerën 200,000 lekë.
5. **Znj. K. H**, me funksion Teknik Specialist Ekspert në Drejtorinë e Prokurimeve..
-Me Urdhrin nr. 1556 prot., datë 17.03.2023 është urdhëruar vjelja e gjobës së vendosur nga APP në vlerën 200,000 lekë.
6. **Znj. Y. N**, me funksion Teknik Specialist Ekspert në Drejtorinë e Prokurimeve..
-Me Urdhrin nr. 1558 prot., datë 17.03.2023 është urdhëruar vjelja e gjobës së vendosur nga APP në vlerën 300,000 lekë.
7. **Znj. E. K**, me funksion Teknik Specialist Ekspert në Drejtorinë e Prokurimeve..
-Me Urdhrin nr. 1557 prot., datë 17.03.2023 është urdhëruar vjelja e gjobës së vendosur nga APP në vlerën 200,000 lekë.
8. **Z. Z. Sh**, me funksion TSE I Kualifikuar në Drejtorinë e Mirëmbajtjes..
-Me Urdhrin nr. 1551 prot., datë 17.03.2023 është urdhëruar vjelja e gjobës së vendosur nga APP në vlerën 150,000 lekë.
9. **Z. A. M**, me funksion Teknik Specialist Ekspert në Drejtorinë e Mirëmbajtjes..
-Me Urdhrin nr. 1548 prot., datë 17.03.2023 është urdhëruar vjelja e gjobës së vendosur nga APP në vlerën 120,000 lekë.
10. **Z. T. D**, me funksion Drejtor në Drejtorinë e Mirëmbajtjes..
-Me Urdhrin nr. 1550 prot., datë 17.03.2023 është urdhëruar vjelja e gjobës së vendosur nga APP në vlerën 160,000 lekë.
11. **Znj. E. M**, me funksion ish- Shef Sektori në Sektori i Planifikimit dhe Ankandeve..
-Me Urdhrin nr. 1549 prot., datë 17.03.2023 është urdhëruar vjelja e gjobës së vendosur nga APP në vlerën 130,000 lekë.
12. **Z. J. K**, me funksion Drejtor Drejtorie, Departament në DKZH..
-Me Urdhrin nr. 1564 prot., datë 17.03.2023 është urdhëruar vjelja e gjobës së vendosur nga APP në vlerën 80,000 lekë.
13. **Z. E. K**, me funksion Drejtor Drejtorie në Departament, DSD..
-Me Urdhrin nr. 1554 prot., datë 17.03.2023 është urdhëruar vjelja e gjobës së vendosur nga APP në vlerën 120,000 lekë.
14. **Z. A. H**, me funksion Shef i Sektorit të e Planifikimit dhe Ankandeve/ Drejtoria e Prokurimit..
15. **Z. B. K**, me funksion Teknik Specialist Ekspert, Sektori i Administrimit të Kontratave..
-Me Urdhrin nr. 1546 prot., datë 17.03.2023 është urdhëruar vjelja e gjobës së vendosur nga APP në vlerën 150,000 lekë.
16. **Znj. A. K**, me funksion Shef Sektori, Sektori i Përgjegjshmërisë Social-Mjedisore..
17. **Z. R. Gj**, me funksion Shef Sektori, Sektori i Zhvillimit të Biznesit dhe Raportimit..
-Me Urdhrin nr. 1568 prot., datë 17.03.2023 është urdhëruar vjelja e gjobës së vendosur nga APP në vlerën 80,000 lekë.

- 18. Z. M. M,** me funksion Shef Sektori, Sektori i Sistemit Mekanik..
- 19. Z. R. P,** me funksion Teknik Specialist, Sektori i Sistemit Mekanik..
-Me Urdhrin nr. 1449 prot., datë 16.03.2023 është urdhëruar vjelja e gjobës së vendosur nga APP në vlerën 90,000 lekë.
- 20. Z. E. Q,** me funksion Teknik Specialist, Sektori i Monitorimit të Sigurisë së Digave..
-Me Urdhrin nr. 1560 prot., datë 17.03.2023 është urdhëruar vjelja e gjobës së vendosur nga APP në vlerën 200,000 lekë.
- 21. Znj. E. Z (M),** me funksion Teknik Specialist Ekspert, Sektori i Sistemit Elektrik..
-Me Urdhrin nr. 1562 prot., datë 17.03.2023 është urdhëruar vjelja e gjobës së vendosur nga APP në vlerën 60,000 lekë.
- 22. Z. I. Sh ,** me funksion TSE i Kualifikuar, Sektori Shërbimeve të Mirëmbajtjes së Digave..
-Me Urdhrin nr. 1559 prot., datë 17.03.2023 është urdhëruar vjelja e gjobës së vendosur nga APP në vlerën 170,000 lekë.
- 23. Znj. A. Q,** me funksion TSE I Kualifikuar, Sektori i Administrimit të Kontratave..
-Me Urdhrin nr. 1553 prot., datë 17.03.2023 është urdhëruar vjelja e gjobës së vendosur nga APP në vlerën 120,000 lekë.
- 24. Z. F. H,** me funksion Teknik Specialist, Sektori i Sistemit Mekanik..
-Me Urdhrin nr. 1561 prot., datë 17.03.2023 është urdhëruar vjelja e gjobës së vendosur nga APP në vlerën 110,000 lekë.
- 25. Z. P. D,** me funksion Shef Sektori i Magazinimit Dhe Logjistikës/ Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme.
- 26. Z. H. D,** me funksion specialist TSE i Kualifikuar në Sektorin e Shërbimit të Mirëmbajtjes së Digave/ Departamenti i Sigurisë së Digave/Divizioni i Gjenerimit..

E. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar dhe neni 7 të kontratave individuale, si dhe rregullores së brendshme të institucionit, **i rekomandojmë Administratori KESH SHA,** të marrë masat disiplinore “Vërejtje” deri në “Zgjidhjen e kontratës së punës”, sipas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për **21 (njëzetënjë)** punonjësit e mëposhtëm për:

1. Z. B. K, në cilësinë e ish-Administratorit të KESH.

Me Urdhrin nr.2245 prot., datë 05.05.2023 është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” për z. B. K.

Rekomandimi është Zbatuar

2. Znj. R. Ll, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Operacioneve Tregtare.

Me Urdhrin nr.2246 prot., datë 05.05.2023 është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” për znj. R. Ll.

Rekomandimi është Zbatuar

3. Z. A. N, Kryetar me funksion Teknik Specialist Ekspert, Sektori i Administrimit Aseteve, në cilësinë e anëtarit të NJPBV, ngritur me urdhrin nr.1 datë 16.01.2020.

Me Urdhrin nr.2251 prot., datë 05.05.2023 është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” për z. A.N.

Rekomandimi është Zbatuar

4. Z. F. D, me funksion Teknik Specialist Ekspert, Sektori i Protokollit dhe Arkivës, në cilësinë e anëtarit të NJPBV, ngritur me urdhrin nr.1 datë 16.01.2020.

Me Urdhrin nr.2250 prot., datë 05.05.2023 është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” për z. F. D.

Rekomandimi është Zbatuar

5. **Znj. M. H**, me funksion Teknik Specialist, Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, në cilësinë e anëtarit të NJPBV, ngritur me urdhrin nr.1 datë 16.01.2020 dhe urdhrin nr.1 datë 08.01.2019.

6. **Z. G. B**, me funksion Shef Sektori, Sektori i Shërbimeve të Transportit, në cilësinë e anëtarit të NJPBV, ngritur me urdhrin nr.1 datë 08.01.2019.

7. **Z. P.** Ime funksion TSE i Kualifikuar, Sektori i Çështjeve Administrative, në cilësinë e anëtarit të NJPBV, ngritur me urdhrin nr.1 datë 09.01.2018.

Me Urdhrin nr.2247 prot., datë 05.05.2023 është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” për z. P. I.

Rekomandimi është Zbatuar

8. **Znj. A. R**, me funksion Shef Sektori në Drejtorinë e Prokurimeve.

9. **Znj. Y. N**, me funksion Teknik Specialist Ekspert në Drejtorinë e Prokurimeve.

10. **Z. L. B**, me funksion Shef Sektori në Sektori i Monitorimit të Sigurisë së Digave.

11. **Z. B. B**, me funksion Drejtor Departamenti në DZHS.

12. **Z. K. M**, me funksion Shef Sektori, Sektori i Çështjeve Rregullatore.

13. **Z. A. Y**, me funksion Teknik Specialist Ekspert, Sektori i Kontroll-Vlerësimit të Transaksioneve dhe Raportimit.

14. **Znj. A. M**, me funksion TSE i Kualifikuar, Sektori i Çështjeve Rregullatore.

15. **Znj. F. K**, me funksion Drejtor në Drejtorinë Ekonomike.

Me Urdhrin nr.2249 prot., datë 05.05.2023 është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” për z. F. K.

Rekomandimi është Zbatuar

16. **Z. E. K**, me funksion Drejtor Drejtorie në Departament, DSD.

17. **Z. R. P**, me funksion Teknik Specialist, Sektori i Sistemit Mekanik.

18. **Znj.B. H**, Shef i Sektorit të Financës në Departamentin Ekonomik..

Me Urdhrin nr.2248 prot., datë 05.05.2023 është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” për znj. B. H.

Rekomandimi është Zbatuar

19. **Z. A. V**, me funksion TSE i kualifikuar në Sektorin e Sistemit Elektrik/Drejtoria e Mirëmbajtjes /Departamenti i Gjenerimit/Qendër.

20. **Z. L. M**, me funksion Drejtori I Drejtorisë së Mirëmbajtjes/Departamenti i Gjenerimit..

21. **Z. A. Sh**, me pozicion Specialist.

ANEKSI 2.

Struktura Organizative

Për sa i përket strukturës organizative të Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH SHA) konstatohet se kjo strukturë është ndryshuar, si më poshtë:

-Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë nr. 7, datë 11.03.2021 për “Emërimin e Administratorit të shoqërisë KESH SHA”, është pranuar dorëheqja e administratorit të shoqërisë z. B. B dhe është emëruar në këtë detyrë z. B. K.

-Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë nr. 9, datë 26.05.2021 për “Emërimin e Administratorit të shoqërisë KESH SHA”, është pranuar dorëheqja e administratorit të shoqërisë z. B. K dhe është emëruar në këtë detyrë z. E. V.

-Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë nr. 10, datë 04.06.2021 për “Miratimin e strukturës organizative të KESH SHA”, është miratuar organigrama e re dhe numri i punonjësve në total 765 për këtë shoqëri.

-Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë nr. 18, datë 09.12.2022 për “Miratimin e strukturës organizative të KESH SHA”, është miratuar organigrama e re dhe numri i punonjësve në total 729 për këtë shoqëri.

Tabela nr. 1: Numri i punonjësve për periudhën objekt auditimi

KESH SHA	Punonjës të përhershëm		Punonjës me kontratë		Punonjës të përhershëm		Punonjës me kontratë	
	Viti 2021		Viti 2021		Viti 2022		Viti 2022	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
	765	741	0	0	765	736	0	0

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike, përpunoi grupi i auditimit.

-Marrëdhëniet e punës janë të rregulluara me kontratën kolektive nr. 2399 prot., datë 23.05.2019 midis KESH SHA të përfaqësuar nga Administratori B. B dhe Federatës Sindikale të Punonjësve të Industrisë të Shqipërisë (FSPISH) të përfaqësuar nga T. K, për një periudhë tre vjeçare.

Sa më sipër rezulton se kontrata kolektive nuk është rinovuar në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar ,neni 176, pika 1: “Organizatet sindikale dhe organizatat e punëdhënësve janë organizata shoqërore të pavarura, që krijohen si bashkime vullnetare të punëmarrësve ose punëdhënësve, qëllimi i të cilave është përfaqësimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe interesave ekonomikë, profesionalë dhe shoqërorë të anëtarëve të tyre.”

- Nga auditimi konstatohet se, niveli i pagave është përcaktuar me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës nr. 09, datë 17.10.2019 për “Miratimin e dokumentacionit të unifikuar të klasifikimit dhe trajtimit të punonjësve të KESH SHA”.

Niveli i shkallëve në këtë vendim është bërë në 6 grupe nga 1 më i ulëti te 4 më i larti, por në këtë klasifikim nuk janë përcaktuar kriteret që i diferencojnë qartë këto shkallë. Sa më sipër nuk ka kriteret të përcaktuara qartë dhe praktika e krijuar ka qenë klasifikimi nga 1 , si shkalla me e ulët në 6, si shkalla më e lartë, duke ju lenë në dorë drejtuesve në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore (duke ruajtur fondin e pagave), sipas aftësive dhe përgjegjësisë, detyrave dhe shkalles së vështirësisë në kryerjen e tyre, si dhe volumit të punës që punonjësit kanë.

Tabela nr. 2:Të dhëna përmbledhëse për treguesit e punës për periudhën objekt auditimi

Nr	Emërtimi	Viti 2021		Viti 2022	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Nr mesatar i punonjësve	765	741	765	736
2	Paga mesatare (lekë)	87,507	85,047	87,505	85,883
3	Fondi I pagave	803,314	755,815	803,314	758,518

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike, përpunoi grupi i auditimit.

-Sipas programit ekonomik për vitin **2021**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 765 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2020 është realizuar 741, pra 24 punonjës më pak. Fondi i pagave është 83,314 mijë lekë, pra realizimi është 47,799 mijë lekë më pak se programi.

-Sipas programit ekonomik për vitin **2022**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 765 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2022 është realizuar 736, pra 29 punonjës më pak. Fondi i pagave është 803,314 mijë lekë, pra realizimi është 44,796 mijë lekë më pak se programi.

Sa më sipër konstatohet se numri i punonjësve të miratuar nga Këshilli Mbikqyrës, dhe i parashikuar në programin ekonomik të shoqërisë nuk është realizuar. Pra, nuk janë parashikuar saktë nevojat e shoqërisë për punonjës.

Procedura e Rekrutimit të Punonjësve

Referuar dokumentacionit të administruar, për periudhën objekt auditimi konstatohet se:

-Është miratuar me nr. 892 prot, datë 17.02.2022 Manuali “Për funksionimin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore”.

-Nuk është bërë për asnjë rast shpallja e vendeve vakante dhe as intervistimi apo testimi i kandidatëve.

-Për mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve për punë, nga Burimet Njerëzore, pranë KESH SHA nuk ka asnjë informacion apo gjurmë si janë kryer këto procedura.

Po ashtu procedura e ndjekur gjatë kësaj përzgjedhje nuk është e qartë dhe transparente, sepse nuk ka të dokumentuar asnjë nga hapat që duhet të ndiqen për rekrutimin e punonjësve të rinj.

Masat Disiplinore

Nga auditimi konstatohet se gjatë periudhës objekt auditimi në total janë dhënë 110 masa disiplinore, në KESH SHA, mëposhtme nga këto 96 “Vërejtje”, 13 masa “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, 1 masë “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna dhe kalim në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët” dhe 0 masa “Pushim nga puna”.

Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se nuk ka procedura transparente, dhe nuk ka komision apelimi.

Tabela nr.3: Evidencat e masave disiplinore

Nr		Vërejtje	Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna	Kalim në një detyrë të një niveli apo klasë më të ulët	Pushim nga puna
1	KESH SHA	96	13	1	0

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, përpunoi grupi i auditimit.

Plotësimi i listë pagesave nga punonjësi i caktuar për pagat, si dhe mbështetja në të dhënat e dokumentacionit bazë (listë prezencë e firmosur nga menaxheri i strukturës përkatëse) për shërbimin e kryer. Kontrolli dhe nënshkrimi nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij.

Nga auditimi në tërësi të listë pagesave për periudhën e përcaktuar në program, rezultoi se shuma e përgjithshme e listë pagesave është e njëjtë me urdhër xhirimin e përgatitur për këtë qëllim. Përmbledhëset e listë pagesës në çdo rast janë të nënshkruara nga eprori direkt dhe drejtori i departamenti etj. Listë pagesat janë të shoqëruara me listë prezencat përkatëse për çdo drejtori. Listë pagesat paraqesin nga paga bruto, shtesat, ndalesat deri në pagën neto.

Në procedurën e pagesës hartohet listë prezencë dhe nënshkruhet nga drejtorët e drejtorive më pas hartohet listë pagesa mbi bazën e klasifikimit të pagave, shtesa për pozicione të veçanta pune të cilat janë të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës, duke kryer llogaritjet për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore plotësohet listë-pagesa përkatëse dhe dërgohet në bankë për pagesë.

Janë kryer ndalesat për tatimin e të ardhurave personale nga punësimi sipas përcaktimeve në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe janë paguar brenda datës 20 të muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa.

Është përllogaritur, ndalur dhe derdhur në organet tatimore kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mbi bazën e pagës minimale dhe maksimale si dhe përqindjeve përkatëse punëdhënës e punëmarrës sipas VKM nr. 1114, datë 30.7.2008 i ndryshuar “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11. 5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligji nr. 9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe ligji nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 26, datë 16.4.2009 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” i ndryshuar, dhe pas hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 457, datë 09.07.2014, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1114, datë 30.7.2008, të këshillit të ministrave, “Për disa çështje në zbatim të

ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërorë në republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërorë dhe shëndetësorë në republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr. 10383, datë 24.2.2011, “për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Afatet e deklarimit dhe pagesës së kontributeve janë në varësi të statusit të personit që detyrohet të paguajë kontributet dhe përcaktohen në nenet 10 dhe 11 të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërorë dhe shëndetësorë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i përcaktuar jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës. Pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi, si dhe kontributeve të sigurimeve shoqërorë dhe shëndetësorë në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, është sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 4: Të dhëna përmbledhëse për detyrimet nga marrëdhëniet e punës për periudhën objekt auditimi

Nr	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
1	Fondi i pagave gjithsej	755,815	758,518
2	Detyrimi për tatimin mbi të ardhurat personale	111,011	99,566
3	Gjoha të paguara për pagesë të vonuar	0	0
4	Interesa të paguar për pagesë të vonuar	0	0
5	Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	151,241	153,683
6	Gjoha të paguara për pagesë të vonuar	0	0
7	Interesa të paguar për pagesë të vonuar	0	0

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike, përpunoi grupi i auditimit.

-Janë audituar me zgjedhje listë-pagesat e periudhës objekt auditimi: (janar 2021 – 2022, shkurt 2021 – 2022, mars 2021 – 2022, prill 2021 – 2022, maj 2021 – 2022, gusht 2020 – 2021 – 2022, nëntor 2020 – 2021, dhjetor 2020 - 2021) nga të cilat rezultojnë se janë hartuar në rregull dhe nuk ka probleme me llogaritjen e ndalesave të tatimit mbi të ardhurat personale dhe kontributet e sigurimeve shoqërorë. Detyrimet janë derdhur pranë institucioneve përkatëse dhe institucioni nuk është penalizuar me gjoha apo interesa të paguara për pagesë të vonuar.

-Nga auditimi i dokumentacionit të listë pagesave për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022 rezultoi se; me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. Nr. 68, datë 7.02.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, pika 2, germa a), kjo dietë është caktuar deri në masën 300 lekë në vakt/ditë pune. Nga ana e Administratorit të Shoqërisë, Drejtorisë Juridike, Drejtorisë së Burimeve njerëzore nuk janë marrë masat për reflektimin e ndryshimeve ligjore për caktimin e dietës ushqimorë në përputhje me legjislacionin e sipërpërmendur, dhe paga në natyrë (dieta) për trajtim ushqimor është paguar në masën 500 lekë vakt/ditë pune. Ky fenomen është konstatuar edhe nga auditimet e mëparshme të KLSH për të cilin janë dhënë rekomandimet përkatëse të cilat përsëri konstatohet se nuk janë bërë reflektimet e duhura për përditësimin e legjislacionit dhe ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive. Nga llogaritja e listëpagesave të periudhës 01.01.2021 - 31.12.2022 rezultojnë se ky përfitim është në masën 170,018,888 lekë, nga 102,011,333 lekë që duhej të ishte pra është paguar më tepër shuma prej **68,007,555 lekë** e cila konsiderohet **efekti financiar negativ** për buxhetin e shoqërisë.

Përshkrimi i procedurave për orët jashtë kohës normale të punës:

Punonjësi i cili ka për të kryer një detyrë (extra), që kërkon angazhimin e tij përtej orarit të punës, 24 orë para plotëson formularin e orëve jashtë orarit, i cili firmoset nga eprori direkt dhe Drejtori i Departamentit.

Specialisti i Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme mbledh listeprezencat me formularët e orëve jashtë orarit të Rajoneve që ai ndjek dhe bën verifikimin e saktësisë së tyre.

Pas kontrollit të dokumentacionit dhe rakordimit të formularëve me listeprezencën e orëve jashtë orarit (kopjet origjinale të firmosura nga eprorët përkates), orët për çdo punonjës hidhen në sistemin e pagave, të ndara në ditë feste, të diela dhe orët normale.

-Përlllogaritja për orët shtesë të punës që punëdhënësi duhet t'i paguajë punëmarresit është shtesa prej 25% mbi pagën normale.

Orët shtesë të punës të kryera gjatë pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare kompensohen me një shtesë prej 50% mbi pagë normale.

Tabela nr.5: Të dhëna mbi orët e punës jashtë orarit për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022

KESH SHA	Orë jashtë orari		Vlera ALL	
	Ditë Normale	Ditë Feste	Ditë Normale	Ditë Feste
2021	3,880	4,245	1,585,599	2,885,004
2022	3,113	3,825	1,387,222	3,170,771
Totali	6,993	8,070	2,972,821	6,055,775

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike, përpunoi grupi i auditimit

Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin e fondit të veçantë, dhënien e shpërblimeve për rezultatet në punë, ndihma për fatkeqësi, për nevojat kulturore, etj.

Nga auditimi, konstatohet se fondi i shpërblimeve përdoret sipas nevojave të cilat dalin në pah në varësi të nevojave të ndryshme në periudhën objekt auditimi.

Tabela nr. 6 Të dhëna përmblledhëse për përdorimin e fondit të veçantë për periudhën objekt auditimi

Nr	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022
1	Fondi i veçantë	0	0
2	Shpërblime për rezultate në punë	0	0
3	Shpërblime për fund viti	61,402	13,960
4	Shpërblime sëmundje	0	0
5	Për largime nga puna	0	0
6	Për raste fatkeqësie/lindje	18,578	19,258
7	Për dalje në pension	26,873	28,690

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike, përpunoi grupi i auditimit.

-Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të KESH SHA nr. 6 prot, datë 26.02.2021 “Për dhënien e shpërblimit për disa punonjës të KESH SHA, pas periudhës të gatishmërisë dhjetor 2020 – shkurt 2021”, është miratuar dhënia e shpërblimit në masën 50,000 (pesëdhjetë mijë) Lekë, për disa punonjës të KESH SHA, në strukturat, si më poshtë:

- punonjës të Departamentit të Gjenerimit,
- punonjës të Drejtorisë së Operacioneve Tregtare.

Duke qenë se shoqëria nuk ka një analizë të realizimit të objektivave, vlera **3,300,000 lekë**, e akorduar për këtë shpërblim, konsiderohet **efektit financiar negativ** për buxhetin e shoqërisë. Sa më sipër bie në kundërshtim me nenin 32 të Kontratës Kolektive “Për një kategori të caktuar punonjësish, Administratori mund të japë shpërblime shtesë (deri në dy paga mujore në vit) në përputhje me realizimin e objektivave të ngarkuara”.

-Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të KESH SHA nr. 6295 prot, datë 29.12.2021 “Për dhënien e një shpërblimi të veçantë mbi pagë në fund të vitit për punonjësit e KESH SHA”, janë dhënë shpërblime me vlerën 61,402 mijë lekë.

Duke qenë se shoqëria nuk ka një analizë të realizimit të objektivave, vlera **61,402 mijë lekë** konsiderohet **efektit financiar negativ** për buxhetin e shoqërisë.

Sa më sipër bie në kundërshtim me nenin 32 të Kontratës Kolektive “Për një kategori të caktuar punonjësish, Administratori mund të japë shpërblime shtesë (deri në dy paga mujore në vit) në përputhje me realizimin e objektivave të ngarkuara”.

Proceset Gjyqësore për Ndërprerjen e paligjshme të marrëdhënie të punës

-Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 81 çështje gjyqësore në apel, nga ku janë humbur 3 çështje gjyqësore në Gjykatat e Shkallës të Lartë dhe në Gjykatat e Apelit, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **2,375,484 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbartimore. Për periudhën objekt auditimi, janë në proces gjykimi 7 çështje gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, në vlerën **1,810,437 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbartimore. Në total, vlera **4,185,921 lekë**, konsiderohet **efekt financiar negativ** për buxhetin e shoqërisë.

Aneksi 3. Procedurat e prokurimit të realizuara për periudhën nga data 01.01.2021 deri me datë 31.12.2022.

Prokurimet e realizuara 2021					
Nr	Objekti i prokurimit	Viti	Fondi Limit i Investimit	Vlera e Kontratës pa TVSH	Vlera e Kontratës me TVSH
1	Ndërtimi i dhe instalimi i impiantit fotovoltai në digën e Qyrasit në Hec Vau Dejës.	2021	470,718,785	468,004,500	561,605,400
2	Riparimi i kushinetës drejtuese të poshtme dhe boshitit të turbinës së AG 4 në proces rehabilitimi.	2021	39,409,989	38,580,000	46,296,000
3	Pjese rezerve për sistemet e rregullimit AVR GE ALSPA për Hec Vau Dejës dhe Hec Fierzë përfshirë testimin në një agregat Hec Vau Dejës.	2021	199,126,000	197,727,000	237,272,400
4	Mbikëqyrje Punimesh Për nevojat e KESH sh.a.	2021	30,000,000	30,000,000	36,000,000
5	Kolaudimi i Punimeve për nevojat e KESH sh.a.	2021	5,000,000	5,000,000	6,000,000
6	Mirëmbajtje 3 vjeçare e sistemit ekzistues hidrometeorologjik, zëvendësimi i pjesëve të dëmtuara më të reja, komisionimi dhe kolaudimi i tyre në vend.	2021	18,000,000	17,998,192	21,597,830
7	Blerje furnizim dhe vendosje e karikuesve elektrik për karikimin e automjeteve me teknologji elektrike hibride në pikat e Kesh Sha.	2021	29,961,000	29,065,420	34,878,504
8	Rehabilitimi i ndërtesës së centralit në Hec Koman	2021	127,000,000	123,864,161	143,194,853
9	Mbrojtja e kullave të ekuilibrit nga çarja e shkëmbinjve mbi to dhe sistemit i rrëshqitjeve e koluvioneve mbi rrugën e digës.	2021	369,639,401	329,790,596	395,748,715.20
10	Furnizim i dy transformatorëve të thatë me fuqi S=500kva tension 13.8/0.4kv për nevojat vetjake të aggregateve në Hec Koman.	2021	11,950,000	8,500,000	10,200,000
11	FV elemente bateri stacionare për dy salla 48V dhe për një salle 220VDC për HEC Fierzë.	2021	18,500,000	14,400,000	17,280,000
12	Monitorimi gjeodezik të digave të kaskadës së lumit Drin dhe për masivet e paqëndrueshëm gjeologjik pranë tyre.	2021	5,000,000	4,600,000	5,520,000

13	Blerje pjese elektrike dhe elektronike dhe pjese mekanike dhe matëse kontrolluese për njësinë e prodhimit Hec Koman.	2021	120,000,000	116,479,598	139,775,518
14	Ndërhyrje për mirëmbajtjen e sistemeve CO2 ne HEC Fierzë dhe Koman.	2021	60,000,000	57,750,000	69,300,000
15	Rinovimi i sistemit te mbrojtjes për dy agregate me vendosje/konfigurim te releve të reja që zëvendësojnë ato ekzistuese REG RET ne Hec Fierzë.	2021	75,000,000	73,500,000	88,200,000
16	Riparimi i rrjedhjeve te materialit bituminoz te AG4, riparimi i galerisë kuote 156MMND dhe i sallës së baterive Hec Fierzë.	2021	66,150,748	64,708,907	77,650,688
17	Mirëmbajtje 3 vjeçare e sistemit te kontroll monitorimit DCS SCADA dhe sistemeve elektrike te Hidrocentralit, trajnim i avancuar ne fabrike për sistemin e kontrollit 250SCALA & SICA AK1703 dhe për sistemet elektrike HEC Koman.	2021	148,333,000	145,363,000	174,435,600
18	Riparimi i dëmtimeve te turbinave te AG 1 dhe AG 3 Hec Fierzë si dhe rehabilitimi i dëmtimeve te turbinave te 5 agregateve ne Hec Vau Dejës.	2021	49,806,888	49,797,878	59,757,454
19	Blerje mjet lundrues për pastrimin e biefit të sipërm nga akumulimet e materialeve dhe mbetjeve urbane për Hec Fierzë.	2021	30,000,000	29,400,000	35,280,000
20	Rehabilitimi elektromekanik i vincit 2x10 Ton ne Bjefin e poshtëm në Hec Fierzë.	2021	27,000,000	26,932,500	32,319,000
21	Projektimi i urës se re Hec Fierzë në biefin e poshtëm.	2021	35,452,872	29,375,000	35,250,000
22	Instalimi/zgjerimi i sistemit te alarmit ne digat e kaskadës se lumit Drin Faza II.	2021	150,000,000	147,281,100	176,737,320
23	Shërbime për përgatitjen e projekteve për ndërhyrjet në njësitë e prodhimit HEC Fierzë, HEC Koman, HEC Vau Dejës.	2021	50,000,000	49,000,000	58,800,000
24	Sistemi i parashikimit satelitor të motit për operimin dhe menaxhimin e kaskadës ne kuadër të sigurisë së digave, faza I.	2021	88,900,000	85,038,000	102,045,600
25	Auditimi i pasqyrave financiare për vitet 2020,2021,2022.	2021	22,890,000	21,788,900	26,146,680
26	Prime sigurimi për automjete	2021	2,400,000	2,397,474	
27	Shërbim dhe mirëmbajtje e sistemit fiskalizimit si dhe një zgjidhje softëerike për lëshimin dhe pranimin e faturës elektronike dhe fiskalizimin e lëshimit të faturës.	2021	3,000,000	2,824,000	3,388,800
28	Kolaudim dhe rimbushje fikës zjarri.	2021	7,384,500	7,177,500	8,613,000
29	Blerje e 55.000 litra lende djegëse, karburant, lloji Benzine UNL 10 PPM për automjetet e Kesh Sh.a.	2021	8,094,050	8,085,000	9,702,000
30	Blerje riparim dhe mirëmbajtje ashensorësh pranë spitalit rajonal Shkodër.	2021	5,500,000	5,470,000	6,564,000
31	Sigurim asetesh.	2021	200,116,168	197,888,460	
32	Mirëmbajtje, riparim i sistemeve impiantistike ngrohje, ftohje, ventilim furnizim me uje MNZSH ne ndërtesat e Hec V.Dejes, Koman, Fierzë për vitet 2021-2023.	2021	85,789,867	81,675,007	98,010,008
33	Shërbimi i enkriptimit të komunikimit. Siguria kibernetike në infrastrukturë kritike.	2021	45,000,000	42,986,880	51,584,256
			2,605,123,268	2,512,449,073	
Realizimi i prokurimeve për vitin 2022					
Nr.	Objekti	Viti	Fondi limit	Vlerë kontrate pa TVSH	Vlerë kontrate me TVSH

1	Prime sigurimi mjete motorike te KESH sh.a .	2022	3,060,737	2,900,000	
2	Menaxhimi financiar, testimi i zhvlerësimit dhe IFRS9.	2022	2,952,000	2,950,000	3,540,000
3	Shërbim mirëmbajtje, rinovim i licencave ekzistuese për pajisjet e infrastrukturës IT.	2022	19,800,000	18,912,000	22,694,400
4	Shërbim për implementimin e standardit ISO 27001 ne sistemet TIK te KESH sh.a.	2022	2,270,000	2,250,000	2,700,000
5	Blerje artikuj higjieno-sanitar për KESH sh.a.	2022	4,829,160	4,187,585	5,025,102
6	Mirëmbajtje dhe suport për pajisjet e rrjetit të transmetimit të të dhënave dhe atyre të sigurisë.	2022	18,000,000	17,267,700	20,721,240
7	Krijimi i programit te menaxhimit te aktivitetit te operimeve tregtare.	2022	198,000,000	173,500,000	208,200,000
8	Demontimi i vinçit 100/5 Ton në veprën e marrjes HEC Vau Dejës.	2022	20,000,000	19,800,071.75	23,760,086
9	Blerje 40,000 Lt vaj hidraulik T-68 për kushinetat e 4 hidroagregateve ne HEC Fierzë.	2022	31,148,000	26,600,000	31,920,000
10	Përmirësimi i versionit të sistemit sofëare të sistemit SCALA 250, sistemit operativ dhe hardëare për DCS SCADA në HEC Koman.	2022	224,000,000	223,500,000	268,200,000
11	Furnizim vendosje i komponentëve plotësues për sistemin satelitor të parashikimit meteorologjik, Faza II.	2022	150,000,000	148,990,000	178,788,000
12	Blerje lëndë djegëse, lloji naftë dhe benzinë për nevojat e KESH sh.a.	2022	56,716,667	56,716,667	68,060,000
13	F.V dhe instalim i infrastrukturës server të konvergjuar me teknologji virtualizimi.	2022	40,000,000	38,383,643	46,060,372
14	Blerje artikuj kancelarie dhe materiale informatike për KESH sh.a.	2022	6,591,000	6,147,644.37	7,377,173
15	Blerje dy elektropompa thellësie dhe tre elektropompa drenazhi rezervë për HEC Fierzë dhe HEC Vau Dejës, fv kompresor i presionit të lartë të ajrit për HEC Vau Dejës dhe pjesëve rezervë për dy kompresorët ekzistues.	2022	52,000,000	51,200,000	61,440,000
16	Ndërtimi i infrastrukturës së aksesimit dhe ankorimit për operimin e asetit gjenerues termik, në portin e peshkimit Triport-Vlorë.	2022	280,000,000	257,200,000	308,640,000
17	Monitorimi treguesve mjedisorë në tre Njësitë prodhuese nën administrimin e KESH sh.a.	2022	6,350,000	5,799,900	6,959,880
18	Sistemi i sigurisë kibernetike faza II.	2022	44,000,000	42,310,000	50,772,000
19	Monitorimi gjeodezik i digave te kaskadës së lumit Drin dhe masivëve të paqëndrueshëm gjeologjik pranë tyre.	2022	6,900,000	6,800,000	8,160,000
20	Studimi i menaxhimit te emergjencave dhe kontrollit te sigurime se digave.	2022	10,000,000	9,250,000	11,100,000
21	Sistemi i DMS dhe arkivës teknike.	2022	43,820,000	41,960,000	50,352,000
22	Pajisje dhe pjesë rezervë për mirëmbajtjen e agregateve e pajisjeve të centralit HEC Vau Dejës.	2022	59,000,000	58,294,600	69,953,520
23	Pajisje dhe pjesë rezervë elektrike, elektronike, mekanike dhe matëse kontrolluese për mirëmbajtjen e agregateve e pajisjeve të centralit HEC Koman.	2022	60,000,000	59,613,700	71,536,440
24	Pajisje dhe pjesë rezervë për mirëmbajtjen e agregateve e pajisjeve të centralit HEC Fierzë.	2022	60,000,000	59,695,700	71,634,840
25	Implementimi i sistemit te monitorimit te infrastrukturave IT ne KESH sh.a dhe lëvrimi i licensave softëare.	2022	11,000,000	10,066,204	12,079,445
			1,410,437,564	1,344,295,415	

Aneksi 4.

Në zbatim të pikës 6 të programit të auditimit “**Nr. 407/1 Prot, datë 05/06/2023**”, i ndryshuar, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1)Kontratat e qiramarrjes.
- 2)Kontratat e qiradhënies.

Në periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2021-31.12.2022 Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a, ka realizuar katër kontrata qiraje, si më poshtë:

- Marrja me qira për qëllim parkimi të automjeteve, e truallit me sipërfaqe 360 m² në oborrin përpara selisë qendrore të KESH sh.a.
- Marrja me qira për qëllim ambient për zyrë në qytetin e Shkodrës, me sipërfaqe 60 m²
- Dhënia me qira për arsye të instalimit të antenës telefonike “V” sh.a me sipërfaqe 20 m².
- Dhënia me qira për arsye shërbimi ndaj punonjësve të HEC Fierzë të objektit “*mensë*” me sipërfaqe 79 m².

Procedura e zakonshme që ndiqet për marrjen me qira të një ambienteve:

1. Hartohet kërkesa e argumentuar me shkrim drejtuar Administratorit nga Drejtoria përkatëse e cila ka nevojë për ambientin që do të merret me qira.
2. Mbi bazën e kërkesës, Administratori nxjerr Urdhër për ngritjen e Grupit të Punës, për vlerësimin e kërkesës dhe procedurën që duhet të ndjekë grupi i punës, lidhur me këtë kërkesë.
3. Grupi i Punës përgatit shkresën për Administratorin, ku përcaktohen kërkesat dhe kushtet që duhet të plotësojë ambienti që do merret me qira si dhe përcakton kriteret e vlerësimit me pikë të plotësimit të kushteve dhe kriterëve të përcaktuara të mësipërm që duhet të plotësohen nga operatorët ekonomikë.
4. Grupi i punës përgatit relacionin për administratorin për vlerësimin e nevojës për të marrë me qira një ambient për nevojat e KESH SHA, ku bëhet argumentimi dhe vlerësimi i kërkesës dhe procedurës që do të ndjekë grupi i punës.
5. Në web-in online të KESH SHA, nga Kryetari i Grupit të Punës lajmërohen të gjithë Operatorët Ekonomikë të cilët zhvillojnë aktivitetin e tyre në fushën e kërkuar, duke dërguar ftesë për ofertë /shprehje interesi bashkëlidhur shkresa e Administratorit të KESH SHA me kërkesat dhe kushtet që duhet të plotësojë ambienti që do merret dhe kriteret e vlerësimit me pikë të plotësimit të kushteve dhe kriterëve të përcaktuara, që duhet të plotësohen nga operatorët ekonomikë.
6. Grupi i punës, administron e dokumentacionit online dhe atij të sjellë dorazi në protokollin e KESH SHA, Bën verifikimin në QKB të Operatoreve Ekonomikë pjesëmarrës, mbi statusin e tyre juridik dhe tatimor. Ftesës për Ofertë iu përgjigjen dhe shprehën interes këta Operatorë Ekonomikë.
7. Grupi i punës mbi bazën e dokumentacionit të negocimit dhe vlerësimit të ofertave të paraqitura nga Operatorët Ekonomikë, dhe pas verifikimit në vend (fizik) të gjithë ambienteve të ofertuar në zbatim të shkresës së Administratorit, ku përcaktohen kërkesat dhe kushtet, që duhet të plotësojë ambienti, i cili do merret me qira, Grupi i punës përpilon Formularët e Vlerësimit të Ofertave dhe përcakton ofertën më të mirë dhe pikët më të larta. Mbi bazën e dokumentacionit të negocimit dhe vlerësimit të ofertave të paraqitura nga Operatorët Ekonomik dhe mbas verifikimit në vend (fizik) të gjithë ambienteve të ofertuar. Grupi i punës përpilon Formularin e Vlerësimit të Ofertës për Operatorë Ekonomik pjesëmarrës dhe përzgjedh ofertën më të mirë dhe pikët më të larta bazuar në kriteret e miratuara.

8. Grupi i punës harton procesverbalin e shpalljes së fituesit, ku fitues shpallet operatori ekonomik i cili plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara në shkresën e Administratorit ka ofertën më të mirë dhe pikët më të larta. dhe ofron çmimin më të ulët. Mbas plotësimit të Formularit të Vlerësimit të Ofertës përpilohet Procesverbali i Shpalljes së Fituesit me shkresën përkatëse.
9. Grupi i punës përpilon Relacionin përmbledhës së procedurës së ndjekur nga grupi i punës dhe ja dërgon për njohje Administratorit.
10. Mbi bazën e dokumentacionit të mësipërm procedohet në përpilimin dhe nënshkrimin e kontratës së qirasë të lidhur ndërmjet përfaqësuesit të KESH SHA dhe përfaqësuesit të Operatorit Ekonomik.
11. Pas nënshkrimit të kontratës, grupi i punës procedon me përpilimin e procesverbal të marrjes në dorëzim të ambientit të marrë me qira, bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në kontratën e qirasë.
12. Për zbatimin e kontratës është caktuar ndjekësi i saj i cili është pjesë përbërëse e Drejtorisë përkatëse që ka bërë kërkesën. Ndjekësi i kontratës dhe Drejtoria përkatëse që ka bërë kërkesën monitoron ndjekjen e kontratës dhe bashkëpunon me Drejtorinë Ekonomike, në zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve që parashikon kontrata. Një kopje e kontratës i dërgohet për administrim Drejtorisë Ekonomike, e cila mbi bazën e shkresës për miratim pagese të përpiluar nga ndjekësi i kontratës dhe Drejtoria përkatëse bën ekzekutimin e pagesës së qirasë dhe tatimit mbi qiranë në bankë.

1. Kontrata e qirasë së oborrit që shërben si parkim i automjeteve të KESH SHA, bëhet fjalë për pasurinë 3/237, ZK 8270, Volumi 38, Faqe 53, Truall me sipërfaqe 360 m², me pronar G. A.

Marrja me qira për arsye parkimi e truallit në oborrin përpara selisë qendrore të KESH SH.A. Me kontratën nr.5624 prot., datë 24.11.2009 është marrë me qira nga subjekt privat truall kufitar me numër pasurie 3/226 e ndodhur në zonën kadastrale 8260 dhe me sipërfaqe prej 360 m².

Ky truall është vendosur në pjesën e oborrit përpara selisë së shoqërisë. Kjo kontratë është rinovuar çdo vit nëpërmjet 11 amendamenteve, në të cilat është përcaktuar jo vetëm zgjatja e afatit të kontratës, por edhe ndryshimi i çmimit.

Në Amendamentin nr. 11 me nr. 408/2 prot., datë 17.02.2023 çmimi është vendosur 85,000 lekë nga 75,000 lekë që ishte vendosur një vit më pare.

Kjo kontratë është përpiluar nga viti 2009 e në vazhdim me të drejtë ripërtëritje, çdo vit.

Në këtë kontratë mundësia e përzgjedhjes së qiradhënësit nga KESH SHA, dhe zbatimi i procedurave ligjore ka qenë e pamundur, për arsye se:

1. Kjo pasuri ndodhet ngjitur me Ndërtesën e Aparatit Qendror të KESH SHA dhe përdorimi i saj nga Pronari z. G A si parkim privat automjeteve, do të sillte shumë konfuzion dhe problematike në zhvillimin normal të aktivitetit administrativ të KESH SHA.
2. KESH SHA mbi këtë pasuri ka bërë investime me vlerë ekonomike në rregullimin e saj dhe përshtatjen e saj, për të shërbyer si ambient për parkim automjeteve.
3. Kjo pasuri i plotëson të gjithë kushtet e favorshme për parkim automjeteve dhe siguron shpejtësinë e shërbimit dhe mundësinë e kontrollit dhe të ruajtjes fizike të automjeteve pa shpenzime shtesë.
4. Çmimi i qirasë fillimisht ka qenë i ulët, por për çdo vit qiradhënësi ka kërkuar rritjen e çmimit të qirasë, sidomos vitet e fundit dhe afati i kontratës është përcaktuar për 1 vit, kërkesë e cila është negociuar nga KESH SHA, sidomos çmimi, për të cilin kemi arritur marrëveshje, ndërsa afati i kontratës ka qenë i pa negociueshëm është kërkuar të përsëritet çdo vit.

5. Për zbatimin e kontratës është caktuar ndjekësi i saj i cili është pjesë përbërëse e Drejtorisë përkatëse që ka bërë kërkesën. Ndjekësi i kontratës dhe Drejtoria përkatëse që ka bërë kërkesën monitoron ndjekjen e kontratës dhe bashkëpunon me Drejtorinë Ekonomike në zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve që parashikon kontrata. Një kopje e kontratës i dërgohet për administrim Drejtorisë Ekonomike, e cila mbi bazën e shkresës për miratim pagese të përpiluar nga ndjekësi i kontratës dhe Drejtoria përkatëse bën ekzekutimin e pagesës së qirasë dhe tatimit mbi qiranë në bankë.

Në kundërshtim me nenin 11, pika 11.1, paragrafi V I, të Statutit të shoqërisë KESH SH. A, kjo kontratë qiraje nuk ka marrë aprovimin e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë.

2. Kontrata e qirasë së ambientit i cili ndodhet në katin e dytë të ndërtimit me sipërfaqe totale 60m² me adresë Lagja Vasil Shanto, Rruga Pedonales, qyteti Shkodër. Bëhet fjalë për pasurinë nr. 4/509-N-12, ZK 8593, Volumi 38, me pronar A. S.

Marrja me qira ambienti me qëllim përdorimin për zyra të shoqërisë KESH sh.a në qytetin e Shkodrës.

Me kontratën nr.3751/7 prot., datë 11.12.2020 është marrë me qira nga subjekt privat të ambientit i cili ndodhet në katin e dytë të ndërtimit me sipërfaqe totale 60 m² me adresë Lagja Vasil Shanto, Rruga Pedonales, qyteti Shkodër, me një qira mujore në vlerën 580 Euro me TVSH dhe 493 Euro pa TVSH.

Kjo kontratë është rinovuar me amendamentin nr. 5874/2., datë 20.12.2021 në të cilin është përcaktuar vetëm zgjatja e afatit të kontratës dhe jo ndryshimi i çmimit të përcaktuar në kontratën fillestare.

Pasqyra nr.1 Qiramarrja në aparatin qendror të KESH SHA

Viti	Nr. kontratave të qirave	Vlera totale kontratës ne EURO	Vlera në EURO për 2021-2022	Vlera e kontratave për 2021-2022 (1)	Shuma e paguar (2)	Diferenca (2-1)
Janar - Dhjetor 2021	G. A amendim 10 Nr.662/3 dt.05.04.21		-	900,000	900,000	-
	Zyra Shkoder Kon3751/7dt.11.12.2020	6,960	-	724,709	724,709	-
Janar - Dhjetor 2022	G. A amendim 10 Nr.662/3 dt.05.04.21		-	780,000	780,000	-
	Zyra Shkoder Amend 1.Kon 5874/7dt.06.12.2021	6,960	-	701,065	701,065	-
Totali		13,920	-	3,105,774	3,105,774	-

Burimi: Drejtoria Ekonomike, përpunoi grupi i auditimit

3. Dhënia me qira për arsye shërbimi ndaj punonjësve të HEC Fierzë të objektit “mensë” me sipërfaqe 79 m².

Kontrata e qerasë midis Njesisë Prodhuese HEC Fierzë dhe subjektit privat, me nr.23 prot., date 10.01.2018, rinovuar nr.23 datë 10.01.2020, rinovuar, është lidhur për shërbimin ndaj punonjësve të Njesisë Prodhuese Fierzë. Kjo kontratë është lidhur mbi bazën e V.K.M nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" me çmimin 3950 lekë/muaj pa TVSH dhe 4740 lekë me TVSH.

Nga evidenca kontabël e klientit, për periudhën objekt auditimi është konstatuar pagesë e rregullt e qirasë dhe se qiramarrësi nuk ka detyrime.

Në kundërshtim me germën b), pika 1. kapitulli II i V.K.M nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" kontrata e qirasë, nuk ka marrë miratimin e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë.

4. Dhënia me qira e sipërfaqes prej 20m2 pranë TEC Vlorë për "V" sh.a.

Është nënshkruar kontrata me nr. 5326/2 prot., datë 25.01.2022 midis "V" sh.a dhe KESH sh.a. Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia me qira e sipërfaqes prej 20m2 me qëllim instalimin dhe funksionimin e një stacioni të transmetimit të telefonisë celulare. Kjo kontratë është lidhur mbi bazën e V.K.M nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" me çmimin 37500 lekë/muaj.

Nga evidenca kontabël e klientit, për periudhën objekt auditimi është konstatuar pagesë e rregullt e qirasë dhe se qiramarrësi nuk ka detyrime.

Pasqyra nr.2: Qiradhënia Hec Fierze dhe Tec Vlorë.

Viti	Nr. kontratave të qirave	Vlera totale kontratës në EURO	Vlera në EURO për 2021-2022	Vlera e kontratave për 2021-2022 (1)	Shuma e arkëtuar (2)	Diferenca (2-1)
Janar - Dhjetor 2021	-	-	-	-	-	-
	A. P (Mensa Fierze)			95,217	95,217	-
Janar - Dhjetor 2022	"V" Kon5326/2 dt.25.01.22	-	-	412,500	412,500	-
	A. P (Mensa Fierze)	-	-	95,217	95,217	-
Totali		-	-	602,934	602,934	-

Burimi: Drejtoria Ekonomike, përpunoi grupi i auditimit

Konkluzione:

-Nga auditimi i procedurave të qirave, rezulton se KESH SHA nuk ka ndjekur ndonjë procedurë të hapur apo me buletine në gazetatat kombëtare apo mediat e shkruara, për ofrimin e ambienteve sa më të përshtatshme dhe me çmim konkurrues, por është nisur dhe ka vazhduar procedurat me propozimet e ardhura nga njësitë respektive sipas rretheve, më tej ka ndjekur një procedurë negocimi çmimi, sipërfaqeje, kushtet e duhura, etj.

-Sa i takon negocimit, grupit të auditimit nuk i janë vendosur në dispozicion dokumente justifikuese. Po ashtu nuk ka rezultuar dokumentacion lidhur me personat përgjegjës për mbikëqyrjen e kontratave të qerasë.

-Lidhja e kontratave të qerasë sa më sipër rezulton të jetë kryer në kundërshtim me:

1. Germën b), pika 1. kapitulli II i V.K.M nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" ku përcaktohet që:

1. Institucioni shtetëror, ndërmarrja apo shoqëria shtetërore, që ka në administrim objektin që do të jepet me qira ose enfiteozë, për të gjitha rastet, përgati dokumentacionin si mëposhtë vijon:

b) vendimin e organit drejtues të institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore (Këshilli Mbikëqyrës, Këshilli Drejtues, Bordi Drejtuesetj.);

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1) Z. A. G, në cilësinë e Drejtorit në Drejtorinë e Shërbimeve.

Aneksi 5.

-Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.

Faktorët kryesorë të mjedisit të kontrollit, si një nga komponentët bazë të kontrollit të brendshëm në njësitë publike, përfshijnë integritetin, vlerat etike dhe aftësinë e stafit të shoqërisë; filozofinë e drejtimit; mënyrën e caktimit të përgjegjësi; vendimet dhe orientimet e bordit të menaxherëve.

Në Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë KESH sh.a me nr.03 datë 09.03.2018 “*Mbi Kodin e Etikës*”, është përcaktuar kuadri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit, i cili përfshin zotimin për të qenë korrekt dhe i ndershëm, respektimin e kuadrit ligjor dhe politikat e shoqërisë, shembullin personal, respektimin e autoritetit etj.

Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14 datë 25.11.2019 është miratuar strategjia “*Politikat e Burimeve Njerëzore*”, e cila parashikon, ndër të tjera, rregulla për planifikimin e burimeve njerëzore, marrëdhëniet e punësimit, rekrutimin, emërimin, trainimin dhe zhvillimin, shpërblimin dhe motivimin e stafit, vlerësimin e performancës.

-Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë nr. 10, datë 04.06.2021 për “Miratimin e strukturës organizative të KESH SHA”, është miratuar organigrama e re dhe numri i punonjësve në total 765 për këtë shoqëri.

-Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë nr. 18, datë 09.12.2022 për “Miratimin e strukturës organizative të KESH SHA”, është miratuar organigrama e re dhe numri i punonjësve në total 729 për këtë shoqëri.

Rekrutimi i punonjësve të shoqërisë, referuar dokumentit të politikave të burimeve njerëzore të shoqërisë, është parashikuar të kryhet në dy faza. Përgjatë procesit të planifikimit të burimeve njerëzore, pasi të jetë verifikuar pamundësia për të mbuluar vendet bosh nëpërmjet rekrutimit brenda shoqërisë, procedohet me gjetjen e personelit në tregun e jashtëm të punës.

Marrja në punë e personave nga jashtë kryhet nëpërmjet procesit të përzgjedhjes dhe përshtatjes së vendit të punës si edhe vlerësimin e kompetencës së arritur.

Me Vendimet nr. 02 datë 23.01.2018 dhe nr.04 datë 24.04.2019 janë miratuar në parim rregullat e përgjithshme të organizimit të aktivitetit tregtar, për tregun e liberalizuar. Gjithashtu, janë miratuar me Urdhrin nr.121 datë 06.12.2019 të Administratorit të shoqërisë KESH sh.a, edhe manualët e pjesëmarrjes, tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike.

Në zbatim të Urdhrit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, me Urdhrin nr. 47 datë 19.07.2018 të Administratorit, është miratuar Rregullorja “*Për menaxhimin e aktiveve*”.

Me Urdhrin nr. 53 datë 24.06.2019 të Administratorit është miratuar Rregullorja e Përdorimit të Internetit dhe Postës Elektronike.

Me Vendimin nr. 08 datë 17.10.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të KESH sh.a është miratuar ndryshimi strukturor i kësaj njësie, i cili e ka përfshirë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Riskut.

Në reflektim të strukturës dhe ndryshimeve të saj me Vendimet nr.03, datë 09.03.2018, si edhe nr. 01 datë 18.02.2020 të Këshillit Mbikëqyrës është miratuar Rregullorja e Përgjithshme e Punës me ndryshimet përkatëse.

-Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues janë të emëruar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*”, pra Nëpunësi Autorizues është Administratori i KESH SHA z. E. V, dhe Nëpunësi Zbatues është Drejtori i Automatizimit znj. K. G.

- “Deklarata e cilësisë” dhe Raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, e cili e ka afatin referuar nenit 18 të ligjit për MFK deri në fund të muajit Shkurt të vititpasardhës nuk është vendosur në dispozicion.

-Me urdhrin Nr. 60, datë 01.09.2020, nga Administratori i KESH SHA është miratuar Rregullorja e Menaxhimit të Riskut në KESH SHA, në të cilën janë përcaktuar dhe detyrat e Koordinatorit të Riskut dhe strukturave të tjera të menaxhimit të Riskut. Nga auditimi konstatohet se për periudhën objekt auditimi nuk është azhurnuar regjistri i riskut.

-Nga auditimi konstatohet se shoqëria KESH SHA nuk ka një plan afatmesëm për rishikimin e sistemeve të brendshme të kontrollit të të gjithë niveleve të njësisë publike dhe përgatitjen e gjurmëve të auditimit për procedurat specifike të njësisë, bazuar në kërkesat e Kreut III të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010.

-Sistemet e kontrollit janë monitoruar gjatë gjithë kohës nga Auditimi Brendshëm KESH SHA është në procesin e plotësimit të Rregullores së Përgjithshme me manualin e procedurave dhe një pjesë të gjurmëve të auditit.

-Me Urdhrin nr.12, datë 22.01.2020 të Administratorit të KESH SHA, është miratuar “Rregullorja për hetimin administrativ të sinjalizuesve dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në KESH sha si dhe Me Urdhrin Nr. 175, datë 25.11.2021 është miratuar Rregullorja “Për hetimin administrativ të sinjalizimit, të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në KESH SHA”, si dhe njësinë e cila funksionon dhe ka zhvilluar trajnime. Kjo njësi raporton rregullisht 1 herë në vit në ILDKPI.

-Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.1, datë 18.02.2020 “Për Miratimin e Ndryshimeve të Rregullores të Përgjithshme të Punës të KESH SHA”, ka miratuar ndryshimet e Rregullores së Përgjithshme të Punës në KESH sh.a., e përshtatur në përputhje me strukturën organizative të shoqërisë dhe parashikimet e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Nga auditimi konstatohet se rregullorja e përgjithshme nuk është azhurnuar me ndryshimet në strukturë dhe si e tillë përshkrimi i vendeve të punës dhe detyrat e secilit pozicion aktual nuk ka përputhshmëri me këtë strukturë.

-Në zbatim të Urdhrit Nr. 105, datë 04.04.2022 të Administratorit është ngritur dhe funksionon Grupi i Menaxhimit Strategjik.

-Në KESH sha, janë hartuar dhe miratuar, gjurmët e auditimit të proceseve kryesore në njësitë prodhuese, duke krijuar bazat në hartimin e një sistemi politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, që ndihmojnë në arritjen e objektivave të shoqërisë.

-Administratori informohet në mënyrë të vazhdueshme nga Drejtoria e Financës për gjendjen financiare të shoqërisë.

Sa sipër, ekziston komunikimi vertikal dhe horizontal në shoqëri.

➤ **Mbi Komitetin e Riskut dhe Auditimit**

-Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 13, datë 10.09.2020 për “Krijimin e Komitetit të Riskut dhe Auditimit të shoqërisë KESH SHA”, është krijuar ky komitet i përbërë nga: T. Xh (Kryetar), E. M (Anëtar) dhe L. P (Anëtar).

Referuar nenit 11, të Statutit të KESH SHA (miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit me vendim nr. 7854/1 prot, datë 18.10.2019), citohet se Këshilli Mbikëqyrës:

“11. 1(viii) nëpërmjet Komitetit të Riskut dhe Auditit dhe bashkërisht me Administratorin ka përgjegjësi për mbikëqyrjen e punës, si dhe vlerësimin e performancës së departamentit të Auditimit të Brendshëm të shoqërisë.”

“11. 5 Këshilli Mbikëqyrës krijon në përbërje të tij, Komitetin e Riskut dhe Auditit, si një organ i brendshëm i Këshillit me funksione këshilluese, i cili ndër të tjera, bashkërisht me Administratorin, ka përgjegjësinë për finalizimin e planit të auditimit si dhe përcaktimin e prioritetëve të departamentit të Auditimit të Brendshëm.”

Sa më sipër, konstatohet se Komiteti i Riskut dhe Auditit nuk është mbledhur, dhe për pasojë nuk është kryer asnjë nga funksionet e sipër përmendura.

Referuar nenit 12, të Statutit të KESH SHA (miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit me vendim nr. 7854/1 prot, datë 18.10.2019), citohet se:

“12.1 Komiteti i Riskut dhe Auditit krijohet me vendim të Këshillit Mbikëqyrës dhe përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës. Në çdo rast, Komiteti duhet të kryesohet nga një anëtar i pavarur dhe me kualifikim të përshtatshëm. Komiteti duhet të mbledhet jo më pak se 4 herë në vit.

12.2 Funksionet dhe përgjegjësitë e Komitetit të Riskut dhe Auditit përcaktohen në dokumentin e veçantë të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.”

Sa më sipër, konstatohet se nga ana e Këshillit Mbikëqyrës nuk është hartuar dokumenti i veçantë lidhur me funksionet dhe përgjegjësitë e Komitetit të Riskut dhe Auditit.

➤ **Mbi Auditin e Brendshëm**

-Drejtoria e Auditit të Brendshëm në shoqërinë KESH sh.a, është strukturë organizative e krijuar në zbatim të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

-Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 08, datë 17.10.2019, është bërë ndryshimi në strukturën e shoqërisë. Kjo drejtori ka kaluar në varësi të Këshillit Mbikëqyrës dhe se në përbërje të saj janë emëruar 6 specialistë dhe Drejtori i Drejtorisë, nga të cilët:

-6 specialistë (përfshirë Drejtori) 4 janë ekonomistë, 2 juristë dhe 1 inxhinier. janë të certifikuar “Audit të brendshëm të sektorit publik” dhe kanë ndjekur rregullisht trajnimet e detyrueshme të përditësuara në zbatim të shkronjës (d), të nenit 15 të Ligjit nr. 114/2015.

-Karta e Auditit të Brendshëm është hartuar nga drejtori i drejtorisë dhe miratuar nga Administratori me Urdhrin nr. 93, datë 02.10.2019. Për shkak të ndryshimeve në strukturë është rishikuar dhe miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me Vendim nr. 19, datë 17.12.2020. Është dërguar në MEF me shkresën nr. 727, datë 02.02.2021.

Për vitin 2021: -Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 17, datë 16.10.2020 për “Miratimin e planit strategjik dhe vjetor të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në KESH SHA”, është miratuar lista e aktiviteteve të auditimit.

-Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 17, datë 21.10.2021 për ndryshimin e vendimit nr. 17, datë 16.10.2021 për “Miratimin e planit strategjik dhe vjetor të drejtorisë së Auditit të Brendshëm në KESH SHA”, është hequr nga “Plani vjetor i auditimit për vitin 2021”, auditimi i administrimit të kontratave të operacioneve tregtare, pjesë e veprimtarisë funksionale të Operacioneve Tregtare, dhe është përfshirë në “Planin vjetor të auditimit për vitin 2021”, auditimi i sistemeve të përgjegjshmërisë sociale në KESH SHA.

Tabela nr.1: Auditime të planifikuara dhe të realizuara në vitin 2021

Nr.	Objekte për tu audituar	Lloji i auditimit Fusha e auditimit	Numri i auditimeve	
			Plan	Fakt
1	Sektori i Përgjegjshmërisë Social – Mjedisore	Auditim procedurash	1	1
2	Drejtoria e Automatizimit dhe TIK	Infrastruktura TIK dhe rrjeti DATA	1	1
3	Njësia e Menaxhimit të Projekteve për Sigurinë dhe Rehabilitimin e Digave	Zbatimi i kontratave	1	1
4	Drejtoria e Sigurisë së Digave	Sistemet thelbësore të procedurave	1	1
5	Drejtoria Ekonomike	Sistemet e procedurave në lidhje me detyrimet	1	1
6	HEC Vau i Dejës	Auditimi i aktivitetit	1	1
7	HEC Koman	Auditimi i aktivitetit	1	1
8	HEC Fierzë	Auditimi i aktivitetit	1	1
9	TEC Vlora SHA	Auditimi i aktivitetit	1	1

10	Auditim i procedurës të prokurimit me Nr. Ref 02220 – 08 – 03 – 2021	Auditim procedure prokurimi	1	1
	TOTALI		10	10

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Auditit të Brendshëm, përpunoi grupi i auditimit

Në total për vitin 2021 janë lënë 108 rekomandime, nga të cilat janë zbatuar 69 rekomandime, janë në proces zbatimi 26 rekomandime dhe të pazbatuara 13 rekomandime.

Për vitin 2022: Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 16, datë 21.10.2021 për “Miratimin e planit strategjik dhe vjetor të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në KESH SHA”, është miratuar lista e aktiviteteve të auditimit në përputhje me Planin Strategjik të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në KESH SHA për periudhën 2022 – 2024.

Nr.	Objekte për tu audituar	Lloji i auditimit Fusha e auditimit	Numri i auditimeve	
			Plan	Fakt
1	DP/ hartimi dhe menaxhimi i kontratave	I lartë	1	1
2	DSH/menaxhimi i fondeve për pandeminë	I mesëm	1	1
3	Njësia Prodhuese/HEC Vau i Dejës	I lartë	1	1
4	Njësia Prodhuese/HEC Fierzë	I lartë	1	1
5	Njësia Prodhuese/HEC Koman	I lartë	1	1
6	Verifikim i zbatimit të rekomandimeve të lëna gjatë vitit 2022	I lartë	1	1
7	TEC Vlora SHA	I lartë	1	1
8	DTE/Menaxhimi i operacioneve energjetike	I mesëm	1	1
9	DÇJR/Sektori i risqeve (shtyrë për një moment të dytë. Në vend të tij është kryer sërish verifikim i zbatimit të rekomandimeve të lëna gjatë vitit 2021)	I mesëm	1	1
	TOTALI		9	9

Lidhur me rekomandimet e lëna në periudhën objekt auditimi nuk janë vendosur të dhëna në dispozicion.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT